



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR i PLANIT TË DETAJUAR TË ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE (PDZRK) VJOSË-NARTË

RAPORTI PARAPRAK

	Qendra Kërkimore për Zhvillim Rural		
Datë	2/09/2021		

*Shënim mbi të drejtën e autorit:

Ky document mbrohet në n kuadrin ligjor: Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012.

Ligjin nr. 9380 datë 28.04.2005 si dhe ai i vitit 2016 me të njejtin emertim ligji "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", nëni 20 dhe 25 i këtij Ligji. si dhe kuadrin ligjor të ndryshuar së fundmi.

Ky ligj është hartuar në përputhje me direktivat e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të BE- së sa më poshtë : 1 Direktiva 2006/115 /EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 dhjetorit 2006 mbi të drejtën e shitjes dhe të drejtën e hua-qirasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale (versioni i kodifikuar); 2 Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 dhjetorit 2006 mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të (versioni i kodifikuar); 3 Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 29 prillit 2004 "Mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale"; 4 Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 majit 2001 "Mbi harmonizimin e disa aspekteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në shoqërinë e informacionit; 5 Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 shtatorit 2001 mbi të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti; 6 Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 marsit 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazës të të dhënave; 7 Direktiva 2009/24/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 prillit 2009 mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike (versioni i kodifikuar); 8 Direktiva 93/83/EEC mbi ritransmetimin kabllor dhe ritransmetimin satelitare; 9 Direktiva 2014/26/EU e organizatave të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me të.

TABLE E PËRMBAJTJES

<i>Table e Përmbajtjes</i>	3
<i>Lista e Tabelave</i>	10
<i>Lista e Figurave</i>	12
<i>Lista e Shkurtimeve</i>	16
KAPITULLI I: HYRJE	20
I.1 ÇFARË ËSHTË VSM	20
I.2 KUADRI LIGJOR I VSM-s	20
I.3 FAZAT KYÇ TË PROÇESIT TË VSM-ës	20
I.4 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE	22
I.4.1 Objektivat Synimet e VSM	23
I.4.2 Kërkesa për VSM dhe ekipi i saj	24
I.5 METODOLOGJIA E STUDIMIT	25
I.6 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR	26
I.7 Kuadri Ligjor	26
I.7.1 Rregulloret e Bashkimit Evropian	28
I.7.2 Konventat ndërkombëtare	30
I.8 LIDHJA ME POLITIKA DHE DOKUMENTE TË TJERË	32
KAPITULLI II: PLANI I DETAJUAR I ZONËS VJOSË - NARTË (SI PDZRK)	34
II.1 KUFIRI I PDZRK-së	34
II.2 TË DHËNA DHE KOMPONENTË TË PLANI I DETAJUAR I ZONËS VJOSË - NARTË (SI PDZRK)	34
II.3 PËRDORIMI I PROPOZUAR I TOKËS DHE NDARJA E NJËSIVE NË NËNNJËSI 35	
II.4 SISTEMET BAZË TË TERRITORIT	35
II.5 PËRDORIMI I TOKËS SIPAS NJËSIVE STRUKTURE	36
II.5.1 Infrastruktura Aeroportuale	36
II.5.2 Njësitë strukturore të sistemit bujqësor	38
II.5.3 Njësitë strukturore të sistemit natyror	39
II.5.4 Njësitë strukturore të sistemit urban dhe infrastrukturor	41
II.5.5 Njësitë strukturore të sistemit ujor	42
KAPITULLI III: ALTERNATIVA TË ZHVILLIMIT/SKENARËT	44

Skenari A: Skenari i ekzistues (asgjë ose zero)	44
Skenari B: Zhvillimi i turizmit elitar jashtë nën zonave të përdorimit të qëndrueshëm në Pajsazhin e mbrojtur (bregdeti i deltës së Vjosës ose pylli Sodës)	45
Skenari C: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i formave alternative të turizmit	45
III.1 VLERËSIMI I SKENAREVE	46
III.1.1 Skenari A: Skenari zero	46
III.1.2 Skenari B: (Skenari 2)	47
III.1.3 Skenari C: (skenari 3)	49
KAPITULLI IV: PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT	51
IV.1 STATUSI I ZONËS SË MBROJTUR	51
IV.1.1 Laguna e Nartës	51
IV.1.2 Pishë-Poro	52
IV.1.3 Kallenga	52
IV.1.4 Kodrat e Panajasë	52
IV.1.5 Kriporet	52
IV.1.6 Fusha e Akërnisë	52
IV.1.7 Zonimi	53
IV.1.8 Faktorët kërcënues të integritetit të Zonës së Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë	55
IV.2 MONUMENTET NATYRORE	60
IV.2.1 Ishull i Zvërnecit	60
IV.2.2 Dunat ranore	60
IV.2.3 Laguna Limopuo	61
IV.3 NDRYSHIMET KLIMATIKE	64
IV.4 TOKA	65
IV.4.1 Tipet dhe potencialet prodhuese të tokave	65
IV.5 SIZMICITETI	67
IV.5.1 Erozioni i tokës dhe Sedimentimi	69
IV.6 NDOTJA AKUSTIKE	71
IV.7 TRASHËGIMIA KULTURORE	74
IV.8 SISTEMI UJOR	77
IV.8.1 Karakteristikat ekologjike të Lagunës së Nartës dhe zonës përreth	77

IV.8.2	Ujërat sipërfaqësorë të embël	80
IV.8.3	Sistemi i ujitjes	80
IV.8.4	Ujërat nëntokësore në zonën e Vjosë-Nartë	80
IV.8.5	Sistemi i kullimit	83
IV.9	CILËSIA E UJRAVE TË LAGUNËS SË NARTËS	89
IV.9.1	Cilësia e ujërave të lagunës Nartë.....	89
IV.9.2	Cilësi e ujrave bregdetar të Nartë-Zvërnec.....	92
IV.10	SISTEMI I UJRAVE URBANE	93
IV.11	SISTEMI NATYROR	94
IV.12	BIODIVERSITETI, FLORA DHE FAUNA	94
IV.12.1	Vështrim i përgjithshëm i biodiversitetit në Shqipëri	94
IV.12.2	Kërcënimet e biodiversitetit.....	94
IV.12.3	Flora	95
IV.12.4	Fauna.....	112
IV.13	SËMUNDJET DHE DËMTUESIT E PYJEVE	124
IV.14	KLIMA	125
IV.14.1	Temperatura.....	125
IV.14.2	Reshjet.....	126
IV.14.3	Lagështia e ajrit.....	128
IV.14.4	Era dhe frekuenca e saj.....	128
IV.14.5	Temperatura e ujit.....	130
IV.14.6	Koha më e mirë e vitit për të vizituar.....	130
IV.14.7	Kushtet për zhvillimin e energjisë diellore.....	131
IV.14.8	Topografia	132
IV.15	CILËSIA E AJRIT	133
IV.15.1	Burime të ndotjes së ajrit	133
IV.15.2	Grimcat e ngurta në ajër (Particle Matter - PM ₁₀ dhe PM _{2.5})	133
IV.15.3	Ozoni O ₃	134
IV.15.4	Monoksidi i Karbonit CO.....	134
IV.15.5	Dioksidi i karbonit CO ₂	134
IV.15.6	Sulfatet-SO ₄	134

IV.15.7	Oksidet nitroze NOx.....	135
IV.15.8	Benzeni	135
IV.15.9	Indeksin European të Përcaktimit të Cilësisë së Ajrit.....	135
IV.16	SISTEMI BUJQËSOR.....	137
IV.17	EKONOMIA BUJQËSORE.....	139
IV.17.1	Peshkimi	142
IV.17.2	Turizmi	142
IV.18	SISTEMI INFRASTRUKTUROR	142
IV.18.1	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm.....	142
IV.19	MENAXHIMI I MBETJEVE DHE INFRASTRUKTURA MJEDISORE.....	146
IV.20	SISTEMI URBAN	150
IV.21	AKSESI DHE RREJTI I TRANSPORTIT	151
IV.22	ENERGJIA DHE TELEKOMUNIKACIONI.....	155
IV.23	DEMOGRAFIA DHE SHPERNDARJA HAPËSINORE E POPULLSISË.....	155
IV.24	EKONOMIA DHE PUNËSIMI.....	156
IV.24.1	Treguesit ekonomik	156
KAPITULLI V: OBJEKTIVAT E VSM DHE LIDHJA ME OBJEKTIVAT NDERKOMBETAR TË ZHVILLIMIT TË QENDRUESHEM		158
V.1	OBJEKTIVAT NDËRKOMBËTARE DHE TË BE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM	158
V.2	OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË NIVEL KOMBËTAR.....	159
V.2.1	Objektivat Kombëtarë të Mjedisit	159
V.2.2	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020	160
V.2.3	Objektivat Kombëtarë për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit	160
V.2.4	Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030	161
V.2.5	Objektivat Ndërkombëtare për Biodiversitetin dhe Mbrojtjen e Natyrës.....	162
V.2.6	Objektivat e BE-së për Biodiversitetin dhe Mbrojtjen e Natyrës.....	163
V.2.7	Objektivat Kombëtarë për Biodiversitetin dhe Mbrojtjen e Natyrës	163
V.2.8	Objektivat Ndërkombëtare për Mbetjet.....	164
V.2.9	Objektivat Kombëtarë për Mbetjet	165
V.2.10	Objektivat Ndërkombëtare për Planifikimin e Territorit	166

V.2.11	Objektivat e BE-së për Planifikimin e Territorit.....	166
V.2.12	Objektivat Kombëtare për Planifikimin e Territorit.....	166
V.2.13	Objektivat në Ndërkombëtar për tokën.....	167
V.2.14	Objektivat në BE për tokën.....	167
V.2.15	Objektivat Kombëtar për tokën.....	168
V.2.16	Objektivat në Ndërkombëtar për Ujin	168
V.2.17	Objektivat në BE për ujin	168
V.2.18	Objektivat Kombëtar për ujin.....	170
V.2.19	Objektivat Ndërkombëtare për Ndryshimet Klimatik	171
V.2.20	Objektivat e BE-së për Ndryshimet Klimatike.....	171
V.2.21	Objektivat Kombëtare për Ndryshimet Klimatike	172
V.2.22	Objektivat në Ndërkombëtar për Ajrin.....	172
V.2.23	Objektivat në BE për Ajrin.....	173
V.2.24	Objektivat në Ndërkombëtar për Zhurmat	174
V.2.25	Objektivat e BE-së për Zhurmat.....	175
KAPITULLI VI: VLERËSIM I EFEKTEVE TË PRITSHME mjedisore TË PLANIT TË PROPOZUAR DHE MASAT PËR PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE.....		178
VI.1	BAZA PËR PERGATITJEN E vlerëSIMIT MJEDISOR.....	178
VI.1.1	Percaktimi i Objektivave Mjedisore.....	178
VI.1.2	Detyrimet e Specifikuara në Konventat e Ratifikuara dhe në Direktivat Respektive të BE-se, si dhe në Dokumentat Strategjike tëShqipërisë.....	180
VI.1.3	Identifikimi i Ndikimeve Mjedisore.....	190
VI.2	METODIKA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	191
VI.2.1	Vlerësimi i Përputhshmërisë	191
VI.3	VLERËSIM I NDIKIMEVE MJEDISORË DHE UDHEZIMET PËR MASAT ZBUTËSE NË LIDHJE ME OM.....	197
VI.3.1	Toka.....	197
VI.3.2	Cilësia e ajrit.....	203
VI.3.3	Faktorët klimatikë	204
VI.3.4	Ruajtja e trupave ujorë.....	205
VI.3.5	Trajtimi i ujërave të zeza	209
VI.3.6	Mjedisi natyror	212

VI.3.7	Mbetjet	216
VI.3.8	Zhurmat.....	217
VI.3.9	Trashëgimia kulturore.....	218
VI.3.10	Peizazhi.....	219
VI.3.11	Popullsia dhe Ekonomia Lokale	220
VI.4	KRAHASIMI I PROJEKTEVE SPECIFIKE ME OBJEKTIVAT MJEDISORE....	222
VI.4.1	Vlerësimi i Impakteve Kumulative të Projekteve Strategjike	222
VI.5	VLERESIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE, MASAT ZBUTËSE DHE PËRMIRËSUESE	224
KAPITULLI VII: VLERËSIMI I SISTEMIT TË PLAN - MONITORIMIT		252
VII.1	VLERËSIM I PËRGJITHSHËM.....	252
VII.2	SISTEMI I MONITORIMIT	253
VII.2.1	Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit	254
VII.3	MONITORIMI DHE VLERËSIMI I CILËSISË SË UJIT, NORMAT E UJIT TË PIJSHËM	255
VII.3.1	Ndotja akustike	257
VII.3.2	Mbetjet dhe objektivat përkatëse	257
VII.3.3	Ujërat e ndotura.....	259
VII.3.4	Larmia Biologjike dhe zonat e mbrojtura	259
KAPITULLI VIII: PËRMBLEDHJE NË GJUHË JOTEKNIKE I RAPORTIT TË VSM-së.....		269
VIII.1.1	ÇFARË ËSHTË VSM.....	269
VIII.1.2	KUADRI LIGJOR I VSM-ës	269
VIII.1.3	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE	269
VIII.1.4	PËRDORIMI I TOKËS SIPAS NJËSIVE STRUKTURE	269
	Infrastruktura aeroportuale.....	269
VIII.1.5	NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT NATYROR.....	270
VIII.2	ALTERNATIVA TË ZHVILLIMIT/SKENARËT.....	270
VIII.3	PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT.....	270
VIII.4	VLERËSIM I EFEKTEVE TË PRITSHME mjedisore TË PLANIT TË PROPOZUAR DHE MASAT PËR PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE.....	271
Toka		271
Cilësia e ajrit		272

Faktorët klimatikë.....	272
Ruajtja e trupave ujorë	273
Trajtimi i ujërave të zeza.....	274
Mjedisi natyror	274
Mbetjet	275
Zhurmat	275
Popullsia dhe asetet materiale	276
Trashëgimia kulturore.....	276
Peizazhi	277
KAPITULLI IX: PËRMBLEDHJE NË GJUHË JOTEKNIKE I RAPORTIT TË VSM-SË.....	278
IX.1.1 ÇFARË ËSHTË VSM.....	278
IX.1.2 KUADRI LIGJOR I VSM-SË	278
IX.1.3 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE	278
IX.1.4 PËRDORIMI I TOKËS SIPAS NJËSIVE STRUKTURE	278
Infrastruktura aeroportuale.....	278
IX.1.5 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT BUJQËSOR	279
IX.1.6 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT NATYROR.....	279
IX.1.7 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT BUJQËSOR ME SHËRBIME AGROTURISTIKE	280
IX.1.8 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT URBAN DHE INFRASTRUKTUROR	280
IX.1.9 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT UJOR	281
IX.2 ALTERNATIVA TË ZHVILLIMIT/SKENARËT.....	283
IX.3 PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT.....	283
IX.4 VLERËSIM I EFEKTEVE TË PRITSHME MJEDISORË TË PLANIT TË PROPOZUAR DHE MASAT PËR PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE	283
Toka	283
Cilësia e ajrit	284
Faktorët klimatikë.....	285
Ruajtja e trupave ujorë	285
Trajtimi i ujërave të zeza.....	286
Mjedisi natyror	287

Mbetjet	288
Zhurmat	289
Popullsia dhe asetet materiale	289
Trashëgimia kulturore.....	290
Peizazhi	290
KAPITULLI X: PROCESI I KONSULTIMEVE.....	291
REFERENCA	303
ANEKS	308
1. <i>Pershkrimi i kritereve dhe metodologjise se vlerësimit për objektivat mjedisore.....</i>	308
2. LISTA FAUNISRIKE DHE FLORISTIKE E ZONËS NARTË-VJOSË.....	320
2.1 Lista e Specieve të Gjitareve në Zonën e Marrë në Studim.....	320
2.2 Lista e Shpendëve të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë Nartë, të cilët përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo habitatet bujqësore të braktisura apo të përdorura	321
2.3 Lista e Specieve të Amfibëve dhe Reptilëve në Zonën e Marrë në Studim	325
2.2. Lista e Specieve Bimore të rrezikuara në Zonën e Marrë në Studim.....	327
3. LISTA FLORISTIKE E ZONËS NARTË-VJOSË.....	328
 <i>Lista e Tabelave</i>	
Tabela I-1: Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtëra të punës në to.	21
Tabela I-2: Sipërfaqet dhe Subjektet që janë përfshirë në zhvillimin e zonës.....	24
Tabela I-3: Ligjet dhe Dokumentet e Politikave Kombëtare	26
Tabela I-4: Ligjet dhe Dokumentet e Politikave Kombëtare	27
Tabela I-5: Lista e direktivave të BE-së	29
Tabela I-6: Lista e Konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara/ratifikuar nga Shqipëria	30
Tabela II-1: Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor.....	38
Tabela II-2: Njësitë strukturore të Sistemit Natyror	39
Tabela II-3: Njësitë strukturore të sistemit natyror dhe shërbime ekoturistike	40
Tabela II-4: Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike	41
Tabela II-5: Njësitë strukturore të Sistemit Infrastrukturor	42
Tabela III-1: Vlerësimi i skenarit zero (skenari A)	46
Tabela III-2: Vlerësimi i skenarit dy (skenari B)	47
Tabela III-3: Vlerësimi i skenarit tre (skenari C).....	49

Tabela IV-1: Përdorimi i territorit në Zonën e Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë (MoE, 2004)	51
Tabela IV-2: Monitorimi i zhurmave të qytetit të Vlorës, sipas AKM [dB]	73
Tabela IV-3: Të dhënat e matjeve të monitoruar në dy faza si akuiferi i depozitimeve në 5 stacione dhe krahasimi i tyre me normat e BE dhe OBSH.	82
Tabela IV-4: Gjendja e sistemit të kanaleve kulluese në fshatrat e NJA Novoselë	83
Tabela IV-5: Të dhëna për makronutrientët, klorofilën dhe gjendjen trifike të lagunës së Nartës, krahasuar me Lagunat e tjera në Shqipëri.	91
Tabela IV-6: vlerësimi i presionit human dhe natyror mbi Lagunën e Nartës. Intensiteti i çdo lloji presioni u vlerësua duke përdorur një shkallë vlerash që varionin nga 0 në 4 (0 = mungon; 1 = shumë i ulët; 2 = i ulët; 3 = i moderuar; dhe 4 = i lartë) sipas një vlerësimi të ekspertëve bazuar në njohuritë ekzistuese siç raportohet në një raport TW Reference Net. A = ngarkesa organike; B = ngarkesa ushqyese; C = substanca të rrezikshme; D = peshkim; E = specie aliene; F = lundrimi; G = modifikim fizik; H = presion mesatar; Ia = presion neto. Të dhënat dhe vlerësimi në këtë tabelë janë nga Barbone et al. (2012), përveç të dhënave dhe vlerësimit të Lagunave Butrinti dhe Kune Vain.	91
Tabela IV-7: Vlerësimi i cilësisë së ujrave bregdetarë të larjes, në plazhet e monitoruara, sipas kategorive për vitin 2019	93
Tabela IV-8: Gjendjen e sistemit të ujrave të përdorura në fshatrat e NJA Novoselë	93
Tabela IV-9: Grupet kryesore të gjallesave shtazore të pranishme në sistemin ligatinor Vjosë-Nartë	113
Tabela IV-10: Lista e llojeve të peshqve të zonës bregdetare dhe Lagunës së Nartës	118
Tabela IV-11: Lista e llojeve të peshqve të zonës së grykëderdhjes dhe pjesës së poshtme të Lumit të Vjosës	121
Tabela IV-12: Përbërja faunës së gjitave të zonës Vjosë-Nartë	124
Tabela IV-13: Të dhënat mesatare 2019	135
Tabela IV-14: Pronësia e tokës sipas kategorive (Burimi: Njësia Administrative Novoselë)	138
Tabela IV-15: Prodhimi bujqësor në Njësia Administrative Novoselë (Burimi: NJA Novoselë)	139
Tabela IV-16: Shtrirja e sistemit arsimor sipas fshatrave dhe gjendja e tyre	140
Tabela IV-17: Burimi i të ardhurave sipas kategorive të prodhimit	141
Tabela IV-18: Sistemi i furnizimit të ujit të pijshëm në fshatrat e Njësia Administrative Novoselë (Burimi: NJA Novoselë)	145
Tabela IV-19: Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në fshatrat e NJA Novoselë (Burimi: NJA Novoselë)	148
Tabela IV-20: Ndarja e territorit sipas pesë sistemeve territoriale në NJA Novoselë (PPV i Bashkisë Vlorë, 2017)	151

Tabela IV-21: Statusi i banimit të banesës në Njësinë Administrative Novoselë (PPV i Bashkisë Vlorë, 2017)	151
Tabela IV-22: Infrastruktura rrugore dhe gjendja e saj në fshatrat e NJA Novoselë (Burimi: NJA Novoselë)	152
Tabela IV-23: Numri i banorëve të shpërndarë sipas familje, gjinisë dhe grup-moshave	156
Tabela IV-24: Treguesit social ekonomike në Shqipëri në vite	157
Tabela V-1: Rekomandimet sipas OBSH-së për zhurmën mjedisore nga aktivitete të ndryshme	174
Tabela V-2: Nivelet kufi të zhurmës për mjedisë të caktuara	176
Tabela VI-1: Për vlerësimin të nivelit të përputhshmërisë së objektivave	192
Tabela VI-2: Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore	193
Tabela VI-3: Simbolet e vlerësimit të Impakteve	223
Tabela VI-4: Ndikimi i Projektit të Aeroportit në Objektivat mjedisore	224
Tabela VI-5: Ndikimi i Projektit të Zonat bujqësore (që do të krijohen) në Objektivat mjedisore	229
Tabela VI-6: Ndikimi i Projektit në Zonat urbane Turistike	233
Tabela VI-7: Ndikimi i Projektit të Infrastrukturës rrugore (që do të krijohet) në Objektivat mjedisore	244
Tabela VII-1: Vlerat e kufi të ndotësve (burimi ISHP)	254
Tabela VII-2: Niveli i kufi i ndotësve të ajrit për tu monitoruar	254
Tabela VII-3: Treguesit fiziko-kimike të ujit të pijshëm dhe objektivat	256
Tabela VII-4: Treguesit mikrobiologjike të ujit të pijshëm dhe objektivat	257
Tabela VII-5: Objektivat, Indikatore & Synimet për VSM-në e Planit Vjosë-Nartë	260
Tabela VIII-1: Njësitë strukturore të konservimit dhe rehabilitimit mjedisor	270
Tabela IX-1: Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor	279
Tabela IX-2: Njësitë strukturore të Sistemit Natyror	279
Tabela IX-3: Njësitë strukturore të sistemit natyror dhe shërbime ekoturistike	279
Tabela IX-4: Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike	280
Tabela IX-5: Njësitë strukturore të Sistemit Infrastrukturor	281

Lista e Figurave

Figura I-1: Harta e kufizimeve të pronave, sipas subjekteve pronarë, që do të zhvillohen.	25
Figura II-1: Harta e Përdorimit të propozuar të tokës (sistemet bazë të territorit)	36
Figura II-2: Plani i vendosjes dhe të dhëna bazë të Aeroportit të Akërnisë, Vlorë	38
Figura IV-1: Harta e Zonimit të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë	54
Figura IV-2: Aktivitete cënuese të integritetit të ekosistemeve në Zonën e Mbrojtur	56

Figura IV-3: Zonat e dëmtuara nga djegjet.....	59
Figura IV-4: a. Pamje e dunave në zonën në afërsi të Lagunës së Kallëngës; b. Pamje në të njëjtin vend ku dunat janë cënuar si pasojë e ndërhyrjeve në këtë Lagunë.....	61
Figura IV-5: Harta e Monumente të Natyrës	63
Figura IV-6: Boniteti i Tokave	67
Figura IV-7: Fragmente të Hartës Sizmotektonike, shk. 1:200 000 për zonën e Vlorës	69
Figura IV-8: Niveli i zhurmave në stacionet e Vlorës gjatë ditës	72
Figura IV-9: Niveli i zhurmave në stacionet e Vlorës gjatë natës.....	72
Figura IV-10: Kisha e Manastirit të Zvërnecit (Burimi: IMK)	75
Figura IV-11: Monumentet arkeologjike dhe kulturore në zonën Vjosë-Nartë.....	76
Figura IV-12: Kisha Ngjallja në Novoselë (foto nga eksperit)	77
Figura IV-13: Harta e trupave uhor të zonës Vjosë-Nartë.....	79
Figura IV-14: Sistemi uhor sipërfaqësor në zonën në studim	81
Figura IV-15: Harta e gjendjes aktuale të kanaleve të kullimit dhe vendodhjes së hidrovoreve në raport me Planin.....	85
Figura IV-16: Kanal kullues në zonën në studim Kellënge-Godull	86
Figura IV-17: Portat hyrëse të hidrovorit të Akërnisë	87
Figura IV-18: Portat dalëse të hidrovorit të Akërnisë	87
Figura IV-19: Uji në dalje të hidrovorit të Akërnisë, në drejtim të Detit Adriatik	88
Figura IV-20: Portat dalëse të Hidrovorit të Goricës.....	88
Figura IV-21: Portat hyrëse të Hidrovorit të Goricës	89
Figura IV-22: Dalja në sipërfaqe e substratit argjilor në Veri të Lagunës së Kallëngës	96
Figura IV-23: Kriporja zë një sipërfaqe të rëndësishme nëpeizazhin e mbrojtur “Vjosë-Nartë”	97
Figura IV-24: Pjesa Veri-Lindore e Lagunës së Nartës	98
Figura IV-25: Laguna e Kallëngës dhe pjesa Veri-Perëndimore e saj	98
Figura IV-26: Lagunës e Nartës, Pjesa Jug-Perëndimore.....	99
Figura IV-27: Laguna e Nartës dhe bimësia tipike e tokave të kripura përreth mjediseve të ngritura të saj.	101
Figura IV-28: Habitat me kod 1410 - Livadhe të kripura mesdhetare (<i>Juncetalia maritimi</i>)	102
Figura IV-29: Shoqërimi bimor me <i>Arthrocnemum</i> sp. Div	102
Figura IV-30: Tipi i habitatit me kod 1420 ose Formacione shkurrëzash halofitike Mesdhetare dhe Termo-Atlantike (<i>Sarcocornetea fruticosi</i>), i vendosur midis grykderdhjes së Vjosës dhe Lagunës së Kallëngës. ..	104
Figura IV-31: Duna të ngritura, Shoqërimi bimor me <i>Ammophila arenaria</i>	105
Figura IV-32: Shoqërimi bimor me <i>Ammophila arenaria</i> në duna embrionale	106

Figura IV-33:Vegetacion artificial për gjatë bregdetit me Pishë të Halepos (Bimësi e pishnajës bregdetare)	107
Figura IV-34: Habitat i degraduar dhe i djegur me Pishë të Halepit, në Jug të Fshatit Delisufaj	108
Figura IV-35: Vegetacion artificial për gjatë bregdetit me Mimoze të artë (<i>Acacia cyanophylla</i>)	108
Figura IV-36: Shoqërim bimor me <i>Pinus halepense</i> – <i>Erianthus ravenae</i> (me pjesmarrje edhe të <i>Erica manipuliiflora</i>)	109
Figura IV-37:Shoqërimi bimor me <i>Phragmites australis</i> dhe bimësia përgjat shtratit të lumenjve	111
Figura IV-38: Biocenozat e dominuara nga <i>Lithophyllum byssoides</i> (Karaburun)	113
Figura IV-39: Habita sipas Mbulesë së tokës Corine dhe habitatet më të rëndësishme sipas NATURA	115
Figura IV-40: Lloje parruazorësh të pranishëm në zonën e studimit	116
Figura IV-41: Specie invertebroresh të pranishem në zonën e studimit	117
Figura IV-42: Struktura e përbërjes llojore mbi bazën e pranisë dhe statusi aktual sipas IUCNsë (Laguna Nartes dhe zona bregdetare)	120
Figura IV-43: Lloje peshqish të pranishem në Nartë	121
Figura IV-44: Struktura e përbërjes llojore mbi bazën e pranisë dhe statusi aktual sipas IUCNsë (rrjedha e poshtme Lumit Vjosë)	122
Figura IV-45: <i>Arnoglossus laterna</i> dhe <i>Anguilla anguilla</i>	123
Figura IV-46: Temperatura mesatare ditore e lartë (vija e kuqe) dhe e ulët (vija blu), me linjat e përqindjes 25 nga 75 dhe 10 deri 90. Vijat e holla me pika janë temperaturat përkatëse mesatare të perceptuara. Burimi:www. weatherspark.com	126
Figura IV-47: Temperatura mesatare për orë, ngjyra kodohet në breza. Mbulesat me hije tregojnë natën dhe muzgun civil	126
Figura IV-48: Përqindja e ditëve në të cilat vërehen lloje të ndryshme të reshjeve, duke përjashtuar sasitë e gjurmëve: vetëm shi, vetëm dëborë dhe të përziera (shiu dhe dëbora ranë në të njëjtën ditë)	127
Figura IV-49:Reshjet mesatare të reshjeve (vija e ngurtë) e akumuluar gjatë një periudhe 31-ditore rrëshqitëse të përqendruara në ditën në fjalë, me brezat e përqindjes 25 nga 75 dhe 10 deri në 90. Vija e hollë me pika është reshja mesatare përkatëse e borës së barasvlefshme me reshjet e shiut	127
Figura IV-50: Përqindja e kohës së kaluar në nivele të ndryshme komode lagështie, të kategorizuara sipas pikës së vesës	128
Figura IV-51: Mesatarja e shpejtësive mesatare të erës për orë (vija gri e errët), me brezat e përqindjes 25-të deri në 75-të dhe 10-të deri në 90-të	129
Figura IV-52: Përqindja e orëve në të cilat drejtimi mesatar i erës është nga secila prej katër drejtimeve kardinale të erës, duke përjashtuar orët në të cilat shpejtësia mesatare e erës është më pak se 1.6 kph. Zonat e ngjyrosura lehtë në kufij janë përqindja e orëve të kaluara në drejtimet e nënkuptuara të ndërmjetme (në verilindje, juglindje, jugperëndim dhe veriperëndim)	129

Figura IV-53: Temperatura mesatare ditore e ujit (vija e purpurt), me brezat e percentileve nga 25-të në 75-të dhe 10-të deri në 90-të.....	130
Figura IV-54: Rezultati i turizmit (zona e mbushur), dhe përbërësit e tij: rezultati i temperaturës (vija e kuqe), rezultati i mbulimit të reve (vija blu) dhe rezultati i reshjeve (vija jeshile).	131
Figura IV-55: Rezultati i plazhit / pishinës (zona e mbushur) dhe përbërësit e tij: rezultati i temperaturës (vija e kuqe), rezultati i mbulimit të reve (vija blu) dhe rezultati i reshjeve (vija jeshile).	131
Figura IV-56: Energjia diellore e valës së shkurtër mesatare ditore që arrin në tokë për metër katror (vija portokalli), me brezat e përqindjes nga 25-të deri në 75-të dhe 10-të deri në 90-të.	132
Figura IV-57: CAQI për zonën Novoselë – Vlorë	136
Figura IV-58: Vlerat e ICA për Vlorën dhe rrethinat, Burimi: https://air.plumelabs.com/air-quality-in-Vlor%C3%AB-dmej	137
Figura IV-59: Vlerat e ICA për Vlorën dhe rrethinat nga muaji Shtator 2020-Shkurt 2021, Burimi: https://air.plumelabs.com/air-quality-in-Vlor%C3%AB-dmej	137
Figura IV-60: Prodhimi bujqësor për vitin 2019, bashkia Vlorë	141
Figura IV-61: Stacionet e pompimit të ujit të pijshëm në NJA Novoselë (Burimi: ASIG)	143
Figura IV-62: Godina e shpërndarjes së ujit (foto nga eksperti)	144
Figura IV-63: Pompat në stacionin e shpërndarjes (foto nga eksperti)	144
Figura IV-64: Rrjeti i furnizimit me ujë të pishëm të propozuar (Burimi: PPV Vlorë).....	145
Figura IV-65: Vendndodhja e venddepozitimeve në Bashkinë e Vlorës.....	147
Figura IV-66: Mbetje të depozituara në mënyrë të paligjshme pranë Lumit Vjosa, në zonën A1 të zonës së mbrojtur (foto nga eksperti)	148
Figura IV-67: Vendndodhja e venddepozitimeve në zonën e mbrojtur Vjosë-Nartë dhe venddepozitimi i planifikuar në Sherishtë	149
Figura IV-68: Mbetje në zonën e Planit (foto nga eksperti).....	150
Figura IV-69: Infrastruktura rrugore për në Lagunën e Kellengës (drejtim perëndimor; foto nga eksperti)	152
Figura IV-70: Harta e infrastrukturës rrugore ekzistuese të NJA Novoselë (Burimi: Harta e rrjetit rrugor eksistues 11c)	153
Figura IV-72: Infrastruktura rrugore ekzistuese në zonën në studim	154
Figura IV-73: Infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike në Lagunën e Nartës (foto nga eksperti)	155
Figura V-1: Zonat për zhvillimin me përparësi të zhvillimit turistik në Shqipëri (Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: Strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2019-2023)	162
Figura VI-1: Humbja e biodiversitetit nga erozioni dhe intrusion i ujit të kripur detar	201

Figura VI-2: Harta e përmbajtjes së zonës së projektit në varësi të nivelit të ujit në urën e Mifolit	202
Figura VI-3: Harta e të dhënave të gropave septike aktuale dhe zgjidhja e planit për trajtimin e ujrave të zeza me impjanin pranë Aeroportit të Akërnisë	211

Lista e Shkurtimeve

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BB	Banka Boterore
BE	Bashkimi Evropian
BOD	Nevoja Biologjike për Oksigjen
BTEX	Kimikate të grupit të Benzene, Toluene, Ethylbenzene dhe Xylene
CFC	Kloro Fluoro Karbonet
CITES	Konventa mbi Tregtine Nderkombetare të Specieve të Rrezikuara të Flores dhe Faunes se Eger
COB	Nevoja Kimike për Oksigjen
COx	Oksidet e Karbonit
DRM	Drejtorinë Rajonale të Mjedisit
DRTK	Rajoni i Policisë dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
EC	Konduktiviteti/Përcjellshmëria Elektrike
GHG	Shkarkimet e gazeve serë
ha	hektarë
HCFC	Hidrofluorokarbonet/Hydrochlorofluorocarbons
IFC	International Finance Corporation
IMK	Instituti të Monumenteve të Kulturës
INSTAT	Instituti i Statistikave

ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotur
IUCN	Unioni Nderkombetar për Ruajtjen e Natyres
KE	Këshilli Europian
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KKT	Keshilli Kombetari Territorit
KM	Keshilli i Ministrave
Konventa e Espoo	Konventa për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Nderkufitar se bashku me Amendimet dhe Protokollet
m	metër
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës
MRR	Mbetje të rrezikshme
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NATURA 2000	Rrjeti i zonave të mbrojtura të natyres në territorine Bashkimit Evropian
NBSAP	Strategjia Kombetare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit
NJA	Njesi Administrative
NO _x	Oksidet Nitroze
OBSH	Organizata Boterore e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OM	Objektiv Mjedisor
OSHEE	Operatori i Shperndarjesse Energjise Elektrike
PBB	Prodhimi i Brendshem Bruto
PCB/PCT	Bifenile të poliklorinuara/ Trifenile të poliklorinuara
PDZRK	Plani i Detajuar i Zonës me Rëndësi Kombëtare
PINS B	Plani i Integruar Ndersektorial për Bregdetin

PKIE	Plani Kombetar për Integrimin Evropian
PKIN	Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes
PKPZM	Programi Kombetar i Punes për Zonat e Mbrojtura
Plani	Plani Vjosë - Nartë
PM ₁₀	Partical Matter 10 micron/Grimca të ngurta pezull dimensiononi 10 mikrometër
PM _{2.5}	Partical Matter 2.5 micron/Grimca të ngurta pezull dimensiononi 2.5 mikrometër
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombetar
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PT	Planifikim i Territorit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QKL	Qendra Kombëtare e Licensimit, tashme e njohur me emërtimin Qendra Kombëtare e Biznesit
SBERAJ	Strategjia Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko-Jonian
SEE	Strategjia Evropes Jug-Lindore
SEIZP	Sistemi Evropian i Informacionit për Zjarret në Pyjet
SHBA	Shtete Bashkuara të Amerikes
SKMIU	Strategjia Kombetare për Menaxhimin e Integruar të Ujërave
SKMM	Strategjia Kombetare për Menaxhimin e Mbetjeve
SKZHI	Strategjia Kombetare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020
SO _x	Oksidet e Squfurit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
TDS	Solidet e Tretura Totale/Total Dissolved Solids
TMD	Teknikat me të mira të disponueshme
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin

UNESCO	Organizata për Edukim, Shkence dhe Kulturee Kombeve të Bashkuara
UNFCCC	KonventaKuadere Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial
VKM	Vendim i këshillit të Ministrave
VOC	Volatile Organic Compounds / Komponenteve Organike të Avullueshme
VSM	Vlerësim Strategjik Mjedisor
ZPM	Zonën e Peizazhit të Mbrojtur

KAPITULLI I: HYRJE

I.1 ÇFARË ËSHTË VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor - VSM është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i ndonjë plani, programi ose dokumenti tjetër strategjik.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si *“nje proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat me të hershme të vendimarrjes”*.

I.2 KUADRI LIGJOR I VSM-S

Kuadri ligjor i VSM-së bazohet në Ligjin Shqiptar për VSM-në dhe kuadri ligjor europian dhe ndërkombëtar sipas referencave më poshtë:

❖ *Ligji nr. 91/2013 “Per vlerësimin Strategjik Mjedisor”*, i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe autoritete përkatese, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe rregullat e procedurës për kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor. Ligji është përafruar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001¹.

❖ *Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian* mbi vlerësimin e efekteve në mjedis prej planeve apo programeve të caktuara (Direktiva e VSM-së)².

❖ *Protokolli i VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE)*³.

I.3 FAZAT KYÇ TË PROÇESIT TË VSM-ës

Fazat për zhvillimin e procesit të VSM detajohen, veç në Ligjin “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, në Vendimin “Për përcaktimin e rregullave të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor” si më poshtë:

¹ http://www.legjislacioni.gov.al/frontend/change_documents/129.

² <http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm>.

³ http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.htm

Tabela I-1: Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtëra të punës në to.

FAZAT	PËRSHKRIME
Nevojshmëria	
Përfshirja / qellimit të VSM	Identifikimi i çështjeve që do të përfshihen në studimin e VSM-së do të orientojnë vlerësimin e gjendjes baze të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM-ja merr në konsiderate përfshirjen e aspekteve me të gjera mjedisore apo sociale në zonë dhe konservimin e të gjitha aseteve më rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese do të perbejë bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemës së monitorimit. për VSM-ne është e rëndësishme që të konsiderohen tendencat e mundshme të zhvillimit në të ardhmen. vlerësimi i ndikimeve të pritshme mund të bëhet vetëm duke kuptuar gjendjen ekzistuese të çështjeve kyç të identifikuar në studimin e shtrirjes/qellimit të VSM-se. Qellimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi më të mirë të çështjeve kyç, dhe një identifikimi më të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet perkatese.
Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutese	VSM-ja analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. një nga perfitimet kryesore prej VSM-se është se ai mundeson identifikimin e efekteve mjedisore të Planit, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve ose Pleneve të tjera në afërsi të zonës. VSM-ja do të analizojë specifikisht masat adekuate përmirësuese që do të rezultojnë nga Plani. Duke konsideruar, bashkërisht, ndikimet dhe raportin benefit/cost të veprimit ose mos veprimit do të analizohen opsionet dhe përzgjidhet ai që rezulton më i mirin e planin ekonomik dhe mjedisor.
Hartimi i raportit të VSM-së	Raporti i VSM-se përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM-se dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet perkatese dhe grupet e tjera të interesit. Qellimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti të shkruar mirë dhe të kuptueshëm, i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në një mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet perkatese dhe grupet e tjera të interesit.
Adoptimi	Jepet informacion mbi përputhshmërinë e objektivave mjedisore me elementët kyç të Planit, të identifikuar paraprakisht. Mos përputhshmëritë e objektivave mjedisore me Planin nevojiten që të rishikohen dhe propozohen ndryshime të mundshme në Plan.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese / zbutese për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar në këtë studim

I.4 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor - VSM është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i ndonjë plani, programi ose dokumenti tjetër strategjik.

Qëllimi i VSM-së është përmirësimi i planit ose programit në mënyrë për të minimizuar ndikimin e tij të mundshëm negativ në mjedis dhe për të maksimizuar ndikimet pozitive, dhe ,po ashtu të sigurojë që ndikimet e mundshme negative, që nuk mund të shmangen, të menaxhohen si duhet dhe të kompensohen gjatë zbatimit të planit ose programi. Me fjalë të tjera, qëllimi i VSM-së është të sigurojë që zhvilluesit të optimizojnë planet dhe programet e tyre dhe t'i bëjnë ato më të miqësore për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Për të siguruar efektivitetin e procesit të VSM-së, është thelbësore që Dokumentet Strategjike të marrin në konsideratë disa opsione alternative për arritjen e qëllimeve të identifikuar. Në këtë rast se VSM lejon vendimmarrësit të marrin në konsideratë opsionin më miqësor ndaj mjedisit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se VSM është një proces transparent i bazuar në pjesëmarrjen e publikut. Personat, kushtet e jetesës dhe shëndeti i të cilëve mund të ndikohen nga zbatimi i planit dhe programit, do të kenë të drejtë të shprehin interesat e tyre dhe ato duhet të merren parasysh përkatësisht në procesin e vendimmarrjes. Përveç kësaj, shoqëria është burim i pashtershëm i ideve jo vetëm për autoritetet publike, por edhe për ekspertët. Planifikuesit dhe ekspertët e VSM-së mund të përfitojnë nga propozimet e ofruara nga qytetarët e interesuar.

Ligji për VSM-në (2013) përcakton domsodoshmërinë e përgatitjes së saj në rastet e:

- I. Planeve strategjike që pasqyrojnë çështjet e zhvillimit të territorit, të cilat zakonisht referohen si plane master të planeve të përdorimit të tokës për zhvillimin e ardhshëm dhe planet e përgjithshme të zhvillimit (lokal ose kombëtar); dhe
- II. Dokumentave strategjike që pasqyrojnë qëllimet e zhvillimit të veçantë të sektorit, të cilat zakonisht referohen si zhvillime sektoriale ose programe të synuara.

Sipas kërkesave të Ligjit Nr.107/2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit", miratimi i çdo plani të ri territorial në Shqipëri i nënshtrohet procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), sipas specifikimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 91/2013 për "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Ligji Nr. 91/2013 është përafshuar plotësisht me direktivën 2001/42/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Europian⁴, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara", e njohur ndryshe si "Direktiva VSM", e cila kërkon që planet dhe programet duhet t'i nënshtrohen një procesi vlerësimi mjedisor në nivel strategjik.

Qëllimet e përgjithshme të këtij procesi janë për integrimin e vlerësimeve mjedisore në përgatitjen e planit dhe vendim-marrjeve, për të përmirësuar planet dhe për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit si dhe për të rritur pjesëmarrjen publike në vendim marrjen mjedisore. Ky dokument është **Raporti Mjedisor** i përgatitur për të vlerësuar efektet mjedisore dhe ato mbi shëndetin publik të Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare - PDZRK. Hartimi I tij bazohet në Ligjin⁵ VSM-së (2013) në nënin 10 të të cilit kërkohet:

⁴ Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 197, datë 21.7.2001, faqe 30 – 37

⁵ Ligji 91/2013, "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"

a) përshkrimin e qëllimit dhe objektivave kryesore të planit ose programit dhe të përputhjes së tij me plane ose programe të tjera që lidhen me të, fazën e vendimmarrjes dhe sqarimet nëse disa çështje janë vlerësuar ose do të vlerësohen në nivele dhe procese të tjera planifikimi;

b) përshkrimin e metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së, përfshirë vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së tij, dhe burimet e informacionit ekzistues, që përdoren për qëllim të hartimit të raportit;

c) përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit, rishikimit, ndryshimit apo modifikimit të planit ose programit të propozuar, përfshi edhe alternativën e mosplanifikimit (alternativa zero), si dhe arsyetimet përkatëse;

ç) objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel kombëtar, rajonal apo lokal, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këta objektiva janë marrë në konsideratë në propozim;

d) përshkrimin e përbërësve të mjedisit në zonën e shtrirjes të planit ose programit të propozuar;

dh) përshkrimin e cilësisë së elementeve të mjedisit në zonën ku propozohet plani apo programi, të cilat mund të ndikohen nga zbatimi i planit ose programit të propozuar;

e) ndërveprimet e mundshme me mjedisin të planit ose programit të propozuar, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si zonat e mbrojtura;

ë) pasojat e mundshme negative në mjedis, duke përfshirë ndikimet në biodiversitet, në shëndetin e njerëzve, në tokë, në ujë, në ajër, faktorët klimaterikë, trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, peizazhin apo dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;

f) pasojat e mundshme negative në mjedisin ndërkufitar, në rast të zbatimit të nënit 17 të këtij ligji;

g) masat e parashikuara për të shmangur apo zbutur sa më shumë të jetë e mundur pasojat e ndikimeve në mjedis, gjatë zbatimit të planit ose programit;

h) përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e pasojave në mjedis gjatë zbatimit të propozimit;

i) përmbledhjen në gjuhë joteknike të raportit paraprak të VSM-së.

I.4.1 Objektivat Synimet e VSM

VSM synon që të analizojë komponëntët thelbësorë të mjedisit dhe të ballafaqojë përputhshmërinë e PDZRK në raport me ta si dhe me strategjitë, Legjislacionin dhe rregulloret të cilave u nënshtrohet mjedis në të cilin zhvillohet Plani.

VSM-ja në planifikimin hapësinor duhet të paraqesë informacion mbi këto ndikime mjedisore, ekzistenca dhe pasojat e të cilit nuk janë definuar në mënyrë specifike. Në këtë mënyrë VSM-ja në planifikimin hapësinor mund të kontribuojë në përmirësimin e procesit të planifikimit dhe vendimmarrjen, pasi ai është një vlerësim gjithëpërfshirës, sistematik dhe transparent i aspekteve mjedisore, sociale dhe ekonomike, si dhe implikimet në planifikim. VSM-ja ka funksionin e identifikimit dhe zbutjen e pasojave negative të Planit. Detyra është që të kontribuojë për një planifikim të tillë që, nga pikëpamja e mjedisit dhe e shëndetit publik është jo vetëm i tolerueshëm, por edhe optimal, ndërsa kërkon alternativa të ndryshme duke marrë parasysh

efektet mjedisore, sociale dhe ekonomike. Gjatë procesit të VSM-së, fushat e rëndësishme mjedisore dhe ato prioritare do të identifikohen duke u bërë një kriter planifikimi për të shpëtuar ata nga dëmtimet e pakthyeshme dhe të plota.

Në planin teknik VSM, në pjesën e parë të tij, do të konsiderojë gjëndjen dhe zhvillimet social ekonomike të Rajonit, ballafaqimet me gjëndjen mjedisore, ndikimet potenciale të tyre të shoqëruara me masat për menjanimin/reduktimin dhe nivelin e përputhshmërisë së ndikimeve negative me Legjislacionin dhe Strategjitë, të përgjithësuar si më poshtë:

- I. Zhvillimi social dhe ekonomik;
- II. Gjendja mjedisore e territorit;
- III. Perspektiva të zhvillimit dhe çështjet më të rëndësishme mjedisore;
- IV. Ndikimet potenciale në mjedis të zhvillimit (në fokusin e zhvillimit të qëndrueshëm)
- V. Masa për eliminimin dhe/ose reduktimin e tyre.

Në pjesën e dytë do të trajtohen Planin duke u ballafaquar me ndikimin në Mjedis që këto zhvillime shkaktojnë potencialisht në terma afat mesem/afat gjatë dhe oponenca përkundrejt këtyre propozimeve në planin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

I.4.2 Kërkesa për VSM dhe ekipi i saj

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është kërkesë për plotësimin e dokumentacionit të PDZRK Vjosë - Nartë, pjesë e paketës së Planeve të Detajuara Vendore të për caktuara në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1. Date 16.10.2017 (në pikën 3 dhe 4), Vendim i cili aprovon Planin e Përgjithshëm Vendor dhe nënvizon përgatitjen e PDV.

Agjensia e Zhvillimit të Territorit-AZHT është autoriteti që ka marrë përsipër në bashkepunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, përgatitjen e PDZRK së zonës Vjosë-Nartë. Paralelisht me Planin ose fill pas përfundimit të tij, para aprovimit nga KKT, nevojitet VSM respektive. Qendra Kërkimore për Zhvillimin Rural -QKZHR me kërkesën e subjekteve private pronarë, në proporcione të ndryshme, të sipërfaqeve në zonën ku është kryer PDZRK kanë kërkuar Vlerësimin Strategjik Mjedisor e cila njëkohësisht plotëson edhe kërkesën e AZHT për nevojën e kryesjes së VSM. Ekipi i QKZHR përbëhet nga ekspertë me eksperiencë në Vlerësimet Mjedisore si biologë (Flora, fauna dhe zogjtë), mjedisore, gjeologë, agronomë, ekonomistë. Subjektet private të cilët kanë kërkuar VSM të PDZRK janë si më poshtë (tabela dhe harta respektive).

Tabela I-2: Sipërfaqet dhe Subjektet që janë përfshirë në zhvillimin e zonës

Nr	Subjekti Zhvillues	Sipërfaqja (ha)
1	Banka Credins	600
2	MABATEX Group & YDA-Group	309
3	Agna Sha	240

4	Sere Shpk	20
5	Adhenis shpk	150
6	Gazmend Demi	180
7	Arjan Pelushi	37

Sipërfaqja totale që kërkohet për tu zhvilluar është 1,536 ha.




Figura I-1: Harta e kufizimeve të pronave, sipas subjekteve pronarë, që do të zhvillohen.

I.5 METODOLOGJIA E STUDIMIT

Metodologjia për përgatitjen e këtij Raporti Mjedisor mbështetet në metodologji, kritere dhe detyrime sipas ligjit Nr.91/2013, ligjit Nr.111/2012, ligjit Nr.10 431/2011, ligjit Nr.107/2014, VKM Nr. 219, datë 11.3.2015 dhe Planit të Planifikimit të Territorit dhe në Direktivën 2001/42 mbi Vlerësimin e Efekteve të Planeve të Caktuara dhe Programeve për Mjedisin, EC.

Ky vlerësim është hartuar duke përdorur “grykimin e ekspertizës” në fushën e mjedisit reth qartësimin të procesit të zhvillimit të PDZRK, kundrejt ndikimit të dukshëm dhe atij të pritshëm social dhe mjedisor. Për këtë qëllim studimi është formuluar sipas komponëntëve të mëposhtëm: (i) analiza e gjendjes aktuale, (ii) analiza e përputhshmërisë së PDZRK me nevojat e ruajtjes së larmisë biologjike dhe (iii) identifikimi i ndikimeve të mundshme nga zbatimi i PDZRK.

Komponenti i parë mori në shqyrtim analizën e mjedisorë në zonën bregdetare, lagunën e Nartës, grykëderdhjen e lumit Vjosë dhe për qëllime krahasimi rrjedhën e mesme të Lumit. Analiza është e mbështetur në të dhëna bibliografike dhe vlerësime në terren të autorëve të realizuara në periudhën Dhjetor-Maj, 2016, Shtator 2020-Mars, 2021. . Të dhënat aktuale të larmisë biologjike, para së gjithash, janë konsultuar me aspekte nga fusha të tjera si hidrologjia, biodiversiteti në tërësi, kuadrin ligjor, rregullator dhe Plani aktual i Menaxhimit të Zonës së Piesazhit të Mbrojtur të Vjosë - Nartë. Të gjitha diskutimet në këtë Raport VSM janë bërë në referencë të Planit të Menaxhimit të Pjesazhit të Mbrojtur (2004) dhe nënzonimit të tij. Funksionet dhe aktivitetet e lejuara/ndaluara në nënzonat e PM janë konsideruar në ballafaqimin e kërkesave për zhvillim me statusin mbrojtës të tyre dhe duke konsideruar Planin e Përgjithshëm Vendor të Vlorë, Himarë, Sarandë, Konispol (2016) së bashku me Planin e Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare, të hartuar nga Bashkia Vlorë dhe Agjensia e Zhvillimit të Territorit - AZHT në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Pas rishikimit të literaturës dhe analizës së gjendjes aktuale raporti është hartuar mbi bazën e analizës së përputhshmërisë së ndërhyrjeve të parashikuara në MP për të prezantuar rekomandimet përkatëse, gjetjet, dhe boshllëqet e hasura.

Kufizimet e vlerësimit: Ky vlerësim ka si qëllim të hulumtojë gjendjen aktuale dhe analizojë tendencat zhvillimit të paraqitura në PM në zonën e Nartës kundrejt ndikimit aktual të vërejtur në mjedis dhe atij të pritshëm. Studimi përpiket të sjellë në një dokument të vetëm elementë të ndryshëm të vërejtur edhe për aspekte të ndryshme të këtij zhvillimi. Dokumenti përpiket të krijojë një bazë alternative të zhvillimit të zonës, i cili shikon jo vetëm nevojën për zhvillim, por ndikimin real pozitiv dhe negativ të këtij zhvillimi. Dokumenti kufizohet në kohë dhe në zhvillimin e munguar të Planit të Ri të menaxhimit të PM, ndonjë gjëndja e përgjithëshme dhe perspektiva e zhvillimit të saj jepet në PDZRK i përgatitur gjatë vitit 2019 dhe 2020.

I.6 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

I.7 KUADRI LIGJOR

Ky seksion ofron një përmbledhje të legjislacionit ndërkombëtar, rajonal dhe atij kombëtar dhe dokumenteve të politikave për hartimin e VSM-së.

Tabela I-3: Ligjet dhe Dokumentet e Politikave Kombëtare

Nr.	Ligjet Rajonale dhe Dokumentet e Politikave
1	Direktiva 2001/42/KE, mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis
2	Direktiva 92/43/KEE për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër
3	Direktiva 2009/147/KE për ruajtjen e zogjve të egër
4	Direktiva 2008/50/KE “Për cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajrit më të pastër për Evropën” Direktiva CAFÉ
5	Direktiva e BE-së për Zhurmën e Mjedisit 2002/49 KE
6	Direktiva Kuadër e BE-së për Mbetjet 2008/98/KE

7	Rregullorja Nr. 1907/2006/KE mbi Kimikatet
8	Direktiva 91/271/KEE për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane
9	Direktiva Kornizë e Ujit të BE-së 2000/60/KE
10	Direktiva 2002/49/KE në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore

Tabela I-4: Ligjet dhe Dokumentet e Politikave Kombëtare

Nr.	Ligjet Kombëtare dhe Dokumentet e Politikave
Legjislacioni horizontal	Ligji Nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar
	Ligjin Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar
	Ligji Nr. 91, datë 27.07.2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”
	Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar
	VKM Nr. 219, datë 11.3.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”
Mbrojtja e natyrës	Ligji Nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”
	Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar
	Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”
	VKM Nr.680, datë 22.10.2004 “Për shpalljen e sistemit ligatinor Vjosë-Nartë peizazh ujor/tokësor i mbrojtur”
	VKM Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës Shqiptare”
	Urdhër Nr. 1280, datë 20.11.2013 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër”
Menaxhimi i ujit	Ligji 111/ 2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar
	Ligj Nr.9115, date 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura”, i ndryshuar
	VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”
	VKM Nr. 246, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”
	VKM Nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”
Toka	Ligji Nr. 8752 Nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar
	Ligji Nr.9244, date 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.
Ajri	Ligji Nr. 162, datë 04.12.2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të ambientit”
	VKM Nr. 803, datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”
	VKM Nr. 248, datë 24.04.2003 “Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre”
Menaxhimi i zhurmave	Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar
	VKM Nr. 123, datë 17.02.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”
	VKM Nr. 587, datë 07.07.2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e niveleve të zhurmës në zonat urbane dhe turistike”
	VKM Nr.613, datë 7.9.2011 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedis të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave”

	Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe i Ministrit të Shëndetësisë Nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”
	Urdhër Nr. 11 262, datë 27.11.2014 Për miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen e mjedisit nga zhurmat nga aviacioni civil”
Mbetjet	Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar
	VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbeturinave jo të rrezikshme dhe informacionin që duhet të përfshihet në shënimin e transferimit”
	VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e mbetjeve të ndara në burim”
	VKM Nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, i ndryshuar
	VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillin e mbetjeve”
Siguria	Ligji Nr. 10237/2010, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.
	VKM Nr. 562/2013, datë 03/07/2013 “Për miratimin e kërkesave të sigurisë dhe shëndetit në vëndin e punës”
TK	Ligji Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”

I.7.1 Rregulloret e Bashkimit Evropian

Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE në 28 Prill 2009 dhe mori statusin e kandidatit të BE në 2014. Bisedimet e pranimit filluan kohët e fundit, në Mars 2020. Periudha që nga viti 2011 është karakterizuar nga përpjekje intensive për të njehësuar legjislacionin mjedisor të BE-së në legjislacionin kombëtar. Qeverisë i është dhënë ndihma për hartimin e pjesëve të reja të kornizës ligjore dhe të politikave mbi mjedisin kryesisht përmes projekteve të financuara nga BE-ja si Forcimi i Zbatimit të Ligjit Mjedisor në Shqipëri (FZLMSH, 2012–2014) dhe Ndërtimi i Institucioneve për Zbatimin e Legjislacionit Mjedisor dhe Klimatik (NIZLMK, 2015–2017). Sidoqoftë, kohët e fundit është rritur numri i akteve të njehësuar në fushën mjedisore. Statusi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së është si më poshtë:

- për cilësinë e ujit, niveli i shtrirjes mbetet i pjesshëm. Është krijuar një Agjenci Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve dhe janë vendosur kontrata të bazuara mbi performancën midis bashkive dhe ndërmarrjeve të ujit;
- shtrirja në fushën e mbrojtjes së natyrës është e mirë avancuar;
- legjislacioni për cilësinë e ajrit ende nuk është përafruar plotësisht;
- kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve është pjesërisht i harmonizuar;
- harmonizimi me legjislacionin e BE-së për ndotjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut është ende në një fazë të hershme;
- për kimikatet, plani kombëtar i Shqipërisë për të zvogëluar dhe eliminuar ndotësit organikë të qëndrueshëm është duke u rishikuar; dhe
- ndryshimet klimatike, ku Shqipëria ka arritur një nivel të përgatitjes, por shtrirja është ende e kufizuar.

Direktivat e BE-së mbulojnë vlerësimin e mjedisit, parandalimin dhe kontrollin e ndotjes, shkarkimet industriale, cilësinë e ajrit, ruajtjen e dioksidit të karbonit, çlirimet e gazrave me efekt

serrë, ujin, ruajtjen e habitatit natyror dhe biodiversitetin, materiale të rrezikshme dhe zhurmë. Një përshkrim i shkurtër i direktivave të BE-së është dhënë më poshtë.

Tabela I-5: Lista e direktivave të BE-së

Direktiva 2001/42/BE	Direktiva synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të kontribuojë në integrimin e konsideratave mjedisore gjatë hartimit dhe miratimit të planeve dhe programeve për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, duke siguruar që, në përputhje me këtë Direktivë, të kryhet vlerësimi mjedisor i planeve dhe programeve të caktuara që mund të kenë efekte të konsiderueshme në mjedis.
Direktiva 2010/75/BE	Mbi çlirimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) përcaktojnë rregulla për parandalimin e integruar dhe kontrollin e ndotjes që vijnë nga aktivitetet industriale. Gjithashtu, përmban rregulla të krijuara për të parandaluar ose, kur nuk është e zbatueshme, për të zvogëluar çlirimet në ajër, ujë dhe tokë dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve.
Direktiva 2003/87/KE	Krijon një skemë për tregtimin e çlirimeve të gazrave me efekt serrë brenda Komunitetit, në mënyrë që të promovojë zvogëlimin e çlirimeve të gazrave me efekt serrë në një mënyrë ekonomikisht të efektshme.
Direktiva 2000/60/KE	Kornizë për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit (Direktiva Kuadër Ujit, DKU). Ajo përcakton strategjit kundër ndotjes së ujit dhe synon të sigurojë që të gjithë ekosistemet ujorë, ekosistemet tokësore dhe ligatinat të plotësojnë gjëndjen e "statusit të mirë" (siç përcaktohet në dokument) deri në 2015.
Direktiva 2008/105/KE	Vendosja e standareve për cilësinë mjedisore në fushën e politikave të ujit (duke ndryshuar dhe shfuqizuar më pas Direktivat e Këshillit 82/176/KEE, 83/513/KEE, 84/156/KEE, 84/491/KE, 86/280/KEE dhe duke ndryshuar Direktivën 2000/60/KE) vendos, ndër të tjera: kufijtë e përqendrimeve në ujërat sipërfaqësorë të 33 substancave me përparësi dhe 8 ndotësve të tjerë (Shtojca I).
Direktiva 2006/11/KE	Përcakton rregullat për mbrojtjen dhe parandalimin e ndotjes që vijnë nga shkarkimi i disa substancave në mjedisin ujor të Komunitetit.
Direktiva 2006/118/KE	Vendosja e një regjimi i cili përcakton standardet e cilësisë së ujërave nëntokësorë dhe prezanton masa për të parandaluar ose kufizuar hyrjet e ndotësve në ujërat nëntokësore.
Direktiva 2012/18/BE	Vendosja e kontrollit të rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme (duke ndryshuar dhe shfuqizuar më pas Direktivën e Këshillit 96/82/KE), detyron Shtetet Anëtare të sigurojnë që

	operatorët të kenë një politikë në funksion për të parandaluar aksidente të mëdha.
Direktiva 2002/49/KE	Përcakton një qasje të përbashkët që synon të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë në bazë të përparësive të efekteve të dëmshme, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore, duke përfshirë, ndër të tjera, metodat e vlerësimit për treguesit e zhurmës.
Direktiva 2000/14/KE	Sugjeron përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me zhurmën për pajisjet për përdorim në ambient të jashtëm, të listuara në Shtojcën I të kësaj Direktive.
Direktiva 92/43/KEE	Synon të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve natyrore, faunës dhe florës së egër në territorin e Shteteve Anëtare.
Direktiva 2009/147/KE	Rritja e masave për ruajtjen e të gjitha llojeve të shpendëve që ndodhen në mënyrë natyrore në gjendje të egër në territorin e Shteteve Anëtare.

I.7.2 Konventat ndërkombëtare

Vendi ynë është nënshkrues i një numri të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen me menaxhimin e mjedisit. Në raste të caktuara, këto konventa dhe marrëveshje kanë ndikuar në politikën e vendit, udhëzimet dhe rregulloret dhe duhet të respektohen gjatë planifikimit, ndërtimit dhe funksionimit të Projektit. Marrëveshjet dhe konventat kryesore ndërkombëtare janë renditur në Tabelën e mëposhtme.

Tabela I-6: Lista e Konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara/ratifikuar nga Shqipëria

Konventa/ Marrëveshja	Përmbledhje	Ratifikuar
Konventa e Aarhus për Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi në Çështjet e Mjedisit (1998)⁶	Konventa vendos një numër të drejtash të publikut në lidhje me mjedisin; përfshirë aksesin në informacionin mjedisor; pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe aksesin në drejtësi.	26 Tetor 2000
Konventa Kuadër e KB për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) (1992) hyri në fuqi në 1994	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) ka qenë vendimtare në adresimin e ndryshimeve klimatike dhe nevojës për një ulje të çlirimeve të gazrave me efekt serrë. Qëllimi përfundimtar i Konventës është të stabilizojë përqendrimet e gazrave me	01 Dhjetor 1994

⁶ <http://ec.europa.eu/environment/aarhus/index.htm>

	efekt serrë (GES) në atmosferë në një nivel që do të parandalonte ndërhyrjen e rrezikshme të njeriut në sistemin e klimës.	
Marrëveshja e Parisit në COP21 në Paris më 12 Dhjetor 2015, hyri në fuqi më 4 Nëntor 2016⁷	Marrëveshja e Parisit bazohet në Konventën e Ndryshimeve Klimatike për të luftuar ndryshimet klimatike.	21 Shtator 2016
Protokolli i Kyoto⁸	Protokolli i Kyotos është një marrëveshje ndërkombëtare e lidhur me Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike; nënshkruesit angazhohen të vendosin objektiva ndërkombëtarisht të detyrueshëm të zvogëlimit të emetimeve.	1 Prill 2005
Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (1992)	Shmang ose minimizon efektet negative në burimet ujore dhe cilësinë e ujit.	5 Janar 1994
Konventa për Diversitetin Biologjik (KDB) (1992)	Shmang ose minimizon efektet negative në habitatet dhe speciet e rëndësishme, vendet e caktuara ndërkombëtare dhe natyrore të mbrojtjes së natyrës; ruajtja, përdorimi i qëndrueshëm dhe i barabartë i biodiversitetit.	5 Prill 1994
Konventa për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Habiteteve Natyrore në Europë (Konventa e Bernës) (1976)⁹	Konventa synon të sigurojë ruajtjen e llojeve të florës dhe faunës së egër dhe habitatet e tyre. Vëmëndje e veçantë i kushtohet specieve të rrezikuara dhe vulnerabël, përfshirë speciet migratore të rrezikuara dhe vulnerabël; për të shmangur ose minimizuar efektet negative mbi habitatet dhe speciet e rëndësishme, vendet e caktuara ndërkombëtare dhe natyrore të mbrojtjes së natyrës.	2 Mars 1998
Konventa për Ruajtjen e Llojeve Migratore të Kafshëve të Egra (Konventa e Bonit) (1979)	Shmang ose minimizon efektet negative mbi speciet migratore.	1 Shtator 2001

⁷ https://unfccc.int/files/paris_agreement/application/pdf/qa_paris_agreement_entry_into_force.pdf

⁸ <https://unfccc.int/process-and-meetings/the-kyoto-protocol/ehat-is-the-kyoto-protocol>

⁹ <https://www.coe.int/en/ëeb/conventions/full-list/-/conventions/treaty/104>

Marrëveshja për Ruajtjen e Shpendëve Ujorë Migratorë Afrikanë-Euroaziatikë (1995)¹⁰	Marrëveshja e Shpendëve Migratorë Ujorë Afrikanë-Euroaziatikë përfshin 254 lloje shpendësh të varur ekologjikisht nga ligatinat për të paktën një pjesë të ciklit të tyre vjetor. Të gjitha këto speciet kalojnë kufijtë ndërkombëtarë gjatë migrimeve të tyre dhe kërkojnë habitat me cilësi të mirë për mbarësim, si dhe një rrjet vendesh të përshtatshme për të mbështetur udhëtimet e tyre vjetore. Shmang ose minimizon efektet negative mbi speciet migratore të shpendëve të ujit.	1 Shtator 2001
Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare në Llojet e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së egër (1975)¹¹	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare në Llojet e Rrezikuara të Faunës dhe Florës së egër është një marrëveshje ndërkombëtare midis qeverive. Qëllimi i saj është të sigurojë që tregtia ndërkombëtare e ekzemplarëve të kafshëve dhe bimëve të egra nuk kërcënon mbijetesën e tyre.	10 Korrik 1989

I.8 LIDHJA ME POLITIKA DHE DOKUMENTE TË TJERË

Në Planin e Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030”¹² për Planifikimin e territorit 2015-2030 nënvizohet se “Shqipëria është e pasur me burime natyrore cilësore por konkurrueshmëria në treg nuk mjafton dhe se i duhet që Ajo të “zbulojë” aftësinë e saj për qëndrueshmëri, ripërfitje dhe përshtatshmëri. Aftësia e shoqërisë për të përdorur në mënyrë të zgjuar “thesaret” e territorit mund të sigurojnë pavarësinë brënda një rrjeti ndaj të cilit jemi të hapur dhe në të cilin duam të ndikojmë.” Me një vizion për mbrojtjen e mjedisit paralelisht me zhvillimin e qëndrueshmë social ekonomik, më tej theksohet se “Ruajtja e ekosistemeve shqiptare dhe e shërbimeve nuk është qëllim në vetvete, por celës i mbijetesës dhe qëndrueshmërisë në një epokë ku ndërthurren krizat e shumfishta globale me qasjen për hapje dhe integrim ndër rajonal dhe ndërkombëtar”.

Përcaktimi për hartimin e PDZRK-së në *Nartë*, shprehet nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT Nr. 01, datë 16.10.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë”.

Qëllimi i PDZRK-së është përcaktimi i qartë i kushteve për zhvillim të cilat do të sigurojnë një balancë të drejtë midis interesit privat dhe publik në zhvillimin e turizmit, ruajtjen e vlerave mjedisore dhe karakteristikat e peizazhit bregdetar e lagunor të zonës. Në themel të këtij procesi qëndron bashkërendimi ndërsektorial, koordinimi institucional si edhe zbatimi i deyrimeve ligjore që rrjedhin nga dokumentat e planifikimit në fuqi, për territorin subjekt zhvillimi.

¹⁰ <https://www.cms.int/en/legalinstrument/aewa>

¹¹ <https://www.cites.org/eng/disc/what.php>

¹² Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Planifikimit të Territorit 2015-2030, Miratuar me VKM nr. 881, date 14.12.2016

Gjithashtu, ky plan synon të sigurojë që zhvillimi turistik i propozuar, të ndjekë një rrugë vërtet të qëndrueshme dhe që kontribuon në një menaxhim të cilësor të zonës së mbrojtur, territorit publik dhe private, siguron bashkëpunim të zgjeruar dhe partneritet konkret midis industrisë dhe mjedisit.

Objektivat kryesor të PDZRK për zonën e Nartës mund të përmbledhen si më poshtë:

- Të sigurojë mundësi për realizimin e strukturave zhvillimore të cilat respektojnë karakteristikast mjedisore, peizazhin dhe kapacitetin mbajtës për zonën;
- Të sigurojë një proces transparent të ndarjes së njësive në në nënjesi strukturore pas riorganizimit të parcelave (përmes ndarjes dhe/ose ribashkimit) me qëllim përmirësimin e mundësive për investim;
- Detajimet për brezat mbrojtës të vijave ujorë, gjerësia e brezave të gjelbërimit dhe të akseve-korridoreve të kalimit;
- Përcaktimi i kushteve dhe rregullave teknike për zbatimin e strukturave dhe infrastrukturës mbështetëse me qëllim ruajtjen e bregut dhe të burimeve ujore në zonë.

KAPITULLI II: PLANI I DETAJUAR I ZONËS VJOSË - NARTË (SI PDZRK)

II.1 KUFIRI I PDZRK-SË

Territori objekt i këtij studimi është pjesë e Bashkisë Vlorë, referuar kufijve administrativ territorial të miratuar me VKM Nr. 360 datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativë-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore", në zbatim të Ligjit Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Territori subjekt i PDZRK-së shtrihet në Veri të qytetit të Vlorës dhe bën pjesë në: Peizazhin e mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartës, Zonë e Mbrojtur të Rëndësisë Kombëtare, miratuar me VKM Nr. 680, datë 22.10.2004.

Vetë zona mbulon një sipërfaqe prej 19,738 hektarësh. Lartësia e kompleksit varion nga 0-246 m mbi nivelin e detit. Pika më e lartë ndodhet midis fshatrave Hoshtimë dhe Llakatund.

Aktualisht territoret në të cilat shtrihen njësitet në studim, bëjnë pjesë në Peizazhin e mbrojtur "Vjose Narte", të miratuar me VKM Nr. 680, date 22/10/2004.

Ligji Nr. 81/2017, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura" përcakton kategorinë "Peizash i mbrojtur" shkallën e V të mbrojtjes me karakteristikat si më poshtë: "Peizazh i mbrojtur" shpallen territore të mëdha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, sipërfaqet brenda të cilave mund të ketë edhe qendra banimi që zhvillojnë aktivitete, si bujqësia, pemtaria, pylltaria e peshkimi. "Peizazhi i mbrojtur" menaxhohet për mbrojtjen e vlerave peizazhistike të zonës, diversiteti biologjik, si dhe për çlodhje e argëtim. Kjo kategori përfshin tokë/det/ujë në pronësi publike ose private."

Pika 4, nëni 20 i këtij ligji përcakton se:

Veprimtaritë, që ndryshojnë përdorimin e territorit si ndërtimet, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane, si dhe veprimtari të ngjashme me këto, lejohen të ushtrohen vetëm nëse subjekti që kërkon të kryejë veprimtarinë është pajisur me leje nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Duhet theksuar se plani i menaxhimit daton i miratuar që në vitin 2004, pas 17 vjetëve mund të themi se nuk i përgjigjet dot dinamikës së zhvillimeve të fundit në territor dhe ndryshimeve të reja si ligjore dhe territoriale ashtu edhe ekonomike strategjike. Megjithatë vlen të përmendim dhe të mbahen në konsideratë disa konstatime të rëndësishme nga ky studim për sa i përket biodiversitetit dhe vlerave që mbart kjo zonë.

II.2 TË DHËNA DHE KOMPONËNTË TË PLANI I DETAJUAR I ZONËS VJOSË - NARTË (SI PDZRK)

Në tërësi, territori subjekt i PDZRK-së ka një sipërfaqe prej **2,083.22 ha**, i përkufizuar sipas figurës II.1. Zona aksesohet për më pak se dy ore nga Tirana dhe deri në 15 min nga Vlora. Ndërkohë, qendra më e afërt e banuar është Novosela deri 12 min larg me makinë. Me investimet në infrastrukturë dhe rritjen e interesit turistik për Shqipërinë nga vëndet e Europës dhe më gjerë,

zona mbetet një nga pikat më atraktive për tu zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme në këtë drejtim. Është e kuptueshme se me shtimin e strukturave pritëse në zonën do të lindë nevoja për infrastrukturë sekondare të shtuar si edhe përmirësim të rrugëve të aksesit ekzistuese.

Propozimet territoriale jepen në zbatim të orientimeve strategjike të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin si edhe duke rivlerësuar parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë. PDZRK propozon përdorimet e detajuara për zhvillime në funksion të turizmit bregdetar dhe ekoturizmit duke përfshirë në parashikimet e tij edhe investimet strategjike nga niveli kombëtar e sektorial i qeverisjes.

II.3 PËRDORIMI I PROPOZUAR I TOKËS DHE NDARJA E NJËSIVE NË NËNNJËSI

Ndarja e njësive strukturore në nënnjësi dhe organizmi i tyre bëhet me qëllim orientimin e zhvillimit të zonës që t'i përshtatet territorit, masave mbrojtëse e kushtëzimeve si dhe kërkesave të sektorit të turizmit për zhvillim.

Projekti është i ndarë në tre përdorime programore: bashkëjetesën midis zonave të banimit dhe të bujqësisë; planifikimin e një rrjeti rrugor sipas një lidhje lindje-perëndim/veri -jug; dhe nëndarjen e zonave të mbetura në makrozona funksionale. Masterplani fokusohet tek një projekt “pa ndërtime” i cili mbështet zonat e tjetërsuara nga njeriu përmes një shpërndarjeje racionale në zonat natyrore. Objektivi i dyfishtë për maksimizimin e një jetë urbane cilësore dhe të qëndrueshme dhe njëkohësisht minimizimin e impaktit mjedisor në territorin përreth duke u përqendruar në marrëdhënien midis objektit dhe natyrës përmes një strategjie të rrehabilitimit të ekosistemit ekzistues. Projekti implementon një system të gjelbër që sillet si shtylla kurrizore e vendbanimeve të reja. Akoma më tej, mjedisi i ndërtuar ndjek peizazhin natyral duke përcaktuar lartësinë e objekteve në përputhje me peizazhin kodrinor.

II.4 SISTEMET BAZË TË TERRITORIT

PDZRK Vjosë Nartë propozon planifikimin e sistemeve të territorit sipas hartës së mëposhtme. Ashtu siç mund të vihet re, pjesa më e madhe e territorit sugjerohet të ruajë karakteristikat ekzistuese në sistemin ujor dhe sistemin bujqësor. Ndërkohë, sistemi natyror përqëndrohet kryesisht në zonat përreth sistemit ujor, përkatësisht brigjet e shtratit të lumit Vjosë, brigjet e shtratit të vjetër të lumit Vjosë si edhe zonat natyrore të bregut të detit të lidhura me territorin e ndarë mes ujit të ëmbël dhe ujit të kripur. Këneta e Kallangës dhe Godulla që furnizohet me uje nga stacioni i pompimit të hidrovorit) **nuk do të preken**, përkundrazi Plani parasheh stabilizimin e dy komunikimeve me detin.




Figura II-1: Harta e Përdorimit të propozuar të tokës (sistemet bazë të territorit)

II.5 PËRDORIMI I TOKËS SIPAS NJËSIVE STRUKTURE

II.5.1 Infrastruktura Aeroportuale

Përsa i përket përdorimit të tokës sipas njësive strukturore së bashku me rrugët lidhëse kombëtare, lokale dhe atë detare (marina) njësia më e rëndësishme e infrastrukturës do të jetë

Aeroporti i Akërnisë i cili për vet rëndësinë dhe karakteristikat është strukturë që zhvillohet në nivel kombëtar. Ai bën pjesë në zonën e peizazhit të mbrojtur dhe analiza e vlerësimit strategjik mjedisor e përfshin atë si njësi strukturorë të ndërlidhur me zhvillimin ekoturistik të zonës veç rëndësisë dhe rolit më të zgjëruar që ai ka.

Ai do të ndërtohet në ish-aeroportin ushtarak pranë fshatit Akëri, Novosele, Vlore. Vendndodhja e propozuar për aeroportin e ri ndodhet pranë Lagunës së Nartës dhe lumit Vjosa. Në anën jugore kufizohet me Lagunën e Nartës rreth 5 km nga peizazhi natyror i mbrojtur. Ana perëndimore kufizohet nga vija bregdetare rreth 6.4 km larg. Në anën lindore rreth 200 m larg, ka disa shtëpi të ndërtuara kohët e fundit, pas mbylljes së aeroportit ('98 -99), ndërsa qendra e fshatit "Akëri" ndodhet rreth 500 m nga pika më e afërt e perimetrit të ish-zona e aeroportit Akëri. Rreth 3 km larg në drejtimin juglindor janë kriporet ndërsa në anën veriore kufizohet nga lumi Vjosa i cili është 3.5. km larg, ndërsa delta e saj ndodhet rreth 10 km larg. Sipërfaqja e tij do të jetë 309 ha (700 m x 3,200 m) me pistë rreth 2,600 m dhe gjërësi piste (kryesore dhe ndihmese) rreth 300 m plus 200 m brez i aeroportit nga të dy anët. Vendoset mbi toka të kripura të kyfizuara me kanalet e drenimit/kullimit si dhe me një territor fushor në të cilin dominojnë tokat e kripura, gjysem të kripura (në territorin e ndërtimit të Aeroportit), tokat fluvisol (tokat në anë të Lumit dhe në brendësi të territorit në raport me bregun e detit) dhe ato ranore të reja (kryesisht, në brezin ranor të detit).






Figura II-2: Plani i vendosjes dhe të dhëna bazë të Aeroportit të Akërnisë, Vlorë

II.5.2 Njësitë strukturore të sistemit bujqësor

Të gjitha njësitë e sistemit bujqësor, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë.

Tabela II-1: Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor

Përshkrim	Njësi me karakter Bujqësor							
Njësia Vendore	Novo selë	Novosel ë	Novoselë	Novosel ë	Novosel ë	Novosel ë	Novosel ë	Novosel ë
Kodi ZRK.NO.	B - 01	B - 02	B - 03	B - 04	B - 05	B - 06	B - 07	B - 08
Sip e njësisë	<u>433 ha</u>	<u>455 ha</u>	<u>1252 ha</u>	<u>148.4 ha</u>	<u>326 ha</u>	<u>125.3 ha</u>	<u>167.2ha</u>	<u>175.7 ha</u>
Mënyra e ndërhyrjes në territor	<u>Konservim, ruajtje e tokës bujqësore. Zhvillim i kufizuar për struktura në ndihmë të aktivitetit bujqësor sipas legjislacionit sektorial në fuqi.</u>							
Kufizime	Të respektohen distancat e zonës buferike për infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri përkatësisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m. Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës.							
Sistemi bazë	Sistemi Bujqësor							
Kategoritë bazë të përdorimit	B-Bujqësi							
Nënkategoritë e përdorimit	B1- kultura të përhershme, B2 - kultura të përkohshme, EB1- Fermë bujqësore, IB - Infrastrukturë Bujqësore							
Tipologjia	<u>Peisazh rural, toka bujqësore me infrastrukturë vaditëse dhe kulluese, në disa raste struktura në shërbim të aktivitetit bujqësor.</u>							
Tregues të zhvillimit	Nuk parashikohen ndërtime, me përjashtim të rasteve në përputhje me legjislacionin sektorial për bujqësinë, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 'Për përcaktimin e tipave, rregullave,							

	kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kritereve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”
--	---

II.5.3 Njësitë strukturore të sistemit natyror

Të gjitha njësitë e sistemit natyror brenda kufirit të zonës së PDZRK Vjosë-Nartë, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë. Në përgjithësi, në njësitë strukturore me përdorim natyrë nuk lejohen zhvillime të asnjë lloji, megjithatë nuk përjashtohen vendosja e strukturave të lehta të përkohshme për ofrimin e disa aktiviteteve dhe shërbimeve pranë zonave të plazhit.

Tabela II-2: Njësitë strukturore të Sistemit Natyror

Përshkrim	Njësi me karakter Natyror											
Njësia Vendore	Novoselë											
Kodi ZRK.NO.	N-01	N-02	N-03	N - 04	N-05	N-06	N-07	N-08	N-09	NAR2.01	NAR2.02	NAR2.03
Sip e njësisë	<u>355.4 ha</u>	<u>22.8 ha</u>	<u>16.4 ha</u>	<u>74 ha</u>	<u>86.3 ha</u>	<u>20 ha</u>	<u>273 ha</u>	<u>192 ha</u>	<u>129.3 ha</u>	<u>73.75 ha</u>	<u>102.37 ha</u>	<u>8.9 ha</u>
Mënyra e ndërhyrjes në territor	Konservim dhe rikuperim mjedisor											
Kufizime	Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës.Të respektohen distancat e zones buferike per infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit te ri perkatesisht me gjeresi 50m, 50m dhe 700m.											
Sistemi	Natyre - N											
Kategoria baze e perdorimi t të tokës	Tokë natyrore - N											
Nënkateg të e përdorimi t	N1,N5, NAR1								NAR2			
Tipologjia	Park natyror & Pyll								Plazh			
Tregues të zhvillimit	Nuk Aplikohen											

Tabela II-3: Njësitë strukturore të sistemit natyror dhe shërbime ekoturistike

Përshkrim	Njësi me karakter Natyror dhe Shërbime Ekoturistike			
Njësia Vendore	Novoselë			
Kodi ZRK.NO.	NAR4.01	NAR4.02	NAR4.03	NAR4.04
Sip e njësisë	224.5 ha	329 ha	335 ha	114.14 ha
Mënyra e ndërhyrjes në territor	Zhvillime të kufizuara për struktura në ndihmë të aktivitetit turistik që integrohen me përdorimin bazë të natyrës.			
Kufizime	Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës. Të respektohen distancat e zonës buferike për infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri përkatësisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m.			
Sistemi	Natyre - N			
Kategoria baze e përdorimit të tokës	Natyre N dhe Shërbime S			
Nënkateg.të e përdorimit	NAR4- Ekoturizëm, S1, S1-6- Bar Restorant, S1-3 - Bujtina			
Tipologjia	Struktura të lehta, me materiale natyrore, gure në dukje, dru, suva etj.			
Tregues të zhvillimit	Treguesit e mëposhtëm janë orjentues por jo kufizues. Treguesit e detajuar do të përcaktohen në bazë të projektit të zhvillimit, në cdo rast të respektohet legjislacioni sektorial për Zhvillimet ekoturistike dhe agroturistike, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kritereve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”			

Këto njësi kanë përdorim bazë bujqësi dhe natyrë, megjithatë nuk përjashtohen disa aktivitete shërbimi. Territori i këtyre njësive shtrihet në sipërfaqe krejtësisht të pashfrytëzuara dhe shërben si një kalim gradual midis përdorimeve bujqësore dhe turistike. Përgjithësisht janë konceptuar të zhvillohen në formën e fermave të mëdha bujqësore të cilat mund të zhvillojnë aktivitetin e agroturizmit, vinotekave etj. Kështu këto ferma mund të specializohen në prodhimin dhe përpunimin e një proukti të vetëm dhe njëkohësisht të shërbejnë si vende atraksioni për kalimin e kohës të turistëve të zonës apo edhe qytetarëve nga Tirana Vlora dhe më gjerë. Zhvillimi i vinotekave, i fermave me pemtari të ndryshme apo të hipizmit etj., do të shndërrojë zonën jo vetëm në prodhuese por edhe një markë për vendin.

- 1 *Kategoria bazë* – Bujqësi dhe Natyrë
- 2 *Nënkategoria* - Agroturizëm, Ekoturizëm
- 3 *Funksioni* – Ferma, Bujtina, Bar, Restorant, njësi akomodimi

Tabela II-4: Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike

Përshkrim	Njësi me karakter miks Bujqësor dhe Natyror me përdorime të lejuara tëshërbimeve agro dhe eko turistike.				
Njësia Vendore	Novoselë				
Kodi	B.EB3.01			B.EB3.02	
Sip e njësisë	385.5 ha			849.4 ha	
Mënyra e ndërhyrjes në territor	Zhvillime të kufizuara për struktura në ndihmë të aktivitetit turistik që integrohen me përdorimin bazë të bujqësisë dhe natyrës.				
Kufizime	Të respektohen distancat e zonës buferike për infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri përkatësisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m. Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës.				
Sistemi	Bujqësi B				
Kategoria baze e përdorimit të tokës	Shërbime(S) + Bujqësi(B) Agroturizëm EB3				
Nënkateg.të e përdorimit	EB3 - Agroturizëm, EB1- Fermë, S1-6- Bar Restorant, S1-3 - Bujtina, NAR4 - Ekoturizëm				
Tipologjia	Struktura te lehta, me materiale natyrore : gure ne dukje, dru, etj.				
Tregues te zhvillimit	Treguesit e mëposhtëm janë orjentues por jo kufizues. Treguesit e detajuar do të përcaktohen në bazë të projektit të zhvillimit, në cdo rast të respektohet legjislacioni sektorial për Zhvillimet ekoturistike dhe agroturistike, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 ‘Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore’ Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”				
Intensiteti i ndërtimit	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05
Koef.shfrytez.territorit	k= 5%	k= 5%	k= 5%	k= 5%	i = 0.05
Sip minimale e sugjeruar për nën darje parcelash	5 ha	5-10 ha	5 ha	5 ha	5 ha
Lartësia në kate	2-3	2-3	2-3	2-3	2-3
Lartësia në m	Sipas projektit				

II.5.4 Njësitë strukturore të sistemit urban dhe infrastrukturor

Njësitë strukturore, pjesë të sistemit urban klasifikohen në:

- Njësi urbane të karakterit banim tradicional, ku përfshihen fshatrat ekzistues të: Akernisë, Poro, Zhukë-Grykëshqipe, Dëllinjë, Bishan, Fitore, novoselë, Aliban, Zërnec dhe Nartë.
- Njësitë urbane të karakterit shërbim-hoteleri, të propozuara nga studimi.

Zonat urbane të përcaktuara sipas pikës a), ruajnë kufirin ekzistues të zhvillimit dhe konsolidohen brenda territorit ekzistues. Parametrat e Zhvillimit për këto zona ruajnë parashikimet e PPV të bashkisë Vlorë. Zonat urbane të përcaktuara sipas pikës b), janë të propozuara për rizhvillim dhe shoqërohen me kërkesë për ndryshim të kategorisë së përdorimit

ekzistues të tokës. Parametrat e përgjithshëm të zhvillimit për këto zona përcaktohen në tabelën e mëposhtme dhe detajohen me lejet e zhvillimit me miratim në KKT, në zbatim të këtij plani.

Të gjitha njësitë e sistemit Infrastruktural, që nuk janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV të Bashkisë Vlorë.

Tabela II-5: Njësiti struktural të Sistemit Infrastruktural

Përshkrim	Njësi me karakter Infrastruktural		
Njësia Vendore	Novoselë		
Kodi ZRK.NO.	INT3-01	INT4-01	S+SHA.01
Sip e njësisë	63.4 ha	<u>135.5 ha</u>	<u>96.4 ha</u>
Mënyra e ndërhyrjes në territor	<u>Rizhvillim</u>		<u>Rizhvillim</u>
Kufizime	Zbatimi i infrastrukturës aeroportuale rrugore dhe portuale kanë prioritet në zbatimin e këtij plani. Të gjitha njësiti kufitare me njësi të përdorimit infrastrukturë duhet të respektojnë distancat e zonës buferike për infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri përkatësisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m.		Të respektohen distancat e zonës buferike nga infrastrukturat e propozuara dhe ndaj brigjeve ujore.
Sistemi baze	Infrastrukturë		Urban
Kategoritë bazë të përdorimit	Infrastrukturë (IN) dhe Shërbime (S)	Infrastrukturë	Shërbime(S), Aktivitete Shiq. Argëtimi(SHA)
Nënkategoritë e përdorimit	INT3 Infrastrukturë e Transportit Ujor	INT4 Infrastrukturë e Transportit Ajror	S2 Shërbime Tregtare dhe Biznesi S2-7(Dyqane), AR3-6 (Fushe Golfi)
Tipologjia	Marine Turistike	Aeroport	Golf Resort
Tregues të zhvillimit	Për zbatimin e këtij plani, dhe përcaktimin e vendosjes dhe kritereve të detajuara për Zhvillimin e Marinës Turistike do të hartohet një studim dhe plan zhvillimi i detajuar	Sipas projektit	Sipas projektit
	NA	NA	NA

II.5.5 Njësiti struktural të sistemit ujor

Të gjitha njësiti e sistemit ujor ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë. Në çdo rast zhvillimi pranë trupave ujorë aplikohen distancat sipas zonave buferike të treguara në hartën e përdorimit të propozuar të tokës:

- Distanca 100m nga bregu i detit dhe bregu i lumit, mbrojtje strikte, ndalohen ndërtimet dhe çdo lloj aktiviteti dhe përdorimi privat që tjetëron territorin, aksesit është i lirë dhe sipas rastit duhet të plotësojë kushtet e sigurisë për jetën e individëve.

- *Distanca 300 m nga bregu i detit dhe rrjedha aktuale e lumit të Vjosës, mbrojtje e moderuar, ndalohen ndërtimet e përhershme, mund të aplikohet për leje për struktura të përkohshme, sezonale, me materiale të lehta të cmontueshme, në shërbim të aktivitetit turistik, mbajtjes pastër të territorit përreth dhe sigurisë për jetën e individëve/pushuesëve.*
- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Njësia NO.U.100, me sipërfaqe 31.63 ha ○ Njësia NO.U.101, me sipërfaqe 62.70 ha ○ Njësia NO.U.103, me sipërfaqe 274.31 ha ○ Njësia NO.U.142, me sipërfaqe 765.40 ha ○ Njësia NO.U.1514, me sipërfaqe 10.82 ha ○ Njësia NO.U.1515, me sipërfaqe 12.08 ha ○ Njësia NO.U.1522, me sipërfaqe 11.03 ha ○ Njësia NO.U.1523, me sipërfaqe 13.34 ha ○ Njësia NO.U.1524, me sipërfaqe 16.08 ha ○ Njësia NO.U.1528, me sipërfaqe 6.11 ha ○ Njësia NO.U.172, me sipërfaqe 46.14 ha ○ Njësia NO.U.177, me sipërfaqe 16.96 ha ○ Njësia NO.U.87, me sipërfaqe 116.32 ha ○ Njësia NO.U.88, me sipërfaqe 28.32 ha ○ Njësia NO.U.90, me sipërfaqe 28.47 ha ○ Njësia NO.U.91, me sipërfaqe 1994.38 ha | <ul style="list-style-type: none"> ○ Njësia NO.U.94, me sipërfaqe 1563.06 ha ○ Njësia QE.N.503, me sipërfaqe 120.48 ha ○ Njësia QE.U.104, me sipërfaqe 43.07 ha ○ Njësia QE.U.105, me sipërfaqe 96.12 ha ○ Njësia QE.U.106, me sipërfaqe 33.70 ha ○ Njësia QE.U.118, me sipërfaqe 11.34 ha ○ Njësia QE.U.1562, me sipërfaqe 0.01 ha ○ Njësia QE.U.1563, me sipërfaqe 0.96 ha ○ Njësia QE.U.1564, me sipërfaqe 7.63 ha ○ Njësia QE.U.1566, me sipërfaqe 44.22 ha ○ Njësia QE.U.1567, me sipërfaqe 39.95 ha ○ Njësia QE.U.208, me sipërfaqe 1.30 ha ○ Njësia QE.U.92, me sipërfaqe 37.52 ha ○ Njësia QE.U.93, me sipërfaqe 84.42 ha ○ Njësia QE.U.95, me sipërfaqe 12.18 ha |
|--|--|

KAPITULLI III: ALTERNATIVA TË ZHVILLIMIT/SKENARËT

Për një vlerësim të argumentuar për Projektin e Zhvillimit dhe kuptuar më mirë avantazhet/disavantazhet e tij në krahasim me alternativa të tjera dhe sidomos me më kryesorin ndër ta – alternativën e gjëndjes egzistuese – nevojitet një analizë krahasuese në planin mjedisor dhe social ekonomik. Proçesi i VSM ka synim që të japë informacion për alternativat e mundëshme duke kombinuar zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit. Për kryerjen e këtij procesi ekipi do të bëjë vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të Planit të zhvillimit eko turistik të zonës të prezantuar në PDZRK si dhe alternativat e pranueshme që mund të ishin ndjekur, pa ekzistencën e këtij plani të veçantë. Roli i VSM nuk është për të vendosur mbi alternativat që duhen zgjedhur, por për të dhënë informacion mbi performancën relative mjedisore, sociale dhe ekonomike të alternativave të ndryshme, për të lehtësuar në këtë mënyrë marrjen e vendimeve midis palëve të interesuara dhe për të ndihmuar në përcaktimin e parametrave dhe elementeve thelbësore të zhvillimit të Planit, si edhe ndryshimet dhe shtesat pozitive.

Tre skenarët e përzgjedhur bazohen në supozimet e mëposhtme:

a) Skenari zero, ku zhvillimi i ardhshëm ndjek trendet ekzistuese, dmth një rast ku nuk janë zbatuar propozime të veçanta të ndërhyrjes sipas planit;

b) Skenari i zhvillimit të Planit në zona bregdetare që nuk bejnë pjesë në asnjë nën zonë të peizazhit të mbrojtur, në zonën e Vjosë Nartë duke zhvilluar turizëm jo elitare por intensiv që ndryshon rrënjësisht potencialin e zhvillimit të turizmit elitare;

c) Skenari konservativ i mbrojtjes së mjedisit i cili lejon vetëm forma miqësore mjedisore të zhvillimit të turizmit, suksesi i të cilit qëndron mbi harmoninë e forcave më të gjera sociale dhe ekonomike, angazhimeve të forta të politikave dhe investimeve publike afatgjatë.

Për çdo alternativë, vlerësimi mbi 3 skenarët e propozuar më lart do të kryhet kundrejt objektivave të VSM, ndërsa do të bëhet përpjekje në mënyrë që efektet pozitive të secilit të përfshihen në alternativën përfundimtare të zgjedhur. Vlerësimi i skenarëve do të bëhet sipas një sistemi të gravitetit nga minus dy (-2) të një ndikimi të rëndë negativ në plus tre (3) të ndikimit pozitiv me shkallë që variojnë “-2, -1, 0 (pa ndikim), +1, +2, +3”.

Tre skenarët e vlerësuar, në mënyrë të detajuar kanë qëllimet si më mëposhtë:

Skenari A: Skenari i ekzistues (asgjë ose zero)

Skenari i parë është i bazuar në vazhdimin e trendeve ekzistuese. Ekosistemi i Pejsazhit të mbrojtur Vjosë – Nartë do të vazhdojë të përdoret në mënyrë spontane duke degraduar ose rigjeneruar ekosistemin. Mungesa e kontrollit të zhvillimit urban do të vazhdojë të ndikojë negativisht në cilësinë e peizazhit bregdetar dhe periurban, duke reduktuar kështu potencialin për zhvillimin e cilësisë së turizmit përgjatë bregdetit. Mungesa e infrastrukturës mjedisore, (trajtimi i ujërave të zeza dhe menaxhimi i mbeturinave) që ndikojnë në cilësinë e ujit të detit përbën një kërcënim të rëndësishëm për atraktivitetin e produktit turistik. Prania e përdorimeve me ndikim negativ mjedisor në përfundim të Vlorës, duke filluar nga Landfilli dhe duke vazhduar me portin Petrolifera dhe TEC-in zvogëlon atraktivitetin e bregdetit Adriatik. Modeli i turizmit i

fokusuar në turizmin “nje copë vend dhe një meter det” do të vazhdojë të gjenerojë një model të paekuilibruar të zhvillimit territorial në drejtim të bregdetit dhe braktisje të zonave malore. Pjesa tjetër e burimeve turistike, siç është rasti i peizazhit të mbrojtur do të vazhdojë të luajë një rol të vogël në produktin turistik, pa tërhequr më shumë vizitorë dhe pa një zhvillim të turizmit eko - miqësor me mjedisin.

Skenari B: Zhvillimi i turizmit elitare jashtë nën zonave të përdorimit të qëndrueshëm në Pajsazhin e mbrojtur (bregdeti i deltës së Vjosës ose pylli Sodës)

Skenari i dytë i përket zhvillimit intensiv të turizmit dhe përdorimit po intensive të burimeve natyrore. Bazuar në gjendjen egzistuese ky skenar do të kërkonte mjete financiare të medha për infrastrukturën dhe blerjen e tokës, në shumicën e rasteve pronë private. Këto investime të rënda në infrastrukturë do të ndryshojnë tërësisht karakteristikat lidhur me vendndodhjen e zonës dhe do të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit ndërkombëtar në numra shumë më të lartë duke sjellë si pasojë edhe investimet private. Vendndodhja e aeroportit rajonal në Akerni do ta bëjë Vlorën përfutuesen direkt si porta kryesore dhe pika e mbërritjes për vizitorët e huaj, por ndërkohë do të shkaktojë ndikim të rëndësishëm në mjedis nëpërmjet shndërrimit të tokës bujqësore dhe natyrore në sistem urban. Ky ndikim prek në mënyrë të drejtpërdrejtë Novoselen dhe në mënyrë të tërthortë të gjithë rajonin. Fokusi territorial i këtij lloji të turizmit është në zonën bregdetare, megjithatë rritja e turistëve ndërkombëtarë me shumë gjasa do të gjenerojë stimuj për përhapjen e shpërndarjeve pozitive mbi pjesët e tjera të zonës lidhur kjo me vendet kulturore dhe natyrore, të tilla si ajo e lagunës së Nartës. Por ndërkohë ekosistemi i lagunës do të ndikohet negativisht nga afërsia me aeroportin e ri. Nevojitet të merren masa për mbrojtjen e ligatinave nga ndotja zhurmat dhe aeroplanët si dhe masa të tjera zbutëse mjedisore për kontrollin e efekteve negative të zhvillimit të ri.

Skenari C: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i formave alternative të turizmit

Skenari tretë përmbush objektivin e mbrojtjes së mjedisit dhe marrjen e masave për të kufizuar rritjen e sistemit urban me qëllim për të ruajtur burimet e virgjëra natyrore të rajonit dhe cilësinë e mjedisit natyror. Skenari parashikon mbrojtjen e rreptë të tokës bujqësore, duke mos lejuar ose nese po një limit shumë të kufizuar të konvertimit të tokës bujqësore në tokë urbane. Ai përkrah ndalimin e shtrirjes urbane përgjatë bregdetit dhe përqendrimin e investimeve të reja në eko - turizem dhe turizëm elitare. Ky është lloji i turizmit që do të kishte më pak dëm në burimet mjedisore dhe shpërndarjen më uniforme territoriale të efekteve të saj të dobishme. Ndërkohë, megjithatë, ky skenar karakterizohet nga perspektivat më të gjata kohore në mënyrë që të ngrihet dhe kërkon investime publike afatgjatë për mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës mjedisore.

Zhvillimi i Projektit është parashikuar në nën zonën B, C dhe A të Pejsazhit të Mbrojtur Vjosë - Nartë dhe do të japë impulse të mëdha për rajonin dhe do të jetë një projekt prestigji për turizmin e qëndrueshëm dhe teknikat e vetë-qëndrueshme. *Ndërtimet e lehta turistike të propozuara në Zvernec, Godull, për rreth Kënetës së Kallëngës, jug të fshatrave Dëllënjë dhe Delisuf, për rreth lumit*

të vjetër të Vjosës dhe përfshin disa njësi strukturore me lartësi deri në 10 m, me koeficientë shfrytëzimi të tokës deri në 5% dhe me intensitet ndërtimi vetëm 0.01 respekton menaxhimin dhe operimin ekologjikisht të qëndrueshëm duke synuar ndikimin sa më të ulët të mundshëm në mjedis. Teknologjitë bashkëkohore të përdorura përforcojnë objektivin e një projekti të qëndrueshëm. Trajtimi i ujërave të përdorura do të realizohet në kompleks dhe ujit i ricikluar do të përdoret për ujitjen e hapësirave të gjelbërta. Gjithashtu, trajtimi i mbetjeve organike do të realizohet në kompleks, dhe do të ripërdoren për trajtimin e produkteve bujqësore pranë kompleksit, si dhe do të studiohen mundësitë e përdorimit për prodhimin e gazit për energji. Furnizimi i kompleksit me ujë të pijshëm do të realizohet nëpërmjet teknologjive të ç'kripëzimi i ujit të detit.

Tre skenarët e mësipërm janë në përputhje edhe me diskutimin e në Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut të Vlorës të përshkruara në PPV (2016) si dhe Planin e Përgjithshëm Kombëtar Disa fraza janë adekuate edhe për diskutimin e alternativave në këtë VSM.

III.1 VLERËSIMI I SKENAREVE

III.1.1 Skenari A: Skenari zero

Skenari i tanishëm nënkupton se zona do të vazhdojë të konservohet dhe të zhvillohet spontanisht. Duke ruajtur këtë trend zhvillimi zona e mbrojtur me se shumti degradohet nga : faktorë natyrorë të mos funksionimit të ekosistemit lagunor, mbetjeve, zjarreve, erozionit, bimesisë. Ndërkohë që avantazhet janë ruajtja e statusit mbrojtës pa masa mbrojtëse për periudhen (2004-2013).

Tabela III-1: Vlerësimi i skenarit zero (skenari A)

Objektiva mjedisore strategjike për komponentët kryesorë	Graviteti
Për tokat objektivi mjedisor mbështetet mbi LIGJIN Nr.9244, datë 17.6.2004. Për mbrojtjen e tokës Bujqësore, dhe LIGJIT nr. 10431, date 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit";	0
Për Ujin objektivi mjedisor mbështetet në LIGJ Nr. 111/2012 , Për menaxhimin e Integruar të burimeve ujore" dhe LIGJIN nr. 10431, date 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" Direktiva Kuader e Ujit) (transpozuar në legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore"); VKM nr. 246, date 30.04.2014"Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore	-2
Për Biodiversitetin – FLORA , objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; LIGJIN "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër""; VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian", Ligjin e përmirësuar për Biodiversitetin për Marrëveshjen e Nagoya-s, 2019, Ligj Nr. 48/2016 Për Disa	+3

Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr. 9385, Datë 4.5.2005, “Për Pyjet Dhe Shërbimin Pyjor”, Të Ndryshuar.	
Për Biodiversitetin FAUNA, objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”; LIGJIN “Për Zonat e Mbrojtura”, nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”; VKM nr. 866, date 10.12.2014 “Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian” dhe LIGJIN nr. 10253, date 11.3.2010 “Per Gjuetie”	+3
Për Biodiversitetin-Peshqit objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”; LIGJIN “Për Zonat e Mbrojtura”, nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”; VKM nr. 866, date 10.12.2014 “Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian”.	+3
Për mbetjet objektivi mjedisor mbështetet në VKM nr. 175, date 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025	-3
Për Ajrin objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 162/2014, date 12.04.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit " dhe VKM nr. 594, date 10.09.2014 " Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit	0
Për Zhurmat objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis	0
Për Zhvillimin urban dhe planifikimin e territorit objektivi mjedisor mbështetet në Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, 2015	-2
Për ruajtjen e Mjedisit natyror në zonat me mbrojtje me status të veçante mbrojtjeje . Objektivi mjedisor mbështetet në Konventa e Bernes (Bern, 1979) (ratifikuar nga parlamenti i Shqipërisë), Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar në 29.3.1996), Direktiva e Keshillit 92/43/EEC për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të flores e faunes se eger. Shqipëria e ka perafuar pjesërisht këtë direktive permes ligjeve: - Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”; Ligji “Për Zonat e Mbrojtura”, nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”; dhe - VKM nr. 866, date 10.12.2014 “Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian”.	+3
Shuma pikë	+5

III.1.2 Skenari B: (Skenari 2)

Sipas këtij skenari zhvillimi i turizmit do të jetë intensiv dhe infrastruktura do të jetë e renduar me ndikime për ekosistemet e ndjeshme natyrore midis të cilëve edhe Peizazhi i mbrojtur Vjosë – Nartë.

Tabela III-2: Vlerësimi i skenarit dy (skenari B)

Objektiva mjedisore strategjike për komponentët kryesorë	Graviteti
Për tokat objektivi mjedisor mbështetet mbi LIGJIN Nr.9244, datë 17.6.2004. Për mbrojtjen e tokës Bujqësore, dhe LIGJIT nr. 10431, date 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit";	-3
Për Ujin objektivi mjedisor mbështetet në LIGJ Nr. 111/2012 , Për menaxhimin e Integruar të burimeve ujore" dhe LIGJIN nr. 10431, date 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" Direktiva Kuader e Ujit) (transpozuar në legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore"); VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore	-3
Për Biodiversitetin – FLORA, objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; LIGJIN "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"; VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian" dhe LIGJIN nr. 10253, date 11.3.2010 "Per Gjetime"	-1
Për Biodiversitetin –FAUNA, objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; LIGJIN "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"; VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian" dhe LIGJIN nr. 10253, date 11.3.2010 "Per Gjetime"	-1
Për Biodiversitetin – Peshqit, objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; LIGJIN "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"; VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian" dhe LIGJIN nr. 10253, date 11.3.2010 "Per Gjetime"	-1
Për mbetjet objektivi mjedisor mbështetet në VKM nr. 175, date 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025	-3
Për Ajrin objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 162/2014, date 12.04.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit " dhe VKM nr. 594, date 10.09.2014 " Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit	-2
Për Zhurmat objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis	-1
Për Zhvillimin urban dhe planifikimin e territorit objektivi mjedisor mbështetet në Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, 2015	+3
Për ruajtjen e Mjedisit natyror në zonat me mbrojtje me status të veçante mbrojtjeje . Objektivi mjedisor mbështetet në Konventa e Bernes (Bern, 1979) (ratifikuar nga parlamenti i Shqipërisë), Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar në 29.3.1996), Direktiva e Keshillit 92/43/EEC për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të flores e faunes se eger. Shqipëria e ka përfunduar pjesërisht këtë direktive permes ligjeve: - Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; Ligji "Për Zonat e	-1

Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër""; dhe - VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian".	
Shuma pikë	-13

III.1.3 Skenari C: (skenari 3)

Tabela III-3: Vlerësimi i skenarit tre (skenari C)

Objektiva mjedisore strategjike për komponentët kryesorë	Graviteti
Për tokat objektivi mjedisor mbështetet mbi LIGJIN Nr.9244, datë 17.6.2004. Për mbrojtjen e tokës Bujqësore, dhe LIGJIT nr. 10431, date 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit";	-1
Për Ujin objektivi mjedisor mbështetet në LIGJ Nr. 111/2012 , Për menaxhimin e Integruar të burimeve ujore" dhe LIGJIN nr. 10431, date 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" Direktiva Kuader e Ujit) (transpozuar në legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore"); VKM nr. 246, date 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore	0
Për Biodiversitetin - FLORA, objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; LIGJIN "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër""; VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian" dhe LIGJIN nr. 10253, date11.3.2010 "Per Gjuetie"	-1
³ Për Biodiversitetin FUANA, objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; LIGJIN "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër""; VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian" dhe LIGJIN nr. 10253, date11.3.2010 "Per Gjuetie"	-1
Për Biodiversitetin - PESHQIT, objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; LIGJIN "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; LIGJIN nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër""; VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian" dhe LIGJIN nr. 10253, date11.3.2010 "Per Gjuetie"	0
Për mbetjet objektivi mjedisor mbështetet në VKM nr. 175, date 19.1.2011 "Për	+3

miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025	
Për Ajrin objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 162/2014, date 12.04.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit " dhe VKM nr. 594, date 10.09.2014 " Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit	0
Për Zhurmat objektivi mjedisor mbështetet në LIGJIN nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis	0
Për Zhvillimin urban dhe planifikimin e territorit objektivi mjedisor mbështetet në Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, 2015	+3
Për ruajtjen e Mjedisit natyror në zonat me mbrojtje me status të veçante mbrojtjeje . Objektivi mjedisor mbështetet në Konventa e Bernes (Bern, 1979) (ratifikuar nga parlamenti i Shqipërisë), Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar në 29.3.1996), Direktiva e Keshillit 92/43/EEC për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të flores e faunes se eger. Shqipëria e ka përfunduar pjesërisht këtë direktive përmes ligjeve: - Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"; Ligji "Për Zonat e Mbrojtura", nr. 8906, datë 6.6.2002, të amenduar; Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër""; dhe - VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian".	0
Shuma pikë	+3

Analiza e pikëzimit është si me poshte: skenari A rezulton me + 5 pikë, pa zhvillim, skenari B me -13 pike nderkohe që skenari C, i propozuar nga investitori rezulton + 3 pike. Po të shtojmë funksionimin ose jo të shërbimeve të ekositemit (të rëndësishme në skenari C, me plus 5 pikë) atehere pikezimi me i lartë i takon skenarit C.

KAPITULLI IV: PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT

IV.1 STATUSI I ZONËS SË MBROJTUR

Zona e Peizazhit të Mbrojtur (ZPM) Vjosë-Nartë (Kategoria e V IUCN) është një kompleks ligatinor që shtrihet në Rajonin e Vlorës. Vetë zona mbulon një sipërfaqe prej 19, 738 hektarësh. Lartësia e kompleksit varion nga 0 - 246 m mbi nivelin e detit. Pika më e lartë ndodhet midis fshatrave Hoshtime dhe Llakatund. ZPM shtrihet në territorin e dy ish-komunave (aktualisht njësi të qeverisjes vendore, Bashkia Vlore): Komuna Novoselë në veri të saj dhe Komuna Qëndër në jug. Zona e projektit përfshin 18 fshatra (Zverrnec, Nartë, Panaja, Oshtime, Kërkovë, Bestrovë, Aliban, Poro, Novoselë, Mifol, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Trevllazër, Akërnë, Bishan, Delisuf, Dellinjë) me një popullsi prej 24 000 banorësh. Qyteti më i afërt është Vlora, një prej qyteteve më të mëdha të Shqipërisë me një popullsi prej 106,000 banorë.

Disa prej mjediseve kryesore të Vjosë-Nartës janë ligatinat, tokat bujqësore, pyjet dhe zonat urbane (Tabela IV-1). Mjediset ligatinore zene 37% të sipërfaqes së përgjithshme. Mjedisi tjetër kryesor është toka bujqësore që zë afro 33% të sipërfaqes. Pyjet përbëjnë habitatin e tretë dhe mbulojnë 6% të territorit. Pjesa qendrore e ZPM është laguna e Nartës, një lagunë e cekët prej 2 900 hektarësh, rrethuar nga kodra, në pjesën jugore dhe lindore, tokë bujqësore në veri dhe dy laguna të vogla në veri-perëndim.

Tabela IV-1: Përdorimi i territorit në Zonën e Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë (MoE, 2004)

Habitatet kryesore	Sipërfaqja (në ha)
Ligatina	10,210
Pyje	1,167
Toka bujqësore	7,798
Zona urbane	277
Aeroport	286
Total	19,738 ha

Nënzonat kryesore në brendësi të kompleksit janë: Laguna e Nartës dhe kriporet, Ish-rezervati i Pishë-Poros, Lagunat e Kallengës, Kodrat e Panajasë dhe Fusha e Akërnisë.

IV.1.1 Laguna e Nartës

Narta është sipërfaqja ujore kryesore e zonës. Pjesa veriore e saj u transformua në kripore të cilat sot mbulojnë një sipërfaqe prej afro 1 500 ha. Kriporja dhe lagunat ndahen nga një digë prej 13.8 km². Laguna e Nartës (2 900 ha) ndahet nga deti prej një brezi ranor, i mbuluar në pjesën më të madhe të tij prej pyllit të pishave. Laguna komunikon me detin nepermjet dy kanaleve

artificiale. Kanali jugor është 200 m i gjatë, 6-48 m i gjerë dhe 0.2 -1.8 m i thellë. Kanali verior është 800 m i gjatë, 11-60 m i gjerë dhe 0.3-0.5 m i thellë. Kanali ka një debit prej 2.2 – 4.3 m³/s., të dy kanalet bllokohen shpesh për shkak të mbushjes nga sedimentet.

Uji i lagunës është tepër i kripur me shifra që në pikun e verës kapin vlerën 78.0%. Gjatë dimrit kripësia zbret në 36 % dhe është e ngjashme me detin Adriatik. Pjesa lindore e lagunës e cila ndikohet pak nga ujrat detare, shfaq luhatje të theksuara të kripësisë. Ujërat e lagunës janë pak alkaline (pH 8.4-8.8). Sasia e Oksigjenit të tretur varion midis 5-10 mg L⁻¹. Kur sasia e ujit të ëmbël është mjaft e ulët (veçanërisht gjatë verës) dhe kur kanalet e komunikimit janë të bllokuara nga mbushjet, një sipërfaqe prej afro 1 000 ha thahet ndërsa një pjesë tjetër prej afro 800 ha kap një thellesi prej 10 cm. Kjo thatësi është mjaft e dëmshme për biotën e lagunës.

IV.1.2 Pishë-Poro

Pishë-Poro, deri në 2004 një “Rezerve Natyrore e Menaxhuar”, përfaqëson duna ranore të mirë zhvilluara (deri në 6-8 m lartësi) si dhe bimësi psamofite, higrofile dhe halofite. Pjesa kryesore e rezerves mbulohet nga pylli i pishës dhe një pjesë e dunave ranore të Pishë-Poros janë shkatërruar si pasojë e marrjes së paligjshme të rërës. Megjithatë demtimet e mësipërme, ish “Rezerva Natyrore e Menaxhuar” është akoma në gjendje të mire. Pjesët e degraduara të saj mund ta rrimarin veten nëse bëhen ndërhyrjet e duhura.

IV.1.3 Kallenga

Kallenga është një lagunë e ceket prej 450 ha. Lidhet artificialisht me detin nëpërmjet një kanali që është hapur vetëm kohët e fundit. Përdoret për peshkim me rrjeta ndërkohë që së fundi në gryken e kanalit është ndërtuar dhe një dajlan.

IV.1.4 Kodrat e Panajasë

Kodrat e Panajasë shtrihen në pjesën lindore dhe jugore të ZPM. Pika më e lartë arrin 246 m dhe ndodhet midis Trevllazerit dhe Llakatundit. Makia mesdhetare dhe pylli i dushkut dikur tipike për këtë zonë, sot janë zëvendësuar nga ullishtat.

IV.1.5 Kriporet

Përfshin pjesën e dikurshme veriore të lagunës së Nartës e transformuar në Kripore në fillimet e viteve 50'. Sipërfaqja e sotme është afro 1,500 hektare. Përbëhet nga shumë pellgje të cekët në brëndësi të cilave ka diga dhe ishuj të vegjël që ti kthejnë kriporet në vënde tepër interesante për shpendët e ujit folezues.

IV.1.6 Fusha e Akërnisë

Shtrihet në veri të lagunës së Nartës dhe kriporeve. Dikur një tokë kënetore, sot kjo hapsirë është zëvendësuar nga toka bujqësore. Deri në fillimin e viteve 90', fusha mbulohej nga një rrjet i

kompletuar ujitjeje dhe kullimi. Më pas, një pjesë e mirë e rrjetit të ujitjes dhe kullimit u shkatërrua. Një pjesë e madhe e tokës së dikurshme bujqësore sot është braktisur ose përdoret për kullotje.

IV.1.7 Zonimi

Kufijtë e Zonës së Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë të përcaktuara në vitin 2004 (MoE, 2004) së bashku me Planin e Menaxhimit ishin të bazuara në gjendjen ekologjike, ekonomike dhe sociale. Sipas këtij koncepti të zonimit territori i Zonës së Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë ndahet në katër nën zona të mëdha:

1. Zona Qëndrore
2. Zone e Përdorimit Traditional
3. Zone e Zhvillimit të Qëndrueshëm
4. Zona e Zhvillimit

Zona qëndrore ka si qëllim të sigurojë një zonë referencë natyrore të pashqetësuar. Ajo përfshin habitate natyrore, gjysëm natyrore, breglumore, pyje bregdetare, laguna dhe duna ranore. Zonat qëndrore përfshijnë Grykë derdhjen e Vjosës, Pyllin e Pishë-Poros, lagunat e Kallengës, një pjesë të lagunës së Nartës (Shamoduri) si dhe dy monumentet e Natyrës: Ishullin e Zverrnecit dhe laguna Limopua. Kjo zonë ndahet në dy nënzona, përkatësisht A1 dhe A2.

Sipas vlerësimit të Planit të menaxhimit, nënzona A1 konsiderohet me Ruajtje të veçante dhe veprimtaritë zhvillohen si më poshtë; Hyrja organizohet dhe kontrollohet nga Autoriteti Manaxhues. Veprimtaritë e pajtueshme përfshijnë rrugëtime natyrore, vrojtime të florës dhe të faunes si dhe peshkim të përgjegjshëm, monitorim shkencor, menaxhim kundër zjarreve, zhvendosje të mbetjeve urbane dhe mirëmbajtje të shtigjeve turistike.

Nënzona A2 konsiderohet si nënzona në Ruajtje, ku në ndryshim nga A1, lejohen struktura të lehta turistike. Hyrja për qëllime edukative apo rekreacion natyror kontrollohet nga Autoriteti Manaxhues.

Zona B u mundëson banorëve vendas të përhershëm apo sezonale në Zonën e mbrojtur, të vazhdojnë mënyrën e tyre të jetesës me mjete tradicionale. Zona lejon subjektin publik të respektojë kufijtë e fushës rezidente dhe aktivitetet ekonomike. Zona përfshin tokë bujqësore (Dëllinje, Zhuke), Kripore dhe Pjesën Lindore të Lagunës së Nartës.

Sipas planit të menaxhimit veprimtaritë e pajtueshme në Zonën B1 e cila njihet si Zonë e Përdorimit Bujqësor Kullotje, bujqësi dhe peshkim tradicional në përputhje me Planin e Menaxhimit të zonës; Hyrja është e lire, ndërkohë që zona B2 e Përdorimit Industrial, lejon nxjerrjen e kripës. Hyrja në zonë duhet kryer në mënyrë të kontrolluar në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Autoriteti Manaxhues.

Në PDZRK (2019) zona Vjosë – Nartë kategorizohet si Peizazh i Mbrojtur në Kategorinë e V^{të} (Pestë) që nënkupton se nuk ka një zonim dhe se statusi i saj i mbrojtjes është ulur një klasë më poshtë. Nga ana tjetër, ky nivel i ri mbrojtjeje supozon një ndërthurje midis zonës natyrore dhe

zhvillimit të qëndrueshem. Sipas Adrian Phillips (2002)¹³ ndër principet më të rëndësishme të menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur nënvizohet se : *“Menaxhimi duhet të ndërmerret me dhe përmes njerëzve lokalë, dhe kryesisht për ta dhe prej tyre. Ky parim pranon që përfshirja e plotë e njerëzve lokalë është thelbësore dhe se zonat e mbrojtura të Kategorisë V nuk duhet të planifikohen kurrë kundër interesave të tyre afatgjata”*.




Figura IV-1: Harta e Zonimit të Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë

Në kategorinë veprimtari të papajtueshme të kësaj zone përfshihen ato të cilat janë në kundërshtim me qëllimin e krijimit të zonës. Këtu futet gjuetia, shaktërrimi dhe shqetësimi i llojeve të faunës dhe florës, menaxhimi i paautorizuar i habitateve, hedhja dhe depozitimi i plehrave, derdhja e patrajtuar e ujërave të ndotur, ndërtimi i stukturave industriale të

¹³ Phillips, Adrian, (2002). *Management Guidelines for IUCN Category V Protected Areas: Protected Landscapes/Seascapes*. IUCN Gland, Switzerland and Cambridge, UK. xv + 122pp.

pashoqëruara nga Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis si dhe futja e llojeve bimore apo shtazore të huaj.

Zona C, ose Zona e përdorimit të qëndrueshëm mundëson ekzistencën e aktiviteve ekonomike të qëndrueshme. Përfshin fushën e Bilbilit, Akërnisë, Novoselës, Skrofotinës, Panajanë dhe Nartën si dhe zonën kodrinore të Kërkoves dhe Bestroves. Këtu nuk lejohen aktivitete në kundërshtim me qëllimin e krijimit të zonës. Këtu futet gjuetia, shkatërrimi dhe shqetësimi i llojeve të faunës dhe florës, menaxhimi i paautorizuar i habitateve, hedhja dhe depozitimi i plehrave, derdhja e patrajtuar e ujërave të ndotur, ndërtimi i stukturave industriale të pashoqëruara nga Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis si dhe futja e llojeve bimore apo shtazore të huaj.

Zona e zhvillimit ekonomik mundëson zhvillimin e aktiviteteve të reja ekonomike me natyrë të qëndrueshme duke lejuar aktivitete ekonomike që zbatojnë rregullat mjedisore por nuk mbështet aktivitete të tjera përveç industrisë së turizmit. Në këtë zonë ndalohen aktivitetet si gjuetia, shkatërrimi dhe shqetësimi i llojeve të faunës dhe florës, menaxhimi i paautorizuar i habitateve, hedhja dhe depozitimi i plehrave, derdhja e patrajtuar e ujërave të ndotur, si dhe futja e llojeve bimore apo shtazore të huaj.

IV.1.8 Faktorët kërcënues të integritetit të Zonës së Peixazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë

Për shkak të ndërveprimeve të ndryshme mjediset e këtij kompleksi shoqërohen me luhatje ditore dhe sezonale të kripësisë, kryesisht në laguna dhe estuaret. Kripësia është shumë e ndryshueshme për shkak të ujërave të ëmbla që hyjnë nga lumenjtë, kanalet dhe pellgu ujëmbledhës, duke u rritur në sasi gjatë periudhave me shi. Uji i kripur hyn përmes baticave duke shkaktuar rritje të kripësisë me rritjen e temperaturës, e shoqëruar me rritje konkurente të avullimit. Kur avullimi është i lartë, kripësia mund të jetë më e madh se ajo e detit, dmth, ujrati mund të jetë hypersaline.

Përveç kësaj, dobësimi ditor dhe rrjedha e baticave në grykëderdhje rezultojnë në një paqëndrueshmëri të fundin e shtratit të rrjedhës (grykëderdhjen), si dhe organizmat që jetojnë në grykëderdhje mund të jenë të ekspozuar çdo ditë në ajër dhe të përmbytur në ujë.

Zona e marrë në konsideratë aktualisht është nën veprimin e faktoreve të ndryshëm që çojnë integritetin dhe funksionimin e ekosistemeve. Në këtë trajtim përmendim:

(i) Ndikime që vijnë nga pellgu ujëmbledhës. Burimet me ujë të freskët, toka bujqësore e braktisur dhe plantacionet e ullinjve tregojnë një tendencë të rritjes së bimësisë, rritje e cila do të çojë në cënimin e habitateve në mungesë të masave menaxhuese të duhura. Rezervuari me ujë të freskët i Zvërnecit tani është dominuar nga bimë të tilla si *Phragmites communis*, *Typha angustifolia*, *Phyllirea latifolia*. Pasqyrat ujore janë zvogëluar ndjeshëm dhe rezervuari nuk është më i përshatshëm për shpend migrues dhe dimërues që kanë nevojë për burime uji të freskët.

(ii) Mbushja e kanaleve të komunikimit të lagunës. Bllokimi e kanaleve të komunikimit të lagunës është një fenomen i shpeshtë që rrit rrezikun e eutrofizimit të lagunës nëpërmjet uljes së nivelit të ujit të lagunës, uljes së hyrjes së oksigjenit të tretur dhe rritjes së nivelit të kripshmërisë. Mbushja është bërë në ditet tona një fenomen natyror i cili është nxitur se pari nga ndërhyrje hidrologjike të kaluara mbi Lumin e Vjosës. Bllokimi i kanaleve çon në eutrofizimin e lagunës dhe me pas në reduktimin e vlerave të biodiversitetit dhe të aktiviteteve ekonomike të bazuara në shfrytëzimin e burimeve natyrore si peshkimi, gjuetia etj.

(iii) Erozioni i digave dhe ishujve në kripore për shkak të ererave dhe stuhive. Digat dhe ishujt e brendshëm të kriporeve kanë treguar shenja të qarta të erozionit për shkak të ererave dhe stuhive të shoqëruara nga levizje të forta të dallgëve. Erozioni nuk është i dëmshëm vetëm për interesin ekonomik të kriporeve por gjithashtu ul vlefshmërinë e zonave folelizuese për një numër të madh shpendësh të rrezikuar në shkallë kombëtare, rajonale dhe lokale.



Figura IV-2: Aktivitete cënuese të integritetit të ekosistemeve në Zonën e Mbrojtur

(iv) Invadimi nga specie jo native. Përmendim *Agave Americana* është mbjelle në dunat ranore të zonës së Zvernecit. Ky lloj i huaj, tregon tashmë shenja pushtimi mbi llojet tipike të dunave ranore. Është e qartë që planet e menaxhimit duhet të kontrollojnë shpërndarjen e saj të mëtejshme në zonë.

(v) Ndotja nga përdorimi i pesticideve për bujqësinë. Pesticidet janë të përdorur gjerësisht në bujqësi. Sipas studimeve të ndërmarra gjatë diagnostikimit të zonës, sasia e pesticideve të përdorura për ha është e lartë dhe ka shumë të ngjarë që të ndikojë në gjallesat e shpërndara në habitatet tokësore dhe ujore.

(vi) Ndotja nga mbetjet e ngurta urbane. Ndotjet e ngurta urbane nuk menaxhohen siç duhet dhe janë të shpërndara gjerësisht në peizazh dhe veçanërisht në afërsi të zonave urbane. Përveç dëmtimit të bukurisë peizazhore të zonës, mbetjet urbane mund të ndotin ujrat nëntokësore. Ka shumë të ngjarë që ndotja të përfshijë sipërfaqje ujore edhe me të mëdha nëse shpërndarja e tyre nuk kontrollohet nga autoritetet vendore.

(vii) Marrja e ujit nga kriporja. Stacioni i pompimit të ujit nga deti nuk është me në funksion ndaj dhe kriporja është e detyruar të marre ujë nga laguna. Çdo vit nëpërmjet pompave thithet rreth 4 milion m³ uje (rreth 10 % e vëllimit të ujit të lagunës) gjatë një periudhë kohe dy mujore e

cila konsiderohet shumë kritike. Kur kanalet e komunikimit janë të bllokuara, kriporja e nxit me shpejt mungesën e ujit dhe eutrofizimin e lagunës së Nartës.

(viii) Peshkimi ilegal. Në vitet e fundit, peshkimi ilegal (peshkatore të palicensuar, përmasat e syzeve të rrjetave etj.) po i dëmtojnë rëndë burimet e peshkimit në lagunën e Nartës. Metodot e përdorura nuk janë përzgjedhëse dhe sjellin dëmtim të gjithë biotës dhe burimeve ushqimore në përgjithësi. Sipas peshkatoreve lokale, peshkimi bregdetar me anije të medha që krehin fundin e detit është një aktivitet tjetër i jashtëligjshëm, i cili dëmton shumë rëndë burimet e peshkimit bregdetar dhe ndikon tepër negativisht në hyrjen e peshkut në lagunat bregdetare.

(ix) Shpyllëzimi. Prerjet, shkulljet, mbikullotja, dhe djegja progresive e pyjeve janë vërejtur veçanërisht në Pishë - Poro dhe në kodrat e Panajasë. Zjarret artificiale janë një shkak tjetër shkatërrimi viteve të fundit. Zakonisht ato përhapen nga barinjtë për krijimin e kullotave të reja, përmirësimin e strukturave të tokës dhe të kullotave. Kjo praktikë e gabuar dëmton jo vetëm florën dhe faunën por gjithashtu ul cilësinë e tokës dhe rrit erozionin e saj.

(x) Planifikimi urban – zhvillimi i pakkontrolluar. Pozicioni gjeografik, klima, peizazhi mjaft tërheqës, pamjet arkeologjike dhe historike, ofrojnë kushte të larta për turizëm dhe pushim për vizitorët vendas dhe të huaj. Por ndërtimi i vendqëndrimeve turistike në zona ekologjikisht të ndjeshme përbën një rrezik të madh për shumë lloje dhe habitate të rrezikuara.

(xi) Ndërrhyrjet hidrologjike në Limopua, Kallengë dhe Nartë. Të gjitha lagunat bregdetare janë lidhur me detin nepërmjet kanaleve të komunikimit. Ndërkohë që kanalet e reja të lagunës së Nartës janë hapur 30 vjet me parë, Kallenga dhe Limopua janë lidhur vetëm kohët e fundit. Ndërrhyrje të tilla kanë sjellë ndryshime në parametrat hidrologjik dhe kanë sjellë ndikim negativ mbi florën dhe faunën që popullon zonën. Të dyja ligatinat kanë në ditët tona shumë pak shpend.

(xii) Toka dhe bujqësia. Tharja e kënetave në zonë ka mbuluar një sipërfaqe prej mijëra hektarësh dhe është përfunduar në vitet 1970'. Ligatinat e Akërnisë (veriu i kriporës së Nartës) kanë qënë subjekt i punimeve kulluese.

(xiii) Eutrofizimi. Laguna Nartë konsiderohet si një lagunë mesatarisht e eutrofizuar. Sasia e oksigjenit të tretur në ujë është shumë e ulët gjatë verës dhe çon në një eutrofizim të shpejtë të lagunës. eutrofizimi është shkaktuar nga reduktimi i prurjeve të ujit të freskët në lagunë, hyrja e ujrave të ndotura se bashku me ndotës të tjerë organike dhe inorganike (në pjesën jug-perëndimore të lagunës) si dhe mungesën e hyrjes së ujit të detit në lagunë nëpërmjet kanaleve të komunikimit me detin. Si më sipër, eutrofizimi zvogëlon diversitetin e florës dhe faunës dhe kufizon burimet natyrore që mund të shfrytëzohen nga komuniteti lokal.

(xiv) Erozioni. Është vërejtur në shtratin e lumit të Vjosës si dhe përgjatë/ bregut. Lumi Vjosë në disa pjesë të tij ka gërryer brigjet duke shkaktuar gjithashtu edhe humbjen e tokave kullosore. Erozion bregdetar është vërejtur në grykëderdhjen e Vjosës si dhe në zonën e Treportit. Duna ranore tipike dhe natyrore janë shkatërruar pjesërisht. Nëse nuk do të kontrollohet, duna të tjera ranore do të zhduken në vitet e ardhshme.

(xv) Përmbytjet. Përgjatë gjithë luginës së Vjosës po ndodh edhe shpyllëzimi masiv, tharja e rrapit lumor që çon në degradimit një prej pasurive më të rëndësishme ujore të Shqipërisë. Lumi disa herë ka përmbytur zonat përreth duke shkaktuar dëme të mëdha në kompanitë e inerteve dhe në ekonominë e vogla bujqësore.

(xv) Ndërgjegjësim i ulët mjedisor. Edhe kjo zone ashtu si e gjithë Shqipëria, ka trashëguar një nivel të ulët të ndërgjegjësimit mjedisor. Përpjekje të vogla janë ndërmarrë në vitet e fundit por ndërgjegjësimi publik është ende në fazat e tij fillestare. Aktualisht, programet edukative të shkollës nuk janë të fokusuara në ruajtjen e natyrës.




Figura IV-3: Zonat e dëmtuara nga djegjet

IV.2 MONUMENTET NATYRORE

IV.2.1 Ishull i Zvernecit

Ishulli Zverneci gjendet në pjesën jugore të Lagunës së Nartës dhe është i mbuluar me një bimësi me gjelbërim të përhershëm të dominuar nga bima e selvisë (*Cupressus sempervirens*). Brezi i bimësisë së lartë dominohet nga *Cupressus sempervirens* në shkallën mbi 80% dhe në një shkallë të ulët nga speciet e *Quercus ilex*, *Quercus pubescens* dhe *Pinus* spp., të cilat arrinë një lartësi 8-10m. Mbulesa e bimësisë është mjaft e dendur. Shtresa bimore e shkureve dominohet nga speciet e *Myrtus communis*, *Pistacia lentiscus*, *Laurus nobilis*, *Rubus* spp., *Phillyrea angustifolia*, *Olea olaster*, etj. Shtresa e bimësisë barishtore paraqitet më e rrallë dhe speciet më të shpeshta janë: *Chrysopogon gryllus*, *Asparagus acutifolius*, *Dactylis glomerata*, *Desmazieria rigida* etj. Nën këtë zonë, të dominuar nga selvia - *Cupressus sempervirens* (në lartësi 1 -2 m deri në 20 m mbi nivelin e detit) shkëmbinjtë (masiv i butë) mbështesin një shoqërim bimor të mbizotëruar nga specie kripëdashëse (halofilike) si: *Suaeda maritima*, *limonium oleifolium*, *Limonium vulgare*, *Arthrocnemum glaucum*, *Halimione portulacoides*, *Elymus pycnanthus*, specie këto karakteristike të shoqërimit *Suaedetum maritimae*.

Aktualisht Ishulli është mjaft i vizitueshëm për shkak të Manastirit me të njëjtin emër dhe ndërkohë që nuk ka ndikime të ndjeshme në drejtim të cënimit të tërësisë natyrore, mirëadministrimi i vizitorëve dhe mbetjeve mbetet një sfidë për sigurimin e integritetit dhe funksionimit të ekosistemeve të tij.

IV.2.2 Dunat ranore

Dunat ranore gjenden në vijën bregdetare të ekspozuar të zonës së Nartës nga delta e Vjosës deri në plazhin e vjetër të Vlorës. Ky rajon krahas të tjerave dallohet për praninë e disa prej dunave më të mëdha të Shqipërisë, me një nga shtrirjet më të mëdha në "kodrat e Zvernecit". Lartësia e tyre varion nga 1-2 m në 4-5 m.

Brezi ranor përgjatë vijës bregdetare është plotësisht i zhveshur nga bimësia në një gjatësi që nganjëherë shtrihet deri në 30 m. Mungesa e bimësisë korrespondon me një jetë aktive të gajllesave shtazore të ndryshme. Pas kësaj zone takohet bimësia e *Fanerogameve* në brez tipik ekotonesh, që aktualisht karakterizohet nga shpëlarja e rërës dhe prania e konsiderueshme e kripës si rezultat i fnoemneve të ndryshme. Këtu takohen speciet pioniere si *Cakile maritima*, *Xanthium strumarium* subsp. *italicum*, *Salsola kali*, që fillimisht paraqiten të rralla dhe izoluara, ndërkohë që me tej dendësohen me largimin nga nga vija bregdetare. Bimësia e këtij rripi ranor i përket shoqërimit bimor pioniere *Cakilo-Xanthietum italicum*. Me largimin gradual nga vija bregdetare dhe me rritjen e lartësisë së dunave ranorepamja e bimësisë fiton tipare të reja duke shprehur dominimin nga speciet *Ammophila arenaria* subsp. *arundinaceae*, *Elymus farctus*, *Echinophora spinosa* etj. Në dunat e rërës, këto specie janë bimë të rëndësishme për ndërtimin e këtyre sistemeve. *Ammophila arenaria* subsp. *arundinacea* përfaqëson speciet karakteristike të

shoqërimit bimor *Ammophiletum*. Degradimi i dunave ranore dhe formimi i depresioneve shoqërohet me bimësi të ndryshme, të dominuara nga *Sporobolus punges*, specie kjo karakteristike e shoqërimit bimor *Sporoboletum*. Shoqërimi i *Ammophiletum* përbën fazën e fundit më të evoluimit të bimësisë së dunave ranore ose vijës kufitare midis bimësisë së dunës dhe pyjeve të pishave mesdhetare.



Figura IV-4: a. Pamje e dunave në zonën në afërsi të Lagunës së Kallëngës; b. Pamje në të njëjtin vend ku dunat janë çënuar si pasojë e ndërhyrjeve në këtë Lagunë.

Këto pyje zënë një pjesë të konsiderueshme të zonës së Nartës, duke u shtrirë paralelisht me sistemet e dunave të kësaj zone. Këto pyje shërbejnë për të stabilizuar dunat ranore dhe për të mbrojtur tokat bujqësore. Karakterizmi i këtij formacioni shprehet përmes specieve *Pinus maritima*, *P. pinea*, *P. pinaster* (me lartësi rreth 5-7 m që mbulon rreth 60-70% të sipërfaqes totale).

Brezi i shkurreve përfaqësohet nga specie tipike mesdhetare si *Pistacia lentiscus*, *Erica manipuliflora*, *Myrtus communis* etj., Specie karakteristike të Shoqërimit *Quercetea ilicis* (ato zene rreth 30-40% të sipërfaqes totale, bimë me lartësi më të madhe se 2 m). Në pyllin e "Sodës" brezi i shkurreve mungon plotësisht dhe kjo gjë lidhet me dendësinë e theksuar brezit drunor. Me rënësi për këtë formacion paraqiten speciet endemike si *Orchis albanica* Goelz & Reinhard si dhe një formë hibride *Orchis x paparisti*. Midis këtyre shoqërimeve bimore (bimësia e dunave ranore dhe pyjet e Pishave Mesdhetare), ekzistojnë dy rripa të pyllëzuara. Në një brez është futur *Acacia saligna* (një pjesë e madhe e saj tashmë është djegur), dhe në brezin e dytë (rreth 200 m) në plazhin e Zverneci që është mbjellë me *Agave americana*.

IV.2.3 Laguna Limopuo

Kjo lagunë përfaqëson një system tranzitot të vogël që gjendet në afërsi të fshatit Zvernec, në pjesën jugperëndimore të Lagunës së Nartës. Sistemi përfaqëson një lagunë bregdetare, me gjatësi rreth 800 m, e gjërë rreth 350 m dhe me sipërfaqe rreth 28 ha. Aksesimi i lagunës mund të arrihet është nëpërmjet intinerarit qyteti i Vlorës-Pylli i Sodës-fshati Zvernec.




Figura IV-5: Harta e Monumente të Natyrës

IV.3 NDRYSHIMET KLIMATIKE

Sipas termave të aprovuara në Konferencën e Parisit objektivi kryesor është që temperaturat në të ardhmen të mos rritet me më shumë se 2 °C. Në varësi të vlerave të faktorit klimaterik dhe të dhënave të siguruara nga studime të ndryshme lidhur me ecurinë në vite të këtyre vlerave mund të paraqiten disa skenarë për ndryshimet klimatike (modeli i ndjekur sipas MAGIC / SCENGEN; v. 5, 3, v 2).

Skenari bazuar në ecurinë e rritjes së temperaturave mesatare, jo vetëm në Shqipëri por edhe në mbarë globin, ndryshimet klimaterike të parashikuara do të sjellin një klimë më të ngrohtë në regjimin e temperaturës në zonat bregdetare shqiptare.

Skenari bazuar në rreshjet mesatare në rënie të regjistruara në stacione të ndryshme meteorologjike tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me mesataren e regjistruar në vitin 1990 si dhe një rritje të përmbytjeve si pasojë e rreshjeve të vrullshme. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezulton se sasia e reshjeve vjetore mund të ulen me 8,5% deri në 2050; dhe deri në 18,1% në 2100. Sigurisht që këto vlera do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në klimën globale dhe për pasojë dhe atë shqiptare. Kombinimi i ndryshimeve të faktorëve klimaterikë do të sjellë disa pasoja të cilat janë të lidhura me :

- Rritjen e temperaturave minimale ditore e shoqëruar kjo me thatësira të zgjatura;
- Ngrohjen dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së sezoneve të ftohta e cila do të ulë nevojat për konsum energjie për përdorim ngrohje;
- Rritje e numrit të ditëve me temperaturë mbi 35°C dhe me shira të rrëmbyeshëm do të sjellë përmbytje të zonave të ulta, pranë lumenjve dhe në bregdet kjo e fundit si pasojë edhe rritjes së nivelit të detit.
- Rritja e temperaturës së tokës duke modifikuar periudhat e rritjes së të mbjellave p.sh zgjatja e periudhës së rritjes së të mbjellave është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.
- Sasia totale e rreshjeve parashikohet të reduktohet për pasojë burimet ujore do të reduktohen në njëkohë që kërkesa për uji do të rritet.
- Ndryshimi i regjimit të rreshjeve do të sjellë ndryshime të cilësisë së ujrave në tërësi dhe atij të pijshëm në veçanti;
- Sektori i turizmit është i ekspozuar në mënyrë direkte dhe indirekte ndaj këtyre ndryshimeve si pasojë e rritjes së nivelit të detit dhe acidifikimit të ujit të deteve. Po ashtu këto ndryshimet do të ndikojnë në biodiversitet duke dëmtuar eko dhe agro turizmin. Kjo do të sjelli sfida të reja për këtë sektor.

IV.4 TOKA

IV.4.1 Tipet dhe potencialet prodhuese të tokave

Tokat në njësitë administrative janë të ndryshme: tokaT e rënda (*Eutric Vertisol*), Cambisol të përzjera me Fluvisols dhe tokat e kripura (*solonchak*)

Përshkrimi i tokave është si më poshtë :

Tokat e rënda (eutric vertisol) ndodhen në pjeset e ulta të njësive midis ullishtave dhe Lagunes dhe kripores. Tokat livadhore moçalike kanë profil me horizonte të diferencuar nga ngjyra, tekstura, ngjeshmëria dhe shkalla e aglejimit. Densiteti vëllimor dhe specific, poroziteti total, kapaciteti fushor i mbajtjes së ujit, lageshtia maksimale higroskopike dhe pika e vyshkjes janë të larta për shkak të përmbajtjes së lartë të argjilave. Janë toka me trashësi profile me të madhe se 1 m. Toka kanë porozitet të ulët (rreth 30-40%) densitet vëllimor dhe specific nga 0.87 në 1.9 dhe 2.3 – 2.5 g/cm³. Aftësia ujëmbajtëse është e lartë (0.57%). Azoti është i lartë (nga 1.5 – 2,5%) dhe nivel mesatar të P dhe K.

Tokat tipike të zonës kodrinore-fushore (*Eutric Camisol*): ndodhen në masivin e kodrave dhe pjerrësive të buta të kodrave dhe fushave që rrethojnë Lagunën dhe Kriporen. *Eutric Cambisol* është e zhvilluar shumë dobët me Horizon A dhe B dhe nuk janë diferencuar. Minerale të tokëformuese janë të pakonsoliduara me vetëm një horizont të kufizuar në sipërfaqe dhe konglomeratë gëlqerore. Faktorë kufizues për zhvillimit të tokës janë temperaturat të larta, thatësi të zgjatur, dhe karakteristikat e materialit mëmë ose erozioni i tokës. Sipërfaqja është rreth 50% tokë bujqësore me një pjerrësi prej 5-40%, e terracuar. Materiali parental "shkëmb sedimentar", kryesisht konglomerat.

Skeletal Cambisols janë në një fazë të hershme të formimit të tokës. Ka, megjithatë, shenjat e erozionit fillestar / shndërrimin e mineraleve primare në një situatë të kullimit dhe drenimit të lirë ku zhvillohet hidroliza e mineraleve të hekurit që përmbajnë (biotite, olivine, pyroxenes, amphiboles, etj) në një mjedis të dobët acid duke "prodhuar" okside (psh: goethite, hematit). Toka bujqësore është 50% e sipërfaqes së përgjithshme. Në disa raste horizonti B mungon dhe më poshtë një thellësi prej 30 cm vazhdon shkëmbin gëlqeror. Profili-i tokës është skeletal i përzier me gur të vogël të përzier me dhe (konglomerat). Sasi e lëndës organike relativisht e lartë (1-2%). Kur horizonti-i parë është-i thellë janë toka me prodhimtari të lartë. Shkalla e erozionit është e lartë por gjatë vizitës në terren nuk u vune re vija të thelluar të erozionit. Shkaku kryesor-i stabilizimit janë se tokat mbillen me foragjere (jonxhe dhe bar-i thatë) dhe pjesa më e madhe e tyre janë të pa kultivuara. Presioni nga kullotja e blektorisë (sidomos të imët) është më-i ulët krahasuar me zonat e tjera. Ullinjtë dhe vreshtat janë potencialisht kulturat më të përshtatshme për tu kultivuar. Një kompani private ka marrë me qera afat gjatë rreth 1,000 ha për ullishta ndonëse deri tani nuk ka mbjellje të dukshme. Fermerët kanë mbjellje ullinj dhe vreshta në sipërfaqe të kufizuara (0.1-0.5 ha) ndonëse krahasuar me sipërfaqen totale bujqësore këto mbjellje zënë pak dhe shumë pak. Mekanizma dhe politika (rajonale dhe qendrore) mund të rritin

eficiencen e këtyre tokave duke rritur mirëqënien, përmirësuar peizazhin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Tokat e kripura (*Sollonchak*): ndodhen në pjesen e ulet dhe domonojnë sipërfaqet e zones së Projektit dhe në Akërnë (rreth 3,200 ha). Tokat e kripura kanë një profil të diferencuar në horizonte. Profili i tyre është kryesisht kalimar A-B-C-G. Ujërat nëntokësore janë të cekët dhe kripërat janë grumbulluar intensivisht në shtresat sipërfaqësore të tokës ose në afërsi të sipërfaqes, kryesisht në tokat solonece. Horizon A ka një trashësi prej 25 cm, me ngjyrë gri në ngjyrë qielli-blu, me spote ndryshkur dhe shkëlqimi i kristaleve të hollë kripe. Horizon B është në i trashë se horizonti A, ngjyrë qielli, i glejuar dhe argjilor në nivele të ndryshme, kompakt. Tiparet e veçanta të solonchaks janë: në horizont sipërme, me një trashësi prej 0.5 - 2 cm, në formën e një kore, që është një përzierje e kripës dhe minerale. Tokat Sollonetz kanë një profil A-B-C. Janë toka që nuk përdoren në bujqësi por mund të përdoren shumë mirë në akuakulturë. Mund të formohen lidhje me deti dhe të kultivohen edhe specie peshku që rriten në uje të kripur. Kripërat në sezonin e shirave shkojnë poshtë (shpëlarje) dhe e kundërta, në sezonin e verës kripërat ngrihen në sipërfaqe dhe depozitohen në formë shtresash me shkëlqim të bardhë (NaCl).

Karakterizimi-i tipeve të tokave në Zvërnec dhe bashkë me to edhe karakteristikat kryesore të cilësive kimiko fizike të tyre të paraqitura më poshtë bëhet me qëllim të vlerësimit të tyre në pikëpamje të përshtatshmërisë (*suitability*) dhe aftësive agroprodhuese (*capability*).

Boniteti (bashkësia e aftësive prodhuese - *capability* dhe përshtatshmëria e tyre nda prodhimit bujqësor - *suitability*) në njësitë Qendër dhe Novloselë prezantohen në figurën më poshtë.




Figura IV-6: Boniteti i Tokave

Tokat, sipas aftësive të tyre janë përgjithësisht të kategorisë III dhe IV në zonën kodrinore, të kategorisë IV dhe V në zonën fushore dhe të kategorisë VI dhe IX në zonat e kripura dhe në kufi të tyre.

IV.5 SIZMICITETI

Në vendin tonë janë përcaktuar zonat e burimeve sizmike në terrene që kanë një aktivitet sizmik të dallueshëm. Shqipëria është një ndër vendet më sizmioaktive në Europë. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M < 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M < 5.0$), nga tërmete të rralla me madhësi mesatare ($5.0 < M < 7$) dhe shumë rrallë

nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Shumica e tërmeteve të fortë ndodhin në 3 breza sizmike mirë përcaktuar, si vijon:

- Brezi termotor Joniko-Adriatik, në buzen lindore të mikropllakes së Adrias me shtrirje veriperëndim – juglindje
- Brezi termotor Peshkopi – Korce, me shtrirje veri-jug,
- Brezi termotor Elbasan – Diber, me shtrirje verilindore.

Rajoni i Vlorës nga ana gjeologjike, përfshihet kryesisht në zonën e jashtme tektonike Jonike që përbën edhe ballin orogjenik në zonën e kolizionit Adriatik. Zona e kolizionit Adriatik është zona aktive më sizmike në vend, që përfaqësohet nga brezi termotor Adriatiko-Jonik gjatë buzinës lindore të mikropllakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje. Duke përgjithësuar të dhënat nga vlerat e thellësive të tërmeteve rezulton se shtresa sizmoaktive në këtë zonë e ka dyshtetësinë në thellësinë rreth 25 km (Ormeni, 2010). Thellësia e gjenerimit të tërmeteve paraqet interes për studimet sizmotektonike veçanërisht në vlerësimin e hazardit sizmik. Tërmeti i ceket me energji më të vogël shkakton dëmtime me të mëdha se një tërmet i thellë me energji më të madhe.

Zona e Vlorës paraqet një nga zonat sizmike me aktive të vendit tonë, për të cilin disponohen të dhëna të mjaftueshme makrosizmike dhe instrumentale (Sulstarova & Kociu 1975). Për qytetin e Vlorës tërmeti më i madh konsiderohet ai i vitit 1983, Intensitet 9 balle. Ka qënë një tërmet shkatërrues që dëmtoi dhe shkatërroi Vlorën dhe vale detare përmbytën ishullin Sazanit. Më vonë në vitin 1851, Vlora u prek nga një seri tërmetesh të fuqishëm. Kështu në Tetor 1851, rreth orës 07 një tërmet i fortë goditi gjirin e Vlorës. Në qytetin e Vlorës u shëmb një pjesë e banesave, kurse pjesa tjetër u dëmtua rëndë. Bazuar në shtypin e kohës, numri i të vdekurve arrinte në 200. U dëmtua rëndë edhe fshati Kaninë. Niveli i detit në gjiun e Vlorës u ngrit me 66 cm dhe u vunë re përmbytje. Përpara goditjes kryesore, në orën 02 e 40 min u ndie një paragoditje e lehtë në Vlorë. Goditja e fortë e orës 07 u pasua nga një numër i madh pasgoditjesh¹⁴.

¹⁴ <http://openprocurement.al/fund/other/241e.pdf>




Figura IV-7: Fragmente të Hartës Sizmotektonike, shk. 1:200 000 për zonën e Vlorës

Duhet theksuar në veçanti është se Vlora ndodhet pranë ballit mbihipës të Orogjenit Shqiptar në konvergencë me Mikropallakën e Adrias, konkretisht me Basenin Shqiptar (Baseni i Adriatikut Jugor) dhe për këtë arsye lëvizjet shtypëse janë nga më të fuqishmet.

Pikërisht ky pozicion tektonik dhe shkëputjet aktive janë shkaktare të gjenerimit të tërmete të fuqishëm në këtë zonë dhe rreth saj. Nga këto shkëputje aktive në zonën përreth Vlorës përfshirë dhe Novoselën janë gjeneruar shumë tërmete të mëdhenj (Figura IV-7). Nga pikpamja sizmotektonike qyteti i Vlorës dhe zona përreth tyre bëjnë pjesë në Zonën sizmogene Joniko-Adriatike me potencial sizmik të pritshëm $M_{max} = 6.0-6.9^{15}$.

IV.5.1 Erozioni i tokës dhe Sedimentimi

Shkalla e erozionit në basenin e Vjosës është e lartë për shkak të shkallës më të lartë të shpyllëzimit, kullotjes së tepërt, përdorimit të biomasës me intensitet të lartë dhe kultivimit të zonave me pjerrësi të madhe. Niveli i raportuar i erozionit në studime të ndryshme të kryera në Shqipëri është i pakët dhe fragmentuar në kohë dhe hapsirë.

15 Aliaj, Sh. (1988) "Neotektonika dhe Sizmotektonika e Shqipërisë", Disertacion për gradën shkencore "Doktor i Shkencave", Arkivi i I.Gj.E.U.M, Tiranë.

Nga njëra anë, sipas studimi nga Grazhdani dhe Shumka (2007), shkalla mesatare e erozionit është më e madhe se $10 \text{ t ha}^{-1} \text{ y}^{-1}$; në disa zona në jug, norma mund të arrijë $100 \text{ t ha}^{-1} \text{ y}^{-1}$. Nga ana tjetër, siç thuhet në raportet e monitorimit të shqiptarit Ministria e Mjedisit (Ministria e Mjedisit, 2010-2012), shkalla e erozionit në Shqipëri varion nga $3.6 \text{ t ha}^{-1} \text{ y}^{-1}$ në kullota në $18.3 \text{ t ha}^{-1} \text{ y}^{-1}$ në zona të kultivuara me misër (raporti i AKK, 2017). Sidoqoftë, duhet theksuar se në zonat e prirura për erozion të lartë, siç përshkruhet nga Grazhdani dhe Shumka (2007), nuk kishte asnjë mbulesë vegjetative për 10 deri në 20% të kohës gjatë vitit dhe intensiteti i reshjeve ishte dy herë më i lartë se sa që në pjesën qendrore të vendit. Erozioni ndikon në dinamikën fiziogjeografike të delatve të lumenjëve sic është edhe rasti i deltës së lumit Vjosë.

Harta e përgjithshme e evolucionit të vijës bregdetare gjatë periudhës 1870-2001 është tregon lëvizje të deltës dhe konfigurim të deformuar të vijës bregdetare në më shumë se 1.5 km në thellësi (afër kanalit të komunikimit të lagunës së Nartës) dhe zgjatje e rrypit të rërës në grykderdhjen e Vjosës. Sot gjurma e lumit të vjetër ndodhet rreth 2 km në jug të grykëderdhjes aktuale. Kontributi i sedimenteve, konfigurimi i vijës bregdetare nga vitet 1870 deri në 2001, sedimentimi bregdetar, proceset e erozionit dhe akumulimit, transporti i sedimenteve, janë shumë të evidentueshme. Shumë transformime bregdetare kanë ndodhur për shkak të modifikimeve të shkaktuara nga migrimi i grykës së lumit, me braktisjen e kanaleve të vjetra pas një rënie të shkarkimit ose krijimit të grykave të reja të lumit (Pano N. 1984¹⁶).

Dinamika e depozitave të ngurta përgjatë zonës bregdetare dhe intensiteti i akumulimit të rërës janë të lidhura ngushtë me procesin e sedimentimit dhe veçanërisht me efektin maksimal të valës. Zhvendosja në drejtim të jugut të grykës së lumit Vjosa gjatë shekullit XX ka krijuar probleme serioze të erozionit në bregdetin verior të lagunës së Nartës. Hyrjet e sedimenteve në deltën e vjetër pushuan, kjo e fundit pothuajse është gërryer plotësisht dhe sedimenti u hoq për të krijuar një gjuhëz, e cila formoi një zonë akumuluese në pjesën jugore të grykës së vjetër të lumit Vjosa. Kjo gjuhëz tenton të kapërcejë kordonin bregdetar të Nartës.

Laguna në drejtim të perëndimit, në zonën bregdetare të Grykës së Lumit dhe Pasha Liman-Vjosa, korridori që lidh ishullin Sazani në Perëndim dhe kodrat e Treportit në Lindje, përfaqëson linjën e transportit të sedimenteve zero. Në këto kushte, gjiri i Vlorës është një zonë e pavarur dhe e veçantë gjeomorfologjike, ku dominojnë proceset e erozionit bregdetar.

Shkarkimi i ngarkesës së pezullive të lumit Vjosa ndryshon në kufij shumë të gjerë nga $R_o = 480 \text{ kg / sek}$ për vitet hidrologjike të shkarkimit të ulët të ujit në $R_o = 3.8 \text{ kg / sek}$ për vitet e shkarkimit të plotave të larta të ujit. Dinamika e ndryshimit të vijës bregdetare në Grykën e Lumit Vjosa përcaktohet gjithashtu nga ndryshimi i ndikimit të shkarkimit të ngarkesës së pezullive të këtij lumi në Detin Adriatik gjatë cikleve shumëvjeçare.

Shkarkimi total i sedimenteve të lumit Vjosa në Detin Adriatik është $WT = 7.5 \times 10^6 \text{ m}^3 / \text{vit}$. Rreth 20% e ngarkesës totale të sedimentit ekuivalente me $WF = 5.6 \times 10^6 \text{ m}^3$ janë ngarkesa e imta që transportohen në deltë, dhe rreth 80% ekuivalente me $WP = 1.9 \times 10^6 \text{ m}^3$ janë grimca të mëdha të sedimentit.

¹⁶ Pano N. et al., 1984. Hydrology of the Albania. Monograph. (In Albanian). Institute of Hydrometeorology, Academy of Sciences, Tirana.

IV.6 NDOTJA AKUSTIKE

Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor “i dukshëm”. Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës. Zhurma ndihet në nivel individit, por kur rrezikon një grumbull individësh atëherë përbën një çështje serioze të shëndetit publik. Ndryshe nga shumë probleme të tjera të mjedisit, ndotja nga zhurma vazhdon të evoluojë dhe krijojë një numër ankesash në rritje të asaj pjese të personave që janë të ekspozuar. Në vendin tonë shkaktari kryesor i emetimit të zhurmave është trafiku rrugor. Kjo sepse në vendin tonë sistemi hekuridhor pothuajse nuk ekziston, ndërsa përta i përket sistemit ajror në kemi vetëm një aeroport ndërkombëtar. Gjithashtu dhe lokalet gjenerojnë zhurma si ditën ashtu dhe natën.

Ndotja akustike në mjedis është e lidhur me shëndetin e njerëzëve dhe shëndetin e biodiversitetit (faunës) dhe veçanërisht tek zogjtë. Ndotja akustike shkakton bezdi, agresion, hipertension, stres të lartë, humbje dëgjimi, shqetësime gjumi apo edhe ndonjë efekt tjetër të dëmshëm. Mbi të gjitha, stresi dhe hipertensioni janë ato që çojnë në problemet shëndetësore më të rënda, mund të çojë në probleme të harresës, panik etj.. Nivele të larta të zhurmave mund të sjellin probleme kardiovaskulare, në rastet e ekspozimit kundrejt zhurmave për rreth 8 orë, mund të çojë në rritje të tensionit të gjakut me 5 shkallë etj..

Ndaj, ndotja akustike mund të sjellë dëme të konsiderueshme për faunën, në mënyrë të veçantë avifaunën (zogjtë), duke dëmtuar në këtë mënyrë biodiversitetin dhe gjithë zinxhirin ushqimor. Kjo është edhe arsyeja përse duhet mbajtur nën kontroll niveli i zhurmave në Bashkinë e Vlorës dhe jo vetëm. Në zonën e Projektit avifauna ka një prezencë të lartë absolute dhe një frekuencë po ashtu të lartë.

Monitorimi i zhurmave kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për një kohë matje 24 orëshe dhe niveli ekuivalent i presionit akustik LAeq ditën u llogarit nga ora 06⁰⁰ - 23⁰⁰ dhe LAeq për periudhën enatës nga ora 23⁰⁰ - 06⁰⁰. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave të monitoruara në vitin 2019 në qytetin e Vlorës është 64.6 dB për LAeq ditën dhe 53.44 dB për LAeq natën, ku përkatësisht vlera e lejuar enormës ditën është 55 dB dhe vlera e lejuar e normës natën është 45 dB.




Figura IV-8: Niveli i zhurmave në stacionet e Vlorës gjatë ditës¹⁷

Monitorimi i zhurmave në Vlorë për vitin 2019 është realizuar në 4 stacione si Uji i ftohtë, Përballe Hotel Bolonjës, Xhamia dhe kryqezimi i hyrjes në dyekspedita.




Figura IV-9: Niveli i zhurmave në stacionet e Vlorës gjatë natës¹⁸

Bazuar në të dhënat e monitoruara në Vlorë për vitin 2019 vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe natën në të gjitha stacionet e monitoruara. Tek stacioni Uji i Ftohtë kemi tejkalim të

¹⁷<http://www.akm.gov.al/assets/rgjm-2019.pdf>

¹⁸<http://www.akm.gov.al/assets/rgjm-2019.pdf>

normës ditën me 22% dhe normës natën me 26%. Në stacionet e tjera nivelet e zhurmave natën dhe ditën janë më të ulëta se në stacionin e Ujit të ftohtë. Në qytetin e Vlorës mund të paraqitet problematike gjatë sezonit veror sidomos në rrugët ku edhe trafiku është më i renduar.

Tabela IV-2: Monitorimit i zhurmave të qytetit të Vlorës, sipas AKM [dB]

Pikat monitorimit e	2015		2017		2018		2019	
	LAeq/Ditën dB (A)	LAeq/Natën dB (A)	LAeq/Ditën dB (A)	LAeq/Natën dB (A)	LAeq/Ditën dB (A)	LAeq/Natën dB (A)	LAeq/Ditën dB (A)	LAeq/Natën dB (A)
Hyrja e Qytetit	63.91	54.69	-	-	62.60	55	64.4	54.3
Përballë Xhamisë	62.34	50.35	61.3	44.34	62.55	54.5	61.8	50.9
Përballë Hotel Bolonjës	62.61	53.56	63.62	55.33	64.03	49.9	65.6	52.2
Uji i Ftohtë	64	48.49	65.81	-	64.19	54.25	67.8	56.2
Standarti i BE-së	55	45	55	45	55	45	55	45

Përgjatë zonës në studim, ambienti i zhurmës ndryshon në mënyrë të parëndësishme, pasi shtrihet nëpër zona bujqësore dhe të pazhvilluara, dhe ndryshon midis verës dhe sezoneve të tjera të vitit. Shumica e receptorëve të mundshëm janë fshatra e Njesisë Administrative Novoselë, që mund të konsiderohen të ndjeshme. Në zonën përreth zonës së studimit, vendbanimet më të afërta janë në Polo dhe Akërn.

Potencialisht, dy janë burimet e ndotjes akustike në zonën e PDZRK Nartë-Vjosë: autostrada Fier-Vlorë (e cila ndodhet 5km larg zonës në studim) dhe TEC-i në afërsi, në pjesën jugore të Projektit. Për TEC-in megjithëse teknologjia e prodhimit të energjisë, sipas manualëve të paraqitura nga ekspertët e fushës, nuk i kalon të 70dB gjatë ditës dhe natës. Prania e autostradës në afërsi të disa zonave të banuara të Njesisë Administrative krijon një shqetësim të vogël për banorët. Kjo zhurmë është shqetësuese edhe për faunën e zonës. Më problematike paraqitet ndotja akustike ujore pasi ardhja në port e anijeve të tonazheve të mëdha krijojnë zhurma nënujore shqetësuese për faunën. Këtu mund të përmendim anijet që furnizohen me hidrokarbure por edhe ato të peshkimit.

Burimet të tjera të zhurmave të identifikuar gjatë vëzhgimit në terren janë aktivitetet bujqësore, kafshët (qentë, pulat dhe dhitë), jeta në fshat dhe aktivitetet bujqësore sporadike (përdorimi i pompave dhe automjeteve rurale, era gjatë periudhës ditore dhe gjatë natës). Ndjeshmëria mund të konsiderohet gjithashtu e lartë në zonat e banuara dhe në afërsi të zonave të banuara.

Zbatimi i Ligjit Nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 587 datë 07.07.2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”, i ndryshuar, do të ndikonte në përmirësimin e mëtejshëm të situatës në territorin e bashkisë dhe mban nën kontroll edhe zhurmat në zonën e studimit, si pjesë e territorit të Bashkisë Vlorë.

IV.7 TRASHËGIMIA KULTURORE

Vlerat historike dhe arkeologjike të zonës janë unike dhe me interes për vizitorët. Disa prej këtyre monumenteve listohen më poshtë:

Ishulli i Zvernecit

Ishulli i Zvernecit është një ishull brenda Lagunës së Nartës. Ai ndodhet në pjesën verilindore të Vlorës. Monumentet e mbrojtura të ndërtuar brenda këtij ishulli janë Manastiri i Zvernecit dhe Kisha e Manastrit, të cilat mbartin vlera të mëdha historike, kulturore. Përveç monumenteve, Zverneci është shpallur në tërësi si një zonë e mbrojtur, ku spikat natyra e gjelbër, ndërtimet në brëndësi, si dhe qasja e këtij ishulli me ujë.

Manastiri i Shën Mërisë në Zvernec¹⁹ (Monument kulture i kategoris së I)

Në Zvernec ndodhet Manastiri në të cilin mund të gjejmë gjithashtu Kishën e Shën Mërisë, monument kulture bizantin e shekullit të XIII-XIV. Kjo kishë ndodhet në ishullin piktoresk të Zvernecit, në lagunën e Nartës. Në ambjentet e brendshme të saj ruhen fragmente të pikturës murale e altari i gdhendur në dru, zbukuruar me motive me lule e kafshë. Vlerë origjinale kishës i jep edhe hajati shtruar me pllakë guri e që në anën veriore merr dritë nga shtatë harqe të mbështetura në kollona guri. Kisha është e restauruar dhe është monument kulture. Kisha e Shën Merisë shërben si vend lutjeje, bëhen ceremoni fetare ortodokse si dhe çdo vit kujtohet 15 gushti, ditëlindja e Shën Merisë.

Kisha e Shën Mërisë

Kisha është e tipit: kryq i lirë me kupolë, me narteks dhe ekzonarteks e një hajat të hapur me kolonadë në anën veriore. Pjesa e vjetër përbëhet nga naosi në formë kryqi të lirë me narteks, ndërsa pjesa tjetër është shtuar më vonë. Narteksi është drejtkëndësh në plan, me brinjë më të gjatë nga veri-jug dhe me dritare të vogël në murin jugor. Ai ka në anën perëndimore portën e mbuluar me arkitrarë të rrafshët dhe dy dritare anash. Naosi ka planimetri në formën e kryqit me krahët lindorë dhe perëndimorë më të gjatë se ata veriorë dhe jugorë. Objekti ka konstruksion me mure mbajtës. Muri është ndërtuar me gurë të zakonshëm duke patur edhe copa tullash. Si lidhës është llaci i gëlqeres. Kultura e përdorur në këtë konstruksion është e tipit bizantin në të cilin janë përdorur dhe kolona cilindrike guri në arkaden e hajatit. Mbulesa është me çati me tjegull vendi.

¹⁹Marrë nga Kartelat e IMK-së



Figura IV-10: Kisha e Manastirit të Zvernecit (Burimi: IMK)

Zona e mbrojtur e Kalasë së Treportit dhe murit antik në det

Gjendet në perëndim të lagunës së Nartes, në afërsi të fshatit Zvërrnec. Kalaja e Treportit dhe muri antik në det janë monument kulture i kategorisë së I-rë. Treporti ka qënë një port i rëndësishëm që lidhte qytetin me qendra të tjera antike si Aulona, Apollonia, Oriku dhe Amantia.

Kërkimet arkeologjike tregojnë për përdorimin e territorit të Treportit nga periudhat evjetra të gurit (Paleolitit, Mezolitit dhe Neolitit). Vendbanimi ndodhet mbi kodrën e quajtur Pllakë. Gërmimet arkeologjike në rrënojat e Treportit paraviteve 90 zbuluan jo vetëm gjurmë të qytetit antik por edhe ato të një vendbanimi prehistorik të fortifikuar.

Spinarica

Dipas dokumenteve të shekullit të 12-të, Spinarica ishte një nga qytetet mesdhetare të Detit Adriatik. Gjendej në afërsi të lagunës së Nartes, në grykederdhjen e lumit Vjosa. Spinarica ishte një qendër e rëndësishme tregtare veçanërisht për drithërat, gjënë e gjallë, leshin dhe hekurin. Pas shekullit të 15-të, qyteti humbi rëndësinë e vet dhe nuk përmendet më nga dokumentet historike. Rrënojat e tij nuk janë zbuluar ende për shkak të ndryshimeve të medha natyrore dhe njerëzore në zonën bregdetare.




Figura IV-11: Monumentet arkeologjike dhe kulturore në zonën Vjosë-Nartë

Gjithashtu, në brendësi të territorit në studim gjenden objekte të kultit të përfaqësuara Kishat Ortodokse dhe Xhamiat si më poshtë:

- Kisha Ngjallja në Novoselë
- Kisha Shën Spiridhoni në Mifol
- Kisha Shën Nikolla në Poro
- Kisha Shën Sotira në Beshisht
- Kisha Shën Harallambi në Dëllenjë
- Kisha Shën e Diela në Nartë
- Kisha Burimi Jetëdhënës në fshatin Zvërnec
- Kisha Fjeltja e Shën Marisë në Monastir të Zvërnecit
- Kisha Shën e Premte në Skrofortinë
- Xhamia e Trevllazërit në Trevllazër
- Xhamia Masjid al Wahhab në Cerkovinë
- Xhamia e Panajasë në Panaja



Figura IV-12: Kisha Ngjallja në Novoselë (foto nga eksperimenti)

IV.8 SISTEMI UJOR

IV.8.1 Karakteristikat ekologjike të Lagunës së Nartës dhe zonës përreth

Narta është pjesë e lagunave bregdetare mesdhetare të cilat janë përshkruar në mënyrë unanime si zona të ekspozuara ndaj shqetësimeve natyrore, në varësi të morphodinamiks dhe faktorëve klimatikë të tillë si përmbytjet e ujërave të ëmbla dhe thatësira e verës. Kjo sjell luhatje në kripësi, të cilat janë për shkak të variacioneve sezonale në reshjevesi dhe avullimit, dhe luhatjeve tipike sezonale të temperaturës, të cilat janë të rëndësishëm në varësi të madhësisë së lagunës dhe gjerësisë gjeografike. Këto luhatje mund të krijojnë kushte ekstreme për shumë species, ndërkohë që larmia biologjike karakterizohet nga një numër të vogël speciesh mjaft të të specializuara. Nga ana tjetër ekositemet janë tejet komplekse duke siguruar ecotone të cilat krijojnë mjedise të shumëllojshme dhe tejet mbështetëse për një larmi biologjike të pasur.

Lagunat bregdetare janë ekosisteme mjaft produktive. Ato kontribuojnë në produktivitetin e përgjithshëm të ujërave bregdetare duke mbështetur një shumëllojshmëri të habitateve, përfshirë zonat kënetore të kripura, kullotat ujore dhe bimësitë shoqëruese. Ato ofrojnë gjithashtu habitate të rëndësishëm për shumë lloje peshqish dhe butakësh. Duke u bazuar në faktin se niveli ushqyes i Lagunës së Nartës është mesotrofik (Babani et al., 2008; Çako et al., 2014) dhe cilësia e ujit është në parametra mesartarë, vegjetacioni paraqitet relativisht i qëndrueshëm (për shkak të niveleve të konsiderueshme të imputit të nutrienëve që nxisin prodhimtarinë primare dhe faktorët e tjerë ekologjik që kontrollojnë përhapjen dhe shpeshinë). Vlerat mesatare të *Klorofilës a* janë $5.9 \mu\text{gL}^{-1}$.

Në sistemin ligatinor përfshihen tipe të ndryshme etnitetesh ekologjike të klasifikuara në përputhje me kriteret funksionale dhe pershkrues si prania ose mungesa e ujit, kripshmeria dhe fizionomia e bimësisë (MT, 2004):

(a) *Kënetat* të cilat janë të përkohshme dhe të përhershme. (a1) *Kënetat e përkohshme*. Zakonisht gjatë periudhës së dimrit kripesia është e ulët dhe zonat me kripësi të ulët mbizotërohen nga *Ranunculus spp*, *Callitriche truncata* si dhe *Chara spp*. dhe *Tolypella spp*. Disa nga vende që janë nën presionin e kullotjes, zhvillojnë komunitete si *Scirpus spp* të cilat në pak vende zëvendësohen nga *Phragmites communis*; (a1) *Kenet e përhershme* të cilat perfaqësohen nga lagunat e Nartës. Fundet e tyre mbulohen nga *Zostera noltii* dhe *Ruppia cirrhosa*. *Zostera* është mbizotëruese me 30-40 % të sipërfaqes së përgjithshme; (a3) *Kenet e kripura*, habitat ky mjaft i përhapur në ekosistemin natyror Vjosë-Nartë. (b). *Kanalet e ujitjes dhe kullimit*. Këto të fundit strehojnë një bimësi dhe faunë komplekse e cila në varesi të thellesisë dhe kripesisë shfaq një perzierje tipesh të ndryshme vegjetacioni zakonisht të pranishëm në kenet e përkohshme dhe të përhershme; (c) *Pyjet aluvionale*; (d) *Dunat ranore*; (e) *Pylli i pishës*




Figura IV-13: Harta e trupave ujq të zonës Vjosë-Nartë

IV.8.2 Ujërat sipërfaqësorë të embël

Në këtë rajon, uji i freskët, përfaqësohet kryesisht nga lumi i Vjosës, i cili derdhet në detin Adriatik, veri të lagunës së Nartës. Cilësia e ujërave të Vjosës sot po shkon drejt degradimit sidomos në pjesën e saj që gjarpëron në këtë zonë si pasojë e aktivitetit të kompanive të inerteve por edhe si pasojë e ndotjeve (ujërave të zeza etj.), që vijnë nga komunat dhe fshatrat (rreth 40 të tilla) përreth luginës së tij. Përveç ndotjes, përgjatë gjithë luginës së Vjosës po ndodh edhe shpyllëzimi masiv, tharja e rrapit lumor dhe gjuetia e paligjshme po çon drejt degradimit një prej pasurive më të rëndësishme ujore të Shqipërisë. Nga monitorimet e raportuara në raportin mjedisor 2018 të kryera në pesë pika (stacione) të ndryshme si Mifol, Carshovë, para derdhjes në det etj, të realizuara me një shpeshti prej më së paku tre herë në vit rezultojnë se BOD₅ është në vlera të ulta që variojnë nga 2-3 mgL⁻¹ me një tendencë në rritje në vite; vlerat COD janë të ulta nga 3.5 deri në 6.8 mgL⁻¹; Total-P me vlera nga 0.014 deri 0.029 mgL⁻¹; përmbajtja me NO₂ rezultojnë në vlera shumë të ulta; për nga përmbajtja e NH₄⁺ ky basen rezultojnë i cilësisë së dytë me vlera që shkojnë nga 0.049 deri 0.123 mgL⁻¹. Në përgjithësi gjendja e këtij baseni konsiderohet akoma e mirë por me tendencë rritjeje të ndotjes nga Carshova në grykë-derdhje në det.

IV.8.3 Sistemi i ujitjes

Përsa i përket përdorimit të ujit për ujitjen e tokave bujqësore, ajo sigurohet nga ujërat e Lumit Vjosë si dhe në rezervuarët e Panajasë, kjo në sajë të sistemit të kanaleve ujitëse me rrjedhje të lirë. Infrastruktura e ujitjes përbëhet nga një stacion ujqor në Mifol me një kapacitet prej 4000 L/sek. Destinacioni final i sistemit të ujitjes është toka bujqësore e Akërnisë dhe rezervuarët e peshkimit në Gorricë. Sipërfaqja e tokës së ujitur sot arrin 1100 ha. Mungesa e investimeve, interesi i dobët i fermerëve, prodhimtaria e ulët e disa tipe tokash ka bërë që një pjesë e mirë e tokave të braktisen.

Infrastruktura e kanaleve vaditëse është e amortizuar, e pa mirëmbajtur për 25 vjet dhe me problematika prej vjetërsisë së ndërtimit. Vetëm vitet e fundit ka filluar tëzbatohen pastrime të shpeshta nga ana e qeverisjes lokale. Aktualisht pritet një investim nga ana e Bankës Botërore për rehabilitimin e sistemit të vaditjes dhe kullimit.

IV.8.4 Ujërat nëntokësore në zonën e Vjosë-Nartë

Kompleksi është përgjithësisht i varfër në ujëra nëntokësore. Këto ujëra akumulohen në depozitime të cekta ranore; janë me cilësi dhe vëllim të ulët. Shpesh uji sigurohet me anë të puseve të gërmuara me dorë. Thellësia e ujërave nëntokësore varion nga 1-10 m. Rryma kryesore e ujërave nëntokësore është perëndimore në drejtim të detit Adriatik.

Për sa i përket ujërave sipërfaqësorë, drenazhuesi kryesor i zonës është lumi Vjosë që derdhet në detin Adriatik dhe lumi i Shushicës i cili është dhe tributar i lumit Vjosë. Kodrat e ulëta në lindje të kompleksit janë të lidhura me zgjerimin më verior të maleve të Kurveleshit. E gjithë toka bujqësore mbulohet nga një rrjet i dendur kanalesh ujitës. Por pjesa më e madhe e tyre janë sot të shkatërruar dhe për pasojë vetëm një pjesë e vogël e tokës është nën ujitje. Zona ka tre

hidrostacione dhe disa kanale me rrjedhje të lirë. Sistemi i drenazhimit nuk funksionon siç duhet për shkak të mbushjes së kanaleve, mos funksionimit të pompave, ndërprerjeve të energjisë elektrike etj. Gjatë shirave të denduar, pjesë të mëdha të tokës bujqësore përmblyten për javë të tëra.




Figura IV-14: Sistemi uhor sipërfaqësor në zonën në studim

Zona e Vjosë - Nartë është përgjithësisht i varfer në ujëra nëntokësore. Këto ujëra akumulohen në depozitime të cekta ranore; janë me cilësi dhe vëllim të ulët. Thellësia e ujerave nëntokësore varion nga 1-10 m. Rryma kryesore e ujerave nëntokësore është perendimore në drejtim të detit Adriatik. Ato përfshihen në basenin e ujerave nëntokësore kuaternare të Vjosës me një koeficient shfrytëzimi që varion nga 0.5-0.7; temperatura nga 14-18.7°C; pH varion nga 7.00-8.25. Ato janë burime karstike që gjenden përgjatë zonës bregdetare, dhe në brendësi të territorit të kësaj bashkie. Burimet e këtyre ujerave dalin në dy nivele; niveli i parë është ai afër zonave të banuara dhe niveli i dytë përfaqësohet nga burimet nëndetare. Burimet buzëdetare dhe

nëndetare janë një lloj i veçantë i burime karstike. Në zonën e Nartë-Vjosës këto ujëra gjenden në thellësi të cekta kryesisht në thellësi nga 1m deri në 10 m. Në pjesën tjetër të Bashkisë (Xyherinë, Panaja, etj) ujërat nëntokësore gjenden edhe më thellë dhe janë burimi kryesor i ujit të pijshëm për pjesën më të madhe të fshatrave, pasi uji i rrjetit është mjaft i ndotur si pasojë e amortizimit shumëvjeçar të tij dhe si pasojë e mungesës së investimeve të rehabilitimit. Në Novoselë fortësia e këtyre ujërave varion nga 15.01 në 15.43°gj; ndërsa përmbajtja në Ca rezulton e lartë në vlera nga 52.14 - 97.08 mgL⁻¹. Tendenda e rrjedhjes së këtyre ujërave është drejt perëndimit në detin Adriatik.

Tabela IV-3: Të dhënat e matjeve të monitoruar në dy faza si akuiferi i depozitimeve në 5 stacione dhe krahasimi i tyre me normat e BE dhe OBSH.

Stacionet & Normat	pH	EC	TDS	Cl ⁻	NO ₃ ⁻	Total-N
	UpH	μS/cm	mgL ⁻¹	mgL ⁻¹	mgL ⁻¹	mgL ⁻¹
Buduk	6.77	600	400	5	2	3
Budrishtë	7.38	750	500	40	4	6
Kafaraj	7.6	900	600	250	15	17
Novoselë	7.74	870	580	80	1	2.5
Pish-Poro	8.16	2475	1650	800	8	9
BE²⁰	5.5-9	1000	500	250	50	72
OBSH²¹						
Class III	6.3-6.0	-----	300-600	250	50	50

Të dhënat e paraqitur në (Tabela IV-3) janë marrë si vlerë e mesatarizuar e monitorimeve të kryera nga **Angjencisë Kombëtare të Mjedisit (në vazhdim AKM)** ku baseni i Vjosës është monitoruar në dy faza si akuiferi i depozitimeve Kuaternare në zonën Buduk, Budrishtë, Kafaraj, Novoselë, Pish-Poro në 5 shpime. Janë marrë 5 analiza kimike dhe një analizë për mikroelementë në Novoselë. **Në fazën e parë të monitorimit të dhënat e përftuara nga raporti i AKM-së:** Temperatura e ujit varion 15.1 - 18 °C.

- **pH i ujit** varion 7.38 – 8.16, në fazën e parë të vitit 2018 ai varionte 6.77 – 7.74. Sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës (pH nga 6,5 - 8,5).

²⁰<https://www.oecd.org/env/outreach/38205662.pdf> as DIRECTIVE 75/440/EEC CONCERNING THE QUALITY REQUIRED OF SURFACE WATER INTENDED FOR THE ABSTRACTION OF DRINKING WATER

²¹ https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/44584/9789241548151_eng.pdf?sequence=1

Në bazë të vlerës së pH (përqendrimi i jonit të hidrogjenit janë ujëra të tipit alkaline të dobët me pH nga 7 - 9.

- **TDS** (Total Dissolved Solids) ose mineralizimi i përgjithshëm varion 390.87 -1661.6 mgL⁻¹, ndërsa në vitin 2018 varionte 407.86 - 1558.5 mgL⁻¹, vlerat e mineralizimit të përgjithshëm janë brenda normës së lejuar derimbi normë në shpimin Pish - Poro. Ndryshimet TDS nga faza e parë e vitit 2018 në fazën eparë të vitit 2019 janë të konsiderueshme në dyfazat e monitorimit duke varjuar nga 3.44 - 40.8 mgL⁻¹ deri me të ndjeshme 69.12 - 93.24 mgL⁻¹ në përgjithësi në shpimin Pishë Poro TDS ka trend rritës.
- Përmbajtje amonjaku **NH₄⁺** takohet në të gjithë shpimet në vlera nga 0.03 - 1.47 mgL⁻¹. Përmbajtja më e lartë është në shpimin Pish -Poro në sasinë 1.47 mgL⁻¹, sasi kjo mbi normën e lejuar 0.05 mgL⁻¹.
- Përmbajtja e nitrateve **NO₃⁻** varion nga 2.04 -12.62 mgL⁻¹, përmbajtja është e vogël brenda normës së lejuar dhe nuk ka tendencë rritjeje (norma 50 mgL⁻¹).
- Përmbajtja e klorit **Cl⁻** në Kafaraj është Cl⁻ = 244.95 mgL⁻¹, ka ulje prej 3.55 mgL⁻¹ në krahasim me fazën e parë të vitit 2018 që ishte Cl⁻ = 248.5 mgL⁻¹. Përmbajtja e klorit në shpimin Pish - Poro është Cl⁻ = 790.97 mgL⁻¹, ka një ngritje prej 70.92 mgL⁻¹ në krahasim me të njëjtën fazë monitorimi të vitit 2018 që ishte Cl⁻ = 736.62 mgL⁻¹. Përmbajtja e Cl⁻ është mbi normën në Kafaraj dhe Pish -Poro.
- **Analiza për mikroelementë është marrë në shpimin Novoselë** për Ni²⁺, Mn²⁺, Zn²⁺, Pb²⁺, Cu²⁺, Co²⁺, Cr³⁺, Cd²⁺. Në këtë analizë ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.008 mgL⁻¹, Mn = 0.006 mgL⁻¹, Zn = 0.067 mgL⁻¹, Pb = 0 mgL⁻¹, Cu = 0.001 mgL⁻¹, Co = 0 mgL⁻¹, Cr = 0.001 mgL⁻¹, Cd = 0 mgL⁻¹. Përmbajtja e mikroelementëve është nën përmbajtjen e rekomanduar.

IV.8.5 Sistemi i kullimit

Zona ka dy stacione pompimi dhe rrjet kanalesh drenimi të hapur me rrjedhje të lirë. Sistemi i drenazhimit nuk funksionon korrektësisht për shkak të mbushjes së kanaleve, mosfunksionimit të pompave, ndërprerjeve të energjisë elektrike etj. Gjatë shirave të rënduar, pjesë të mëdha të tokës bujqësore përmythen për javë të tëra.

Relievi i zonës është faktor përcaktues për sistemin e kullimit. Si një nga zonat fushore të qytetit dhe në veçanti në zonat e identifikuara me rrezik për përmytje, infrastruktura kulluese duhet të vendoset në thellësi, në sipërfaqe për të parandaluar çdo përmytje të zonave të ulta.

Tabela IV-4: Gjendja e sistemit të kanaleve kulluese në fshatrat e NJA Novoselë

Fshati	Gjendja sistemit të kanaleve kulluese	Gjatësia në km	Frekuenca e mirëmbajtjes vjetore
Dëllinjë	E mirë	5	Pastrohen
Mifol	E mirë	31	Pastrohen

Bishan	E pranueshme	26	Pastrohen
Poro	E pranueshme	45	Pastrohen
Delisuf	E mirë	5	Pastrohen
Trevllazër	Nuk ka	3	Pastrohen
Aliban	E mirë	5	Pastrohen
Akerni	E pranueshme	40	Pastrohen
Fitore	E mirë	20	Pastrohen
Novoselë	E mirë	26	Pastrohen
Cërkovinë	E pranueshme	5	Pastrohen
Skrofotinë	E pranueshme	10	Pastrohen

Gjendja e sistemit të kullimit në fshatrat e NJA Novoselë është e degraduar dhe funksioni i rrjetit të sistemeve ujitëse dhe kulluese në këtë zonë është problematike. Pastrimi i kanaleve të kategorisë së dytë dhe të tretë do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetin kullues.




Figura IV-15: Harta e gjendjes aktuale të kanaleve të kullimit dhe vendodhjes së hidrovoreve në raport me Planin



Figura IV-16: Kanal kullues në zonën në studim Kellënge-Godull

Hidrostationi i Akërnisë gjendet në pjesën veriperëndimore të kompleksit lagunor. Ai kullon një sipërfaqe prej 6500 ha dhe pjesa kryesore e ujthidhet në det dhe një pjesë e vogël hyn në pjesën lindore të lagunës së Nartës. Hidrovori i Akërnisë realizon kullimin e ujrave të të gjithë kanaleve kulluese të Myzeqesë së Vlorës, duke i derdhur në Detin Adriatik dhe mos lejuar përmbytjen e zonës. Hidrovori është i përbërë nga katër pompa funksionale për largimin e ujit, dy prej të cilave me kapacitet 700 litër/s dhe dy me kapacitet 150 litër/s, ndërsa një pomp e pestë nuk është në funksionim. Hidrovori është në punë prej një periudhe 45 vjeçare dhe amortizimi i paisjeve elektromekanike ka ulur kapacitetin e tij.



Figura IV-17: Portat hyrëse të hidrovorit të Akërnisë



Figura IV-18: Portat dalëse të hidrovorit të Akërnisë



Figura IV-19: Uji në dalje të hidrovorit të Akërnisë, në drejtim të Detit Adriatik

Gjatë vizitës në terren niveli i ujit gjendej -12 m, sipas përcaktimit të nivelatorit. Gjatë periudhës së rreshjeve me intensitet të lartë, niveli arrin deri në -2 metër. Ndërsa gjatë periudhës së thatë arrin deri në -14 m.

Gjithashtu në pjesën lindore të Lagunës së Nartës gjendet dhe Hidrovori i Goricës, i cili është stacion pompimi me katër pompa për kullim, prej të cilave vetëm dy funksionojnë. Pompat në funksionim kanë një kapacitet 700 litër/s secila. Hidrovori zbaton kullimin e zonës ujmedhëse të fshatrave Panaja dhe Bestrovë. Ai drenazhon një sipërfaqe prej 1000 ha dhe uji derdhet në lagunë.



Figura IV-20: Portat dalje të Hidrovorit të Goricës



Figura IV-21: Portat hyrëse të Hidrovorit të Goricës

IV.9 CILËSIA E UJRAVE TË LAGUNËS SË NARTËS

IV.9.1 Cilësia e ujërave të lagunës Nartë

Gjatë dekadave të fundit imputet e nutriendeve në ujërt bregdetare dhe lagunat është ritur në mënyrë të konsiderueshme për shkak të intensifikimit të aktiviteteve njerëzore dhe urbanizimit përgjatë zonave bregdetare. Kjo ka çuar në përshpejtimin e procesit të eutrofizimit dhe përkeqësimin e cilësisë së ujit në shumë zona bregdetare të botës, dhe në këtë kuadër edhe në vendin tonë.

Tejpamja e ujit : Duke u bazuar në të dhënat e Çako et. Al. (2014) vlerat e Secchi diskut (tejpamjes) luhateshin nga 0.7 deri 6.4 m; vlara më e ulët është matur në muajin prillit, ndërsa ajo më e lartë është matur në nëntor. Situata e tejpamjes është mjaft e lidhur me stinën dhe aspektet hidrologjike të komunikimit me detin dhe ndikimet nga kontinenti.

pH: pH i ekosistemeve ujore varet nga aktivitet kimike dhe biologjik ujit. Ndryshimet në pH mund të tregojnë praninë e ndotësve industrial, fotosintezë apo frymëmarrje e algave të cilat ushqehen me anë të ndotësve të ndryshëm. Shumica ekosistemeve janë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të pH, ndaj dhe monitorimi i pH është përfshirë në ligjet mjedisore të shumicës së vendeve të industrializuara. Sipas të dhënave të (Kane et al., 2015) vlerat e pH luhaten 7.72 - 8.16.

Temperatura: Temperatura e unit të detit është ndikuar nga disa faktorë, duke përfshirë kushtet e motit, ndikimin e vegjetacionit dhe faktorë të tjerë fizike. Temperatura e ujërave sipërfaqësor të Nartës luhaten në vlerat 8.3-9.2°C me një vlerë mesatare prej 8.9°C për muajin shkurt deri në 28°C gjatë muajve të verës.

Oksigjeni i tretur: Në përgjithësi, në trupat ujorë oksigjeni është në dispozicion në formën e oksigjenit të tretur. Luhatjet në nivelet e oksigjenit të tretur në ujë mund të shkaktohet nga bimësia ujore dhe nga nivelet e ndikimeve antropogjene në mjedisin ujor. Teorikisht është e njohur mirë

së temperatura dhe kripësia ndikojnë në nivelin e tretjes së oksigjenit në ujë. Oksigjeni i tretur në ujë e ka burimin nga tretja e ajrit dhe procesin e fotosintezës që ndodh gjatë ditës. Në temperaturë të lartë, e cila është vërejtur zakonisht në sezonin e thatë dhe të nxehtë, tretshmëria e oksigjenit zvogëlohet ndërsa në temperaturë të ulët (sezonin e lagësht) rritet. Bazuar në të dhënat e ndryshme (Çako et al., 2014) vlerat e oksigjenit të tretur luhaten nga 6.42-9.8 mgL⁻¹, me një vlerë mesatare prej 8.17 mgL⁻¹. Në përgjithësi vlerat e oksigjenit të tretur në lagunë janë më të ulta sesa ato të kanaleve lidhës me detin dhe mjediseve të tjera bregdetare.

Potenciali redox: Potenciali redoks është aktiviteti apo forca e proceseve të redoks në tretësi. Në bazë të të dhënave të ndryshme (Kane et al., 2014) vlerat e këtij parametri luhatet midis një minimum prej -62.5 mV në maksimum prej -37.2 mV. Vlerat negative të potencialit Redox në mjedisin ujqor tregojë vetitë reduktuese të ujit të lagunës.

Konduktiviteti: Mbi bazën e vlerësimeve të ndryshme, vlerat e konduktivitetit ose përçueshmërisë luhaten në nivelet nga 22.6 mS/cm në 76.3 mS/cm me një vlerë mesatare prej 47.46 mS/cm. Përcjellshmëria në ujë është një variabël që ndikohet nga prania e përbërjeve të ngurta inorganike të tretur të tilla si klorure, nitrate, sulfate dhe anioneve fosfat ose natriumit, magnezit, kalciumit, hekurit, dhe kationeve alumini.

Saliniteti: Saliniteti ose kripësia është vlera e matur e përbërjes jonik të me ujë dhe kjo ndryshon relativisht në varësi të përzierjes së ujit të ëmbël në brendësi me ujërat e kripura detare. Nga matjet në Lagunën e Nartës (Kane et al., 2014) rezulton se kripësia luhatet midis 15.1-45.4‰ me një mesatare 30.05‰.

TDS: Lëndët e ngurta totale (TS) i referohet çdo lëndë të pezulluar ose tretur në ujë. Përqendrime të larta të TSS kanë disa efektet negative, të tilla si uljen e sasisë së dritës që mund të depërtojë në ujë, duke ngadalësuar fotosintezën e cila nga ana tjetër mund të ulë prodhimin e oksigjenit të tretur; thithjen e lartë e nxehtësisë nga rrezet e diellit, duke rritur kështu temperaturën e cila mund të rezultojë në uljen e nivelit të oksigjenit.

TSS: Përmbajtja TSS në ujin e lagunës luhatet në mes të një vlere minimale e 21.6 mgL⁻¹ në vlerën maksimale e 165,3 mgL⁻¹.

Nitrat (N-NO₃): Vlerat e nitrateve në lagunë luhaten nga 0,016 në 0.084 mgL⁻¹ me një vlerë mesatare prej 0.035 mgL⁻¹.

Nitritet (N-NO₂): Nitritet në ujë të detit janë gjetur si komponimet e ndërmjetme të marra nga reduktimi mikrobik i nitrateve ose oksidimit të amonjakut. Niveli i tyre varion nga 0,004-0,024 mgL⁻¹ me një vlerë mesatare prej mgL⁻¹. Një tjetër burim i mundshëm i nitriteve mund të jetë fitoplanktonin dhe shkarkimet e ujërave të zeza.

Amonjak (N-NH₄⁺): Niveli i lartë është një tregues i besueshëm i shkarkimeve të ujërave të zeza dhe mbeturinave të lëngshme blegtorale (manureve). Gjithashtu reduktimin kushtet e ujit të lagunes nuk e favorizojnë oksidimin e amonit ndaj nitrateve. Në Nartë përmbajtja e amonit luhatet në nivelet mes 0.016-0.112 mgL⁻¹.

Fosfatet: Pothuajse i gjithë fosfori (P) i pranishëm në ujë është në formën e fosfatit (PO₄³⁻) dhe është një lëndë ushqyese thelbësore me karakter kufizues për thvillimin e bimëve (algave). Fosfatet në ujin e lagunës vlerësohen në nivele të ulta (Kane et al., 2014) nga 0.004 në 0.045 mgL⁻¹.

Nivelet e Indeksit Trofik: Duke u bazuar në matjet e niveleve të tejpamjes dhe klorofilës a Cako et al., (2015), niveli trofik i ujit të Lagunës së Nartës vlerësohet në kufijtë mesotrofikë eutrofik (TSI-SD²²: 54.27 dhe TSI-Chl²³ 37.78).

Statusi dhe presionet antropogjene në lagunë: Narta ka një status mbrojtje të mesem; së bashku me Patokun dhe Kune Vainit katagrizohet në zone të mbrotjes locale (shqiptare) është laguna me sipërfaqen të dyte me të madhe në Shqipëri. cilësia e ujit në të karakterizohet mesatare ; dhe dominanca është e kategorise Mesotrofik në oligotrofik.

Tabela IV-5: Të dhëna për makronutrientët, klorofilën dhe gjendjen trifike të lagunës së Nartës, krahasuar me Lagunat e tjera në Shqipëri.

Lagunat	Mbrojtja	Sipërfaqja (km ²)	Niveli i tretur (μmol l ⁻¹)	Përqendrimi i tretur (μmol l ⁻¹)	Chlorophyll (μgram dm ⁻³)	Statusi i mbështetur në N dhe P të treura	References
Butrinti	a	16.0	3.51±2.7 (n=14)	0.055±0.04	1.8±0.47	Oligotrofik	Sulce and Bani (2011)
Narta	c	29.90	3.3±4.5 (n=7)	0.06±0.084	2.38±5.62	Mesotrofik-Oligotrofik	Bino et al. (2004), Cako et al. (2014)
Karavasta	a	43.3	4.8±6.6 (n=9)	0.079±0.03	0.33±0.35	Oligotrofik Mesotrofik	Babani et al. (2012)
Patok	b, c	7.10	2.4 ± 7.7 (n=18)	0.043±0.09	2.1 -9.6	Mesotrofik	Avdoli (2012), KociKalfa et al. (2014)
Kune Vain Lagoons	b, c	11.45	6.4±2.2 (n=12)	0.088±0.062	4.3±3.6	Mesotrofik	Koci Kalfa et al. (2014), Kokali (2014)

The protection actions are classified as a = Ramsar site; b = Nature 2000 site; c = Local protection plans (classification by Barbone et al., 2012). Referenca: Sulce et al., 2016, Science of the Total Environment, submitted and accepted

Ndër ekosistemet lagunore cilësia e ujit të saj ka tendence kalimi nga e pastër në masatarisht e pastër. në lidhje me presionin human ndaj ekosistemit Narta është nder me të kercenuarit (presioni total = 2.7 dhe presion net = 2.6), e nxjerre nga studimet e referuara në Tabela IV-6.

Tabela IV-6: vlerësimi i presionit human dhe natyror mbi Lagunën e Nartës. Intensiteti i çdo lloji presioni u vlerësua duke përdorur një shkallë vlerash që variojnë nga 0 në 4 (0 = mungon; 1 = shumë i ulët; 2 = i ulët; 3 = i moderuar; dhe 4 = i lartë) sipas një vlerësimi të ekspertëve bazuar në njohuritë ekzistuese siç raportohet në një raport TW Reference Net. A = ngarkesa organike; B = ngarkesa ushqyese; C = substanca të rrezikshme; D = peshkim; E = specie aliene; F = lundrimi; G = modifikim fizik; H = presion mesatar; Ia = presion neto. Të dhënat dhe vlerësimi në këtë tabelë janë nga Barbone et al. (2012), përveç të dhënave dhe vlerësimit të Lagunave Butrinti dhe Kune Vain.

Lagunat	Presionet nga aktiviteti njerzor sipas katedrive									Referencat
	A	B	C	D	E	F	G	H	Ia	
Butrinti	2	2	-	4	1	-	2	1.4	1.1	Bino et al.

²² Trophic State Index sipas Sechi Disc

²³ Trophic State Index sipas Chlorophyll a

										(2004), Bego et al. (2009), Sulce and Bani (2011)
Narta	2	2	-	3	-	-	4	2.7	2.6	Cullaj et al. (2005), Xhullaj and Miho (2008), Cako et al. (2014)
Karavasta	1	1	-	4	1	1	3	1.8	1.4	Cullaj et al. (2005), Xhullaj and Miho (2008), Bani (2014)
Patok	-	-	-	2	1	-	1	1.3	1.0	Cullaj et al. (2005), Xhullaj and Miho (2008), Avdolli (2012)
Kune Vain	-	-	-	3	2	-	1	3.0	2.8	KociKalfa et al. (2014)

IV.9.2 Cilësi e ujrave bregdetar të Nartë-Zvërnec

Referuar rekomandimeve të OBSH-së (Organizatës Botërore të Shëndetësisë), në lidhje me monitorimin e ujërave bregdetare të larjes apo ujëra rekreative, kryhet në vendet Europiane si dhe në vendet të cilat aspirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Europian, vlerësimi i cilësisë mikrobike të tyre por gjithashtu dhe inspektimi sanitar i zonave bregdetare. Mostrat e ujërave bregdetarë të larjes u analizuan për 2 tregues bakteriologjike: 1- Intestinal Enterococci (IE) – Metoda ISO 7899-1, 2- Escherichia Coli (E.coli) – Metoda ISO 9308-3, e Membranave Filtrante (MF).

Rëndësia në aspektin mjedisor: Efektet direkte ose indirekte të nutriendeve në mjediset ujore dhe sasia e tyre ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujrave larëse bregdetarë dhe ujrë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Metoda e përdorur për vlerësimin e cilësisë u bazuar në këto kategori:

- A - Cilësi e shkëlqyer
- B - Cilësi e mire
- C - Cilësi e mjaftueshme
- D - Cilësi e keqe/masa të menjëherëshme

TabelaIV-7:Vlerësimi i cilësisë së ujrave bregdetarë të larjes, në plazhet e monitoruara, sipas kategorive për vitin 2019

Kategorite e Cilësisë	Zvërnec	Nartë
A	3	3
B	0	0
C	0	0
D	0	0

Gjatë inspektimit higjeno sanitar të bregdetit, janë vërejtur në brezin ranor, në disa fushata mbeturinatë dala nga deti, leshtërikë, me prani të pakët të këshave të mbeturinave dhe të tualeteve. Në 9 seritë e monitoruara, në të 3 pikat e monitorimit të analizuar në plazhin e Zvërnecit, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave *E. Coli* dhe *S. Fecal*) nuk ka ngarkesë mikrobike të ujërave në këto plazhe.

IV.10 SISTEMI I UJRAVE URBANE

Territori i zonës në studim mbulohet pjesërisht nga një rrjet i kanalizimeve i ujërave të ndotura, pjesa tjetër shfrytëzon sistemin e gropave septike. Rrjeti kryesor i kanalizimeve kalon vetëm në fshatin Novoselë dhe në Ibën e Poshtme në dy lagje. Në këtë njësi fshatrat Bishan, Mifol, Poro, Dëllinjë, Trevllazër, Çarkovinë, Skrofotinë, Akërnë funksionojnë me gropë septike (në total 506 të tilla), sidomos në Akërnë situata është më e rëndë. Sistemi i kanalizimeve funksionon më mirë në fshatrat Novoselë, Fitore, Aliban por me përjashtim të Novoselës rrjeti është i amortizuar. Nga rrjeti KUZ përfitojnë 41% e popullsisë që ka dendësinë më të madhë në këto tre fshatra. Rrjeti i ujërave të bardha në këtë njësi nuk ekziston. Në disa vende ku gjendet ai bashkohet me KUZ.

TabelaIV-8: Gjendjen e sistemit të ujërave të përdorura në fshatrat e NJA Novoselë

Fshati	Gjendja sistemit të ujërave të përdoruar	Ku shkarkohen?	Nr. i gropave septike
Dëllinjë	E pranueshme	Nga K2-K3 në KK1	30
Mifol	E mirë	Në K2-K3	40
Bishan	E amortizuar	Nga K2-K3 në KK1	50
Poro	E pranueshme	Nga K2-K3 në KK1	60
Delisuf	E pranueshme	Nga K2-K3 në KK1	25
Trevllazër	E pranueshme	Në K2	45
Aliban	E amortizuar	Nga K2-K3 në KK1	35
Akërnë	E amortizuar	Nga K2-K3 në KK1	45
Fitore	E amortizuar	Nga K2-K3 në KK1	50
Novoselë	E pranueshme	Nga K2-K3 në KK1	70
Çërkovinë	E amortizuar	Në K2 në KK1	30
Skrofotinë	E amortizuar	Në K2 në KK1	26

Me zhvillimin e parashikuar të zonës, si nga pikpamja e infrastrukturës ashtu edhe të ekoturizmit, është e domosdoshme ndërtimi i rrjetit të UKZ paralelisht me sistemin e

infrastrukturës rrugore. Studimi planifikon vendosjen dhe/ose lidhjen me një impianti të trajtimit të ujrave të ndotur shiko hartën Figura VI-3.

IV.11 SISTEMI NATYROR

Biodiversiteti i zonës së gjerë të studimit si pjesë e rajonit të Vlorës përfshin zona të rëndësishme natyrore siç është ajo e Lagunës së Nartës, Gadishullin e Karaburunit dhe Ishullin e Sazanit, të cilat bazuar në pozicionin gjeografik, natyrën e substratit dhe klimës dallohen për llojshmërinë, karakteristikat specifike të llojeve bimore dhe shtazore që ato strehojnë dhe sasinë e tyre të konsiderueshme, duke e kthyer tërësinë natyrore të rajonit një një kombinim të njërendësie të veçantë.

Kompleksi ligatinor Nartë-Vjosë me VKM Nr.680, datë 22.10.2004 është shpallur peizazh ujqor/tokësor i mbrojtur (Kategoria IV IUCN), ndërsa ishulli i Sazanit përfaqëson një pjesë të Parkut Kombëtar tokë/det. Në këto eksosisteme dallohe Laguna e nartës, Grykëterdhja e Lumit Vjosë, sistemet bujqësore – kryesisht kodrat e mbjella me ullinj dhe vreshta, ndërkohë të bimësia është tipike mesdhetare, pyjet me pisha, etj. Në tërësinë e saj ekosistemet dinamike mbajnë një numër të madh habitatesh natyrore të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo pasuri natyrore përbën një tërheqje turistike e cila padyshim që po ushtron një ndikim mbi të si pasojë e zhvillimit të saj aktual dhe perspektiv.

IV.12 BIODIVERSITETI, FLORA DHE FAUNA

IV.12.1 Vështrim i përgjithshëm i biodiversitetit në Shqipëri

Në Shqipëri gjenden rreth 3.660 lloje bimësh vaskulare një nje sipërfaqe prej 28,748 km², duke e rankuar Shqipërinë për aspektin floristic ndër vendet më të pasura në dhe 756 specie vertebrorë; përafërsisht 30% e të gjithë florës evropiane ndodhet në Shqipëri.

IV.12.2 Kërcënimet e biodiversitetit

Kërcënimet kryesore të biodiversitetit në Shqipëri mund të lidhen me faktorë të tillë si: (i) mungesë e strategjive dhe legjislacioni efektiv për mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore; (ii) mungesë e fondeve për monitorimin dhe ruajtjen e habitateve si dhe mungesë dokumentimi e tyre; (iii) mungesa e njohurive të duhura administruese për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe varfëria në zonat rurale si dhe, mundësitë e pakta të punësimit. Duhet theksuar se varfëria në zonat rurale shkakton një mbishfrytëzim të burimeve

natyrore përmes: mbledhjes së bimëve mjeksore; mbikullotjes dhe gjuetisë mbi kapacitetet e mundshme; prerjes së pyllit për burime energjie dhe ushqim për bagëtinë.

Ruajtja e natyrës në vend është kufizuar ndjeshëm në dekadat e fundit si pasojë e zhvillimit ekonomik dhe rritjes së popullsisë, duke reduktuar apo shkaktuar humbje të vazhdueshme të llojeve biologjike. Ndikimet kryesore të zhvillimit njerëzor në natyrë përfshijnë:

- Ndryshimet në përdorimin e tokës;
- Copezimin dhe humbje e habitateve;
- Dëmtim dhe degradim të habitateve dhe ekosistemeve;
- Shqetësim dhe keqtrajtim i botës së egër;
- Humbje e llojeve, kërcënim i tyre për zhdukje;
- Dëmtim dhe erozion i burimeve gjenetike.

IV.12.3 Flora

Ndikimi i fuqishëm i detit Adriatik si dhe i erërave dhe rreshjeve kanë bërë që e gjithë vija vija bregdetare, të ketë pësuar dhe pësojë ndryshime të mëdha me akumulime të ndryshme të rërës, këtu referuar si duna ranore, në ekuilibër dhe në gërryerje intensive. Gërryerjet dunore më të mëdha hasen më së shumti në pjesën veriore bregdetare të zonës e cila karakterizohet nga ngritje të ultaosepa duna, me gjerësi shumë të madhe të pjesëssterile (pa bimësi), ose me bimësi të instaluar gjatë 60-70 viteve të fundit dhe dominuar kryesisht nga Pisha e Halepit (*Pinus halepensis*). Procesi i gërryerjes intensive të brigjeve, takohet në gati gjithë gjatësinë e vijës bregdetare, më e theksuar nga Laguna e Kallëngës deri në grykëderdhjene Vjosës, por me shtrirje, përshkallëzim dhe kohë veprimi jo të njëjtë. Siç duket gërryerja në këtë zonë është favorizuar edhe nga mungesa e mbulesës bimore, kryesisht asaj drunore të dominuar nga Pisha e Halepit.



Figura IV-22: Dalja në sipërfaqe e substratit argjilor në Veri të Lagunës së Kallëngës

Kripëzimi në disa zona të peizazhit arrin vlera të larta, sidomos në tokat ku lartësia e ujit nuk i kalon 70-80 cm, mjedise në të cilat kristalet e kripës depozitohet në anë ose si [përfaqe të tokës pas tharjes së ujit. Në pjesën qendrore të peizazhit, ky nivel i lartë i kripës shfrytëzohet për nxjerrjen e saj në vaskat e krijuara, sidomos gjatë 80-viteve të fundit.

Pjesa me e ngritur e dunave ranore të hasura në afërsi të grykëderdhjes, në zonën e Hidrovorit dhe në zonën Jugore të vijës bregdetare, mbizotrohet nga plazhe ranore në ekuilibër, të favorizuara edhe nga prezenca e bimësisë së kultivuar të Pishës së Halepit dhe Mimosës së Artë (*Acacia cyanophylla*) si dhe bimësisë natyrore të instaluar kohët e fundit dhe dominuar nga Dëllinja kokërrmadhe (*Juniperus oxycedrus* subsp. *macrocarpa*) dhe Marina e Hampeanit (*Tamarix hampeana*).

Erozioni masiv vërehet përgjatë gjithë vijës bregdetare, ku për shkak të gërryerjes së vazhdueshme, në tabanin detar vërehet dalja në sipërfaqe e substratit argjilor si dhe në depërtimin e vazhdueshëm të detit në stere ose në përmytjen e vazhdueshme të zonës bregdetare dhe Lagunës së Kallëngës. Nga ana tjetër, pjesa veriore e zonës, gjatë periudhës Vjeshtë-Dimër i nënshtrohet edhe depërtimit përmytës të ujrave të Lumit Vjosë, si pasojë e daljes së tij nga shtrati për shkak të shirave të vazhdueshme të kësaj periudhe.



Figura IV-23: Kriporja zë një sipërfaqe të rëndësishme nëpeizazhin e mbrojtur “Vjosë-Nartë”

Pjerrësia jashtëzakonisht e vogël e fushave, në të dy anët e Vjosës, kushtëzon akumulime masive të Vjosës. Nga ana tjetër, mungesa e dunave të larta në të dyja anët e Lagunës së Kallëngës, përgjatë vijës bregdetare, lejon vërshimet e herëpashershme të ujit të detit në brendësi të ultësirës duke përmbytur dhe kënetizuar tokat përreth. Po kështu, depërtimi i ujrave të ëmbla nga përmbytjet e Lumit të Vjosës mundëson zbutjen e kripësisë në disa pjesë të zonave nën nivel.

Pasojë e përmbytjeve të dyanshme, detare dhe lumore, kanë ndikuar në formimin e lagunës së Nartës dhe në evolucionin e vijës bregdetare. Përmbytja e shpeshtë e kësaj zone nga Vjosa ka mundësuar gjithashtu edhe mbathjen e shpeshtë të zonave me sedimentet aluvionale që mbart uji i lumit të Vjosës, por njëkohësisht edhe zhvillimin e një bimësie pushtuese (invasive) dhe të dominuar nga Ditrike veshtullore (*Dittrichia viscosa*), e përshatur ndaj kushteve specifike që favorizohet nga çrregullsia e depërtimit të ujrave të ëmbla dhe të kripura, në zonat që kanë prezencë të përkohshme të ujrave përmbytëse.



Figura IV-24: Pjesa Veri-Lindore e Lagunës së Nartës




Figura IV-25: Laguna e Kallëngës dhe pjesa Veri-Perëndimore e saj



Figura IV-26: Lagunës e Nartës, Pjesa Jug-Perëndimore

IV.12.3.1 Bimësia dhe Tipet e Habitave

Bimësia është element shumë i rëndësishëm në funksion të krijimit të habitateve të ndryshme të specieve përfaqësuese por edhe për botën shatzore, sepse ajo përcakton karakteristikat kryesore të biocenozave.

Duke patur parasysh se kjo zonë është me zhvillim potencial turizmi dhe aktualisht me aktivitet bujqësor dhe blektoral të popullatës po kështu duke pasur parasysh shfrytëzimin për kullotje, bimët mjekesore etj, të dhënat mbi larminë bimore dhe përdorimit të saj, janë me rëndësi për evolucionin e habitateve dhe cilësisë së ujrave dhe mjedisit.

Veprimtaria dinamike e deltës së Lumit të Vjosës, paqëndrueshmëria e bregdetit dhe ndryshimi i nivelit të ujit në këtë kompleks lagunor kanë krijuar një tërësi habitatesh si deltë lumi, duna ranore të mëdhaja e disa të vjetra, kënetat të kripura, livadhe të lagështa etj., për rritjen e njëbimësie të larmishme barishtore hidrofile submerse (*Zostera noltii*, *Ruppia cirhosa*), higrofile, halofite, psamofite (mbi duna ranore), pyje aluvionale, pyje pishash kryesisht të kultivuara (*P.halepensis*), pyll selvie (*Cupressus sempervirens*) në Zvernec, etj.

Vegjetacioni (Bimësia) i grykëderdhjes së lumenjëve

➤ 1130 - Grykëderdhje të lumenjëve

Grykëderdhjet e lumenjëve janë habitate interesante nga këndvështrimi i biotës shatzore, për shkak të përzierjes së ujrave të ëmbla me ato të kripura si dhe sasisë së lartë të lëndëve ushqyese që sjellin lumenjtë në këtë tip habitati.

Vegjetacioni bimor i këtij tipi habitati përfaqësohet nga shoqërimet të algave bentike mikroskopike, të cilat në periudhën e prurjeve të lëndëve ushqyese shoqërohen me rritjen e biomasës së tyre. Në zonën e bashkimit të ujit të Vjosës me detin haset gjithashtu bimësia e dominuar nga *Zostera noltii* dhe *Ruppia cirrhosa*.

Vegjetacioni (Bimësia) i kënetave të kripura

➤ Tipi i Habitatit: 1150 * Laguna bregdetare

Ky tip habitati haset kryesisht në të dy lagunat e peizazhit të mbrojtur, Laguna e Nartës dhe e Kallëngës. Laguna e Nartës dhe e Kallëngës dhe mjediset e tjera ujqor të përkohshme në kanale ose pellgje temporale dominohen nga bimësia higrofile me lloje të mjediseve ujqore të mjelmëta si: *Ranunculusspp*, *Chara spp.* etj. në mjediet me kripësi më të lartë dominojnë llojet *Chara canescens*, *Ruppia maritima* dhe *Zannichellia pedunculata*. Fundet e lagunave të kripura, sidomos ajo e Nartës, vegjetohe nga *Zostera noltii*, mbizotëruese, dhe *Ruppia cirrhosa*. Të dy llojet, si dhe disa alga, përfaqësojnë bimësinë më të rëndësishme të lagunës së Nartës (Figura IV-27).

Në tokat përreth lagunave, të cilat para viteve 1990, kanë qënë të shkripëzuara, dhe tashmë të kripëzuara për shkak të qënies nën ujqrat e kripura gjatë periudhes vjeshtë-dimër dhe fillimi i pranëverës është zhvilluar një bimësi tipike e e ketyre mjediseve me *Salicornia spp.*, *Arthrocnemum spp.*, *Salsola soda*, *Limonium vulgare* etj. Në tokat ku kripësia bëhet më e ulët, dhe për shkak të përmytjes nga ujqrat e ëmbla mbizotrojnë llojet e *Arthrocnemum fruticosum*, *A. perenne* etj .

IV.12.3.2 Bimësi e vendeve të kripura dhe të kripura moçalore (halo – halohigrofile).

➤ Tipi i Habitatit: 1410 - Livadhe të kripura mesdhetare (*Juncetalia maritimi*)

Mbulon sipërfaqe të mëdha në pjesën rreth-bregedatë të peizazh ujqor/ tokësor i mbrojtur dhe shtrihet në tokat të cilat gjatë periudhës së dimrit vendosën në nën efektin kripëzues të depërtimit të detit në stere, ose efektit zbutës të përmytjes nga ujqrat e ëmbla të Lumit Vjosë.

Habitati fillon më në perëndim të fshatit Dëllënjë deri tek derdhja e e Vjosës, duke shkuar në Jug drejt Kripores dhe Lagunës së Nartës (Figura 8), përjashtuar dunat ranore ose sipërfaqet e përhershme ujqore të kënetave dhe kriporeve si dhe pyjet e dominuara me Pishë të halepos.



Figura IV-27: Laguna e Nartës dhe bimësia tipike e tokave të kripura përreth mjediseve të ngritura të saj.

Këtu dallohen disa shoqërime bimore të cilat janë barishtore me përjashtim të shoqërimit bimor me *Tamarix hampeana* që është shkurror dhe mjaft karakteristik, si dhe formacioneve me Pishë të halepos të vendosura më në brëndësi të territorit me sasi të madhe në këtë zonë. Kjo lloj bimësie i është përshtatur tokave të kripura ku një pjesë e mirë e tyre në periudha të lagështa (dimër) mbulohet me ujë të cekët.

Shoqërimet kryesore bimore të këtij habitati janë:

Shoqërimi bimor me *Arthrocnënum sp. div.*

Shoqërimi bimor me *Arthrocnënum sp.* përbën shoqërimin më të përhapur gjatë gjithë zonës më toka të kripura dhe të “vizituara” shpesh nga uji i detit dhe më pak nga ujrë e embla të Vjosës gjatë përmbytjeve (Figura IV-28). Ka përhapje mjaft të madhe në tokat e kripura, në vendet e stabilizuara me një regjim të caktuar ujor dhe kripshmëria. Këtu bëjnë pjesë bimët që populli i quan kripçe ose jambruk i trashë që ndryshon nga jambruka e hollë (*Salicornia europea*) një vjeçare, për shkak se këto janë shumëvjeçare. Mbulesa bimore arrin gati 100 %, me shumë pak territore të pambuluara. Të tilla janë *Arthrocnënum perene*, *Arthrocnënum fruticosum*, *Arthrocnënum glaucum*.



Figura IV-28: Habitat me kod 1410 - Livadhe të kripura mesdhetare (*Juncetalia maritimi*)

Në përgjithësi shoqërimet e jambrukës janë të varfra në përbërje llojore duke marrë formën e oligocenozaave dhe ndonjëherë të monocenozaave. Veç llojeve mbizotëruesve hasen gjithashtu edhe: *Arthrocnëumsp. div.*, *Halimione portulacoides*, *Limonium vulgare*, *Plantago maritima* etj.



Figura IV-29: Shoqërimi bimor me *Arthrocnëumsp. Div*

Shoqërimi bimor me *Limonium vulgare* – *Arthrocnënum* sp. div.

Shoqërimet bimore të *Limonium vulgare* me *Arthrocnënum* sp. div., mbulojnë sipërfaqe jo shumë të mëdha në territorin e peizazhit ujor/tokësor Nartë-Vjosë. Në përgjithësi ky shoqërim haset në toka me kripshmëri jo uniforme, në formë vatrash apo njollash duke na dhënë një mozaik të bukur të këtyre mjediseve. Shoqërimi haset gjithashtu edhe buzë kanaleve me ujëra të mjelmëta ose të ëmbla, sidomas në anë të vjosës. Në përgjithësi, në këtë shoqërim hasen në toka të zhveshura, të bardhë nga kripa e alternuar me ngjyrën e blertë në tokën me bimë. Sasia e madhe e kripës shfaqet dhe në gjethet e *Limoniumvulgare* që pas tharjes së solucionit shfaqen kristalet e kripës me ngjyrë të bardhë, ashtu si dhe prezenca e madhe e saj në tokë e jep asaj ngjyrën e bardhë të saj. Mbulesa bimore arrin 50 – 60 %. Llojet bimore kryesore të këtij shoqërimi janë *Limonium vulgare*, *Arthrocnënum* sp. div., *Halimione portulacoides*, *Plantago crassifolia*, *Inula chrithmoides* etj.

Shoqërimi bimor me *Schoenus nigricans*.

Ky shoqërim bimor popullon vendet më pak të kripura por me më shumë ujë, dmth është më moçalor aty ku ujjat nga shirat që bien janë më të shumta. Veçori e tij është se krijon popullime të dendura duke mbizotëruar. Mbulesa bimore arrin 100 %. Llojet bimore me sasin mbulesë më të madhe janë *Arthrocnënum* sp. div., *Erianthus ravenae*, *Inula chrithmoides*, *Plantago crassifolia*, *Lactuca* sp. Div (shih Figura IV-30).

Shoqërimi bimor me *Juncus maritimus*.

Shoqërim bimor me Kulmak bregdetar popullon po ato mjedise me ujëra të mjelmëta ose mjediset të cilat përmyten shpesh nga ujjat e Vjosës. Mbulesa bimore arrin 60 – 70 %. Mbizotëruesi është *Juncus maritimus*, lloje të tjera bimore që e shoqërojnë janë *Limonium vulgare*, *Bellis annua*, *Plantago crassifolia*, *Plantago maritima*, *Juncus acutus*, *Blackstonia perfoliata*, *Inula chrithmoides* etj. Shoqërimet bimor me *Juncus maritimus* shpesh hasen të përzierje me *Limonium vulgare* ose lloje të tjera duke formuar mozaikë mikro habitatesh në depresionet e krijuara në çeltirat që krijon bimësia e Pishës së Halepit (Figura IV-33).

➤ Tipi i Habitatit: 1420 Formacione shkurrëzash halofitike Mesdhetare dhe Termo-Atlantike (*Sarcocornetea fruticosi*)

Ky tip habitat mbulon sipërfaqe të vogla e krahasuar me habitatin e mësipërm. Shpesh vendoset pas dunave ose në vende me ujëra të mjelmëta të përkohshëm ose ujëra të ëmbla. Flora e këtijshoqërimi është e përzier dhe dominohet nga Marinë e Hampeanit.

Shoqërimi bimor me *Tamarix hampeana*

Shoqërim bimor me Marinë të Hampeanit është mjaft karakteristik për zonën bregdetare dhe pavarësisht se zë sipërfaqe shumë të vogël paraqitet mjaft interesant. Shpesh takohet përgjatë dunave ose menjëhere pas formacioneve me pishë dhe përgjatë kanaleve ujore, kryesisht me ujëra të mjelmëta ose me shumë pak kripësi. Në zonën midis grykëde4rdhjes së Vjosës dhe venderdhjes së ujjave të shtratit të vjetër të Vjosës në det zësipërfaqe të konsiderueshme. Mbulesa bimore varion nga 40 – 70 %. Lartësia mesatare e shkurreve që përbëhen nga marina është 1.5-2 m. Llojet bimore me sasi mbulese më të madhe janë *Tamatix hampeana*, *Bellis perennis*, *Arthrocnënum* sp. div.,

Limonium vulgare, Inula chrithmoides, Halimione portulacoides, Blackstonia perfoliata, Centaurium erythraea, Schoenus nigricans etj.



Figura IV-30: Tipi i habitatit me kod 1420 ose Formacione shkurrëzash halofitike Mesdhetare dhe Termo-Atlantike (*Sarcocornetea fruticosi*), i vendosur midis grykderdhjes së Vjosës dhe Lagunës së Këllëngës.

IV.12.3.3 Bimësia pioniere e plazheve dhe e ranishteve e dunave bregdetare

Megjithëse në peizazhin e mbrojtur Nartë-Grykderdhja e Vjosës nuk mund të flitet për duna të mirëfillta, prezenca e tyre në afërsi të grykderdhjes së Vjosës si dhe në jug të Lagunës së Kallëngës deri në perëndim të Ishullit të Zvërnecit, me një bimësi karakteristike të zonës paraqet interes për të krijuar brezin parandalus të depërtimit të ujrave detare në brendësi të territorit. Në veri të Lagunës së Kallëngës, dunat janë inekzistente dhe ndikimi i ujrave detare në kripëzimin e tokave të kësaj zone është i lartë. Kjo zonë duke qënë më pak e ndikuar nga turizmi dhe ndërhyrja e njeriut paraqet pamjen natyrore të bimësisë, gjë që duhet vlerësuar për ruajtjen e saj duke marrë parasysh dëmtimet e shkaktuara në zona të tjera të bregdetit Adriatik. Bimësia e këtyre habitateve është e përshtatur ndaj modifikimeve të shumta specifike të ndikuara nga rëra dhe thatësira siç janë: gjethe sekulente, sistem rrënjor i fuqishëm, gjethe tubore etj. Në pamje të parë duket uniforme por një vëzhgim më i hollësishëm tregon për praninë e disa shoqërimeve bimore ndër të cilat përmendim:

- **Tipi i Habitatit: 2120 Duna të lëvizshme përgjatë brigjeve me *Ammophila arenaria* (Duna të bardha).**

Bimësi pioniere e plazheve përfaqësohet nga shoqërime bimore ku dunat janë më të ulura dhe të rahura nga valët e detit (Figura IV-31). Bimësia e plazheve në peizazhin e mbrojtur Vjosë-Nartë përfaqësohet nga dy shoqërime bimore karakteristike: me *Cakile maritima* në sipërfaqe të pakëta dhe shoqërime psamo – higrofile të laboteve *Atriplex tatarica – hastata*. Janë shoqërime të

ralla jo vetem si mbulesë por dhe si sipërfqe. Rëndësia e tyre qëndron se janë fillimi i zhvillimeve bimore në stade të mëtejshme klimakse të bimësisë bregdetare.

Shoqërimi bimor me *Sporobolus pogens*.

Mbulon sipërfaqe ranore në vende gjysem të lugëta dhe të lugëta midis dunave por të thata. Mbulesa bimore arrin 15 – 20 %. Llojet bimore që shoqërojnë mbizotëruesin *Sporobolus pogens* kurse bimësia shoqëruese përbëhet nga llojet e *Tribulusterrestis*, *Crepisfoetidae*, *Calystegiasoldanella* ose *Datura stramonium*.

Shoqërimi bimor me *Ammophila arenaria*.

Është shoqërimi më karakteristik dhe me pamje piktoreske i kësaj zone, që shpesh herë prishet (si pamje) prej mbeturinave të shumta ose edhe bimëve të thara të *Echinophora spinosa*, *Eryngium maritimum*, *Datura stramonium*. Shoqërimi mbizotrohet nga llojet e *Ammophila arenaria* i vendosur në formë tufash me popullim të dendur dhe sistem rrënjor të fuqishëm në dunat e valëzuara (Figura IV-31) dhe me më pak mbulesë në dunat embrionale ose në formim e sipër (Figura IV-32). Mbulesa bimore arrin deri 40 – 60 % në zona të veçanta të dunave. Megjithatë në shumë pjesë të tyre mbulesa e Arenaries është e vogël. Mbizotëruesi shoqërohet me pak lloje bimore të përshtatura në këto mjedise siç janë *Euphorbia paralias*, *Echinophora spinosa*, *Sporobolus spunges*, *Cakile maritime*, *Eryngium maritimum*, *Inula crithmoides*, *Calystegia soldanella*, *Cakile maritima* ose *Alkanna tinctoria* etj.



Figura IV-31: Duna të ngritura, Shoqërimi bimor me *Ammophila arenaria*

➤ **2250 * Duna bregdetare me *Juniperus* spp.**

Ky tip habitati, takohet pothuaj në të gjitha brezat dunore të pjesës bregdetare të peizazhit të mbrojtur. Habitati mbulohet nga dëllinja e kuqe kokër madhe (*Juniperus oxycedrus* subsp.

macrocarpa) dhe specie të tjera të ranishteve të cituara më sipër. Dëllinja e kuqe kokërr madhe, shpesh është e përzier me Pishën e Halepit dhe dukja e saj “maskohet nga kjo e fundit” me të cilën formon shoqërimin bimor me *Pinus halepense* – *Juniperus oxycedrus*.

IV.12.3.4 Bimësi e pishnajës bregdetare

- **Tipi i Habitatit: 9540 Pyje me pishë mesdhetare të karakterizuar nga Pishat endemike Mesogeane**

Vegetacion bimor me pishë të Halepit (*Pinus halepensis*) përbën tiparin karakteristik të vijës bregdetare (Figura IV-32) dhe në disa raste edhe më në brendësi të territorit, si në zonën mbi Lagunën e Kallangës dhe më në Jug të Bunkerëve (Fshati Delisufaj, e cila duke shkuar më në jug vjen duke u ngushtuar deri poshtë kripores ku edhe arrin zonën me të ngushtë të saj në Hidrovorin e Lagunë së Nartës. Në vende që ka më tepër ujë, në periudha të caktuara të vitit (fund pranverë, fillim vjeshtë) kjo bimësi rrallohet, ulet kurorë dendësia duke u lënë vëndin bimësisë halofite dhe halo e halohigrofile. Pjesa më e zhvilluar dhe më e shëndetëshme është ana më larg detit, në lindje, në toka më të ngritura kryesisht ranore (Jugu i bunkierëve, zonë e e pëllëzuar që tashmë është e djegur). Kjo vërehet dhe në pjesët e lugëta ku pisha është më pak e zhvilluar dhe e rallë (Figura IV-36).



Figura IV-32: Shoqërimi bimor me *Ammophila arenaria* në duna embrionale

Në të gjithë mbulesën bimore mbas dunave ranore të zonës bregdetare në jug të Lagunës së Kallëngës një vend të rëndësishëm sin ë stabilizimin e dunave ranore ashtu edhe në mbulesën bimore luan vegetacion i Mimosës së artë (*Acacia cyanophylla*), një lloj i cili është sjellë në këtë mjedis pas viteve 1970 (Figura IV-35). Dallohen disa shoqërime bimore të pyllit të pishës së Halepit

(Figura IV-34), të cilat janë të diferencuara në tre kate: druror, shkurre, barishtor. Shoqërimet më të rëndësishme të këtij vegjetacioni janë:

Shoqërimi bimor me *Pinus halepense* – *Juniperus oxycedrus*

Si shoqërim bimor zë sipërfaqe të vogël dhe vendoset më së shumti në duna të ulëta. Është më i rrallë, kurorë dendësia është më pak se 60 – 70 %. Edhe këtu kemi diferencim të katëve: kati i parë është i përbërë nga *Pinus halepense*, ndërsa kati shkurre është me *Juniperus oxycedrus subsp. macrocarpa*, *Pistacia lentiscus*, *Myrtus communis*, etj.

Kati barishtor është më i pasur me bimësi ranishtore pasi dhe drita depërton më shumë sepse është pyll më i rrallë: *Crepis foetida*, *Bellis annua*, *Ophrys sphegodes*, *Erythraea centaurea*, *Teucrium polium*, *Lagurus ovatus*, *Alkana tinctoria* etj.



Figura IV-33: Vegjetacion artificial për gjatë bregdetit me Pise të Halepos (Bimësi e pishnajës bregdetare)

Shoqërimi bimor me *Pinus halepense* – *Myrtus communis*

Përbën shoqërimin bimor mbizotërues të pishnajës që popullon vende të ngritura ranore. Më shpesh kurorë dendësia është 80-90 % dhe e ndarë në tre kate: kati i parë është i përbërë nga *Pinus halepense* që shfaqet si dominant, kati i dytë shkurre është i përbërë nga *Pinus pine*, *Myrtus communis*, *Pistacia lentiscus*, *Erica manipuliflora*, *Smilax aspera*, *Hedera helix* dhe *Acacia cyanophylla*, etj. Kati barishtor është i përbërë nga *Chrystopogon gryllus*, *Galium aparine*, *Teucrium polium*, *Daucus guttatus*, *Blackstonia perfoliata*.



Figura IV-34: Habitat i degraduar dhe i djegur me Pishë të Halepit, në Jug të Fshatit Delisufaj

Shoqërim bimor me *Pinus halepense* – *Erianthus ravenae*

Ky shoqërim bimor është më pak i përhapur dhe është karakteristik për vendet ranishtore më të ulëta e të lugëta (sarace), ku në periudhat me reshje të dimrit mbulohen cektësisht me ujë. Kjo është arsyeja që pylli me pishë është më i rrallë dhe me pak i zhvilluar duke i lënë vendin kati drunor, atij shkurre e barishtor.



Figura IV-35: Vegetacion artificial për gjatë bregdetit me Mimosë të artë (*Acacia cyanophylla*)

Mbulesa bimore është 60 – 70 %. Llojet bimore me sasi mbulesë më të madhe janë: *Pinus halepense*, *Eriathus ravenae*, *Juniperus oxycedrus*, *Schoenus nigricans*, *Crepis setosa*, *Plantago crassifolia*, *Juncus littoralis*, *Ranunculus sardous*, *Picris echioides*.



Figura IV-36: Shoqërim bimor me *Pinus halepense* – *Erianthus ravenae* (me pjesmarrje edhe të *Erica manipuliiflora*).

IV.12.3.5 Bimësi e shtretërve të poshtëm lumor e kanaleve dhe e vendeve me ujë të ëmbël (higro – e higrohidrofile)

Bimësia përreth shtratit të lumenjëve (të rrjedhshëm si ai i Lumit të Vjosës ose ujrave jo të rrjedhëshme si shtrati i lumit të vjetër të Vjosës, i cili kalon në fshatin Delisufaj dhe Dëllenjë (Figura IV-37), bashkë me bimësinë e kanaleve ujore me ujëra të ëmbla përbëjnë habitate të rëndësishme në peizazhin e mbrojtur Naretë-Vjosë. Bimësinë e këtyre mjediseve, në e kemi përfshirë në dy tipe habitatesh:

- **3280** - Lumenj Mesdhetarë me rrjedhje të vazhdueshme të karakterizuar nga specie të aleancës Paspalo-Agrostidion dhe brezave pyjore me dominancë të *Salix* dhe *Populus alba*
- **Tipi i Habitatit: 6430** - Shoqërime hidrofiliqe të buzëujrave të llojeve barishtore të larta të ultësirave dhe zonave malore deri në nivelet alpine

Bimësia për gjatë shtratit lumor të Vjosës ose pylli aluvjonal, dominohet kryesisht nga llojet e shelgheve dhe Plepit të bardhë (*Salix alba*, *Salix purpurea* dhe *Populus alba*), po ashtu me më pak

mbulesë edhe nga llojet e tjera si *Populus nigra*, *Salix amplexicaulis*, *Alnus glutinosa*, *Platanus orientalis*, *Ulmus minor*, *Ulmus glabra*, *Fraxinus angustifolia* etj.

Bimësia barishtore e shtratit lumor përbëhet nga dy kate, kati i pari përfaqësohet kryesisht nga kallamishte dhe lloje të tjera hidrofile; i dyti kryesisht nga klasa e Kallamishteve (*Phragmitetalia*), me mbizotërim të shoqërimit *Phragmites australis*, me plasticitet ekologjik mjaft të lartë dhe shtrirje nga brigjet e lumenjve deri larg tyre dhe Shavar gjethehollë (*Typha angustifolia*). Një florë dhe bimësi tjetër shfaqet përgjatë kanaleve ujitëse e kulluese të cilët dominohen nga bimësia halo-higrofile e përfaqësuar nga *Phragmites australis*, *Typha angustifolia* etj. Tipet e tjerë të bimësisë përfshijnë bimët notuese *Equisetum* spp., *Lemna minor*, *Spyrodela polyrhiza* etj.

Me rëndësi të veçantë për gjallesat shtazore në zonën e vlerësuar janë edhe habitatet me ujëra të përkohshëm ose temporale, të cilat thahen gjatë verës. Këto habitate vegjetojnë nga llojet *Suaeda maritima*, *Suaeda splendens* etj., ndërsa në sektorët që janë nën trysinë e kullotjes, zhvillohen komunitete bimore me Shqirrë (*Scirpus* spp.) dhe Xunkth (*Juncus acutus*) etj.

Duke patur parasysh habitatin karakteristik si dhe shtratin e lumit me bimësin anash që përbëjnë një biokorridor, kuptohet që kjo bimësi ka rëndësinë e vetë si pjesë e rëndësishme e biodiversitetit bimor. Këtu dallohen disa shoqërime bimore ndër të cilat veçojmë për zonën në studim:

Shoqërimi bimor me *Phragmites australis*.

Popullon brigjet buzë ujit të Vjosës, vende të lagëta ku uji del në sipërfaqe si dhe buzë kanaleve dhe pellgjeve të tjera që mbajnë ujin në pjesën më të madhe të vitit. Llojet bimore shoqëruese janë të pakta prandaj më shpesh paraqitet si oligocenzë por edhe monocenzë me mbulesë bimore gati 100 %. Përveç mbizotëruesit *Phragmites australis*, lloje të tjera shoqëruese janë *Typha latifolia*, *Scirpus div.*, *Cyprus longus*, *Alisma plantago – aquatica*, *Ranunculus* spp. etj.

Shoqërimi bimor me *Typha latifolia*

Shoqërim bimor me Shavar është karakteristik për buzë ujërave të kanaleve më shpesh por dhe buzë lumit. Është oligocenzë, ka pak lloje shoqëruese dhe ndonjëherë merr formën e ndonjë monocenzoze. Mbulesa bimore arrin 80 – 100 %. Përveç mbizotëruesit *Typha latifolia* ka dhe lloje të tjera si *Alisma plantago – aquatica*, *Paspalum paspalade*, *Rumex* sp. etj.

Shoqërimi bimor me Xunkth (*Juncus acutus*).

Ky shoqërim bimor mbulon sipërfaqe të vogla në toka të lagura. Mbulesa bimore në raste të veçanta arrin 80 %. Shoqërimet bimore përveç *Juncus acutus*, në këtë shoqërim hasen edhe lloje të tjera si: *Calystegia sepium*, *Plantago lanceolata*, *Trifolium sp. div.*, *Bellis perennis*, etj.

IV.12.3.6 Bimësi e djerrinave

Tokat që kanë qënë punuar para viteve 1992 dhe të lëna djerr për shkaqe të ndryshme ose për shkak të kripëzimit ose edhe për shkak të qënies së tyre anës kanaleve merr një rëndësi jo vetëm për kullotje por edhe për shkak të mbulesës që ajo krijon. Në tokat e papunuar në shumë raste është zhvilluar bimësi invazive me llojin *Ditrichia viscosa* ose Xunkth. Përjashtuar llojet invazive, bimët e tjera të këtyre mjediseve ka interes ndër të tjera për vlerat aromatiko – mjekësore

pasi është e pasur me këto lloj bimësh. Këto djerrina mund të jenë të thata apo të lagura. Në djerrinat e thata janë të pranishme më tepër shoqërimet bimore të *Erianthu shosti*, *Dactylis glomerata* dhe *Aegilopstriuncialis*, kurse për djerrinat e freskëta janë karakteristike shoqërimet bimore të *Lamium purpureum*, *Ditrichia viscosa*, *Ranunculus velutinus*. Në tokat e papunuara sidomos në mbarim të verës mbizotërojnë shoqërimet bimore të *Daucus carota* – *Cichorium intybus*.




Figura IV-37:Shoqërimi bimor me *Phragmites australis*dhe bimësia përgjat shtratit të lumenjve

Peisazhi i mbrojtur Nartë-Vjosë është i njohur për florën e tij mesdhetare si dhe larminë e habitateve ujore dhe tokësore të kripura ose gjysëm të kripura. Pavarësisht se në shumë raporte për këtë zonë citohen të rriten rreth 25 lloje bimësh të rrezikuara dhe të përfshira në listën e kuqe të bimëve të mbrojtura të vendit (MoE, 2013), në kemi listuar si të rrezikuara vetëm 9-lloje bimore (Aneks 2), me një përhapje të gjerë në mesdhe dhe më gjerë. Midis tyre, përmenden edhe prezencat dy llojeve endemike shqiptare, Salepi shqiptar (*Orchis albanica*)dhe një formë hibride e tij (*Orchis paparisti*). Pavarësisht kësaj, nga të dhënat e fundit rezulton se kjo specie është përfshirë në llojin *Anacamptis morio* subsp. *caucasica* (K.Koch) H.KretzschmarEccarius & H.Dietr, me përhapje mjaft të gjerë në kontinentin Evropian dhe Aziatik (Kaukaz), nga edhe ka marrë emrin e ri. Po kështu bie edhe forma e tij hibride *Orchis x paparisti* një ish hybrid midis *Orchis albanica* x *Orchis coriophora*.

Nga vëzhgimet tona rezulton se nëpeisazhin e mbrojtur Nartë-Vjosë rriten tre lloje bimore të mbrojtura nga direktiva e habitateve (*Anacamptis pyramidalis* (L.) Rich., *Ruscus aculeatus* L. dhe *Riella helicophylla* (Mont.) Hook.) që gjenden në janë të mbrojtura nga direktiva e Habiteteve (Habitat Directive92/43/EEC), kurse lloji *Ophrys apifera* Hudson, është i mbrojtur nga Konventa

e Bernës (Bern Convention (1979). Pavarësisht kësaj, 2-llojet e para kanë një përhapje mjaft të gjere në vendin tonë, kurse lloji i tretë që gjendet në Lagunën e Nartës është me përhapje të kufizuar.

Brënda territorit të kësaj zone nuk ka asnjë lloj të rrezikuar globalisht (IUCN) ose rajonalisht, ku nënkuptohet rajoni mesdhetar.

IV.12.4 Fauna

Në habitatet detare dhe bregdetare, në stadin mediolitoral, janë të pranishme, si në ishullin e Sazanit edhe në gadishullin e Karaburunit, biocenoza e dominuara nga *Lithophyllum byssoides* (UNDP, 2010). Kjo alge e kuqe kalcike, lloj karakteristik i Mesdheut perëndimor dhe detit Adriatik, rritet pak mbi nivelin e detit, në zgavra të vogla, korridore dhe përgjate faqeve shkembore. Në këtë zone ajo formon jastek të vegjel (masa gjysem sferike) dhe rralle formon breza, zakonisht të njohur si “trotuar”. Një tjetër biocenoze e mediolitoralit është ajo e shpellave të mediolitoralit, të cilat janë të çara apo hyrje të shpellave që janë pjesërisht jashtë ujit. Biocenoze tjetër e rëndësishme është ajo e shpellave gjysem të errëta, ku jeton koral i kuq (*Coralium rubrum*) dhe disa lloje sfungjesh. Biocenoza e Koraligjenit gjendet në substratet e forta, me alga të kuqe të kalcifikuara, gorgonie dhe briozoare. Kjo biocenoze është e zhvilluar më mirë në anën perëndimore të ishullit të Sazanit dhe gadishullit të Karaburunit.

Në ujërat e zonës Karaburun–Sazan është raportuar prania e breshkave të detit, delfineve, dhe fokës së Mesdheut, të cilat janë ndër llojet më të kërcënuara në shkallë globale. Raporte të ndryshme shkencore theksojnë se përgjatë bregut perëndimor të gadishullit të Karaburunit gjenden habitate mjaft të përshtatshme për fokën e Mesdheut.



Figura IV-38: Biocenozat e dominuara nga *Lithophyllum byssoides* (Karaburun)

Kjo zonë është edhe një korridor i rëndësishëm për migrimin e breshkave të detit nga zonat e tyre të folezimit në ishujt Greke në detin Jon për në bregdetin e Patokut në pjesën shqiptare të detit Adriatik, e cila së fundmi është identifikuar si një zonë e rëndësishme ushqimi për këtë lloj breshke.

Vlerat mjedisore, natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike, biodiversiteti dhe larmia e peizazheve e bëjnë këtë zonë një nga pikat me tërheqëse përse i takon turizmit. Topografia interesante nënujore, me shpella e mikro habitate shumë të larmishme, si dhe prania e anijeve të mbytura, i japin zonës me tepër vlera turistike, veçanërisht për të apasionuarit pas sportit të zhytjes.

Studimet për zonën e Nartës e rëndisin atë si zonë të rëndësishme për shpendët e ujit në Shqipëri, ku gjatë periudhës së dimrit strehohen një numër i madh i tyre. Këtu takohen flamingot *Phoenicopterus ruber roseus*, rosën laramane *Tadorna tadorna*, rosën bishtgjele *Anas acuta*, rosën me katër sy *Bucephala clangula*, vraponjësin gushëbardhë *Charadrius alexandrinus* dhe gjelzën pikaloshe *Pluvialis squatarola*. Vlen të përmendet edhe prania e pelikanit kacurrel *Pelecanus crispus* (9%) dhe pulëbardhës së Audouinit *Larus audouinii* (100%), lloje këta të konsideruar si “Globalisht të Rrezikuara”.

Tabela IV-9: Grupet kryesore të gjallesave shtazore të pranishme në sistemin ligatinor Vjosë-Nartë

Grupi	Specie të rrezikuara Kombetare	Specie të rrezikuara Globalisht	Statusi i mbrojtjes	Numri i llojeve
Insekte	12	-	-	32
Moluske	57	1	28	287
Crustacea	9	-	-	61
Ekinodermate	6	-	-	6
Peshq	16	5	1	102
Amfibe	9	2	5	9
Reptile	23	5	20	26
Shpend	43	4	52	192
Gjitare	14	9	12	32
Gjithsej	189	26	118	749

Burimi: MedWetCoas, 2010

Kjo zonë shpesh për shkak të larmisë që ofron ka qenë dhe është një zonë objekt-studimi për kërkues, studiues, institucione shkencore dhe mësimore etj. Kjo tregon për rëndësinë e lartë në lokal por edhe në nivel kombëtar si dhe për disa elementë të saj edhe në nivel ndërkombëtar.

Të gjitha këto lloje përbëjnë një pasuri pasi një pjesë e tyre përdoren për qëllime mjekësore, industrinë ushqimore dhe si bimë dekorative. Një pjesë e tyre janë të rralla dhe rrezikohen të zhduken. Zona në studim përmban rreth 1400 lloje bimësh enëzore që përfaqësojnë rreth 42% të tërësisë së bimëve në Shqipëri.

Fauna:

Përveç bimësisë të përmendur më sipër në këtë zonë dhe që janë të lidhura me të gjendet një faunë e pasur rreth 747 lloje vertebrorë, si peshq, shpend, amfibë, reptilë, gjitarë, molusqe, insekte, ekinodermatë etj. Ndër invertebrorët dallojmë rreth 390 lloje molusqe, flutura, krustace dhe ekinodermatë. Peshqit më të njohur në këtë zonë janë ato të detit dhe të ujit të ëmbël ku dallojnë Ngjala (*Anguilla anguilla*), Koca (*Sparus aurata*), Levreku (*Dicentrarchus labrax*), Qefulli (*Mugil cephalus*), si dhe *Aterina sp*, *Solea vulgaris*, *Liza aurata*, *Trachurus trachurus*, *Mullus barbatus* etj.

Nga shpendët ku dallohen ato të llojit dimëruar dhe folezues dhe janë në total rreth 192 lloje mund të përmendim Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*), Capka e madhe e bardhë (*Egretta gazeta*), Rosat e ndryshme (*Anas sp.*), Lejleku (*Ciconia ciconia*), Kredharakët e ndryshëm (*Podiceps sp.*), Skifterët e ndryshëm (*Falco sp.*), Shqiponja (*Haliaeetus albicilla*), Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*), Laraska e detit (*Haematopus ostralegus*), Pulëbardhat e ndryshme (*Larus sp.*), Dallëndyshtet, Bilbilin, Laureshat, Korbin, Sorrat, Mëllenja (*Turdus merula*), Harabelat (*Passer sp.*), etj.

Amfibët po ashtu janë të shumtë në numër dhe mund të përmendim *Triturus sp.*, *Bufo sp.*, *Rana sp.* Në total ka 9 lloje, ndërsa nga reptilët *Caretta caretta*, *Coluber sp.*, *Lacerta sp.*, *Testudo hermani*, *Vipera ammodytes*, *Elaphe sp.*, etj në total 26 lloje.

Gjitarët në këtë zonë janë të shumtë në numër rreth 32 lloje ku mbizotërojnë brejtësit dhe lakuriqët e natës, por mund të përmendim edhe gjitarët e rendit të Insectivora, Chiroptera, Carnivora, Cetacea etj.




Figura IV-39: Habita sipas Mbulesës së tokës Corine dhe habitatet më të rëndësishme sipas NATURA


IV.12.4.1 Fauna në zonën e projektit

Ky seksion i raportit jep informacion mbi taksonet kryesore të faunës (parruazoret, peshqit, reptilët dhe amfibët, shpendët dhe gjitarët,) të cilët janë të pranishme ose pritet të strehohen në zonën ku zhvillohet projekti. Metoda kryesore e vërtetimit në terren është ajo e transekteve, vlerësimit të rastesisht të kombinuar me numërimin, ndërkohë që gjerësisht janë shfrytëzuar burime bibliografike të ndryshme.

Një theks i veçantë është kushtuar ndaj llojeve të lidhur me habitatet ujore dhe të brigjeve, si lumenjtë, kanalet kulluese dhe ujitëse, lagunat, etj., për ndjeshmërinë e lartë ekologjike që kanë në drejtim të strehimit të taksonëve të ndryshëm.

IV.12.4.2 Parruazoret

Të dhënat në lidhje me llojet e parruazorëve janë mbështetur kryesisht në të dhëna bibliografike, inventarizimet, diagnostikime si dhe në publikime të tjera primare dhe sekondare. Sipas studimeve të mëparshme, Vjosë-Narta strehon të pakten 390 lloje para-rruazoresh përfshirë Moluske. Flutura, Kraheforte, Krustace dhe Ekinodermate. Fluturat me të zakonshme janë Tabakja, Kleopatra, Fluturat blu etj. Përveç tyre mjediset me të thata të zonës regjistrojnë edhe ortoptere të medhenj e të vegjel, kraheforte, milingona të ndryshme etj. Studimet mbi molusket (Beqiraj 2001; 2007) kanë treguar se Narta është habitat i 32 llojeve të moluskeve ujore pjestare të familjeve Gastropoda dhe Bivalvia.



a. *Cerastoderma glaucum*; b. *Loripes lacteus*; c. *Abra segmentum*; d. *Scrobicularia cottardi*;
e. *Cyclope neritea*; f. *Cerithium vulgatum*; g. *Pirinella tricolor*

Figura IV-40: Lloje parruazorësh të pranishëm në zonën e studimit

Gjate vizitave në terren janë marre në konsiderate strukturat e makrozoobentosit në perberje të kanaleve të kullimit në zonën e studimit, të lidhur në mënyrë të drejtperdrejte me Lagunën e Nartës, dhe të lidhura me fundet e buta dhe mjediset e krijuara nga gërmimet e kanaleve. Gjatë këtyre sondazhi, shoqerimet mbizotërues ishte ai tipik 'bashkësi e ujit të njelmët', me praninë e disa specieve tipike për 'komunitetet marine' të dominuar nga filtruesit, dhe një 'komunitet detar' tipik, që okuponte fundet e imëta me rërë. gjatë vëzhgimit janë regjistruar 17 specie të makrozoobentosit, duke përfshirë katër bivalvë, gjashtë gastropodë dhe pjesa tjetër e specieve u përket grupeve të tjera jovertebrore. Speciet më të përhapura ishin: *Cerastoderma glaucum*, *Loripes lacteus*, *Abra segmentum*, *Cyclope neritea*, *Cerithium vulgatum*, *Pirinela conica*, *Crangon crangon* dhe *Idotea baltica*.



a. *Phyllodocidae*; b. *Lumbricidae*; c. *Idotea baltica*; d. *Crangon crangon*;

Figura IV-41: Specie invertebroresh të pranishem në zonën e studimit

IV.12.4.3 Peshqit

Peshqit e zones bregdetare dhe të lagunës së Nartës

Popullatat iktike bregdetare dhe e lagunave bregdetare shqiptare është tipike Mesdhetare me dy grupe kryesore të llojeve: peshqit migratore dhe peshqit sedentarë. Llojet e gjinive Sparidae, Mugilidae, Moronidae, Soleidae, Anguillidae, Belonidae përfshijë grupet kryesore migratore, ndërkohë që Gobiidae, Cyprinodontidae, Atherinidae, Syngnathidae janë grupet kryesore me speciet sedentare, edhe pse disa lloje të këtyre grupeve janë gjithashtu migratore.

Nga 43 lloje peshqish të pranishëm, 25 prej tyre takohen në sistemin lagunar prej të cilave llojet: *Anguilla anguilla*, *Sparus aurata*, *Dicentrarchus labrax*, *Mugil cephalus*, *Liza ramada*, *Liza aurata*, *Gobius buchichi*, *Atherina boyeri*, etj, janë më të përhapurit (TabelaIV-10).

TabelaIV-10: Lista e llojeve të peshqve të zonës bregdetare dhe Lagunës së Nartës

Speciet	RL IUCN	RL IUCN MED	RL ALB	HDAII	HDAIV	HDAV	Lagun	Bregdet
<i>Anguilla anguilla</i>	CR	CR					+	+
<i>Aphanius fasciatus</i>	LC	LC	EN	Y			+	+
<i>Aphanius iberus</i>	EN	EN	EN	Y			+	+
<i>Aphanius dispar</i>	LC	LC	EN				+	+
<i>Arnoglossus laterna</i>	LC	LC					+	+
<i>Atherina boyeri</i>	LC	LC					+	+
<i>Atherina hepsetus</i>							+	+
<i>Belone belone</i>	LC	LC					+	+
<i>Boops boops</i>	LC	LC					-	+
<i>Chelon labrosus</i>	LC	LC					+	+
<i>Citharus linguatula</i>	LC	LC					-	+
<i>Dentex dentex</i>	VU	VU					-	+
<i>Dicentrarchus labrax</i>	LC	LC					+	+
<i>Diplodus annularis</i>	LC	LC					+	+
<i>Diplodus sargus sargus</i>	LC	LC					+	+
<i>Engraulis encrasicolus</i>	LC	LC					-	+
<i>Gobius buchichi</i>							+	+
<i>Lichia amia</i>	LC	LC	EN				-	+
<i>Liza aurata</i>	LC	LC					+	+
<i>Liza ramada</i>	LC	LC					+	+
<i>Liza saliens</i>	LC	LC					+	+
<i>Lophius piscatorius</i>	LC	LC					-	+
<i>Merluccius merluccius</i>	VU	VU					-	+
<i>Mugil cephalus</i>	LC	LC					+	+
<i>Mullus barbatus</i>	LC	LC					+	+
<i>Mullus surmuletus</i>	LC	LC					-	+
<i>Pagrus caeruleostoticus</i>	LC	LC					+	+
<i>Platichthys flesus</i>	LC	LC	VU				-	+
<i>Psetta maxima</i> (<i>Scophthalmus maximus</i>)	NT	NT	VU				-	+
<i>Seriola dumerili</i>	LC	LC	EN				-	+
<i>Sarda sarda</i>	LC	LC					-	+

<i>Sardinella aurita</i>	LC	LC					-	+
<i>Sardina pilchardus</i>	LC	LC					-	+
<i>Scomber scombrus</i>	LC	LC					-	+
<i>Scophthalmus rhombus</i>	LC	LC					-	+
<i>Seriola dumerili</i>	LC	LC					+	+
<i>Solea vulgaris</i>	LC	LC					+	+
<i>Solea impar</i>	LC	LC					+	+
<i>Pegusa (Solea) lascaris</i>	LC	LC					+	+
<i>Sparus aurata</i>	LC	LC					Yes	Yes
<i>Sygnathus spp.</i>							No	Yes
<i>Trachurus trachurus</i>	LC	LC					Yes	Yes
<i>Trigla lyra</i>	LC	LC					No	Yes
<i>Umbrina cirrosa</i>	LC	LC					Yes	Yes
<i>Zeus faber</i>	DD	DD					Yes	Yes

Duke u bazuar në Tabela IV-10, ngjala (*Anguilla anguilla*) përfaqëson lloj të rezikuar në mënyrë kritike sipas Listës së Kuqe të IUCNsë, ndërkohë që përfaqëson edhe ndër llojet kryesore të gjuetisë në Lagunë. Sipas të dhënave statistikore në stokun aktual të gjuajtur pesha e këtij lloji ka ardhur në rënie të theksuar, mbase kjo e lidhur edhe me situatën aktuale në të cilën kalon popullata në të gjithë rajonin e Mesdheut.

Llojet *Aphanius fasciatus* (çeluku), *Aphanius iberus* (lareza), *Aphanius dispar* (çeluku), dhe *Lichia amia* (Lojba) sipas Listës së Kuqe të Flores dhe faunes se Shqipërisë janë lloje të konsideruar si të kërcënuar (EN).




Figura IV-42: Struktura e përbërjes llojore mbi bazën e pranisë dhe statusi aktual sipas IUCNsë (Laguna Nartes dhe zona bregdetare)

Popullatat iktike lokale të peshkut dhe specieve të rrezikuara në veçanti në sistemin kompleks Laguna e nartes, zona bregdetare dhe rrjedha e poshtme e Lumit Vjosë, aktualisht janë të kërcënuara nga një sërë aktivitetesh antropogjene dhe faktorë si: (i) menaxhimin e dobët trupave ujqorë, ndotja e ujit dhe mungesa e qasjeve të integruara të menaxhimit të ujit; (ii) praktikave të parregulluara të peshkimit dhe peshkimi i paligjshëm; (iii) Mbipeshkimi; (iv) speciet jo native të llojeve iktike; (v) Ndikimet në zona specifike të riprodhimit të specieve të veçanta dhe (vi) integrimi i dobët i praktikave të menaxhimit të peshkimit në Planin e menaxhimit të Zonës së peizazheve të Mbrojtura Nartë Vjosë (MoE, 2004; Munari *et al.*, 2012; Mathers *et al.*, 1999; Gjijnuri *et al.*, 1996).



Figura IV-43: Lloje peshqish të pranishem në Nartë

Peshqit e zones e rrjedhes se poshtme të Lumit Vjosë

Gjatë vlerësimeve më të fundit ët lidhura me lumin Vjosa, në pjesën e ulët dhe të mesme të rrjedhës janë identifikuar 15 lloje peshqish (Shumka, 2014). Speciet me shpërndarjen më të gjerë përgjatë lumit janë *Alburnoides bipunctatus*, *Barbus presepsis*, *Squalius cephalus*, *Chondrostoma nasus*, *Pachichilon pictum* dhe *Oxynoemacheilus pindus*. Llojet me shpërndarje të kufizuar janë *Salmo trutta fario*, *Gobio scadernsis*, *Cobitis ohridana* dhe *Anguilla Anguilla* - specie tipike stenovalent. Llojet më të shumta janë gjetur në zonën afer grykëderdhjes së lumit Vjosë (21 në total) (Tabela IV-11), perfshijne dhe llojet me origjine detare si *Mugil cephalus* (qefulli i zakonshem), *Liza ramada* (qefulli i vjeshtës) etj. Keto të fundit paraqiten ndër llojet që kanë përhapje më të gjerë dhe kryejnë migracione të konsiderueshme në distancë.

Tabela IV-11: Lista e llojeve të peshqve të zonës së grykëderdhjes dhe pjesës së poshtme të Lumit të Vjosës

Species	RL IUCN	RL IUCN MED	RL ALB	HDAII	HDAV	Vjosa rjedha poshte	Vjosa rjedha lart
<i>Alburnoides bipunctatus</i>	LC					-	+
<i>Alburnus scoranza</i>						-	+
<i>Anguilla anguilla</i>	CR	CR				+	+
<i>Barbus presepsis</i>	VU	VU	LR		Y	-	+
<i>Chondrostoma nasus</i>	LC	LC	LR			-	+
<i>Cobitis ohridana</i>	LC	LC	LR	Y		-	+
<i>Dicentrarchus labrax</i>	LC	LC				+	-

<i>Gambusia affinis</i>	LC		LR			+	+
<i>Gobius buchichi</i>						+	-
<i>Liza ramada</i>	LC	LC				+	+
<i>Liza saliens</i>	LC	LC				+	-
<i>Mugil cephalus</i>	LC	LC				+	+
<i>Mullus barbatus</i>	LC	LC				+	-
<i>Misgurnus fossilis</i>	LC	LC				+	-
<i>Oncorhynchus mykiss</i>						-	+
<i>Oxynoemacheilus pindus</i>	VU	VU	LR			-	+
<i>Pachychilon pictum</i>	LC	LC				+	+
<i>Pseudorasbora parva</i>	LC					+	+
<i>Solea vulgaris</i>	LC	LC				+	-
<i>Sparus aurata</i>	LC	LC				+	-
<i>Squalius cephalus</i>	LC	LC				+	+




Figura IV-44: Struktura e përbërjes llojore mbi bazën e pranisë dhe statusi aktual sipas IUCN-së
(rrjedha e poshtme Lumit Vjosë)



Figura IV-45: *Arnoglossus laterna* dhe *Anguilla anguilla*

Situata aktuale e ndotjeve të ndryshme dhe pransë së lartë të sedimenteve kushtëzon popullatat e varfëra të llojeve komerciale në grykëderdhjen e Lumit të Vjosës. Sidoqoftë, migrimet e vazhdueshme të ngjalës dhe qefujve vërtetojnë rolin e rëndësishëm të këtij koridori në biologjinë e këtyre gjallesave.

IV.12.4.4 Herpetofauna (Amfibët dhe Zvarranikët)

Sipas të dhënave të publikuara zona e studimit është strehe e gjashtë amfibëve (nga 16 specie amfibësh të regjistruara në Shqipëri) dhe 23 zvarranikë (nga 43 specie të raportuara në Shqipëri). Dy specie të bretkosave (*Rana dalmatina* dhe *Hyla arborea*) janë pjesë e Aneksi IV i BE HD, ndërsa një specie (*Pelophylax shqipericus*) është një specie endemike e Shqipërisë dhe Malit të Zi, e vlerësuar si specie e Rrezikuar (EN) nga IUCN. Kjo shpërndarje e specieve është e kufizuar përgjatë zonës bregdetare të dy vendeve dhe prania e saj në vendin e studimit, rrjeti i kanaleve kulluese dhe ujitëse brenda kompleksit ligatinor është shumë i mundshëm (Saçdanaku *et al.*, 2015)

Prania e tre specieve të bretkosave (*Pelophylax kurtmuelleri*, *Rana dalmatina* dhe *Hyla arborea*) është e konfirmuar gjatë vezhgimeve në teren (Saçdanaku *et al.*, 2015).

Nga 23 specie zvarranikësh, prania e 9 specieve është konfirmua gjatë sondazheve të kryera në terren (MedWetCoast, 2010; Jablonski, 2011). Speciet e konfirmuara përfshijnë: *Testudo hermanni*, *Emys orbicularis*, *Podarcis muralis*, *Podarcis turcicus / ionicus*, *Zamenis longissimus*, *Natrix tessellate*.

IV.12.4.5 Shpendët

Kompleksi është një zonë e rëndësishme për 192 lloje të vrojtuar deri më sot (Aneksi 4) por sidomos për shpendët e ujit dimërues dhe folezues (AKZM, 20201). Numërimet dimërore të viteve 1995-2004 kanë regjistruar 12 000 - 81 000 individë me një mesatare prej 34 800 individësh

. Pjesa më e madhe e dimëruesve (afro 91% e tyre) gjen strehë në ujërat e lagunës. Shpendët më të zakonshëm janë Rosat dhe Bajzat. Gjatë sezonit të folezimit, Narta kthehet në vend shumimi për 630-830 çifte shpendësh të ujit. Pjesa më e madhe (afro 88 % e tyre) përqëndrohet në Kriporet e Nartës (MoE, 2004).

Të dhënat e viteve të fundit e çmojnë zonën Vjosë-Nartë si zona e dytë më e rëndësishme për shpendët e ujit në Shqipëri (AKZM, 2020). Në dimër kompleksi strehon më shumë se 23% të shpendëve të ujit dimërues në Shqipëri. Për më shumë se 35 lloje zona regjistron më shumë se 6% të efektivave kombëtare. Për Flamingot *Phoenicopterus ruber roseus*, Rosën laramane *Tadorna tadorna*, Rosën bishtgjel *Anas acuta*, Rosën me katër sy *Bucephala clangula*, Vrqaponjësën gushëbardhë *Charadrius alexandrinus* dhe Gjelëzën *Pluvialis squatarola*, Vjosë-Narta është vendi nder vendet kryesore të dimërimit në Shqipëri.

IV.12.4.6 Gjitarët

Në kompleksin ligatinor regjistrohen 32 lloje gjitarësh nga 71 lloje të vrojtuar në Shqipëri. Komuniteti i gjitarëve (Tabela që vijon) dominohet nga brejtësit e ndjekur nga lakuriqtë e natës dhe llojet mishngrënës.(MoE, 2004)

Tabela IV-12: Përbërja faunës së gjitareve të zonës Vjosë-Nartë

	Taxa/Rendi	Numri i llojeve
1	<i>Insectivora</i>	5
2	<i>Chiroptera</i>	8
3	<i>Rodentia</i>	9
4	<i>Lagomorpha</i>	1
5	<i>Carnivore/Fissipedia</i>	6
6	<i>Artidactila</i>	0
7	<i>Cetacea/Odontoceti</i>	3
8	<i>Pinnipedia</i>	0
	Totali	32

IV.13 SËMUNDJET DHE DËMTUESIT E PYJEVE

Një sëmundje kërcënuese për pyjet e rrapit të ndodhura në basenin e Lumit Vjosë është tharja nga kërpudha që po infekton atë. *Platanus orientalis* është njolla e kancerit (*Cerotostitis Platenea*) e rrapave. Në luginën e Vjosës kjo sëmundje është shfaqur në dhjetë vitet e fundit dhe po përhapet me shpejtësi. Në Drino, gryka e Kelcyrës dhe në rrjedhën e Sukës (Katundishte) janë vëzhguar individët e parë plotësisht të tharë nga kjo sëmundje kërpudhore. Kërkesat për temperatura midis 10 dhe 40 °C bëjnë që *C. platani* të vazhdojë të përhapet me të njëjtin trend kur rriten temperaturat. Ndryshimet e temperaturës me 1 °C favorizojnë insektet vektorë dhe vetë sëmundjen, që të

përhapet në luginën e Drinos, Këlcyrës, Shushicës, Sukës, Langaricës, pjesën e sipërme të Vjosës dhe në lumin Izvor.

IV.14 KLIMA

Territoret e bashkisë Vlorë, si një pjesë territoriale e Shqipërisë, janë pjesë e gjerësisë mesatare. Qasje e gjerë në Detin Adriatik, si pjesa më veriore e Detit Mesdhe, i jep klimës karakteristika mesdhetare. Karakteristika dalluese e klimës mesdhetare është ekzistenca e katër sezoneve (pranverë, verë, vjeshtë dhe dimër). Formimi i klimës së vendit tonë në tërësi dhe klima tipike në hapësirën territoriale të Vlorës janë ndikuar nga rrezatimi diellor, qarkullimi i masave të përgjithshme ajrore dhe faktorët lokalë. Ndikimi mbizotërues në formimin e klimës është energjia direkte diellore, Deti Adriatik dhe relievi kodrinor. Një ndikim më i vogël ushtrohet nga masat e qarkullimit të ajrit, lloji i tokës, mbulesa e bimësisë dhe aktiviteti njerëzor në këto territore.

Zona në studim ndodhet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë dhe si e tillë ajo karakterizohet nga fusha klimatike Qendrore Mesdhetare. Dimri është përgjithësisht i butë, me rreshje të shumta ndërsa vera e nxehtë dhe e thatë. Rreshjet bien kryesisht në formën e shiut. Rreshjet e borës janë tepër të pakta dhe me kohëzgjatje shumë të shkurtër.

Ky raport ilustron kushtet klimatike tipike në Novoselë, bazuar në një analizë statistikore të raporteve historike të klimës për orë dhe rindërtimet e modeleve nga 1 janari 1980 deri më 31 dhjetor 2019²⁴.

IV.14.1 Temperatura

Sezoni i nxehtë zgjat për 3.0 muaj, nga 13 qershor deri në 12 shtator, me një temperaturë mesatare ditore të lartë mbi 27 ° C. Dita më e nxehtë e vitit është 30 korriku, me një mesatare të lartë prej 31 ° C dhe të ulët prej 21 ° C.

Sezoni i freskët zgjat për 4.0 muaj, nga 25 nëntor deri më 24 mars, me një temperaturë mesatare ditore të lartë nën 16 ° C. Dita më e ftohtë e vitit është 31 janari, me një mesatare të ulët prej 5 ° C dhe të lartë prej 12 ° C.

²⁴ Burimi: www.weatherspark.com




Figura IV-46: Temperatura mesatare ditore e lartë (vija e kuqe) dhe e ulët (vija blu), me linjat e përqindjes 25 nga 75 dhe 10 deri 90. Vijat e holla me pika janë temperaturat përkatëse mesatare të perceptuara. Burimi: www. weatherspark.com

Figura më poshtë ju tregon një karakterizim kompakt të të gjithë vitit të temperaturave mesatare për orë. Boshti horizontal është dita e vitit, boshti vertikal është ora e ditës, dhe ngjyra është temperatura mesatare për atë orë dhe ditë.




Figura IV-47: Temperatura mesatare për orë, ngjyra kodohet në breza. Mbulesat me hije tregojnë natën dhe muzgun civil.

IV.14.2 Reshjet

Një ditë e lagur është ajo me të paktën 1 milimetër reshje të lëngshme ose ekuivalente me të. Mundësia e ditëve të lagështa në Novoselë ndryshon ndjeshëm gjatë gjithë vitit. Sezoni më i lagësht zgjat 7.2 muaj, nga 23 Shtatori deri në 28 Prill, me më shumë se 23% mundësi që një ditë e caktuar të jetë një ditë e lagur. Mundësia e një dite të lagësht arrin në 40% më 20 nëntor.

Sezoni i thatë zgjat 4.8 muaj, nga 28 Prill deri më 23 Shtator. Shansi më i vogël për një ditë të lagësht është 7% në 7 Korrik.

Ndër ditët e lagështa, në bëjmë dallimin midis atyre që përjetojnë vetëm shi, dëborë vetëm ose një përzierje të të dyve. Bazuar në këtë kategorizim, forma më e zakonshme e reshjeve gjatë gjithë vitit është shiu, me një probabilitet maksimal prej 40% më 20 nëntor.




Figura IV-48: Përqindja e ditëve në të cilat vërehen lloje të ndryshme të reshjeve, duke përfshirë sasi të gjurmëve: vetëm shi, vetëm dëborë dhe të përziera (shiu dhe dëborë ranë në të njëjtën ditë).

Periudha me reshje e vitit zgjat për 11 muaj, nga 23 korrik deri më 6 korrik, me një reshje 31-ditore prej të paktën 13 milimetra. Më shumë reshje bien gjatë 31 ditëve të përqendruara rreth 29 Nëntorit, me një akumulim total mesatar prej 113 milimetra. Periudha pa reshje e vitit zgjat për 2.5 javë, nga 6 korrik deri më 23 korrik. Reshjet me sasi më të ulët janë rreth 16 korrik, me një akumulim total mesatar prej 12 milimetra.




Figura IV-49: Reshjet mesatare të reshjeve (vija e ngurtë) e akumuluar gjatë një periudhe 31-ditore rrëshqitëse të përqendruara në ditën në fjalë, me brezat e përqindjes 25 nga 75 dhe 10 deri në 90. Vija e hollë me pika është reshja mesatare përkatëse e borës së barasvlefshme me reshjet e shiut.

IV.14.3 Lagështia e ajrit

Ne e bazojmë nivelin optimum të lagështisë me pikën e vesës, pasi përcakton nëse djersa do të avullojë nga lëkura, duke ftohur kështu trupin. Pikat më të ulëta të vesës ndihen më të thata dhe pikat më të larta të vesës ndihen më të lagështa. Ndryshe nga temperatura, e cila zakonisht ndryshon ndjeshëm midis natës dhe ditës, pika e vesës ka tendencë të ndryshojë më ngadalë, kështu që ndërsa temperatura mund të bjerë gjatë natës, një ditë e zymtë zakonisht pasohet nga një natë e errët.

Zona Novoselë – Vlorë përjeton ndryshime ekstreme sezonale në lagështinë e perceptuar.

Periodha më e mirë e vitit zgjat për 3.8 muaj, nga 9 qershori deri më 3 tetor, gjatë së cilës kohë niveli i rehatisë është i dobët, shtypës ose i i pa pranueshëm të paktën 15% të kohës. Dita më ekstreme e vitit është 10 gushti, me kushte e zagushisë 61% të kohës.




Figura IV-50: Përqindja e kohës së kaluar në nivele të ndryshme komode lagështie, të kategorizuara sipas pikës së vesës.

IV.14.4 Era dhe frekuenca e saj

Kjo pjesë diskuton vektorin mesatar për orë të erës në sipërfaqe të gjerë (shpejtësia dhe drejtimi) në 10 metra mbi tokë. Era e përjetuar në çdo vend të caktuar varet shumë nga topografia lokale dhe faktorë të tjerë, dhe shpejtësia dhe drejtimi i erës së menjëhershme të erës ndryshojnë më shumë sesa mesatarja e orës.

Era kryesore është briza detare, tepër e dukshme sidomos gjatë verës. Stina e dimrit dominohet përgjithësisht nga era e lindjes me një shpejtësi mesatare prej 3.5 m/s. Drejtimi kryesor i erës është ai lindor (24.4 %) i ndjekur nga drejtimi veri-lindor. Vera dominohet nga briza detare me drejtim perëndimor. Drejtimi kryesor është ai veri-perëndimor (17.6 %) dhe perëndimor (9.4 %). Shpejtësia mesatare e erës është përkatësisht 4.4 m/s dhe 5.2 m/s.

Shpejtësia mesatare e erës për orë në zonën Novoselë - Vlorë përjeton ndryshime të lehta sezonale gjatë vitit.

Pjesa me erë e vitit zgjat për 5.8 muaj, nga 22 tetor deri më 14 prill, me shpejtësi mesatare të erës më shumë së 12.6 kilometra në orë. Dita me erë e vitit është 21 shkurt, me një shpejtësi mesatare të erës në orë prej 14.8 kilometra në orë.

Koha më e qetë e vitit zgjat për 6.2 muaj, nga 14 Prill deri më 22 Tetor. Dita më e qetë e vitit është 1 Qershori, me një shpejtësi mesatare të erës në orë prej 10.3 kilometra në orë.




Figura IV-51: Mesatarja e shpejtësive mesatare të erës për orë (vija gri e errët), me brezat e përqindjes 25-të deri në 75-të dhe 10-të deri në 90-të.

Drejtimi mesatar mbizotërues i orës në orë në zonën Novoselë - Vlorë ndryshon gjatë gjithë vitit. Era është më shpesh nga veriu për 4.2 muaj, nga 20 maj deri më 26 shtator, me një përqindje kulmi prej 50% në 20 korrik. Era është më shpesh nga jugu për 7.8 muaj, nga 26 shtatori deri në 20 maj, me një vlerë përqindje kulmi prej 34% më 1 janar.




Figura IV-52: Përqindja e orëve në të cilat drejtimi mesatar i erës është nga secila prej katër drejtimeve kardinale të erës, duke përjashtuar orët në të cilat shpejtësia mesatare e erës është më pak së

1.6 kph. Zonat e ngjyrosura lehtë në kufij janë përqindja e orëve të kaluara në drejtimet e nënkuptuara të ndërmjetme (në verilindje, juglindje, jugperëndim dhe veriperëndim).

IV.14.5 Temperatura e ujit

Zona Novoselë - Vlorë ndodhet pranë një pellgu të madh ujëmbledhës dhe buzë detit Adriatik. Temperatura mesatare e ujit përjeton ndryshime ekstreme sezonale gjatë vitit. Koha e vitit me ujë më të ngrohtë zgjat për 3.1 muaj, nga 24 qershori deri më 28 shtator, me një temperaturë mesatare $\geq 23^\circ \text{C}$. Dita e vitit me ujin më të ngrohtë është 15 gushti, me një temperaturë mesatare prej 25°C .

Koha e vitit me ujë më të freskët zgjat për 4.4 muaj, nga 16 dhjetor deri më 28 prill, me një temperaturë mesatare nën 16°C . Dita e vitit me ujin më të freskët është 25 shkurti, me një temperaturë mesatare prej 14°C .




Figura IV-53: Temperatura mesatare ditore e ujit (vija e purpurt), me brezat e percentileve nga 25-të në 75-të dhe 10-të deri në 90-të.

IV.14.6 Koha më e mirë e vitit për të vizituar

Për të karakterizuar përputhshmërinë e kushteve të motit në zonën Novoselë - Vlorë me kushtet e turizmit mesdhetar gjatë vitit

Kushtet favorizojnë ditë të pastra, pa shi dhe me temperatura të perceptuara midis 18°C dhe 27°C . Bazuar në këtë rezultat, periodhat më të mira të vitit për të vizituar Novoselën për aktivitete të përgjithshme turistike në natyrë janë nga fillimi i majit deri në mes të korrikut dhe nga fundi i gushtit deri në mes të tetorit, duke arritur pikun në javën e parë të qershorit.




Figura IV-54: Rezultati i turizmit (zona e mbushur), dhe përbërësit e tij: rezultati i temperaturës (vija e kuqe), rezultati i mbulimit të reve (vija blu) dhe rezultati i reshjeve (vija jeshile).

Rezultati i periudhës më të mirë për plazh në pishinë favorizon ditë të pastra, pa shi dhe temperatura të perceptuara midis 24°C dhe 32°C . Bazuar në këtë rezultat, koha më e mirë e vitit për të vizituar zonë Novoselë - Vlorë për aktivitete me mot të nxehtë është nga fundi i qershorit deri në fillim të shtatorit, me një pik në javën e tretë të korrikut.




Figura IV-55: Rezultati i plazhit / pishinës (zona e mbushur) dhe përbërësit e tij: rezultati i temperaturës (vija e kuqe), rezultati i mbulimit të reve (vija blu) dhe rezultati i reshjeve (vija jeshile).

Përkufizimet e sezonit të rritjes ndryshojnë në të gjithë botën, por për qëllimet e këtij raporti, në e përcaktojmë atë si periudha më e gjatë e vazhdueshme e temperaturave jo të ngrirjes ($\geq 0^{\circ}\text{C}$) në vit (viti kalendarik në Hemisferën Veriore, ose nga 1 korriku deri më 30 qershor në hemisferën jugore).

IV.14.7 Kushtet për zhvillimin e energjisë diellore

Kjo pjesë diskuton energjinë diellore të valës së shkurtër të incidentit ditor të përgjithshëm që arrin sipërfaqen e tokës në një zonë të gjerë, duke marrë parasysh plotësisht ndryshimet sezonale në gjatësinë e ditës, lartësinë e Diellit mbi horizontin dhe thithjen nga retë dhe përbërësit

e tjerë atmosferik. Rrezatimi i valëve të shkurtra përfshin dritën e dukshme dhe rrezatimin ultraviolett.

Energjia diellore me valë të shkurtër me incidente mesatare ditore përjeton ndryshime ekstreme sezonale gjatë vitit. Periudha më e ndritshme e vitit zgjat për 3.2 muaj, nga 12 maj deri më 18 gusht, me një energji mesatare ditore të valës së shkurtër të incidentit për metër katror mbi 6.7 kwh. Dita më e ndritshme e vitit është 6 korriku, me një mesatare prej 7.9 kwh. Periudha më e errët e vitit zgjat për 3.6 muaj, nga 30 tetor deri më 16 shkurt, me një energji mesatare ditore të valës së shkurtër për metër katror nën 3.0 kwh. Dita më e errët e vitit është 13 Dhjetori, me një mesatare prej 1.8 kwh.




Figura IV-56: Energjia diellore e valës së shkurtër mesatare ditore që arrin në tokë për metër katror (vija portokalli), me brezat e përqindjes nga 25-të deri në 75-të dhe 10-të deri në 90-të.

IV.14.8 Topografia

Për qëllimet e këtij raporti, koordinatat gjeografike të zonë Novoselë janë 40.625 gradë gjerësi gjeografike, 19.467 gradë gjatësi gjeografike dhe 6 m lartësi.

Topografia brenda 3 kilometrave nga Novoselë përmban vetëm variacione modeste në lartësi, me një ndryshim maksimal të lartësisë prej 48 metrash dhe një lartësi mesatare mbi nivelin e detit prej 3 metrash. Brenda 16 kilometrave përmban vetëm variacione modeste në lartësi (515 metra). Brenda 80 kilometrave përmban ndryshime shumë të rëndësishme në lartësinë (2,435 metra).

Zona brenda 3 kilometrave nga Novoselë është e mbuluar nga toka bujqësore (73%) dhe sipërfaqe artificiale (14%), brenda 16 kilometra nga toka livadhore (50%) dhe ujë (24%).

IV.15 CILËSIA E AJRIT

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Zonën e Vlorës realizohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila është autoriteti kompetent për hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Per mbrojtjen e Mjedisit”, Ligjit Nr. 10 266 date 15.04.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 8897 date 16.05.2002 “ Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, Vendim Nr.1189 date 18.11.2009”. Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar Monitorimit të Mjedisit”. Vendim nr. 352, datë 29.4.2015”Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.

Njerezimi ushtron një ndikim të madh në perberjen e atmosferes. Disa nga përbërësit dhe gazet të cilet rriten për shkak të aktivitetit human janë PM_{10} , $PM_{2.5}$, CO_2 , CH_4 , N_2O , CO , SO_4 dhe CFCs. këto gaze ndikojnë direkt ose indirekt në rritjen e sasisë së thithur të rrezatimit infra të kuq, duke intensifikuar efektin sere. ndotësit atmosferike depozitohen në perqendrime me të larta atmosferen e qyteteve dhe të zonave industriale, zona që kanë burime ndotëse.

Rezultatet e raportuara për cilësinë e ajrit janë marrë nga raporti i monitorimit i përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në vitin 2019, përkatsisht nga stacioni i monitorimit në Vlore. Referuar rezultateve mesatare mujore të monitoruara janë paraqitur në tabelen Tabela IV-13.

IV.15.1 Burime të ndotjes së ajrit

Si rezultat i zhvillimit të të gjitha fushave të ekonomisë dhe transportit kemi një rritje të faktorit ndotës në zonat urbane dhe përgjatë akseve kryesore rrugore, si pasojë e rritjes së numrit të makinave që ndikojnë në rritjen e shkalles së ndotjes në këto zona. Po kështu futja në vendin tonë e makinave të përdorura dhe të lëndëve djegëse të një cilësie të ulët çon në një rritje akoma me të madhe të nivelit të ndotjes në mjediset urbane. Bazuar në këto kushte monitorimi dhe evidentimi i të dhenave të cilësisë së ajrit në qytete, të cilat kanë një zhvillim demografik, ekonomik e social të ndjeshëm, bëhet domosdoshmëri. Zona e mbrojtur ofron një cilësi ajri të mirë por që mund të luhatet në zonat ku kemi çlirim të formave okside të azotit nga proceset denitrifikuese në mjedise me mungesë oksigjeni nga ujrat e freskët, që zakonisht i referohen kanaleve kulluese me bimësi që degradon në to.

IV.15.2 Grimcat e ngurta në ajër (Particle Matter - PM_{10} dhe $PM_{2.5}$)

Grimcat e ngurta në ajër kategorizohet në bazë të madhësisë së grimcave (për shembull $PM_{2.5}$ janë grimca mediametër më të vogël se $2.5\mu m$). PM përbëhet nga një rang i gjerë materialeesh dhe çlirohet nga burimet e ndryshme. Përqendrimeve të PM-ve përfshijnë grimca primare të emetuara direkt në atmosferë nga burimet e djegies dhe grimca dytësore të formuara nga reaksione kimike në ajër. Burime të PM vijnë si nga aktivitetet njerëzore, ashtu edhe ato natyrore (si stërkalat e detit dhe pluhuri i Saharasë). Në Shqipëri burimi më i madh njerëzor është transporti. Transporti rrugor krijon grimat primare nga shkarkimet që vijnë nga motori i automjeteve, ngrënia dhe

prishja e rrotave dhe sistemi i frenimit të mjeteve, si dhe shkarkime të tjera. Burime të tjera primare përfshijnë guroret dhe sektorin e ndërtimit, si dhe burimet jorrugore. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojnë sëmundjet e zemrës dhe mushkrive, goditje në zemer dhe aritmi. PM mund të dëmtojnë sistemin nervor qendror, sistemin riprodhues dhe mund të shkaktojë tumor. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.

IV.15.3 Ozoni O_3

Ozoni nuk emetohet direkt nga ndonjë burim njerëzor. Ai është produkt i reaksioneve kimike që ndodhin ndërmjet ndotësve të ndryshëm të ajrit, kryesisht NO_x dhe përbërjet organike të avullueshme VOC (Volatile Organic Compounds), të iniciuar nga rrezatimi i fortë diellor. Niveli i lartë i ozonit mund të shkaktojë problem të shëndetit respirator duke zvogëluar funksionimin e mushkerive, përkeqësimin e astmës dhe sëmundje të tjera të mushkerive deri në vdekje të parakohshme. Ozoni gjithashtu është gaz me efekt serë duke kontribuar në ngrohjen e atmosferës.

IV.15.4 Monoksidi i Karbonit CO

Formohet nga djegia jo e plotë e karburanteve që përmbajnë karbon. Burimi më i madh është transporti rrugor, të cilat së bashku me djegien nga sektori shtëpiak dhe industrial konsiderohen si kontribues kryesorë. Monoksidi i karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemer dhe të dëmtojë sistemin nervor. Ky gjithashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje dhe lodhje.

IV.15.5 Dioksidi i karbonit CO_2

Dioksidi i karbonit (CO_2) ndodhet në atmosfere në koncentrim të lartë, me një raport me pak së 200, i krahasuar me gaze të tjera të efektit sere, dhe përben kontribuesin me të rëndësishëm (afersisht 60%) në efektin serë antropogjenik.

Metani është me potent së CO_2 . Me një koncentrim atmosferik afer 1700 ppbv, CH_4 kontribuon me rreth 15% në efektet serë antropogjenik.

IV.15.6 Sulfatet- SO_4

Sulfatet kanë origjinë djegien e karburanteve që përmbajnë squfur, si qymyri dhe vajra të rëndë nga rafineritë. SO_4 është një ndotës që shkakton probleme serioze në shëndetin e popullatës si përkeqësimin e astmës si dhe redukton funksionin e mushkerive dhe irriton aparatit respirator. Kjo mund të shkaktojë dhimbje koke, shqetësim dhe ankth. SO_4 ndihmon në formimin e shiut acid impaki i të cilit mund të jetë i dukshëm duke shkaktuar dëmtimin e pyjeve dhe ekosistemin e liqeneve dhe lumenjve.

IV.15.7 Oksidet nitroze NO_x

Oksidi nitror (NO₂) kontribuon afersisht 5% në efektin serë. Përqëndrimi i tij në atmosfere është rritur në 200 vjetet e fundit afersisht nga 280 në 310 ppbv. Transporti rrugor është burimi kryesor, i ndjekur nga sektori i industrisë NO₂ është i lidhur me efekte të padëshiruara në shëndet, ky mund të dëmtojë melcine, mushkритë, shpretkën, gjithashtu mund të përkeqësojë semundjen e mushkërive duke krijuar problem respiratore. Ashtu si dhe SO₄, NO₂ ndikon në formimin e shiut acid dhe në eutrofizimin e tokës dhe ujit.

IV.15.8 Benzeni

Ka një shumëllojshmëri burimesh, por mënyra kryesore është përftimi nga djegiet shtëpiake dhe striale, si dhe nga transporti rrugor. NMVOCs (Non-Methane Volatile Organic Compounds) përfshijnë kimikate të ndryshme si benzene (C₆H₆), xylene, propane dhe butane ku 1,3 butadiene rrezikojnë direkt shëndetin njërezor, gjithashtu janë dhe pararendës të ozonit të nivelit të ulët të atmosfere.

Tabela IV-13: Të dhënat mesatare 2019

Parametri i matur	SO ₄	O ₃	CO	NO ₂	PM ₁₀	PM _{2.5}	Benzen
Njësia matëse	$\mu\text{g m}^{-3}$						
Vlorë	-	71.1	0.29	7.32	18.87	7.59	0.88
BE	20	25	8	40	40	25	5

Referuar vlerave mujore nuk kemi tejkalim të normës vjetore të vlerave të monitoruar në asnjërin nga parametrat e matur në këtë stacion përveç të O₃ i vërejtur me së shumti gjatë verës ku niveli i rrezatimit diellor është i lartë.

Ndonse industria e metaleve është shumë pak e zhvilluar në zonë cilësia e ajrit nuk është në nivele të larta të pastërisë për shumë shkaqe nga të cilët tre janë më të rëndësishëm: (i) aksi rrugor qendror (autostrada Fier - Vlorë) dhe cilësia e keqe e rrugëve rurale, të pa shtruara, (ii) djegja e mbeturinave urbane shkakton ndotje deri në komponime kimike të rrezikshme (ekspozim direkt dhe indirekt në shëndetin e njerëzve) dhe (iii) ndotja e ajrit nga zona urbane të mëdha në afërsi të zonës së projektit nga transporti (ndikime kufitare në mënyrë direkte nëpërmjet smogut që krijohet në to dhe ndikimeve në cilësinë e ajrit me SO_x dhe NO_x të cilët provokojnë shiut acid jo ku gjenerohen por më tej, në kufi të këtyre territoreve).

IV.15.9 Indeksin European të Përcaktimit të Cilësisë së Ajrit

Përcaktimi i cilësisë së ajrit bazohet në Indeksin European të Përcaktimit të Cilësisë së Ajrit (CAQI ose në gjuhën angleze Common Air Quality Index) i cili ka pesë nivele duke përdorur një

shkallë nga '0' (shumë e ulët) në '> 100' (shumë e lartë). Paraqet një tregues relativ të masë e sasisë së ndotjes së ajrit. Llogaritja bazohet në tre ndotës shqetësues: PM₁₀, NO₂, O₃. Mund të marrë parasysh ndotësit PM_{2.5}, CO dhe SO₂ nëse këto të dhëna janë gjithashtu të disponueshme.

Për t'i bërë qytetet më të krahasueshme, të pavarura nga natyra e rrjetit të tyre të monitorimit, dy situata janë përcaktuar:

- Historiku i Qytetit, që përfaqëson cilësinë e përgjithshme të ajrit në një grumbullim (bazuar në sfondin urban, stacionet e monitorimit),
- Në anë të rrugës, që përfaqëson cilësinë e ajrit në rrugë (bazuar në stacionet e monitorimit në anë të rrugës).




Figura IV-57: CAQI për zonën Novoselë – Vlorë

Ashtu siç është paraqitur në Tabela IV-13 ku ky indeks i matur nga të dhënat e raportuara nga stacione të ndryshme monitorimi që reflektojnë këto vlera në sajë të modeleve të përdorura tregon se ka nevojë të kemi një monitorim më periodik për të saktësuar në menyre periodike përqëndrimin e elementëve dhe industritë ndotëse që e gjenerojnë problemin.




Figura IV-58: Vlerat e ICA për Vlorën dhe rrethinat, Burimi: <https://air.plumelabs.com/air-quality-in-Vlor%C3%AB-dmej>




Figura IV-59: Vlerat e ICA për Vlorën dhe rrethinat nga muaji Shtator 2020-Shkurt 2021, Burimi: <https://air.plumelabs.com/air-quality-in-Vlor%C3%AB-dmej>

Vihet re se nga raporti rezulton një vlerësim vjetor ku 314 ditë të vitit kanë një një ICA që përkon me vlerën 20-50, të një cilësie ajri të moderuar, 29 ditë shumë e mirë dhe 18 ditë e dobët.

IV.16 SISTEMI BUJQËSOR

Është e sigurt që aktiviteti ekonomik kyesor në zonën e studimit është bazuar në sipërfaqjet e mëdha të tokave bujqësore. Njësisia Administrative e Novoselës dhe asaj të Qendër Vlorës, konsiderohen me nivel zhvillimi mbi mesataren për Qarkun e Vlorës. Ky nivel përcaktohet nga burimet e disponueshme, nga pozicioni gjeografik dhe nga vetë mentaliteti punëtor i popullatës.

Sipërfaqja e tokave bujqësore, kullimore dhe pyjore në Njësinë Administrative Novoselë zë një sipërfaqe prej 13.000 ha, ku 6.500 ha janë tokë bujqësore. Përgjithësisht, shkalla e bonitetit për tokat bujqësore në këtë njësi administrative është relativisht e ulët për shkak të pranisë së tokave

të kripura në një pjesë të gjerë të saj. Këto toka kanë qënë kënetat, të bonifikuara përgjatë periudhës së regjimit komunist për të zgjeruar prodhimin bujqësor. Por për shkak të afërsisë me detin, këto toka kanë sasi të lartë kripash. Për Njësinë Administrative Novoselë, pjesa më e madhe e tokave i takon kategorive VI, VII dhe III. Ndërsa në Njësinë Administrative Qendër Vlorë dominojnë kategoritë V, VIII dhe IV. Sipas agronomëve të NJA Novoselë, cilësia më e mirë e tokës i takon përgjithësisht kategorive I-III, në fshatrat Skrofotinë dhe Cerkovinë, pra një cilësie të mirë dhe të përshtatshme për prodhim bujqësor. Ndërsa, fshatrat Aliban, Fitore, Delisuf dhe Dëllinj kanë një klasë të bonitetit të tokës V dhe Akërnë VI. Sipërfaqet në fushën e Akërnës, dikur ligatina me vlera të larta të biodiversitetit, për një periudhë kohe, midis viteve '60 – 90, ato u thanë nëpërmjet kanaleve kulluese dhe u kthyen në toka bujqësore. Për shkak të kripëzimit të lartë, efektiviteti bujqësor i tyre ishte i ulët dhe masat përmirësuese jo efektive. Pas viteve '90 interesi për to u ul për shkak të efektivitetit të ulët dhe ato janë pothuajse të braktisura ndonëse kanë statusin “tokë arë” dhe janë tokë bujqësore të fshatareve të ndarë me Ligjin e ndarjes së tokës (Ligji Nr. 7501/1992). Tani ato përdoren vetëm si kullota dimërore.

Tabela IV-14: Pronësia e tokës sipas kategorive (Burimi: Njësia Administrative Novoselë)

Fshati	Sipërfaqe tokë për familje/frymë (m ² /person)	Sip. tokë arë në pronësi (m ² /familje)	Sip. truall në pronësi (m ² /familje)	Sip. në proces të dhënies së titullit të pronësisë
Dëllinjë	4500	13.500	250	-
Mifol	4200	12.600	300	-
Bishan	2800	8.400	250	-
Poro	3600	10.800	250	-
Delisuf	5500	16.500	250	-
Trevllazër	2800	11.200	300	-
Aliban	4500	13.500	250	-
Akërnë	6000	18.000	250	-
Fitore	2800	11.200	250	-
Novoselë	3600	10.800	250	-
Cërkovinë	2700	10.800	300	-
Skrofotinë	2700	10.800	300	-

Nivelirelativisht i lartë i prodhimeve bujqësore (kryesisht në frutikulturë) ka sjellë ngritjen e fabrika të përpunimit të ullirit, prodhimin të vajit të ullirit (tre të tilla) dhe fabrika të prodhimin të lengjeve të frutave. Njësitë Administrative të Novoselës dhe Qendër Vlorë, të cilat kanë toka me pjellori më të lartë, kanë përkatësisht 42.380 rrënjë ulliri në Novoselë dhe 118.000 rrënjë ulliri në Qendër Vlorë. Gjatë viteve të fundit, ka një rritje të interesit për vreshtarinë e cila përdoret për prodhimin e verës dhe të rakisë. Kjo sipërfaqe rritet për çdo vit me 8 ha në Njësinë Administrative Qendër Vlorë dhe me 5-6 ha në Novoselë. Në Njësinë Administrative Novoselë prodhimi i frutave zë vetëm 8.4% të prodhimin bujqësor ndërsa në Qendër Vlorë 21% të tij.

Sipas statistikave bujqëore, sipërfaqja më e madhe e tokës përdoret për prodhimin e foragjereve, grurit dhe perimeve të ndryshme, siç shihet në tabelën e mëposhtme. Po këto kultura zënë dhe peshën kryesore në prodhim.

Tabela IV-15: Prodhimi bujqësor në Njësinë Administrative Novoselë (Burimi: NJA Novoselë)

Prodhimet	Sipërfaqja	Prodhimi (në kv)
Grurë	940	32110
Misër	20	695
Perime	334	63950
Perime të thata	60	1605
Shalqi	140	40000
Patate	41	2105
Bizele	429	2910
Tagji	173	3010
Foragjere	1957	278600

Gjatë viteve të fundit, sipërfaqja e tokës bujqësore e përdorur për drithëra është reduktuar në favor të perimeve. Një pjesë e tokës bujqësore është transformuar në sera për prodhimin e domates dhe të kastravecit. Megjithë rëndësinë e tij të vogël, aktiviteti bujqësor vuan nga mungesa e një tregu bujqësor të organizuar, infrastrukturës së transportit, zhvillimi i dobët i agro-industrisë, mungesa e kreditimeve bankare për fermerët dhe shërbimet e dobëta agronomike.

Qeveria qendrore ka ofruar mbështetje për përmirësimin dhe rritjen e vlerës së shtuar për ekonominë bujqësore të zonës nëpërmjet ndërtimit të serrave në Bishan, fabrikës së ullirit dhe heqjes së aksizës së naftës, e cila është në fazën e aplikimeve. Ndërsa qeverisja lokale (Njësia Administrative Novoselë) ka mbështetur bujqësinë nëpërmjet pastrimit të kanaleve kulluese dhe infrastrukturës së brendshme (ndriçim dhe rrugë).

Në Njësinë Administrative Novoselë, aktiviteti blegtoral është i rëndësishëm pasijell 57% të të ardhurave ndërsa në Qendër Vlorë ky aktivitet sjell 34% të të ardhurave. Pjesa më e madhe e blegtorisë përbëhet nga dele, lopë dhe dhi. Gjithashtu është i lartë dhe numri i pulave. Çdo familje ka mesatarisht një lopë, dy dele dhe disa pula për nevojat familjare. Disa prej fermerëve kanë nisur mbarështimin e fermave të vogla prodhuese për mish, qumësht, vezë dhe mjaltë. Destinacioni përfundimtar i prodhimeve blegtoriale është tregu vendas si dhe përdorimi vetjak. Në total zona ka 4.100 gjedhë, 25.200 dele etj. Çdo përmirësim në cilësinë e kullotës dhe furnizimin me ujë për bagëtinë do të rriste sigurisht një aktivitet të tillë si dhe rëndësinë e saj ekonomike. Ashtu si dhe prodhimi bujqësor, edhe prodhimi blegtoral vuan nga mungesa e një tregu blegtoral të organizuar, mungesa e infrastrukturës së transportit, zhvillimi i dobët i agro-industrisë, mungesa e kreditimeve bankare, shërbimet e dobëta veterinare etj.

IV.17 EKONOMIA BUJQËSORE

Një ndër aktivitetet kryesore të banorëve të zonës së Novoselës është bujqësia. Sipas të dhënave nga komuna rreth 70% e popullsisë merren me bujqësi, ku kryesisht kultivohen drithëra,

fruta dhe pemë frutore. Prodhimet kryesore të bashkisë Vlorë janë foragjerët, drithrat dhe perimët (Figura IV-60, INSTAT, 2019). Kategoritë e tokës bujqësore variojnë nga kategoria VI, VII dhe III në bashkinë Novoselë, ndërsa në komunën Qendër dominojnë toka bujqësore të kategorive V, VIII dhe IV. Një pjesë e tokës bujqësore është transferuar në serra për kultivimin e domates dhe kulturave të tjera të arrës. Prodhim i frutave përben 21% të prodhimit total bujqësor në komuninën Qendër, ndërsa në Novoselë vetëm 8.4%. Një tjetër kulturë e rëndësishme e zonës është vreshtaria, e cila përdoret për prodhimin e verës dhe rakisë, sidomos zona e Nartës njihet për cilësinë e prodhimit të verës.

Tabela IV-16: Shtrirja e sistemit arsimor sipas fshatrave dhe gjendja e tyre

Fshati	Nr. i Çerdheve	Nr. i Kopshteve	Nr. i Shkolla 9 - vjeçare	Nr. i Gjimnazeve	Gjendja e tyre sipas klasave
Dëllinjë	-	1	-	-	-
Mifol	-	-	-	-	-
Bishan	-	1	1	-	E mirë
Poro	-	1	1	-	E mirë
Delisuf	-	-	-	-	-
Trevllazër	-	1	1	-	Shumë mirë
Aliban	-	-	-	-	-
Akerni	-	1	1	-	E mirë
Fitore	-	1	1	-	E mirë
Novoselë	-	1	1	1	Shumë mirë
Cërkovinë	-	1	1	-	E mirë
Skrofotinë	-	-	-	-	-

Burimi: Të dhëna nga pyetësi me administratorin e zonës Novoselë

Sic vërehet në Tabela IV-14: Pronësia e tokës sipas kategorive (Burimi: Njësia Administrative Novoselë)Tabela IV-14, sipërfaqja për familje/frymë është më e lartë në Akerni prej 6000 m²/familje, dhe më e ulët në Cërkovinë me 2700 m²/familje.

Burimi kryesor i të ardhurave ashtu sic vërehet në Tabela IV-17 janë të ardhurat nga bujqësia që përbejnë rreth 70%. Blegtoaria dhe frutikultura zënë më pak peshë në të ardhurat totale të zonës Bashkia Vlorë (Figura IV-60). Një tjetër burim i rëndësishëm janë të ardhurat nga remintancat, gjë që tregon një nivel të lartë të emigrimit të zonës.




Figura IV-60: Prodhimi bujqësor për vitin 2019, bashkia Vlorë

Blegtoria është një tjetër aktivitet i rëndësishëm për këtë zonë. Në komunën Qendër, blegtoria siguron 34% të ardhura, ndërsa në Novoselë rreth 57% të të ardhurave. Çdo familje zotëron mesatarisht nga një lopë, dy dele dhe pula. Ndërkohë që janë krijuar ferma të vogla që merren me rritjen e deleve për përdorim vetjak apo edhe për shitje në kompanitë e përpunimit të qumështit. Një ndër problem që hasnin këta fermerë ishte mungesa e tregut për produktet e tyre. Në këtë zonë kemi një zhvillim të pakët të industrisë agropërpunuese, ku më kryesore janë fabrika të përpunimit të qumështit, të vajit, përpunimit të bimëve medicinale, frutave, mishit, leshit etj.

Tabela IV-17: Burimi i të ardhurave sipas kategorive të prodhimit

Fshati	Bujqësi %	Blegtori %	Frutikulturë %	Sera %	Ndërtim %	Emigrimi %	Të tjera %
Dëllinjë	70 %	15 %	-	-	-	10 %	5 %
Mifol	65 %	10 %	10 %	-	-	13 %	2 %
Bishan	70 %	10 %	5 %	5 %	-	7 %	3 %
Poro	60 %	20 %	5 %	-	-	10 %	5 %
Delisuf	70 %	10 %	3 %	-	-	15 %	2 %
Trevllazër	60 %	20 %	10 %	-	-	10 %	-
Aliban	65 %	15 %	10 %	-	-	10 %	-
Akerni	55 %	25 %	5 %	-	-	12 %	3 %
Fitore	50 %	10 %	30 %	-	-	10 %	-
Novoselë	60 %	10 %	15 %	-	-	10 %	5 %
Cërkovinë	40 %	15 %	25 %	-	-	15 %	5 %
Skrofortinë	45 %	10 %	20 %	-	-	10 %	5 %

Burimi: Të dhëna nga pyetësi me administratorin e zonës Novoselë

IV.17.1 Peshkimi

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm ekonomik është edhe peshkimi. Aktiviteti i peshkimit në zonën e lagunës bazohet në punën e grupi të licensuar peshkatarësh. Megjithë legalizimin e aktivitetit, peshkimi ilegal është present në këtë zonë. Prodhimi është i destinuar për zonën dhe një pjesë e vogël eksportohet. Peshkimi punëson rreth 100 persona të zonës. Zona e peshkimit përfshin lagunën e Nartës, rrjedhën e lumit Vjosë, lagunën e Kallenga, lumin Vjosë dhe bregun e detit.

IV.17.2 Turizmi

Zona e Nartës është një mundësi e mirë për zhvillimin e ekoturizmit. Në këtë zonë gjenden një sërë pikash të rëndësishme historike. Në ishullin e Zvernecit, pranë lagunës së Nartës ndodhet Manastiri i Shën Mërisë. Në fshatin Nartë, ndodhet një zonë arkeologjike me mbetjet e lashta të qytetit Aulona. Pranë lagunës së Nartës ndodhet qyteti i Vlorës, ku mund të vizitohen muze dhe monumente të trashëgimisë kulturore, të tilla si "Shtëpia e Pavarsisë", xhamia e Sulltan Murad e ndërtuar rreth vitit 1542 nga arkitekti shqiptar Mimar Sinau, Kështjella e Kaninës etj. Po kështu në këtë zonë vlen të përmendet që kalon Rruga Egnatia, që lidh bregun e Illirisë Jugore me Lindjen duke kaluar nga qyteti i Aulonës, ose Vlora e sotme. Në ishullin e Zvernecit ndodhet një nga pikat turistike më tërheqëse të zonës, sic është Manastiri i Zvernecit. Të dhënat për këtë manastir tregojnë se është ndërtuar rreth shekujve XIII-XIV. Një ndër ngjarjet që e bën edhe më të njohur këtë manastir janë karnavalet që zhvillohen çdo vit në muajin Prill. Qëllimi i këtij aktiviteti është promovimi i vlerave kulturore dhe historike të zones si dhe mbeshtetje për ruajtjen dhe konservimin e zonës.

IV.18 SISTEMI INFRASTRUKTUROR

IV.18.1 Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm

Njësia Administrative Novoselë identifikohet si njëzonë ujëmbajtëse me kapacitet të lartë të mundësive të prodhimit të ujit të pijshëm joveitem për nevojat e popullatës por edhe me mundësi të furnizimit të fshatrave të Njesisë Administrative QendërVlorë si dhe të qytetit të Vlorës. Megjithë rezervat ujore janë të mëdha, përsëri furnizimi me ujë mbetet problematik për Novoselën. Në vitet 60 është ndërtuar ujësjellësi i Novoselës, me kapacitet 400 l/s, i cili në vite ka furnizuar gjithë fshatrat e zonës dhe qytetin e Vlorës. Në vend të kuotës së përcaktuar prej 150 l/person, furnizimi i sotëm është vetëm 90 l/person. Mangësia e furnizimit me ujë lidhet me amortizimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit, dëmtimit të tubacioneve kryesore, mungesës së energjisë elektrike dhe për shkakun e kohës së gjatë të shërbimit. Ndaj, pusët e marrjes së ujit janë mbathur dhe lind nevoja e çpimit të puseve të reja. Planet e rehabilitimit të rrjetit ujqor janë tashmë të përfunduara. Këto plane i sigurojnë Novoselës ujë të rrjedhshëm në 24 orë. Rrjeti i ujësjellësit do të ketë një investim prej 9 miliard lekësh, ku punimet do të fillojnë brenda muajit Mars 2021.

Njësia Administrative e Novoselës furnizohet me ujë të pijshëm nga stacioni i pompimit të Novoselës. Uji merret nëpërmjet 6 puseve qëndodhen në Novoselë, në të cilët janë të instaluar nga

dy pompa të lidhura paralel me prurje $q=27 \text{ l/sek}$ ose $100 \text{ m}^3/\text{orë}$. Njësia Administrative Qendër Vlorë furnizohet nga burimi i “Ujit të Ftoht ë” nëpërmjet stacionit Nr. 4 me një kapacitet prej 5 l/sek . Uji është i siguruar për 24 orë.




Figura IV-61: Stazionet e pompimit të ujit të pijshëm në NJA Novoselë (Burimi: ASIG)

Sasia e ujit dërgohet nëpërmjet tubacionve prej celiku me diametër 200mm në depon e ujit me kapacitet 300 m^3 që ndodhet pranë stacionit kryesor të pompave shpërndarëse, e cila ndodhet në zonën e urbanizuar të Njesisë Administrative (siç tregohet në foton e mëposhtme).



Figura IV-62: Godina e shpërndarjes së ujit (foto nga eksperti)

Këtu uji klorifikohet dhe shpërndahet tek banorët e 12 fshatrave të Njesisë Administrative Novoselë nëpërmjet sistemit të infrastrukturës së ujë. Shpërndarja ndodh nëpërmjet 4 pompave centrifugale, dy prej të cilave me fuqi 250 kilowatt (pompave me ngjyrë jeshile në foton e mëposhtme) dhe kapacitet $Q=360 \text{ m}^3/\text{orë}$ lidhur në paralel dhe dy të tjera me fuqi 160 kilowatt (pompave me ngjyrë blu në foto e mëposhtme), me kapacitet $Q=360 \text{ m}^3/\text{orë}$, lidhur në paralel.



Figura IV-63: Pompave në stacionin e shpërndarjes (foto nga eksperti)

Nga depoja uji shpërndahet nëpërmjet tubacionit me diametër 250mm në drejtim të Poros dhe drejtimi tjetër është ai i Panajasë ku merr furnizim Aliban dhe Akërni. Novosela e merr furnizimin direkt nga rrjeti. Po kështu fshatrat Çerkovinë, Skrofotinë e Mifol e marrin nga daljet që janë lenë në linjën e dërgimit të Panajase nëpërmjet tubit me diametër 315mm. Trevllazeri furnizohet nga depoja që e merr ujin nga stacioni i pompave në Skrofotinë.

Tabela IV-18: Sistemi i furnizimit të ujit të pijshëm në fshatrat e Njësisë Administrative Novoselë
(Burimi: NJA Novoselë)

Fshati	Sasia e ujit të pijshëm që konsumohet në ditë/frymë	Numri i puseve	Burimi i ujit të pijshëm	Gjendja e sistemit të ujit të pijshëm
Dëllinjë	26 litër	-	Nga Novosela	E mirë
Mifol	30 litër	-	Nga Novosela	E mirë
Bishan	35 litër	-	Nga Novosela	E pranueshme
Poro	27 litër	-	Nga Novosela	E mirë
Delisuf	24 litër	-	Nga Novosela	E mirë
Trevllazër	26 litër	1	30 % Novoselë	E pranueshme
Aliban	32 litër	-	Nga Novosela	E mirë
Akerni	29 litër	-	Nga Novosela	E mirë
Fitore	30 litër	-	Nga Novosela	E pranueshme
Novoselë	34 litër	1	Novosela	E mirë
Cërkovinë	27 litër	-	Nga Novosela	E pranueshme
Skrofotinë	26 litër	-	Nga Novosela	E pranueshme

Problematika e furnizimit me ujë për këtë Njësi Administrative konsiston në sigurimin e kapacitetit prodhues të stacionit të ujit. Në këtë mënyrë garantohet furnizimi i popullatës në prespektivë dhe sigurohet sasia e nevojshme e ujit të pijshëm për strukturat e ardhme të turizmit dhe të aktiviteteve prodhues, që do instalohen në zonë.




Figura IV-64: Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të propozuar (Burimi: PPV Vlorë)

IV.19 MENAXHIMI I MBETJEVEDHE INFRASTRUKTURA MJEDISORE

Bashkia Vlorë referon si vend depozitim kryesor atë afër qytetit të Vlorës, në vendin e quajtur “Fusha e Aviacionit”. Ky venddepozitim ndodhet shumë pranë qytetit të Vlorës dhe aktualisht është i rrethuar me shtëpi banimi. Ka një sipërfaqe rreth 12,6 ha dhe është shumë pranë (5-20 m) kanalit të ujërave të zeza, që derdhet në detin Adriatik. Është i rrethuar me një gardh të thjeshtë me lartësi 1m, e cila e bën të lehtë hyrjen në brendësi të tij të personave të pa autorizuar dhe kafshëve shtëpiake. Vlorë gjenerohen më shumë se 40.000 ton/vit mbetje urbane dhe po aq afërsisht edhe mbetje inerte me një mesatare prej rreth 1.9kg mbetje/ditë/banor. Sot fusha e aviacionit mban afërsisht rreth 250.000m³ mbetje. Sasia e mbetjeve që depozitohen aty është 140 ton/ditë ose 51.100 ton në vit. Nga venddepozitimi largohet një pjesë e mbetjeve të plastikës. Pavarësisht studimeve të fizibilitetit për menaxhimin e mbetjeve gjendja mbetet problematike. Afërsia e pikës së grumbullimit të mbetjeve me qytetin e Vlorës është një problem akut që lidhet ngushtë me cilësinë e ajrit në zonë, me shëndetin e popullatës dhe zhvillimin e tij.

Është propozuar për mbylljen e këtij venddepozitimi që në vitin 2015. Duhet theksuar se ky venddepozitim ndodhet në Zonën B të “Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë-Nartë””, shpallur zonë e mbrojtur me VKM Nr.680, datë 22.10.2004, “Për shpalljen e sistemit ligatinor Vjosë-Nartë peizazh ujor/tokesor i mbrojtur”.

Një zonë të nxehtë përbëjnë edhe mbetjet dhe ndotjet kimike në zonën e plazhit pranë ish-Uzinës së Sodë-PVC, (Vlerësimi i mërkurit dhe metaleve të rënda në biota, sedimente dhe tokën e lagunave të Nartës dhe Orikumit, raporti teknik i monitorimit Lazo, Çullaj, Baraj), e cila në vitet 1967-1992 ka shkarkuar drejtpërdrejt në det mbetjet e lëngëta (rreth 500 m³/orë) me përmbajtje të lartë mërkuri, rreth 1.1 mg/L me një total prej 64 ton.

Duke patur parasysh shpërndarjen e popullsisë në territorin e Bashkisë Vlorë, duhet konsideruar që aktualisht përdoren disa venddepozitime përveç atij të cituar më sipër, të cilat tregohen në hartën e mëposhtme.



Figura IV-65: Vendndodhja e venddepozitimeve në Bashkinë e Vlorës²⁵

Sipas pikës 3 të nënit 12 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndyshuar, detyrohet që “Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore përcakton rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve, që gjenerohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, ose masën e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive. Këto rregulla mund të jenë më strikte sesa qëllimet dhe kërkesat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.

Njësia Administrative Novoselë prodhon 15 ton/ditë mbetje, të cilat në se ndjekim hierarkinë, një sasi e rëndësishme (rreth 50%) mund të reduktohet pas ndarjes, ripërdorimit dhe ricikimit. Aktualisht, administrimi i mbetjeve është kaotik, pa plane lokale menaxhimi, pa infrastrukturë të nevojshme në kushtet e mungesë së finacimeve. Për momentin problemi i mbetjeve të ngurta në Njësinë Administrative Novoselë është zgjidhur nëpërmjet një kompanie të kontraktuar nga Bashkia Vlorë, e cila mbledh mbetjet nënjë rrjet prej 50 pika grumbullimi (kazanë dhe kosha) të shpërndara në territorin e njësisë për hedhje mbetjesh dhe largimin e tyre në zonën

²⁵ <http://uts-01.com/WebGis/venddepozitime/>

e landfill-it të Vlorë. Pavarësisht këtij sistemi, shumë mbetje depozitohen përgjatë brigjeve të Lumit Vjosa. Depozitimet e paligjshme përgjatë bregjeve të lumit të Vjosës janë vendi më i papërshtatshëm për depozitim të mbetjeve. Ato depozitohen këtu pasi sipërfaqet anës lumit, duke qënë pronë shtetërore, janë objekt aktivitetesh të paligjshme.



Figura IV-66: Mbetje të depozituara në mënyrë të paligjshme pranë Lumit Vjosa, në zonën A1 të zonës së mbrojtur (foto nga eksperti)

Problem shqetësues janë edhe mbetjet ndërtimore, por aktualisht pjesa e dherave të nxjerrë nga gërmimet është zgjidhur nga vetë firmat e ndërtimit. Mbetjet industriale në këtë njësi janë të pakta. Në të ardhmen mbetjet do të depozitohen në landfill-in e Sherishtës, i cili aktualisht është në fazën e përfundimit të ndërtimit dhe pritet të përfundojë në muajin Prill 2021.

Tabela IV-19: Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në fshatrat e NJA Novoselë (Burimi: NJA Novoselë)

Fshati	Sasia në ton/vit	Sasia për g/frymë/ditë	Sa % riciklohet	Sa % menaxhohet	Gjendja e koshave
Dëllinjë	15	800	-	100%	E amortizuar
Mifol	17	600	-	100%	E pranushme
Bishan	26	900	-	100%	E mirë
Poro	30	700	-	100%	E pranushme
Delisuf	18	600	-	100%	E amortizuar
Trevllazër	22	500	-	100%	E mirë
Aliban	17	900	-	100%	E pranushme
Akerni	24	850	-	100%	E pranushme
Fitore	19	780	-	100%	E mirë
Novoselë	35	850	-	100%	E mirë
Cërkovinë	16	550	-	100%	E pranushme
Skrofotinë	14	600	-	100%	E mirë




Figura IV-67: Vendndodhja e venddepozitimeve në zonën e mbrojtur Vjosë-Nartë dhe venddepozitimi i planifikuar në Sherishtë²⁶

²⁶<http://uts-01.com/WebGis/venddepozitime/>

Në zonën pranë projektit ka disa ndërtesa betoni të cilat presin gjatë sezonit të verës rreth 150 familje dhe disa kasolle kashte (rreth 60) në të cilat kalojnë pushime ditore rreth 300 pushues. Tek këto veprimtari turistike mbetjet nuk janë të menaxhuara, duke mos patur as trajtim të tyre dhe as largim nga zona e mbrojtur (figura e mëposhtëme).



Figura IV-68: Mbetje në zonën e Planit (foto nga eksperti)

IV.20 SISTEMI URBAN

Sistemi Urban i referohet një tokë tashmë të zhvilluar. Pjesa më e madhe e tokësurbane, rreth 70% përbëhet nga qyteti i Vlorës duke përfshirë luginën bregdetare nga ultësiraderi në bregdet. Zona urbane përfshin gjithashtu edhe komponentë të karakterit industrial qeradhiten pranë saj si fabrika e Sodës dhe TEC të cilat janë të vendosura në perëndim. Qyteti i Vlorës është relativisht kompakt, por gjatë dy dekadave të fundit paraqet një shtrirje dhe zgjerim dinamik. Pas vitit 1990 zona urbane është zgjeruar kryesisht në jug përgjatë bregdetit Jon drejt Orikumit, ku janë të pozicionuara zonat kryesore të shtëpive dytësore dhe infrastruktura çlodhëse. Një drejtim dytësor i zhvillimit urban është formuar në lindje përgjatë rrugës që kalon përmes kodrave të Vlorës përmes luginës së Shushicës. Ka një përqendrim të zonaveinformale të banimit të kombinuara me zhvillime të reja me shfrytëzim ekonomik. Disatendenca në zhvillimin urban në pjesën veriore përgjatë rrugës së vjetër nacionale janëbraktisur pas hapjes së rrugës së re nacionale gjatë 15 viteve të fundit. Përveç qytetit të Vlorës, sistemi urban i bashkisë përbëhet nga vendbanimet e shumta rurale të Shushicës, Qendrës, Orikumit dhe Novoselës, të cilat formojnë rrjete të një densiteti relativisht të ulët. Modeli ishpërndarjes ndryshon nëse ndjekim karakteristikat e secilës zonë. Përqëndrimi më i lartë ipërdorimeve urbane vihet re në verilindje dhe është i lidhur me relievin e butë, vendndodhjen etokës bujqësore dhe të afërsisë me Vlorën.

Mjediset kryesore të zonës së Njësisë Administrative Novoselë janë sistemet bujqësore, ujore, natyrore, infrastrukturore dhe urbane. Sistemet e urbanizuara në Njësinë Administrative Novoselë përbëjnë 2.1 % të totalit të sistemeve të saj territoriale, afërsisht 345 ha. Sistemet bujqësore mbulojnë 44% të totalit të sistemeve të saj territoriale, rreth 7307 ha. Ndërsa sistemi ujqor mbulojnë 32.9 % të totalit të sistemeve të saj territoriale, rreth 5451 ha.

Tabela IV-20: Ndarja e territorit sipas pesë sistemeve territoriale në NJA Novoselë (PPV i Bashkisë Vlorë, 2017)

Sistemet territoriale	Sipërfaqja (në ha)
Sistemi urban	345.29
Sistemi natyror	3120.50
Sistemi bujqësor	7301.01
Sistemi ujor	5451.59
Sistemi infrastrukturor	372.61
Total	16591 ha

Sipas Plani të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë numri total i banesave në Njësinë Administrative Novoselë është 3477, ku 2333 banesa janë të banuara nga persona me vendbanim të zakonshëm, 156 banesa janë të destinuara për qëllime dytësore apo sezonale dhe 988 banesa të pabanuar apo të banuara nga persona që nuk përfshihen në census.

Tabela IV-21: Statusi i banimit të banesës në Njësinë Administrative Novoselë (PPV i Bashkisë Vlorë, 2017)

Njësia Administrative	Gjithsej Total	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar ose e banuar nga persona që nuk përfshihen në census
Novoselë	3477	2333	156	988

IV.21 AKSESI DHE RREJTI I TRANSPORTIT

Rrjeti rrugor është një pjesë integrale e rëndësishme, pasi lidh zona të ndryshme duke filluar që nga bashkitë mes tyre, deri tek qytetet e fshatrat, duke lehtësuar lëvizjen mes njerëzve, automjeteve dhe mallrave. Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe tërheqjeve të tjera.

Infrastruktura rrugore dhe aksesit në territorin në studim, në gjëndjen aktuale, paraqitet deri diku i izoluar. Kjo vjen si pasojë e statusit të mëparshëm dhe prej tipologjisë së tokave përbërëse të terrenit. Megjithatë prania e Autostradës Kombëtare “100 Vjetori i Pavarësisë” në një distancë prej 10km larg zonës në studim, ka ndryshuar panoramën e aksesit në këtë territor.

Në zonën në studim mbërrihet duke ndjekur rrugën kombëtare Vlorë-Fier (Vlorë-Kriporja-bregdeti i Nartës-Hidrovori), ose Vlorë-Pylli i sodës-fshati Zvërnec. Rrjeti rrugor në rrethin e Vlorës ka një zgjerim prej 200 km. Ekzistenca e tij mundëson zhvillimin e turizmit, ndonëse duhet theksuar se cilësia e rrjetit rrugor nuk është shumë e mirë. Parashikohet që në këtë rrjet mund të kalojnë afro 4000 makina në ditë gjatë verës dhe afro 5000 makina gjatë fundjavës verore. Transporti publik midis Vlorës dhe Nartës kryhet me anë të autobuzave.

Bashkia e Vlorës ka rreth 193 rrugë dytësore në gjendje relativisht të mirë. Një pjesë e rrugëve dytësore sidomos ato që lidhen me bregun janë të rikonstruktura dhe në gjendje të mirë ndërsa pjesa tjetër që lidhet me pjesën malore janë nën ndërtim.



Figura IV-69: Infrastruktura rrugore për në Lagunën e Kellengës (drejtim perëndimor; foto nga eksperti)

Njësia Administrative Novoselë klasifikohet ndër njësitë me rrjet rrugor të gjerë dhe me gjendje teknike relativisht të kënaqshme, kryesisht në anën perëndimore. Të gjithë fshatrat e Njësisë Administrative Novoselë lidhen me qendrën e njësisë me rrugë automobilistike të asfaltuara. Volumi në rritje i trafikut në rrugë është burimi kryesor i trafikut të renduar duke shkaktuar probleme ekonomike dhe mjedisore. Volumi i trafikut në stinën e verës përkeqëson më tej situatën për shkak të numrit të lartë të turistëve. Ndër të metat e sistemit rrugor të Njësisë Administrative Novoselë është fakti se rrugët që të çojnë në bregdet janë të pasistemuara dhe në gjendje të keqe, gati të pakalueshme sidomos në stinët me reshje. Rruga kryesore e Njësisë Administrative Novoselë që kalon përgjatë fshatrave Aliban, Fitore deri në Bishan, Delisufi, Dellinjë etj. në tërësi 12 km ka mungesë të sistemit të ndriçimit ndërsa segmenti 7 Bunavi e Sipërme - Bestrovë 2.7 km është i paasfaltuar. Brenda Njësisë Administrative mungon transporti publik urban, vetëm një kompani me minibus e licensuar nga Bashkia Vlorë operon nëpër fshatra.

Tabela IV-22: Infrastruktura rrugore dhe gjendja e saj në fshatrat e NJA Novoselë (Burimi: NJA Novoselë)

Fshati	Gjendja sistemit të infrastrukturës	Gjatësia në km me asfalt	Gjatësia në km me çakëll
Dëllinjë	E mirë		2.2
Mifol	E mirë	1	1.3
Bishan	E pranueshme	3	3.5
Poro	E amortizuar	4	3
Delisuf	E pranueshme	2	2.3
Trevllazër	E mirë	5	1.6

Aliban	E pranueshme	1.5	1.4
Akerni	E pranueshme	2.5	1.8
Fitore	E mirë	3.5	1
Novoselë	E mirë	7	2.7
Cërkovinë	E pranueshme	1.6	1.8
Skrofortinë	E pranueshme	1	1.5

Rruga hyrëse në Akërnë është me gjerësi 5.0 m (3,5m asfalt + 2 x 0,75bankinat anësore) është në gjendje të pranueshme. Gjatësia e rrugës nga Novosela-Akerni-Poro është 9.0 km. Gjatësia e rrugësFitore - Bishan -Poro -Delisuf është 10,5 km²⁷.

Fshati Mifol ka rrugë me gjerësi totale 6m (4 asfalt dhe bankinat 2 x1 m), e shtruar me asfalt. Ndërsa në fshatrat Trevllazër, Cerkovinë, Skrofortinë, të cilat janë në krahun lindor të Njësisë Administrative Novoselë, rrugët janë me gjerësi 5.0 m (3,5m asfalt + 2 x 0,75 bankinat anesore).




Figura IV-70: Harta e infrastrukturës rrugore ekzistuese të NJA Novoselë (Burimi: Harta e rrjetit rrugor eksistues 11c)

Në këtë moment nuk ka rrugë të vazhdueshme nga bregu, lugina dhe më pas në zonën e Pishë-Poros. Kjo e bën përvojën rrugore të fragmentuar. Rrugët e Poro janë dytësore ose terciare, që do të thotë se janë të ngushta. Ndër pengesat e sistemit ekzistues rrugor është fakti që rrugët që çojnë në bregdet janë të degraduara dhe në gjendje të dobët, në sezonin me shi ato bëhen të pakalueshme, gjithashtu mungojnë trotualet dhe gjelbërimi në rrugë.

Zona e Poros është e përfshirë në një nga projektet më të rëndësishme për aksesueshmërinë e zonës së Vlorës, siç është “Rruga Bregdetare”, e cila përfshin Divjakë-Poro-Narta-Vlorë-Dhërmi.

²⁷Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë, 2017




Figura IV-71: Infrastruktura rrugore ekzistuese në zonën në studim

IV.22 ENERGJIA DHE TELEKOMUNIKACIONI

Njësia Administrative Novoselë furnizohet me enegji nga rrjeti 35/10 kv në Mifol dhe infrastruktura për lidhjen me energjinë elektrike mbërrin në çdo banesë të 12 fshatrave të saj. Disa banorë të fshatrave shfrytëzojnë energjinë e rrezatimit diellor përmes instalimit të paneleve diellore individuale në çatit e banesave të tyre. Ndërsa, Njësia Administrative Qendër Vlorë ka problematikë lidhur si me rrjetin shpërndarës ashtuedhe me parametrat që ofrojnë linjat e elektrikut. Në të gjithë zonën situata e rrjetit elektrik gjithashtu është në gjendje jo të mire sidomos vitet e fundit për arsyen e shtimit të rrjetit në drejtim të ndërtimeve informale si shtëpi, ndërtesa industrial etj.. Si rezultat sistemi pëson humbje të mëdha.



Figura IV-72: Infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike në Lagunën e Nartës (foto nga eksperti)

Përsa i përket telekomunikacionit, aktualisht ka një mbulim nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të Bashkisë. Rrjeti i internetit është gjerësisht i përdorur në të gjithë fshatrat e Njesisë Administrative Novoselë. Përdorimi i kabllave optike për internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen edhe nga operatorë të fuqishëm si Vodafone dhe One.

IV.23 DEMOGRAFIA DHE SHPËRNDARJA HAPËSINORE E POPULLSISË

Në zonën e mbrojtur Vjosë Nartë, banojnë rreth 8,140 banorë, (Tabela IV-23) të shpërndarë në 12 njësi/fshatra. Numri i familjeve është gjithsej 2,473, me një mesatare prej 4 personash për familje. Numri mesatar i familjeve varion nga 100 familje në Dëllinjë në 480 familje në Trevllazër. Në këtë zonë njësia administrative Novoselë dhe fshati Trevllazër kanë infrastrukturë shumë të

mirë për arsimimin, ndërsa fshatrat e tjera kanë një nivel të mirë dhe ka nevojë për përmirësime (Tabela IV-23).

Tabela IV-23: Numri i banorëve të shpërndarë sipas familje, gjinisë dhe grup-moshave

Fshati	Census 2011	Familjeve	Mesatarja e Personave /Familje	Burra	Gra	Numri i popullates sipas grup - moshave		
						0-14	15-64	65+
Dëllinjë	290	100	3	130	160	60	195	35
Mifol	480	170	3	230	250	90	344	46
Bishan	1660	460	4	810	850	290	1166	204
Poro	520	175	3	240	280	90	370	60
Delisuf	370	105	4	170	200	65	263	42
Trevllazër	1760	480	4	870	890	270	1355	138
Aliban	280	110	3	130	150	40	202	38
Akerni	440	140	3	210	230	73	313	54
Fitore	570	160	4	260	310	105	390	76
Novoselë	910	240	4	440	470	140	646	124
Cërkovinë	560	190	3	260	300	90	375	95
Skrofotinë	300	107	3	140	160	45	220	35

Burimi: Të dhëna nga pyetësi me administratorin e zonës Novoselë

IV.24 EKONOMIA DHE PUNËSIMI

Të dhëna parësore u mbledhën nëpërmjet intervistave të zhvilluara në grup me anëtarë të ndryshëm të autoriteteve vendore dhe qendrore të zonave. Intervista më të specifikuar u zhvilluan me përfaqësues kryesore të njësive administrative, të cilët zotërojnë informacion mbi problemet e identifikuar, dhe për më tepër, u kërkua opinion i tyre mbi mundësitë për përmirësim. Të dhëna dytësore u mbledhën nga buletinet e publikuara të INSTAT, Ministria e Financave, si dhe një sërë raportesh dhe studimesh të publikuara. Të dhënat social-ekonomike për fshatrat që përfshihen në projekt janë të pakëta dhe jo zyrtare. Në rastet kur një tregues mungon është përdorur informacioni në nivel njësie administrative/qarku/prefekturë ose të dhëna të komunës në ndarjen e mëparshme territoriale.

IV.24.1 Treguesit ekonomik

Shqipëria gjatë 30 viteve të kalimit nga periudha e komunizmit në ekonominë e tregut është karakterizuar nga tregues ekonomikë që shumë herë kanë qënë në vlera negative dhe në rates të tjera në vlera pozitive shumë të larta në krahasim me rajonin e sidomos deri në vitet 2000. Kështu në vitet e para të tranzicionit rritja ka qënë 9% në vit, ndërkohë që rrënia e skemave piramidale solli një rrënie të konsiderueshme të GDP në -7%. Në periudhën 2000-2006 edhe në vendin tonë u ndien pasojat e krizës financiare globale ku vlen të përmendet rënia nga 7% në 3% të GDP. Një rritje e investimeve të huaja, sidomos në sektorin e energjitikës, përgjatë viteve 2011-2019 ka

ndikuar në një rritje të qëndrueshme të GDP gjatë këtyre viteve. Disa nga treguesit kryesore ekonomike përgjatë viteve 2011-2019 gjenden në Tabela IV-24.

Tabela IV-24: Treguesit social ekonomike në Shqipëri në vite

Treguesit	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Rritja ekonomike	2.6	1.4	1.0	1.8	2.2	3.4	3.8	4.1	2.2	-8.4*
Norma e inflacionit	3.45	2.03	1.94	1.63	1.91	1.28	1.9	2.02	1.4	
Norma e papunësisë	14	13.4	15.6	17.5	17.1	15.2	13.6	12.3	11.47	11.7
Rritja e popullsisë	(0.27)	(0.17)	(0.18)	(0.21)	(0.29)	(0.16)	(0.08)	(0.05)	(0.06)	(0.11)

Burimi i informacionit: Banka Botërore, <https://data.Worldbank.org/indicator> (* parashikim)

Tërmeti i Nëntor 2019, pasuar me situatën pandemike të vitit 2020, solli një rënie të konsiderueshme të rritjes ekonomike në Shqipëri, që sipas vlerësimeve të Bankës Botërore arrin me -8.4% në vitin 2020. Në të njëjtën situatë të vështirë gjendet edhe buxheti i shtetit ku deficitit buxhetor përbën 80% të GDP. Për më tepër efektet negative ndihen dhe në një përkeqësim të treguesve të punësimit me një rënie prej 34,000 të vendeve të punës ose një normë papunësie prej 12%.

KAPITULLI V: OBJEKTIVAT E VSM DHE LIDHJA ME OBJEKTIVAT NDERKOMBETAR TË ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM

Objektivat e përcaktuara mjedisorë janë në perputhje me Ligjin 91/2013 “Per vlerësimin Strategjik Mjedisor”, objektivat e përcaktuara në SKZHI II, EU SDS²⁸ dhe Direktiven 2001/42/KE²⁹, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani për të arritur objektivat e tij.

V.1 OBJEKTIVAT NDËRKOMBËTARE DHE TË BE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Shqipëria është mbështetëse dhe nënshkruese e radhës së parë Konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare (Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Konventën e ndryshimeve Klimatike).

Po ashtu, merr pjesë aktive në organizata, plane, konferenca dhe aktivitete shumëplanëshe që lidhen me problemet globale/locale të cilat synojnë të përmirësojnë mbrojtjen e mjedisit në ballancë me zhvillimin e kërkuar për rritjen e mirëqënies nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivat kryesore që Shqipëria kërkon të arrijë në këtë nivel janë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), të pranuar nga përfaqësuesit e 189 vendeve në Konferencën e OKB-së të vitit 2000, dhe synimeve të përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillim të Qëndrueshëm (SBZHQ) në Johaneshburg. Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johaneshburg, 2002) ishte rezultante i një serie konferencash, duke përfshirë Konferencën e Stokholmit mbi Mjedisin në vitin 1972 dhe Konferencën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin në vitin 1992 - e cila paraqiti parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Politikat në Nivel Evropian Politika mjedisorë e BE-së është udhëhequr nga parimi i parandalimit dhe parimi i "Ndotesi Pagan", nëpërmjet ngritjes së shumë institucioneve dhe instrumenteve menaxhuese dhe financiare për të siguruar zbatimin efektiv të saj. Pjesëmarrja qytetare është gjithashtu një element kyç dhe një prioritet i kësaj politike. Më poshtë po renditim Strategjitë në nivel Evropian të lidhura ngushtë me zhvillimin dhe problemet e PDZRK.

Strategjia e BE-së për Zhvillim të Qëndrueshëm është miratuar fillimisht në Këshillin Evropian të Goteborgut në vitin 2001 dhe është rishikuar në vitin 2005, plotësuar nga parimi i integritetit të dimensionit mjedisor në të gjitha politikat e BE-së. Strategjia e rishikuar përmbankatër objektiva kryesore:

I. Mbrojtjen mjedisore;

²⁸ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52009DC0400&from=EN> Sustainable Development Strategy of the European Union (EU SDS)

²⁹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32001L0042&from=EN>

- II. E drejta sociale dhe bashkëveprimi;
- III. Prosperiteti ekonomik;
- IV. Pranimin e përgjegjësisë tona ndërkombëtare.

Sfidat kyçe janë evidentuar, për të cilat janë propozuar një seri objektivash të përgjithshme specifike, veprime dhe objektiva funksional:

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	Objekti Përgjithshëm
Ndryshimet klimatike dhe energjia e pastër	Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe shpenzimet e lidhura me të si dhe impaktet negative sociale dhe mjedisore
Transport i qëndrueshëm	Sigurimi se sistemet e transportit plotësojnë nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë, duke minimizuar ndikimet negative në shoqëri, në ekonomi dhe në mjedis.
Prodhim dhe konsum i qëndrueshëm	Promovimi i metodave të prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm.
Konservimi dhe menaxhimi i pasurive natyrore	Përmirësimi i menaxhimit për të shmangur mbi-shfrytëzimin e burimeve natyrore, duke njohur vlerën e shërbimeve të ekosistemit.
Shëndeti publik	Promovimi për shëndet të mirë publik dhe përmirësimin e mbrojtjes kundër rreziqeve shëndetësore.
Përfshirja sociale, Demografia dhe emigracioni	Krijimi i një shoqërie sociale gjithëpërfshirëse, duke marrë në konsideratë solidaritetin midis dhe brenda brezave dhe sigurimin / përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve si parakusht për mirëqenien individuale të vazhdueshme.
Varfëria globale dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm	Të promovojë në mënyrë aktive në mbarë botën zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurojë që politikat e brendshme dhe të jashtme të BE-së të jenë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm global dhe angazhimet e saj ndërkombëtare

V.2 OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË NIVEL KOMBËTAR

V.2.1 Objektivat Kombëtare të Mjedisit

Qeveria Shqiptare ka hartuar dhe miratuar paketën e plotë të Ligjeve për mbrojtjen e Mjedisit të cilët janë përgatitur edhe duke konsideruar përafrimin e kuadrit ligjor të lidhur me mjedisin me atë të BE-së si dhe mbrojtjen e tij. Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2013-2020 dhe draft-Strategjia Kombëtare për Mjedisin 2015-2025 janë dokumentet të rëndësishme që përcaktojnë drejtimit kryesor të politikave mjedisore që do të ndiqen nga institucionet ligj-zbatuese në harkun kohor të përcaktuar. Këto politika të cilat janë të domosdoshme për ruajtjen dhe

përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës duke i siguruar kësaj të fundit standarte të njejta me ato evropiane.

V.2.2 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020

Dokumenti liston sfidat kryesore me të cilat përballet sektori, përfshi zbatimin e standardeve, cilësinë e shërbimeve dhe faciliteteve turistike, zhvillimin e produkteve turistike, mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimin efektiv mes aktorëve që janë apo mund të ishin pjesë përbërëse e industrisë së turizmit.

Ndër objektivat specifike përfshihen: (1) nevoja për një integrim më të madh të planfikimit të turizmit dhe destinacioneve turistike (2) zhvillimi i një mjedisi më të favorshëm ligjor dhe institucional për përthithjen e investitorëve të vendas dhe të huaj privatë; (3) nevoja për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe strategjike në lidhje me zhvillimin e turizmit në Shqipëri, për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe sigurimin e të ardhurave dhe mundësive të punësimit; dhe (4) nevoja për miratimin dhe zbatimin e “Strategjisë ndërsektoriale kombëtare të turizmit”.

V.2.3 Objektivat Kombëtarë për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit

Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2018 – 2022 (2018) përcakton dy objektiva strategjike për turizmin.

- I. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në vend për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe punësimin, nëpërmjet rritjes së qëndrimeve për ndërkombëtarët dhe rritjes modeste të emigrantëve dhe shqiptarëve etnikë; rritjes së kontributit direkt të turizmit në PBB; dhe rritjes së kontributit direkt të turizmit në punësim
- II. Krijimi i një modeli të integruar të turizmit, me përmasa kulturore, natyrore dhe bregdetare nëpërmjet zhvillimit të një strategjie "Branding Albania" me një logo dhe slogan të unifikuar për investimet në turizëm; miratimit dhe zbatimit të “Strategjisë kombëtare për zhvillimin e turizmit”; zhvillimit dhe zbatimit të një Planit kombëtar për zhvillimin e turizmit, të integruar me Planin e Përgjithshëm të Territorit Kombëtar; dhe krijimit të produkteve të reja kulturore, natyrore dhe të turizmit bregdetar.

Parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit

- Procesi i zhvillimit duhet të jetë i qëndrueshëm dhe objektivi ekonomik duhet balancuar me mbrojtjen e mjedisit, kulturës dhe mirëqenies së komunitetit;
- Zhvillimi i turizmit do të bazohet dhe mbështetë mbrojtjen e mjedisit, përfshirë burimet natyrore, ekosistemet, peizazhet, biodiversitetin etj. dhe, në disa zona, edhe do të mbështetet nga përmirësimi i mjedisit ekzistues;
- Zhvillimi i turizmit do të sigurojë strukturat sociale dhe mirëqenien sociale të banorëve të destinacioneve turistike, të njerëzve që punojnë në këtë biznes dhe të gjithë shoqërisë;

- Zhvillimi i turizmit do të mbështesë mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, zakoneve dhe traditave kulturore;
- Burimet e turizmit do të inventarizohen, auditohen, mbrohen dhe përmirësohen;
- Gjithë projektet e reja për zhvillimin e turizmit do të vlerësohen paraprakisht dhe, paszbatimit, do të monitorohen për sa i takon ndikimit të tyre të mundshëm lidhur me kriterete mësipërme.

V.2.4 Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030

Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton orientimet kryesore të zhvillimit të turizmit bazuar në potencialet e territorit. Harta e potencialit turistik (Figura V-1 **Error! Reference source not found.**) brenda këtij Plani ilustron zona të cilat klasifikohen si Zona me Rëndësi Kombëtare për vlerat që kanë në planikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Një numër i konsiderueshëm i këtyre zonave rregullohet nga legjislacioni sektorial në fuqi, si p.sh: zonat e mbrojtura natyrore; burimet ujore dhe fashat e tyre mbrojtëse; zonat minerare; zonat industriale; zonat e trashëgimisë historike dhe kulturore; monumentet e kulturës; zonat dhe parqet arkeologjike; qendrat historike; brezi bregdetar, etj.

PPK-ja mbështet dhe fuqizon rëndësinë që kanë këto zona për interesin kombëtar duke zgjeruar territoret e shpallura në mbrojtje të një pjese të tyre, por edhe duke propozuar zona të reja, të cilat duhet të merren në mbrojtje në përputhje me procedura të përcaktuara në legjislacionin sektorial në fuqi. Në hartën e potencialit turistik detajohet lista e zonave me rëndësi kombëtare, të cilat kanë rëndësi specike për potencialin turistik të vendit.




Figura V-1: Zonat për zhvillimin me përparësi të zhvillimit turistik në Shqipëri (Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2019-2023)

V.2.5 Objektivat Ndërkombëtare për Biodiversitetin dhe Mbrojtjen e Natyrës

Strategjia Globale për Ruajtjen e Bimëve adreson sfidat e paraqitura nga kërcënimet ndaj diversitetit biologjik. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë është arritja e tre objektivave të Konventës së Larmisë Biologjike, veçanërisht për diversitetin e Bimëve, duke marrë parasysh Nënin 8 (j) të Konventës dhe Protokollin e Kartagjenës për Biosigurinë.

Strategjia konsideron bimet në mjediset tokësore, ujin e brendshëm dhe mjediset detare. Për më tepër, Strategjia zbatohet për tre nivelet kryesore të diversitetit biologjik siç njihet nga Konventa, pra diversiteti gjenetik, llojor dhe shoqerimeve të lidhura me habitatet dhe ekosistemet e tyre shoqëruese.

Zbatimi i Strategjisë duhet të konsiderohet brenda kornizës më të gjerë të Planit Strategjik për Biodiversitetin 2021-2030. Në mënyrë të ngjashme, mekanizmat e kërkuar për të mundësuar Palët, partnerët dhe palët e tjera të interesit për të zbatuar në mënyrë efektive Konventën dhe për të monitoruar progresin në zbatim sipas këtij Plani të ri Strategjik do të jenë gjithashtu të rëndësishëm për këtë Strategji.

Strategjia përbëhet nga pesë objektivat e mëposhtëm: (i) Diversiteti i bimëve kuptohet, dokumentohet dhe njihet mirë; (ii) Diversiteti i bimëve ruhet në mënyrë efektive; (iii) Diversiteti i bimëve përdoret në mënyrë të qëndrueshme dhe të barabartë; (iv) Promovohet edukimi dhe ndërgjegjësimi për larminë e bimëve, rolin e saj në jetesën e qëndrueshme dhe rëndësinë për të gjithë jetën në Tokë; (v) Janë zhvilluar kapacitetet dhe angazhimi publik i nevojshëm për zbatimin e Strategjisë.

V.2.6 Objektivat e BE-së për Biodiversitetin dhe Mbrojtjen e Natyrës

Strategjia e Biodiversitetit të BE-së për 2030. Komisioni Evropian ka miratuar Strategjinë e re të Biodiversitetit të BE-së për 2030 dhe një Plan Veprimi shoqërues - një plan gjithëpërfshirës, ambicioz, afatgjatë për mbrojtjen e natyrës dhe ndalimin e degradimit të ekosistemeve. Ai synon të vendosë biodiversitetin e Evropës në një rrugë drejt rimëkëmbjes deri në vitin 2030 me përfitime për njerëzit, klimën dhe planetin. Ai synon të ndërtojë qëndrueshmërinë e shoqërive tona ndaj kërcënimeve në të ardhmen siç janë ndikimet e ndryshimit të klimës, zjarret në pyje, pasiguria ushqimore ose shpërthimet e sëmundjeve, duke përfshirë mbrojtjen e jetës së egër dhe luftimin e tregtisë së paligjshme të kafshëve të egra. Një pjesë thelbësore e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, Strategjia e Biodiversitetit do të mbështesë gjithashtu një rikuperim të gjellbër pas pandemisë COVID-19.

V.2.7 Objektivat Kombëtare për Biodiversitetin dhe Mbrojtjen e Natyrës

Për të arritur objektivin e përgjithshëm të ruajtjes së natyrës në vendin tone janë identifikuar prioritetet, qëllimet, dhe objektivat specifike kombëtare të biodiversitetit.

1. Deri në vitin 2020, të sigurohet përafrimi dhe zbatimi i acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes natyrore.

2. Deri në fund të vitit 2015, të ketë një dokument strategjik për biodiversitetin (DPSMB) të rishikuar dhe të miratuar - në përputhje me objektivin e Aichi 17;

3. Deri në vitin 2020, të krijohet një objektiv i ruajtjes prej 17 % të zonave ujore tokësore dhe në brendësi dhe 5% e zonave detare, bregdetare. Krijimi i Rrjetit Kombëtar ekologjik i Shqipërisë, si një pjesë integrale e Rrjetit Ekologjik Pan-Evropian (PEEN) - në përputhje me objektivin e Aichi 11;

4. Të rehabilitohen të paktën 15 % e zonave të degraduara përmes aktiviteteve konservuese dhe restauruese - në përputhje me objektivat e biodiversitetit Aichi - ky veprim do të arrihet përmes zbatimit të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe përmes zbatimit të planeve të veprimit për llojet në veçanti dhe habitatet;

5. Bujqësi dhe pylltari më të qëndrueshme në përputhje me objektivat e biodiversitetit;

6. Zbatimi i protokollit Nagoya për aksesin dhe ndarjen e përfitimit të resurseve gjenetike dhe përfitimet që lindin nga përdorimi i tyre - në përputhje me objektivin e Aichi 16;
7. Ndërgjegjësimi mbi biodiversitetin - në përputhje me objektivin Aichi 1.

Objektiva të tjera sektoriale strategjike për mbrojtjen e natyrës janë: (i) Adresimi i shkaqeve të humbjes së biodiversitetit; (ii) Ulja e presioneve të drejtpërdrejta mbi biodiversitetin dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm; (iii) Rritja e zbatimit përmes planifikimit me pjesëmarrje, menaxhimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve; (iv) Rritja e përfitimeve për të gjithë, nga biodiversitet dhe shërbimet e ekosistemit; (v) Përmirësimi i statusit të biodiversitetit duke ruajtur ekosistemet, llojet dhe diversitetin gjenetik. Nëntë objektivat e biodiversitetit kombëtar, të grupuara në katër prioritete që përfshijnë hapat e nevojshëm drejt objektivave të 2020. Ata kanë për qëllim arritjen e objektivit të përgjithshëm të Strategjisë dhe për të kontribuar në vizionin e tij.

V.2.8 Objektivat Ndërkombëtare për Mbetjet

Kombet e Bashkuara pranojnë që zhvillimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm urban janë thelbësore për cilësinë e jetës së njerëzve. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe ujërave të zeza janë objekt i Kapitullit 21 të Agjendës 21 në Kombet e Bashkuara “*Transformojnë Botën Tonë*”: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Siç është konsideruar në Kapitullin 21, mbetjet e ngurta përfshijnë të gjitha mbetjet shtëpiake dhe mbetjet jo të rrezikshme siç janë mbetjet tregtare dhe institucionale, fshirjet e rrugëve dhe mbetjet e ndërtimit. Mbetjet e rrezikshme shpesh përzihen me mbetje të tjera, duke paraqitur sfida të veçanta për menaxhimin. Ndaj kërkon vëmendje prioritare për parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin, zhvillimin e mjediseve të asgjësimit ekokompatibël, përfshirë teknologjinë për të shndërruar mbetjet në energji. Objektivat e BE-së për Mbetjet

Direktiva Korniz e Mbetjeve 2008/98/KE³⁰ në lidhje me mbetjet vendos masa për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut duke shmangur ose zvogëluar prodhimin e mbetjeve, efektet negative të prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve, zvogëlimin e efekteve të përgjithshme të përdorimit të burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të tyre, të cilat janë elemente themelore për kalimin në një ekonomi qarkulluese dhe për të siguruar konkurrencën afatgjatë. Ajo shpjegon kur mbetjet pushojnë së qënuri mbetje dhe bëhen një lëndë e parë dhe si të bëhet dallimi midis mbetjeve dhe nënprodukteve. Direktiva përfshin masat e nevojshme për të siguruar që administrimi i mbetjeve të kryhet pa dëmtuar shëndetin e njeriut, pa dëmtuar mjedisin dhe, në veçanti:

- a) pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën ose faunën;
- b) pa shkaktuar shqetësime nga zhurmat apo aromat; dhe
- c) pa dëmtuar peizazhin ose vendet me interes të veçantë.

³⁰<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:02008L0098-20180705&from=EN>

Direktiva prezanton parimin “ndotësi pagan” dhe “përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit”. Ajo përfshin dispozita për mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e vajrave dhe përfshin dy objektiva të reja riciklimi dhe rikuperimi: 50% e mbetjeve të disa materialeve të mbetjeve familjare dhe origjina të tjera të ngjashme me mbetjet familjare përgatitet për ripërdorim dhe riciklim, dhe 70% e mbetjeve të ndërtimit dhe inerte përgatitet për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim tjetër. Masave do të jetë prishja e lidhjes midis rritjes ekonomike dhe ndikimeve mjedisore që lidhen me gjenerimin e mbetjeve.

V.2.9 Objektivat Kombëtarë për Mbetjet

Legjislacioni shqiptar, në lidhje me mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti, ka ecur përpara si rezultat i transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e vendit. Vendi ka bërë progres të konsiderueshëm në përafrimin ligjor të kryer gjatë viteve të fundit. Kuadri është përforcuar dhe bashkërendimi i politikave në nivel qendror është përmirësuar. Qeveria Shqiptare ka konsideruar çështjen e mbetjeve, si një ndër gjashtë prioritetet e programit analitik, duke i dhënë rëndësi të lartë trajtimit dhe depozitimit fundor të mbetjeve të ngurta urbane. Në përputhje me politikat e Qeverisë Shqiptare për garantimin e një mjedisi të pastër e të shëndetshëm, shumë prej burimeve njerëzore dhe financiare të qeverisë i janë dedikuar zhvillimit të një kuadri të mirë ligjor, bazuar në transpozimin e legjislacionit të BE-së për fushën e mbetjeve.

Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar. Synon të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin dhe të sigurojë një menaxhim të shëndoshë mjedisor të mbetjeve përmes menaxhimit të integruar. Ligji përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efikasitetit të këtij përdorimi.

Bazuar tek Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, janë parashikuar objektivat strategjike për sektorin e mbetjeve, të cilat përfshijnë si më poshtë vijon:

1. Sigurimin e manaxhimit gjithëpërfshirës dhe strategjik për manaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane, ku një pikë e rëndësishme do të jetë përditësimi dhe zbatimi i plotë i Strategjisë Kombëtare Ndër Sektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve, 2010-2025, dhe hartimi i master planit për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta.
2. Përmirësimi e performancës së përgjithshme së manaxhimit të mbetjeve, deri në vitin 2020 përmes, për shembull, rritjes së sasisë së mbetjeve të grumbulluara dhe të asgjësuara në venddepozitime, rritjes së sasisë së mbetjeve që shkon në impiantet e riciklimit dhe kompostimit.
3. Përmirësimin e llogaridhënies për menaxhimin e mbetjeve.

Në mënyrë që të ofrohet një zgjidhje e qëndrueshme për këtë problem dhe të rritet niveli i kontrollit në depozitimin e mbetjeve, është miratuar VKM nr. 645, datë 14.09.2016

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të aksionit “Të Pastrojmë Shqipërinë që Duam”, në bashkëpunim me Pushtetin Vendor dhe me Prefekturat, nisur në periudhën shkurt 2018, ka identifikuar të gjithë venddepozitimet ekzistuese të mbetjeve në të gjithë vendin tonë dhe ka vlerësuar për rehabilitim një venddepozitim për çdo bashki për një periudhë 5-10 vjeçare.

V.2.10 Objektivat Ndërkombëtare për Planifikimin e Territorit

Objektivat kryesore që Shqipëria kërkon të arrijë në planifikimin e territorit janë: Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), të pranuar nga përfaqësuesit e 189 vendeve në Konferencën e OKB-së të vitit 2000, dhe synimeve të përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillim të Qëndrueshëm (SBZHQ) në Johaneshburg. Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johaneshburg, 2002) ishte rezultat i një serie konferencash, duke përfshirë Konferencën e Stokholmit mbi Mjedisin në vitin 1972 dhe Konferencën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin në vitin 1992 - e cila paraqiti parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjatë takimeve të mëvonëshme kishin të benin me kanalizimet, rritja e rezervave të peshkut dhe ngritja e një rrjeti global për mbrojtjen e zonave bregdetare, sa me shpejt të jetë e mundur.

V.2.11 Objektivat e BE-së për Planifikimin e Territorit

Zhvillimi i qëndrueshmë karakterizon çdo direktive të BE për rritjen e mirëqënies dhe mbrojtjen e mjedisit por parimet dhe objektivat e planifikimi i territorit përfshihen esencialisht në atë që konsiderohet si Karta e Leipzigut për Qytete të Qëndrueshme Evropiane. Kjo marrëveshje është të nxisë shtetet anëtarët BE të promovojnë konsultimet publike për integrimin e parimeve dhe strategjive të "zhvillimit të integruar urban" në politikat e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe lokal. Ajo stimulon krijimin e qeverisjes përkatese dhe masave zbatuese për promovimin e organizimit të balancuar territorial, të bazuar në njëstrukturë evropiane policentrite urbane. Parimet udhëzueset “Kartës” për zhvillimin e qëndrueshëm urban janë:

- Promovimin e politikave " urbane për zhvillimin e integruar";
- Krijimin e hapësirave publike të cilësisë së lartë;
- Modernizimin e rrjetit të infrastrukturës dhe përmirësimin e efciences mjedisore;
- Futja e politikave pro-aktive të rinovimit dhe arsimimit.

V.2.12 Objektivat Kombëtare për Planifikimin e Territorit

Ligji 107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” krijon sistemin e planifikimit territorial të Shqipërisë nëpërmjet krijimit të dy institucioneve, si dhe instrumenteve dhe procedurave që karakterizojnë praktikën bashkëkohore të planifikimit Evropian dhe sistemit të menaxhimit të tokës. Kompetencat e planifikimit të territorit janë ndarë midis autoriteteve të planifikimit kombëtar dhe lokale. Bazuar në këtë kuadër në të gjithë territorin e Shqipërisë është pajisur me plane lokale që duhet të mbështesin synimet e mëposhtme:

- Të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- Të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për;
- Të mbrojë burimet natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
- Të mundësojë krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë sëbanimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike tëpërshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale ekulturore, lehtësimit të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, tëtransportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura;
- Të garantojë kushte të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
- Të nxitë zhvillim të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve, dhe;
- Të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas legjislacionit mjedisor në fuqi.

V.2.13 Objektivat në Ndërkombëtar për tokën

Sipas Dokumentit të Udhëzimeve Vullnetare për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Tokës: "Menaxhimi i tokës është i qëndrueshëm nëse shërbimet mbështetëse, siguruese, rregulluese dhe kulturore të siguruara nga toka mirëmbahen ose përmirësohen pa dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme as funksionet e tokës që mundësojnë ato shërbime ose biodiversiteti. Bilanci midis shërbimeve mbështetëse dhe siguruese për prodhimin e bimëve dhe shërbimeve rregulluese që toka ofron për cilësinë e ujit dhe disponueshmërinë dhe për përbërjen atmosferike të gazrave serrë është një shqetësim i veçantë".

V.2.14 Objektivat në BE për tokën

Direktiva 2008/98/EC për mbetjet, Direktiva 2006/12/EC për mbetjet. Qëllimi thelbësor i të gjitha rregulloreve mbi mbetjet është mbrojtja e shëndetit të njerezve dhe e mjedisit nga efektet e dëmshme që shkaktohen nga grumbullimi, transportimi, perpunimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Direktiva 2008/98/KE (Direktiva Kuader mbi Mbetjet) parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe

rikuperimi. Mbetja është një burim i lëndës së parë (dhe jo diçka që duhet shpërbërë sa më lirë që të jetë e mundur), kështu që duhet të merren masa për të ripërdorur mbetjet sa më shumë të jetë e mundur.

V.2.15 Objektivat Kombëtar për tokën

Transpozuar i Direktivës 2008/98/EC për mbetjet, Direktivës 2006/12/EC në legjislacionin shqiptar si VKM nr. 175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjise kombëtare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025”. Përsa i përket riciklimit, SKZHI-II paraqet një objektiv mjedisorë që është “55% e masës totale të mbetjeve të ripërdoret apo riciklohet, deri në 2020”.

V.2.16 Objektivat në Ndërkombëtar për Ujin

V.2.16.1 OBSH

OBSH angazhon institucionet që kryejnë programet e certifikimit kombëtar, të qeverisjes vendore ose private (të palëve të treta të auditimit) që të kenë në konsideratë një numër objektivash të mundshëm:

- certifikimi i produkteve për të siguruar që përdorimi i tyre nuk kërcënon sigurinë e përdoruesit ose publikut të gjerë, të tilla si duke shkaktuar ndotjen e ujit të pijshëm me substanca toksike, substanca që mund të ndikojnë në pranueshmërinë e konsumatorit ose substanca që mbështesin rritjen e mikroorganizmave;
- testimi i produktit, për të shmangur rritimin në nivele lokale ose para çdo prokurimi;
- sigurimi i cilësisë dhe gjendjes uniforme të produkteve;
- certifikimi dhe akreditimi i laboratorëve analitikë dhe laboratorë të tjerë të testimit; dhe
- kontrollin e materialeve dhe kimikateve të përdorura për trajtimin e ujit të pijshëm, përfshirë performancën e pajisjeve për përdorim shtëpiak.

Një hap i rëndësishëm në çdo procedurë certifikimi është vendosja e standardeve, të cilat duhet të formojnë bazën e vlerësimit të produkteve. Këto standarde duhet gjithashtu - sa të jetë e mundur - të përmbajnë kriteret për aprovim. Në procedurat për certifikim në aspektet teknike, këto standarde zakonisht zhvillohen në bashkëpunim me prodhuesit, agjencinë certifikuese dhe konsumatorët. Autoritetet kombëtare të shëndetit publik duhet të kenë përgjegjësi për zhvillimin e pjesëve të procesit të miratimit ose kriterëve që lidhen drejtpërdrejt me shëndetin publik.

V.2.17 Objektivat në BE për ujin

Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kuader e Ujit) (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”). Ajo synon në arritjen e objektivit strategjik të statusit të mirë ekologjik për ujërat në vitin 2015.

Direktiva 2008/56/EC që vendos kuadrin për veprimin e komunitetit në fushën e politikës mjedisorë të detit (Direktiva Kuader e Strategjise Detare). Shqipëria kish planifikuar ta adoptojë

plotësisht këtë strategji gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 përmes një VKM-je specifike “ëer përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë mjedisore Detare” por akoma e pa arritur. Direktiva përcakton kuadrin brenda se cilit vendet anetare duhet të marrin masat e nevojshme ‘për të arritur apo mbajtur një gjendje të mirë mjedisore në mjedisin detar’ deri në vitin 2020, në përputhje me këtë Direktive janë hartuar dhe zbatuar strategjite detare, me qëllim që të:

- mbrojnë mjedisin detar, parandalojnë degradimin e tij, apo, nese është e mundur, rivendosin ekosistemet detare në zonat e prekuara nga efektet e dëmshme;
- parandalojnë dhe pakesojnë ndërhyrjet në mjedisin detar me qëllim eliminimin gradual të ndotjes dhe kështu garantojnë se nuk ka pasoja të medha për biodiversitetin detar, ekosistemet detare dhe shëndetin e njeriut dhe se këto nuk janë të kercenuara.

Direktiva 2008/105/EC për standartet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave ujore (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujrat sipërfaq/sore”). Kjo Direktive përcakton standartet e cilësisë mjedisore për substancat prioritare dhe ndotësit e tjerë, sic përcaktohet në Direktiven 2000/60/EC me objektive arritjen e një gjëndjeje të mirë kimike të ujerave siperfaqesore dhe në përputhje me parashikimet dhe objektivat e Direktives 2000/60/EC mbi parandalimin e emetimit të substancave në uje, duke ndarë ujërat e zeza. VKM-ja që transpozon Direktiven 2008/105/EC në legjislacionin shqiptar përcakton normativa të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për vlerësimin e gjëndjes kimike të ujrave sipërfaqesore.

Direktiva 2006/7/EC për Menaxhimin e Cilësisë së Ujit për Larje (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”). Direktiva përcakton masat për të:

- a) monitoruar dhe klasifikuar sipas cilësisë ujin për larje;
- b) menaxhuar cilësinë e ujit për larje; dhe
- c) informuar publikun mbi cilësinë e ujit për larje.

Qëllimi (objektiva) i kësaj Direktive është ‘të ruaje, mbroje dhe përmirësoje cilësinë e mjedisit dhe të mbrojë shëndetin e njerëzve, duke plotësuar Direktiven 2000/60/EC’.

Direktiva e Keshillit 98/83/EC në lidhje me cilësinë e ujit të caktuar për konsumim njerëzor (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat siperfaqesore”). Direktiva e Keshillit 98/83/EC regullon cilësinë e ujit që përdoret për konsum nga njerëzit. Uji është i shëndetshëm dhe i paster nëse ai nuk përmban mikroorganizma, parazitë dhe çdo substance tjetër, të cilat në sasi apo përqëndrime të caktuara përbejnë një rrezik potencial për shëndetin e njerëzve. Objektiva e kësaj direktive është të mbroje shëndetin e njerëzve prej çdo efekti negativ apo ndotjeje të ujit që përdoret për konsum nga njerëzit, duke garantuar që uji të jetë i pastër dhe i shëndetshëm.

Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujerave nëntokesore nga ndotja dhe perkeqesimi (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat siperfaqesore”). Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujerave nëntokesore nga ndotja dhe përkeqësimi përcakton masa specifike për të parandaluar

dhe kontrolluar ndotjen e ujrave nëntokesore në përputhje me Direktivën 2000/60/EC. Këto masa kryesisht përfshijnë:

- kritere për vlerësimin e statusit kimik të ujit nëntokesor, dhe
- kritere për identifikimin dhe kthimin mbrapsht të tendencave të konsiderueshme dhe të qëndrueshme të rritjes, dhe për përcaktimin e pikënisjeve për tendencat e kundërta. Objektiva: 'Deri në vitin 2015 duhet të arrihet një status i mirë kimik i ujit nëntokesor'.

V.2.18 Objektivat Kombëtar për ujin

Shqipëria e ka përafuar pjesërisht këtë direktivë përmes: - Ligji nr. 9860, datë 21.01.2008 që amendon Ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999 "Për Ujitjen dhe Kullimin" - VKM nr. 835, datë 3.12.2004 "Për Planin Kombëtar të Emergjencave Civile" - VKM nr. 267 datë 07.05.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore". Direktiva ka përcaktuar negociatat ndërkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integritimin e qytetareve. Objektiva e direktivës së menaxhimit të rreziqeve nga përmbytjet është të reduktoje rreziqet dhe pasojat negative të përmbytjeve në BE. Përsa i përket Shqipërisë, në fund të 2015, dhe gjatë tremujorit të parë të 2016, është parashikuar miratimi i dy VKM-ve:

- VKM "Për kushtet dhe kriteret e nevojshme për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore"

- VKM "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ujrat, planet e menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet". Kjo përpjekje do të garantojë përafrim të plotë të legjislacionit shqiptar me këtë direktivë.

VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore" ku qëllimi i saj është vendosja e normave të cilësisë së mjedisit të trupave ujorë sipërfaqësore, për substancat prioritare dhe ndotës të tjerë, me qëllim arritjen e statusit të mirë kimik të ujërave sipërfaqësorë dhe në përputhje me objektivat mjedisore, sipas nënit 25 të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim, drafti i 2-te, 2015 - 2020

Strategjia e dytë **Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim** (SKZHI-II) paraqet vizionin e Shqipërisë për zhvillimin e saj social, demokratik dhe ekonomik për periudhën 2015-2020, si dhe aspiratën për integritimin evropian. SKZHI-II shpjegon se si do të arrihet ky vizion përmes politikave dhe strategjive të qeverisë, duke synuar në:

- Shndërrimin e Shqipërisë në një vend të denjë për t'u anetaresuar në Bashkimin Evropian,
- Arritjen e standarteve që i shërbejnë qytetareve, rritjes së mirëqënies së tyre dhe garantimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, dhe
- Hartimit të politikave që nxitin konkurrueshmërinë dhe prosperitetin ekonomik në Shqipëri si dhe krahasuar me vendet e rajonit dhe më gjërë.

V.2.19 Objektivat Ndërkombëtare për Ndryshimet Klimatik

Konferenca e Parisit (2015) theksoi se akoma është e mundur sot që përmes politikave dhepërdorimit të teknologjive të reja, ndryshimit të sjelljes ndaj mjedisit do mund të kufizojmë rritjen globale mesatare të temperaturës me 2 gradë celsius në raport meperiudhën e paraindustrializimit dhe se ndryshimet teknologjike dhe ato institucionale do të krijojnë mundësi që ngrohja globale të mos e kalojë këtë vlerë prag. Për këtë arsye duhet adresuar problemi i reduktimit të shkarkimeve duke e integruar objektivat dhe procesin e vendimmarrjes në një numër nivelesh:

- Qeverisje – në mënyrë të veçantë në strategjitë për energjinë, ekonominë dhe transportet për tëpërfshirë hapa për kufizimin e shkarkimeve.
- Industri dhe tregti –të inkurajohen për të qenë efektive në energji dhe në reduktimin e shkarkimeve.
- Individët- të inkurajohen për ta konsideruar si kriter në veprimet dhe blerjet e tyre çështjen eefektivitetit të energjisë.

Masat që duhen të ndërmerren do të duhet të shoqërohen nga instrumente ekonomike nësejanë efektive. Në mënyrë të veçantë janë të specifikuara masat e mëposhtme:

- Futja e taksës së Karbonit, të ardhurat e së cilës do të futen në Fondin e Mjedisit
- Fushata të vazhdueshme për reduktimin e numrit të lidhjeve të paautorizuara në rrjetin elektrik (nëse konsumatori nuk paguajnë atëherë nuk mund të ketë stimuj për reduktimin e përdorimit të energjisë).
- Zhvillimi dhe publikimi i Strategjisë afatgjate të Çmimeve të Energjisë, duke treguar tendencën e çmimeve të energjisë në një afat të mesëm - kjo do të publikohet që konsumatorët të kuptojnë përfitimet e investimeve në pajisje dhe në aktivitete duke hequr subvencionimet që ekzistojnë midis sektorëve shtëpiakë dhe jo shtëpiakë.

V.2.20 Objektivat e BE-së për Ndryshimet Klimatike

Me anë të kornizës së saj të klimës dhe energjisë 2030, e cila gjithashtu përfaqëson angazhimin e saj në bazë të Marrëveshjes së Parisit, BE-ja është angazhuar për qëllimet e mëposhtme që do të arrihen deri në vitin 2030:

- ulja e emetimeve të GES me të paktën 40% nën nivelet e vitit 1990;
- përmirësimi i energjisë efikasitetin me 32.5%, dhe rritjen e përqindjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë në 32% të konsumit përfundimtar.

Kuadri 2030 vjen si vijim i synimeve të vendosura në 2007 nga udhëheqësit e BE-së për vitin 2020: një ulje prej 20% e emetimeve të GES, një rritje prej 20% e pjesës së energjisë së rinovueshme në energjinë finale konsumi, dhe një ulje prej 20% e konsumit total të energjisë primare të BE (të gjitha krahasuar me vitin 1990), të gjitha të përkthyer në masa ligjore detyruese.

V.2.21 Objektivat Kombëtare për Ndryshimet Klimatike

Në Konventen Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, në Protokollin e Kiotos, Shqipëria nuk ka detyrime tëpercaktuara për të reduktuar shkarkimet e gazeve serrë. Në takimet e paleve të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) të zhvilluara në Kopenhagen COP 15, Kankun COP16 dhe në Durban, Shqipëria, si Palë në KKKBNK dhe Protokollit të Kiotos ka mbështetur qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar për të zbutur ndryshimet klimatike.

Së fundi Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, Qëllimi i të cilit është: a) të kontribuojë në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serë; b) të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, me synim zbutjen e efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe c) të kontribuojë në përpjekjet globale ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës.

Objektivat dhe parimet e Ligjit përmbledhen në: a) zvogëlimi i shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë në nivel kombëtar, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare; b) rritja e aftësisë për t’u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike, në nivel kombëtar, qendror e vendor; c) ruajtja dhe rritja e përthithësve dhe rezervuarëve të gazeve me efekt serrë; ç) nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe konkurrencës, duke përfshirë edhe diversifikimin ekonomik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore; d) pjesëmarrja graduale në zbatimin e politikës së ndryshimeve klimatike të Bashkimit Evropian.

V.2.22 Objektivat në Ndërkombëtar për Ajrin

“Luftimi i ndotjes së ajrit: një përparësi për shëndetin, klimën dhe zhvillimin e qëndrueshëm” kjo ishte moto e disave prej organizatave botërore të mjedisit të mbledhura sëbashku kundër ndotjes së ajrit.

Me qëllim që të adresohen në mënyrë më efikase sfidat me të cilat përballen vendet dhe qytetet për shkak të ndotjes së ajrit, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara (Mjedisi i KB) dhe Organizata Botërore Meteorologjike (WMO), me mbështetjen e Koalicionit të Klimës dhe Ajrit të Pastër (CCAC), po bashkojnë forcat për të ofruar shërbimet e tyre në një mënyrë të integruar dhe plotësuese për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe si pasojë, shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve në të gjithë botën. Një bashkëpunim midis OBSH, Mjedisi i KB dhe WMO, i mbështetur nga CCAC, kap pikat e forta dhe ekspertizën e organizatave të ndryshme për të monitoruar më mirë cilësinë e ajrit dhe ndikimet e tij në shëndet dhe mjedis dhe për të siguruar mjete të përmirësuar për politikëbërësit dhe praktikuesit për të zbatuar efektivisht ndërhyrjet dhe vërtetoni rezultatet e tyre.

Për më tepër, KB Environment, OBSH dhe WMO po mbështesin gjithashtu punë të tjera kritike tematike si si agjenci individuale ashtu edhe së bashku. Shembujt përfshijnë: Vlerësimi i ndikimeve ekonomike të ndotjes së ajrit; Legjislacioni dhe rregullimi i cilësisë së ajrit; Veprimi i

qeverisë lokale për ndotjen e ajrit; Stuhi rëre dhe pluhuri; dhe djegia e biomasës duke përfshirë zjarret e torfe që çojnë në episode të mjegullt³¹.

V.2.23 Objektivat në BE për Ajrin

Direktiva 2008/50/EC mbi cilesine e ajrit dhe për ajër me të paster për Evropën. Direktiva 2004/107/CE lidhur me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hirdokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit.

Direktiva 2008/50/EC përcakton masat që synojnë si vijon: 1. Përkufizimin dhe përcaktimin e objektivave për cilësi të ajrit të ambientit hartuar në mënyrë të tillë që shmangin, parandalojnë apo reduktojnë efektet e dëmshme në shëndetin e njerezve dhe në mjedisin në teresi; 2. Përlllogaritjen e cilesisë së ajrit të ambientit në Vëndet Anëtare me bazë metoda dhe kriteret të përbashkëta; 3. Sigurimin e informacionit mbi cilësinë e ajrit të ambientit në mënyrë që të ndihmojë luftën kundër ndotjes dhe shqetësimit të ajrit dhe të monitorojë prirjet dhe përmirësimet që vijnë si rezultat i masave kombëtare dhe të Komunitetit; 4. Garantimin se informacioni i tillë mbi cilësinë e ajrit të ambientit do t'i bëhet i disponueshëm publikut; 5. Mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit atje ku është e mire dhe përmirësimin e saj në raste të tjera; 6. Nxitjen e rritjes së bashkëpunimit midis Vëndeve Anetare për reduktimin e ndotjes së ajrit.

Objektivat Kombëtar për Ajrin

Shqipëria i ka përafruar plotësisht Direktivën 2008/50/EC dhe Direktivën 2004/107/CE përmes: - Ligjit nr. 162/2014, datë 12.04.2014 " për mbrojtjen e cilesisë së ajrit të mjedisit " dhe - VKM nr. 594, datë 10.09.2014 " për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit "

Objekti i Ligjit nr. 162/2014, datë 12.04.2014 " për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit " është:

- a) përcaktimi dhe vendosja e vlerave kufi, pragut të alarmit, pragut të informacionit dhe vlerave të synuara për disa lloje ndotësish në ajër, të listuar në aneksin 2, bashkëlidhur këtij ligji;
- b) përcaktimi dhe vendosja e objektivave për cilësinë e ajrit në mjedis që synojnë të shmangin, parandalojnë ose pakësojnë efektet e dëmshme në shëndetin publik dhe mjedisin në tërësi;
- c) vlerësimi i cilësisë së ajrit në mjedis, në bazë të metodave dhe kriterëve europiane;
- c) marrja e informacionit mbi cilësinë e ajrit në mjedis, duke synuar parandalimin e ndotjes së tij dhe pasojave që lidhen me të, monitorimin e tendencave afatgjata, si dhe përmirësimin e tij nëpërmjet masave kombëtare e ndërkombëtare;
- d) bërja e mundshme për publikun e informacionit mbi cilësinë e ajrit në mjedis;
- dh) ruajtja e cilësisë së ajrit në mjedis aty ku kjo është e mirë dhe përmirësimi i saj në raste të tjera, përmes kufizimit të shkarkimeve nga burime të lëvizshme ose jo;
- e) promovimi i bashkëpunimit me vendet e tjera për pakësimin e ndotjes së ajrit.

³¹ <https://www.who.int/phe/delivering-air-quality.pdf?ua=1>

VKM nr. 594, date 10.09.2014 " për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit " ka si objektiv t'i sigurojë të gjithë qytetarëve akses ndaj një ajri pa rreziqe serioze për shëndetin e tyre. Kjo strategji është bazuar në standarde që përfaqësojnë nivele të tilla që asnjë efekt shëndetësor serioz nuk do të ishte i pritshëm në një popullsi të marrë si e tërë dhe mbi standarde dhe principe të një legjislacioni më të mirë. Objektivat në këtë strategji synojnë afrimin e cilësisë së ajrit sa më afër këtyre standardeve.

Objektivi afatgjatë i qeverisë shqiptare, në linjë me politikat1 europiane mbi ndotjen e ajrit, është të mënjanojë të gjitha nivelet kritike, si dhe tejkalimet e ngarkesave

V.2.24 Objektivat në Ndërkombëtar për Zhurmat

Udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për zhurmën mjedisore³² kanë si qëllim kryesor të tyre të ofrojnë rekomandime për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga ekspozimi ndaj zhurmës mjedisore që gjenerohet nga burime të ndryshme: zhurma nga transporti (trafiku rrugor, hekurudha dhe avionët), zhurma e turbinës së erës dhe zhurma e kohës së lirë. Këto udhëzime marrin në konsideratë veçmas ekspozimin në natyrë ndaj zhurmës mjedisore nga trafiku rrugor, trafikut hekurudhor, aeroplanëve, turbinave me erë, si dhe ekspozimi i jashtëm dhe i brendshëm gjatë aktiviteteve rekreative (të tilla si pjesëmarrja në klube nate, bare, klasa fitnesi, ngjarje sportive të drejtpërdrejta, koncerte ose lokale të muzikës live dhe duke dëgjuar muzikë me zë të lartë përmes pajisjeve personale të dëgjimit).

Tabela V-1: Rekomandimet sipas OBSH-së për zhurmën mjedisore nga aktivitete të ndryshme

Mjedisi	Lden (dB)	Lnight (dB)
Zhurma e trafikut rrugor	53 dB	45 dB
Zhurma hekurudhore	54 dB	44 dB
Zhurma e avionëve	45 dB	40 dB
Zhurma e turbinës së erës	45 dB	-

Për ekspozimin mesatar të zhurmës, udhëzimi rekomandon fuqimisht uljen e niveleve të zhurmës të prodhuara nga trafiku rrugor nën 53 decibel (dB) Lden, pasi zhurma e trafikut rrugor mbi këtë nivel shoqërohet me efekte të pafavorshme shëndetësore. Ndërsa, për ekspozimin e zhurmës gjatë natës, udhëzimi rekomandon fuqimisht zvogëlimin e niveleve të zhurmës të prodhuara nga trafiku rrugor gjatë kohës së natës nën 45 dB Lnight, pasi zhurma e trafikut rrugor gjatë natës mbi këtë nivel shoqërohet me efekte anësore në gjumë.

Për ekspozimin mesatar të zhurmës të prodhuara gjatë ditës nga avionët udhëzimi rekomandon fuqimisht zvogëlimin e niveleve të zhurmës nën 45 dB Lden, pasi zhurma e avionit mbi këtë nivel shoqërohet me efekte të pafavorshme shëndetësore. Për ekspozimin e zhurmës gjatë natës rekomandohet fuqimisht zvogëlimi i niveleve të zhurmës të prodhuara nga avionët

³²https://www.euro.who.int/__data/assets/pdf_file/0008/383921/noise-guidelines-eng.pdf?ua=1

gjatë kohës së natës nën 40 dB Lnight, pasi zhurma e avionëve gjatë natës mbi këtë nivel shoqërohet me efekte anësore në gjumë.

V.2.25 Objektivat e BE-së për Zhurmat

Në politikën e BE-së një nga objektivat që duhet të ndiqet në kontekstin e një niveli të lartë të shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit është mbrojtja nga ndotja akustike. Komisioni Evropian përcakton zhurmën mjedisore si një nga problemet më të mëdha mjedisore në Evropë. Koncepti i vlerësimit dhe menaxhimit të zhurmës mjedisore është prezantuar për herë të parë nga Direktiva 2002/49/KE³³ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit më 25 Qershor 2002 në lidhje me përcaktimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore, e ndryshuar. Ajo synon që të përcaktojë një qasje të përbashkët që synon të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë në mënyrë prioritare efektet e dëmshme, përfshirë bezdisjen, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore. Objektivat Kombëtar për Zhurmat

Përsa i përket politikave për zhurmën në mjedis, një nga prioritetet kryesore të MTM në këtë fushë është një hartë e zhurmave, vlerësimi i situatës lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për menaxhimin e zhurmave në mjedis dhe forcimi i zbatimit të legjislacionit në këtë fushë; përmbushja e detyrimit ligjor nga njësitë e qeverisjes vendore për hartimin e planeve lokale të veprimit për zhurmat, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të MTM, Nr. 01.datë 19.02.2018; forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës së ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare.

Ligji aktual i zhurmave Nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 39/2013 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, është i përfaruar në pjesën më të madhe të tij me direktivën kornizë të BE-së për zhurmat (Direktivës 2002/49/KE). Ky ligj përcakton rregullat kryesore në Shqipëri për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis dhe kërkesat për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit nga zhurmat, si të shmangen dhe parandalohen, zvogëlohen dhe zhduken efektet e dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë shqetësimet nga zhurma.

Në vitin 2011 Shqipëria miratoi Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 123, datë 17.02.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”. Plani kombëtar për menaxhimin e zhurmës në mjedis është një plan ndër-sektorial që krijon kornizën për të analizuar, planifikuar dhe zbatuar masat e nevojshme për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmës mjedisore me qëllim parandalimin e efekteve negative të ndotjes së zhurmës në mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Megjithëse burimet e zhurmës mund të jenë të ndryshme, plani i veprimit përqendrohet në zhurmën e shkaktuar nga transporti (rrugë, hekurudhë, ajër), sektori i mikpritjes (që rezulton nga muzika në bare, restorante, pub dhe diskoteka) dhe makineritë dhe pajisjet e vendosura në hapësirat publike.

³³<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:02002L0049-20200325&from=EN>

Sipas Udhezimit të Përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Shëndetësisë Nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, nivelet kufi të zhurmës për mjediset e zonave të banimit, (jashtë banesës, mjediset e brendshme të banesës), institucionet (arsimore, parashkollore e shëndetësore), zona me aktivitet social-ekonomik, mjedise urbane dhe parqet publike, të jenë sipas vlerave udhëzuese të OBSH, të dhëna më poshtë:

Tabela V-2: Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të caktuara

Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	LAmaz Fast (dB)
Zona banimi				
Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
	Bezdi (shqetësim) i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
Institucione				
Klasa mësimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmëri e bisedës, vështirësi në kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjatë mësimi	-
Dhomat e fjetjes në kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri i shkollës, vendet e lojërave në shkollë	Bezdi (shqetësim) - (burime të jashtëme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit natën Prishja e gjumit ditën dhe në mbrëmje	30	8	40
		30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim në pushim, çlodhje	# 1		
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/vit)	100	4	110
Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85 # 4	1	110

Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit) Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140#2 120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

Ku:

- LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.
- Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.
- LAmax Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën fast (e shpejtë)
- # 1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.
- # 2 = Presioni zanor maksimal (LAmax, fast) matur 100 mm larg veshit.
- # 3 = Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.
- # 4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë.

Urdhër Nr. 11 262, datë 27.11.2014 Për miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen e mjedisit nga zhurmat nga aviacioni civil”, e cila ka si qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga zhurmat e aviacionit civil, ku, sipas nënit 5 të së cilës, të gjithë avionët civil reaktiv subsonik të regjistruar në regjistrin e avionëve civilë të Republikës së Shqipërisë apo të regjistruar në shtete të tjera dhe që kanë destinacion aeroportet e Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë të pajisur me Certifikatën për Zhurmat, në përputhje me detyrimet ndërkombetare. Kjo rregullore përafron pjesërisht Direktivën Nr. 89/629/EEC e datës 4 Dhjetor 1989 mbi kufizimin e emetimeve të zhurmave nga avionët civil reaktiv subsonik, CELEX:31989L0629, OJL 363, 13.12.1989 dhe Direktivën Nr. 2006/93/EEC, e datës 12 Dhjetor 2006, mbi rregulloren e operimit të aeroplanëve që përfshihen në Pjesën II, Kapitulli 3, Volumi I Aneksit 16 të Konventes së Aviacionit Ndërkombëtar Civil, CELEX: 32006L0093, OJL 374/2, 76/12/2006.

KAPITULLI VI: VLERËSIM I EFEKTEVE TË PRITSHME MJEDISORË TË PLANIT TË PROPOZUAR DHE MASAT PËR PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE

VI.1 BAZA PËR PERGATITJEN E vlerëSIMIT MJEDISOR

VI.1.1 Percaktimi i Objektivave Mjedisore

Bazuar në analizen e detyrimeve të specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-se, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërië, situatës ekzistuese të mjedisit, dhe ndikimeve potenciale mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan Raporti i VSM-se përcakton komponëntet më të rëndësishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore si me poshtë:

➤ Toka: Objektiva mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qendrueshem të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva mjedisore 2 (OM 2): Ruajtja e mjedisit fizik dhe tërësisë së elementëve natyrorë të zonës nga erozioni/sedimentim.

➤ Ajri: Objektiva mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes se objektivave afatgjata për sasite vjetore të shkarkimeve të ndotesve, për të arritur perputhshmërinë me kufijtë maksimale të lejueshem nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

➤ Faktoret klimatike: Objektiva mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastruktures në pergjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

➤ Uji: Objektiva mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqësore, ujrë e njelmët, ujrë bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.

➤ Mjedis natyror dhe biodiversiteti: Objektiva mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteve me ndikime të konsiderueshme. Ruajtja e biodiversitetit dhe zhvillim i integruar i ekoturizmit në harmoni me zonimin e e zonës se pejzazhit të mbrojtur.

Objektiva mjedisore 8 (OM 8): Ruajtja e popullatave të zogjeve me rëndesi të veçante kombëtare dhe ndërkombetare nëpërmjet sigurimit të korridoreve komunikues dhe reduktimit të efekteve negative të Planit mbi to.

➤ Mbetjet: Objektiva mjedisore 9 (OM 9): Zhvillimi dhe aplikimi e skemës së menaxhimit të mbetjeve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes se riciklimit e ripërdorimit.

➤ Zhurma: Objektiva mjedisore 10 (OM 10): Reduktimi i ndotjes së zhurmes/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

➤ Popullsia dhe ekonomia lokale: Objektiva mjedisore 11 (OM 11): përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe levizshmërisë së qëndrueshme.

➤Trashegimia Kulturore: Objektiva mjedisore 12 (OM 12): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashegimise kulturore.

➤Peizazhi: Objektiva mjedisore 13 (OM 13): Garantimi i ruajtjes se peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombetar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilesi të lartë. Shpjegimi i përcaktimit të objektivave mjedisore jepet në seksionet në vij.

VI.1.2 Detyrimet e Specifikuara në Konventat e Ratifikuara dhe në Direktivat Respektive të BE-se, si dhe në Dokumentat Strategjike të Shqipërisë

Për të përcaktuar objektivat e rëndësishme specifike, janë përdorur detyrimet e specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentat strategjike të Shqipërisë. Lidhja mes sektoreve të mjedisit dhe objektivave mjedisorë si dhe dokumentat përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisorë është paraqitur në *Table VI-1*.

Table VI-1: Lidhja mes sektoreve të mjedisit dhe objektivave mjedisorë si dhe dokumentat perkates të planit

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
Strategjia tematike për Mbrojtjen e Tokës – COM(2006)231. Referenca ne Shqiperi gjendet në Ligjin nr. 10431 date 9.6.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit” (nëni 18) Ligji për mbrojtjen e tokës bujqësore 2014/2010.	Duhet marre në konsiderate pozitat mbi të cilat është bazuar hartimi i Direktives që përcakton kuadrin për mbrojtjen e tokës dhe amendon Direktiven 2004/35/EC. Strategjia merr në konsiderate një serë funksionesh, diversitetin dhe kompleksitetin e tokës si dhe njesere procesesh degradimi të cilave ajo (toka) u nënshtrohet. Objektivi strategjik është mbrojtja dhe shfrytëzimi i qendrueshem i tokës, bazuar në parimete mëposhtme udhezuese: - parandalimi i degradimit të metejshem dhe ruajtja e funksioneve të tokës kur tokapërdoret dhe kur funksionet e tokës shfrytëzohen, si dhe kur toka sherben si mjedis prites per efektet e aktivitetit të njeritu apo fenomeneve mjedisore; - Rikthimi i tokës se degraduar në një nivel funksionaliteti konsistent të pakten me ërdorimin aktual apo të synuar, duke pasur parasysh kostot e restaurimit të tokës.	Toka	OM1
Direktiva 2008/98/EC për mbetjet, përafruar plotësisht në legjislacionin shqipëtar me Ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe VKM	Qëllimi thelbësor i të gjitha rregulloreve mbi mbetjet është mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe e mjedisit nga efektet e demshme që shkaktohen nga grumbullimi, transportimi, perpunimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Direktiva 2008/98/KE (Direktiva Korniz mbi Mbetjet) parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe	Toka Mbetjet	OM 2 OM 8

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
nr. 175, date 19.1.2011 "Per miratimin e strategjise kombetare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombetar të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025"	administrimit mbi shendetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Mbetja është një burim i lendes se parë (dhe jo dicka që duhet shperbere sa me lire që të jetë e mundur), keshtu që duhet të merren masa për të ripërdorur mbetjet sa me shumë të jetë e mundur.		
Direktiva 2008/50/EC mbi cilesine e ajrit dhe për ajër me të paster për Evropën. Direktiva 2004/107/CE lidhur me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hirdokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. Shqiperia i ka perafuar plotesisht keto direktiva permes: - Ligjit nr. 162/2014, date 12.04.2014 " për mbrojtjen e cilësisë se ajrit të mjedisit " dhe - VKM nr. 594, date 10.09.2014 " për miratimin e Strategjise Kombetare të cilësisë se Ajrit "	Direktiva 2008/50/EC përcakton masat qe synojne si vijon: 1. Perkufizimin dhe përcaktimin e objektivave per cilesi te ajrit te ambientit hartuar ne mënyrë te tillë qe shmangin, parandalojne apo reduktojne efektet e demshme ne shendetin e njerezve dhe ne mjedisin ne teresi; 2. Perlllogaritjen e cilësisë se ajrit te ambientit ne Vendet Anetare me baze metoda dhe kriteret te perbashketa; 3. Sigurimin e informacionit mbi cilesine e ajrit te ambientit ne mënyrë qe te ndihmoje luften kunder ndotjes dhe shqetesimit te ajrit dhe te monitoroje prirjet dhe permiresimet qe vijne si rezultat i masave kombetare dhe te Komunitetit; 4. Garantimin se informacioni i tillë mbi cilesine e ajrit te ambientit do t'i behet i disponueshem publikut; 5. Mirembajtjen e cilësisë se ajrit atje ku eshte e mire dhe permiresimin e saj ne raste te tjera; 6. Nxitjen e rritjes se bashkepunimit midis Vendeve Anetare per reduktimin e ndotjes se ajrit. Objektivat e Direktives 2004/107/CE jane te: (a) te përcaktoje nje vlere te synuar per perqendrimin e arsenikut , kadmiumit , nikelit dhe benzo (a) pirenit ne ajrin e ambientit me qellim shmangien , parandalimin ose reduktimin e efekteve te demshme te arsenikut , kadmiumit , nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike ne shendetin e njeriut dhe ne mjedis si nje i tere; (b) te sigurojne, ne lidhje me arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike aromatike, qe cilesia e ajrit te ambientit eshte	Ajri	OM 3

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
	ruajtur atje ku ajo është e mirë dhe është permiresuar në raste të tjera; (c) të përcaktoje metodat e përbashketa dhe kriteret për vlerësimin e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe për depozitimin e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike; (d) të siguroje që informacioni i duhur mbi përqendrime të arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe mbi depozitimet e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike është marrë dhe të siguroje se ajo është vënë në dispozicion të publikut. SKZHI II përcakton objektivat për nivelet e emetimeve në ajër si më poshtë: për NO_x - 40 µ/m³, për PM₁₀ - 40 µ/m³, për PM_{2.5} - 25 g / m³ dhe SO₂ - 125 µ/ m³.		
Strategjia e BE për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike (COM (2013) 216 final).	Objektiva e përgjithshme e Strategjisë së BE për adaptimin është të kontribuojë në një Evropë me elastike ndaj klimës. Kjo do të thotë rritjen e punës përgatitore dhe të kapacitetit për t'ju përgjigjur ndikimeve nga ndryshimet klimatike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, duke zhvilluar një përafrim logjik dhe duke përmirësuar koordinimin.	Faktorët klimatike	OM 4
Vendimi 406/2009/EC për përpjekjet e Shteteve Anëtare të zvogelojnë emetimet e gazeve serë që t'i plotësojnë detyrimet e Komunitetit për zvogelimin e gazeve serë deri më 2020	Vendimi 406/2009/EC përcakton kontributin minimal të vendeve anëtare për të arritur detyrimin për zvogelimin e emetimit të gazeve 'serë' për periudhën nga 2013 deri në 2020 për emetimet e gazeve 'serë' që mbulohen nga ky vendim si dhe rregullat për arritjen e ketyre kontributeve dhe vlerësimin e tyre. Angazhimi për reduktimin e emetimeve të gazeve 'serë' i referohet: - emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në shtëpi dhe në sektorin e shërbimeve; - emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në sektorin e transportit;	Faktorët klimatike	OM 4

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
	- emetimeve nga përdorimi i lendeve djegese në ndermarrjet e vogla dhe të mesme dhe në sektorin e energjise; - emetimet që clirohen nga sektori i energjise; - emetimet nga proceset industriale; - përdorimi i tretesve dhe produkteve të tjere; - emetimet nga bujqësia; - emetimet nga administrimi i mbetjeve.		
Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kuader e Ujit) (transpozuar në legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Per përcaktimin e normave të cilësisë se mjedisit për ujërat siperfaqesore”)	Direktiva përcakton masat për arritjen e objektivit strategjik të statusit të mire ekologjik për ujërat në vitin 2015.	Uji	OM 5
Direktiva 2008/56/EC që vendos kuadrin për veprimin e komunitetit në fushen e politikës mjedisorë të detit (Direktiva Kuader e Strategjise Detare). Shqiperia planifikon ta adoptoje plotesisht këtë strategji gjatë tremujorit të funksit të vitit 2016 permes një VKM-je specifike “Per permbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjise mjedisorë Detare”.	Direktiva përcakton kuadrin brenda se cilit vendet anetare duhet të marrin masat e nevojshme ‘per të arritur apo mbajtur një gjendje të mire mjedisorë në mjedisin detar’ deri në vitin 2020. në perputhje me këtë	Uji	OM 5

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
Direktiva 2008/105/EC për standartet e cilësisë mjedisorë në fushën e politikave ujore (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqesore”)	Kjo Direktive përcakton standartet e cilësisë mjedisorë për substancat prioritare dhe ndotesit e tjere, sic përcaktohet në Direktiven 2000/60/EC me objekte arritjen e një gjendjeje të mirë kimike të ujerave sipërfaqesore dhe në përputhje me parashikimet dhe objektivat e Direktives 2000/60/EC mbi parandalimin e emetimit të substancave në ujë, duke ndare ujërat e zeza. VKM-ja që transponon Direktiven 2008/105/EC në legjislacionin shqiptar përcakton normat e detajuara dhe gjithëpërshirëse për vlerësimin e gjendjes kimike të ujerave sipërfaqesore.	Uji	OM 5
Direktiva 2006/7/EC për Menaxhimin e cilësisë së Ujit për Larje (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqesore”)	Direktiva përcakton masat për të: a) monitoruar dhe klasifikuar sipas cilësisë ujin për larje; b) menaxhuar cilësinë e ujit për larje; dhe c) informuar publikun mbi cilësinë e ujit për larje. Qëllimi (objektiva) i kësaj Direktive është ‘te ruaje, mbroje dhe përmirësoje cilësinë e mjedisit dhe të mbroje shëndetin e njerëzve, duke plotësuar Direktiven 2000/60/EC’.	Uji	OM 5
Direktiva e Keshillit 98/83/EC në lidhje me cilësinë e ujit të caktuar për konsumim njerëzor (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqesore”)	Direktiva e Keshillit 98/83/EC rregullon cilësinë e ujit që përdoret për konsum nga njerëzit. Uji është i shëndetshëm dhe i pastër nëse ai nuk përmban mikroorganizma, parazitë dhe çdo substancë tjetër, të cilat në sasi apo përqendrime të caktuara përbejnë një rrezik potencial për shëndetin e njerëzve. Objektiva e kësaj direktive është të mbroje shëndetin e njerëzve prej çdo efekti negativ apo ndotjeje të ujit që përdoret për konsum nga njerëzit, duke garantuar që uji të jetë i pastër dhe i shëndetshëm.	Uji	OM 5
Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujerave nëntokesore	Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujerave nëntokesore nga ndotja dhe përkeqësimi përcakton masa specifike për të parandaluar dhe	Uji	OM 5

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
nga ndotja dhe perkeqesimi (transpozuar në legjislacionin shqiptar permes VKM nr. 246, date 30.04.2014 “Per përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat siperfaqesore”)	kontrolluar ndotjen e ujerave nëntokesore në perputhje me Direktiven 2000/60/EC.		
Direktiva 2019/883/KE për mjediset e pritjes në porte të mbetjeve që gjenerohen nga anijet dhe tepricat e mbetura prej kargove. Shqiperia ka miratuar një rregullore respektive për këtë qellim.	Qëllimi i Direktives është të reduktoje shkarkimet në det të mbetjeve që gjenerohen nga anijet dhe tepricat e mbetura prej kargove, veçanërisht shkarkimet ilegale. Objektiva: ‘Forcimi i mbrojtjes së mjedisit detar duke përmirësuar disponibilitetin dhe përdorimin e mjediseve pritese në porte për mbetjet që gjenerohen nga anijet dhe tepricat e mbetura prej kargove’. Zbatimi i rregullores që transponon këtë Direktive në legjislacionin shqiptar kontribuon në arritjen e një gjendjeje të mire ekologjike për ujërat detare.	Uji	OM 5
Direktiva 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga permbytjet (Direktiva e Permbytjeve). Shqiperia e ka perafuar pjesërisht këtë direktive permes: - Ligji nr. 9860, date 21.01.2008 që amendon Ligjin nr. 8518, date 30.7.1999 “Per Ujitjen dhe Kullimin” - VKM nr. 835, date 3.12.2004 “Per Planin Kombëtar të Emergjencave Civile” - VKM nr. 267 date 07.05.2014 “Per	Direktiva ka përcaktuar negociatat nderkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga permbytjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integrimin e qytetareve. Objektiva e directives së menaxhimit të rreziqeve nga permbytjet është të reduktoje rreziqet dhe pasojat negative të permbytjeve në BE. Përsa i përket Shqipërisë, në fund të 2015, dhe gjatë tremujorit të parë të 2016, është parashikuar miratimi i dy VKM-ve: - VKM “Per kushtet dhe kriteret e nevojshme për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe perditesimin e Kadastres Kombetare të Burimeve Ujore” - VKM “Per permbytjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjise Kombetare për Ujërat, planet e menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe planet e menaxhimit të rrezikut nga permbytjet”	Uji	OM 5

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
miratimin e listes se substancave prioritare në mjediset ujore	Kjo përpjekje do të garantojë përafrim të plotë të legjislacionit shqiptar me këtë direktivë.		
Direktiva 2009/147/EC për mbrojtjen e zogjve të eger. Shqipëria e ka përafruar pjesërisht këtë direktivë, përmes ligjeve: - Ligji nr. 68/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar” - Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008; “Për mbrojtjen e faunës së eger” - Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për Gjuetinë”	Direktiva ofron një kornizë të plotë për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë zogjve të eger që ndodhen në BE. Direktiva udhëzon shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur popullacionin e të gjitha llojeve të zogjve të eger që ndodhen në shtetin e BE-së.	Mjedisi natyror	OM 6
Direktiva e Keshillit 92/43/EEC për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të flores e faunës së eger. Shqipëria e ka përafruar pjesërisht këtë direktivë përmes ligjeve: - Ligji nr. 68/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar”; - Ligji nr.9868, datë 4.2.2008. për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë.	Direktiva e habitateve kërkon që Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për të menjauar në zonat e veçanta të ruajtjes shkaterimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të specieve si dhe shqetësimin e specieve për të cilat janë përcaktuar zonat e Natura 2000, në rastet kur ky shqetësim është dukshëm i lidhur me objektivat e kësaj Direktive. Kjo dispozitë aplikohet për ZVM-te e propozuara, siç përcaktohet në mënyrë të përbashkët me procedurat dhe kriteret e direktivës së habitateve. SKZHI II përcakton si objektiva strategjike: - një rritje e synuar me 17% e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në gjithë territorin, përmes zgjerimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura;	Mjedisi natyror	OM 6

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" - Ligji nr. 10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger""; and - VKM nr. 866, date 10.12.2014 "Per miratimin e listes se habitateve natyrore, flores, faunes dhe zogjve me interes për komunitetin evropian"	- Garantimi i statusit të mbrojtur për 5% të specieve dhe habitateve të kercenuara.		
Konventa e Bernes (Bern, 1979) (ratifikuar nga parlamenti i Shqiperise me Ligjin nr. 8294, date 2.3.1998)	Per ruajtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisit natyror evropian. Objektiva kryesore është ruajtja e flores dhe faunes se eger dhe habitateve natyrore.	Mjedisi natyror	OM 6
Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar në 29.3.1996)	Shtetet pale kane rene dakort që te: • përcaktojnë ligatinat e territorit të tij të pershtatshme për tu perfshire në listen e ligatinave me rëndësi nderkombetare; - formulojnë dhe zbatojnë plane për promovimin dhe mbrojtjen e ligatinave të perfshira në Liste, si dhe për përdorimin sa me racional të ligatinave në territorin e tyre -promovojne ruajtjen e ligatinave dhe shpendeve ujore duke krijuar rezervate natyrore në ligatina, të perfshira ose jo në Liste, dhe siguron ruajtjen e tyre në menyren me të pershtatshme;	Mjedisi natyror	OM 6
Direktiva 2002/49/EC për vlerësimin dhe administrimin e zhurmes në mjedis. Shqiperia e ka perafuar pjeserisht këtë Direktive permes Ligjit nr. 9774, date 12.07.2007 "Per vlerësimin dhe	Objektivi kryesor është menaxhimi i qendrueshem i zhurmes me qëllimrespektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shendetit të njerezve. përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektore të tjere, sic është transporti rrugor, ajror, hekurudhor, zhurmat e gjeneruara nga pajisjet dhe makinerite. në tremujorin e fundit të vitit of 2017 është parashikuar miratimi i dy VKM-me:	Zhurmat	OM 9

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
menaxhimin e zhurmës në mjedis”. Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të shkaktuara nga çlirimet e zhurmës në Shqipëri u forcua me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 587 datë 07.07. 2010 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”, i ndryshuar.	- "Per kriteret, procedurat dhe rregullat për certifikim, pezullimin dhe heqjen e certifikates se ekspertit të zhurmës në mjedis” and - për perberjen dhe organizimin e Komitetit Teknik të Zhurmave (KTZH)"Kjo gje do të siguroje perafrimin e plote të kesaj Direktive në legjislacionin shqiptar. Sipas Udhezimit të përbashkët të Ministrit të Mjedisit dhe Ministri i Shëndetësisë Nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, nivelet kufi të zhurmës të jenë sipas vlerave udhëzuese të OBSH-së.		
Direktiva 2008/96/EC mbi sigurinë e infrastruktures rrugore (e përafuar plotësisht nepermjet Udhezimit Nr. 9, date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore”	Objektiva e kesaj Direktive është ‘garantimi i infrastruktures se sigurt rrugore për të gjithë përdoruesit e rruges’.	Popullsia dhe ekonomia lokale	OM 10
Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashegimise Arkeologjike – Konventa e Maltes (MEKVAD) (Shqiperia ka aderuar permes miratimit të Ligjit Nr. 9806 datë 17.9.2007).	Konventa i referohet konceptit gjithëpërfshires të ruajtjes se trashegimise arkeologjike. Ajo përcakton lidhjen mes ruajtjes se trashegimise arkeologjike dhe planifikimit hapësor.	Trashegimia kulturore	OM 11
Konventa për Mbrojtjen e Trashegimise Arkitektonike të Europes – Konventa e Granades (Shqiperia ka aderuar permes	Konventa perforcon konceptin gjithëpërfshires në ruajtjen e trashegimise arkitektonike (monumente, njesi arkitektonike, zona apo struktura memoriale).	Trashegimia kulturore	OM 11

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës mjedisor	Lidhja me objektivin mjedisor
miratimit të Ligjit nr. 9806 date 17.9.2007)			
Strategjia Kombetare për Zhvillim dhe Integrim, drafti i 2-te, 2015 - 2020	Strategjia e dyte Kombetare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II) paraqet vizionin e Shqiperise për zhvillimin e saj social, demokratik dhe ekonomik për periudhen 2015-2020, si dhe aspiraten për integrimin evropian. SKZHI-II shpjegon se si do të arrihet ky vizion permes politikave dhe strategjive të qeverise.	Toka Ajri Faktoret klimatike Uji Mjedisi natyror Mbetjet Zhurma POPULLSIA DHE EKONOMIA LOKALE Trashegimia kulturore peizazhi	OM 1 OM 2 OM 3 OM 4 OM 5 OM 6 OM 7 OM 8 OM 9 OM 10 OM 11 OM 12

Burimi: Plani Kombetar për Integrimin Evropian – Shqiperi
Strategjia Kombetare për Integrimin Evropian

VI.1.3 Identifikimi i Ndikimeve Mjedisore

Ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen nga aktivitetet e parashikuara në Plan janë përshkruar në tabelën më poshtë.

Table VI-2: Identifikimi i ndikimeve potenciale mjedisore

Komponenti mjedisor	Percaktimi i ndikimeve që mund të vlerësohen në raportin e VSM-se	Vlerësimi PO/JO
Toka	-fragmentimi i zonave me aktivitet të dendur bujqësor apo zona pyjore -përdorimi i burimeve të energjiise se rinovueshme dhe karburanteve 'bio' -administrimi i mbetjeve të gjeneruar nga aktivitetet e ndërhyrjeve infrastrukturore	PO
Ajri	- emetimi i ndotesve në ajër, të cilet kanë ndikime të dëmshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti -emetimi i ndotesve për të cilet janë përcaktuar kufijte e sipërm në nivel kombëtar -ndikimi në shendet (sistemi respirator) në rastet e një pranie të lartë të ndotësve në ajër	PO
Faktorët klimatike	- ndjeshmeria e rrjeteve dhe strukturave ndaj situatave ekstreme të motit - emetimet e gazrave 'serë' që shkaktohen nga djegia e karburanteve	PO
Uji	- siguria nga përmytjet -ndikimet e substancave të rrezikshme në cilesinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, në rast të derdhjeve aksidentale të tyre - ndikimet tek ujësjellesat dhe cilësia e ujit të pijshëm - ndikimet mbi ujrën që përdoren për larje (plazh)	PO
Mjedisi natyror (biodiversiteti, habitatet, zonat e mbrojtura)	- fragmentimi i habitateve - ndikim në linjat e migrimit të kafsheve - ndikim në integritetin dhe funksionalitetin e zonave të mbrojtura dhe të zonave të Natura 2000 - ndikime mbi tipologjinë dhe cilësitë e veçorive të rëndësishme natyrore	PO
Mbetjet	- ndikimet nga zona të ndotura të njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që ende nuk janë sistemuar - ndikimet nga vend depozitime të hapura (te ligjshme dhe të paligjshme) - kapaciteti i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues / mungesa e tyre - mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafsheve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore - ndarja në burim e mbetjeve / riciklimi (kuadri ligjor është plotësuar që prej vitit 2011, por nuk zbatohet në praktike).	
Zhurma	- ndotja akustike që shkaktohet gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastruktures përkatese dhe ndikimi tek shëndeti i njerëzve	PO

Popullsia dhe ekonomia lokale	- ndikime mbi asetet materiale për shkak të nevojës për hapësirë - aksesibiliteti dhe lidhjet mes zonave/rajoneve të ndryshme - ndikimet që lidhen me sigurinë rrugore	PO
Trashegimia kulturore	- ndikime në elementet e trashëgimisë kulturore	PO
Peisazhi	- ndryshimi i peizazhit dhe i veçorive pamore të hapësirës	PO

VI.2 METODIKA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Vlerësimi i paraqitur në kapitullin VI është përgatitur në perputhje me kërkesat e Ligjit 91/2013 “Për vlerësimin Strategjik Mjedisor”, ku jepet edhe përvijimi dhe përmbajtja e raportit të VSM-se. Ndikimet e rëndësishme të Planit në mjedis dhe objektivat mjedisorë janë analizuar dhe vlerësuar sipas shkalleve të mëposhtme:

- A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv;
- B – ndikim i parëndësishëm;
- C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutse;
- D – ndikim i rëndësishëm;
- E – ndikim degradues dhe i pa kthueshëm;
- X – vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur

Vlerësimi i ndikimeve të Planit sipas shkalles A, B dhe C do të thotë që ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisorë janë të pranueshme. Ndikimet e parëndësishme janë vlerësuar me B, ndersa ndikimet që bëhen të pranueshme vetëm pas zbatimit të masave zbutese përkatëse, janë vlerësuar me C. Shkallet D dhe E nënkuptojnë se ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisorë janë të papranueshme. Në aneksin 1 janë përshkruar indikatorët dhe kriteret e vlerësimit si dhe shkallët përkatëse të vlerësimit për secilen objektiv mjedisore.

VI.2.1 Vlerësimi i Përputhshmërisë

Objektivat e përcaktuara mjedisorë duhet të jenë në perputhje me Ligjin 91/2013 “Për vlerësimin Strategjik Mjedisor”, objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani për të arritur objektivat e tij. Për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, duhet të vlerësohet përputhshmëria e objektivave dhe politikave të Planit me objektivat e përcaktuara mjedisore. Vlerësimi i përputhshmërisë krijon konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave dhe politikave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave; të gjitha keto duhen venë në dukje veçanërisht në pjesën e vlerësimit të projekteve specifike të Planit.

Përputhshmëria e politikave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar këto politika me objektivat mjedisorë të kësaj VSM-je. Vlerësimi është bërë duke përdorur përafrimin standart në formë matrice. Për të kryer vlerësimin numerik të nivelit të përputhshmërisë është përdorur grafiku i vlerësimit që jepet në Tabela VI-1 më poshtë.

Tabela VI-1: Për vlerësimin të nivelit të përputhshmërisë së objektivave

Niveli i përputhshmërisë	Vlerësimi numeric absolut	Vlerësimi numeric mesatar
Objektivat përputhen plotësisht	3	3.00
Objektivat përputhen pjesërisht	2	1.50 – 2.99
Lidhje mes objektivave është e zbehtë	1	0.00 – 1.49
Nuk ka lidhje mes objektivave	0	0.00
Objektivat nuk përputhen	-1	negativ

Tabela VI-2: Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore

Objektiva Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	OM10	OM11	OM12	MESAT ARJA
Objektiva e PDZRK	Toka - Përdorimi i qendrueshëm i tokës	Toka - Shfrytëzimi i burimeve natyrore	Ajri - Emetimet e ndotesve	Faktoret Klimatike - Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike	Uji - Kufizimi i efekteve negative	Mjedisi Natyror - Kohëzoni i popullatave dhe biodiversiteti	Mjedisi Natyror - Zonat e Mbrojtura	Mbetjet - Kompletimi i landfilleve	Zhurnat - Reduktimi i zhurmave deri në nivele të OBSH-se	Popullsia dhe ekonomia lokale - kohëzoni social, siguria e trafikut	Trashegimia kulturore - Ruajtja	Peisazhi - Ruajtja	Vlerësimi numerik
Objektiva Strategjike 1 (OS 1): Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik													
Objektivi 1: EB3 - Agroturizëm	3	3	3	3	3	1	1	3	2	3	0	1	2.27
Objektivi 2: EB1 - Fermë	3	3	3	3	3	1	1	3	3	3	0	1	2.25
Objektivi 3: S1-6 - Bar Restaurant	3	3	3	3	3	2	2	1	0	3	0	2	2.08
Objektivi 4: S1-3 - Bujtina	3	3	3	3	3	2	2	3	1	3	0	2	2.33
Objektivi 5: NAR4 - Ekoturizëm	3	3	3	3	3	1	1	3	3	3	0	1	2.25
Objektiva Strategjike 2 (OS 2): Përmirësimi i Cilësisë Urbane													
Objektivi 1: A1 - Banim	2	2	3	3	3	1	1	2	1	3	0	1	1.83
Objektivi 2: A2 - Banim dhe Shërbime	2	2	3	3	3	1	1	3	1	3	0	1	1.92
Objektivi 3: S1 Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi	2	2	3	3	3	1	1	3	2	3	0	1	2.00
Objektivi 3.1: S1-1 Hotel	2	2	3	3	3	1	1	2	-1	3	0	1	1.67
Objektivi 3.2: S1-2 Resort	2	2	3	3	3	1	1	1	-1	3	0	1	1.58
Objektivi 3.3: S1-6 Bar - Restorante	2	2	3	3	3	1	1	1	-1	3	0	1	1.58
Objektivi 4: AR1 Hapesira Publike	3	3	3	3	3	2	2	3	3	3	0	2	2.17

Objektiva Mjedisorë	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	OM10	OM11	OM12	MESAT ARJA
Objektiva e PDZRK	Toka – Përdorimi i qendrueshem i tokës	Toka – Shfrytëzimi i burimeve natyrore	Ajri – Emëtimet e ndotesve	Faktoret Klimatike – Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike	Uji – Kufizimi i efekteve negative	Mjedisi Natyror – Kohezioni i popullatave dhe biodiversiteti	Mjedisi Natyror – Zonat e Mbrojtura	Mbetjet – Kompletimi i landfilleve	Zhurnmat – Reduktimi i zhurmave deri në nivlete e OBSH-se	Popullsia dhe ekonomia lokale – kohezioni social, siguria e trafikut	Trashegimia kulturore – Ruajtja	Peisazhi – Ruajtja	Vlerësimi numerik
Objektivi 5: S2 S2-7 Dyqane	2	2	3	3	3	0	0	1	1	3	0	1	1.58
Objektivi 6: AR3 Aktivitete Sportive	2	2	3	3	3	1	1	3	2	3	0	2	2.08
Objektivi 7: S2 Shërbime Tregtare dhe Biznesi	2	2	3	3	3	0	0	1	1	3	0	1	1.58
Objektiva Strategjike 3 (OS 3): përmirësimi i cilësisë Rurale													
Objektivi 1: B1- Kultura të përhershme	2	2	2	2	2	1	1	3	3	3	0	1	1.83
Objektivi 2: B2 – Kultura të përkohshme	2	2	2	2	2	2	2	3	3	3	0	0	1.92
Objektivi 3: EB1- Fermë bujqësore	2	2	2	2	2	1	1	3	2	3	0	1	1.75
Objektivi 4: IB-Infrastrukturë Bujqësore	2	2	2	2	2	2	2	3	3	3	0	1	2
Objektiva Strategjike 3 (OS 3): përmirësimi i Infrastruktues se Transportit dhe Mobilitetit në Zonë													
Objektivi 1: INT3 Infrastrukturë e Transportit Ujor	1	1	1	1	1	-1	-1	2	-1	3	-1	0	0.50
Objektivi 2: INT4 Infrastrukturë e Transportit Ajror	1	1	1	1	1	-1	-1	2	-1	3	0	0	0.58
Objektiva Strategjike 4 (OS 4): Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë se Mjedisit Natyror													
Objektivi 1: N1-NAR.1Park natyror & Pyll	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	0	3	2.75

[illegible]

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat e PDZRK, janë si më poshtë:

- Objektivat e planit përputhen pjesërisht me objektivat mjedisorë (21 objektiva)
- Objektivat e planit me lidhje të zbehtë me objektivat mjedisorë (2 objektiva)

Në këndvështrimin e lidhjes mes Objektivave të PDZRK dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:

- Objektivat që lidhen me Përmirësimin e Cilësisë Urbane dhe ato që lidhen me Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Cilësisë së Mjedisit Natyror kanë klasifikimin me të ulët në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore. Sidoqoftë, secila prej këtyre objektivave është në përputhshmëri të plotë apo të pjesëshme me të paktën një, dhe një shumicën e rasteve, me 2 dhe 3 objektiva mjedisore.

- Objektivat që lidhen me Zhvillimin e Qëndrueshem Ekonomik, me Zhvillimin e Turizmit dhe Përmirësimin e Infrastruktura të Transportit kanë klasifikimin mesatar në nivelin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore. Sidoqoftë, secila prej këtyre objektivave është në përputhshmëri të plotë apo të pjesëshme me të paktën një, dhe një shumicën e rasteve me 2 dhe 3 objektiva mjedisore.

- Dy Objektiva të PDZRK-ës, që lidhen me Mbrojtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit Natyror, specifikisht: N1-NAR.1Park natyror & Pyll; NAR2 Plazh, janë në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore, duke marrë rezultatin maksimal të mundshëm.

- Disa prej objektivave të Përmirësimit të Cilësisë Urbane si dhe Përmirësimi i Infrastruktura të Transportit dhe Mobilitetit në Zonë, ka një lidhje të pjesëshme me objektivat mjedisore.

- Disa prej objektivave të Përmirësimit të Cilësisë Rurale kanë në lidhje të kënaqshme me objektivat mjedisore. Sidoqoftë, përputhshmëria e plotë me 2 objektiva dhe e pjesëshme në njërin prej tyre, e klasifikon këtë objektiv në terësi me një lidhje përputhur me objektivat mjedisore.

- Secila prej Objektivave të PDZRK-ës nuk kanë lidhje me të paktën 1 objektive mjedisore dhe në shumicën e rasteve me 2 objektiva.

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të PDZRK-ës dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë ekziston. Konkretisht:

- Objektiva mjedisore 3, 4, 5, 8, 10 që lidhen me cilësinë e ajrit, faktorët klimatik, ujë, mbetjet dhe popullsinë, janë në përputhshmëri të plotë me pjesën më të madhe të objektivave të planit.

- Duhet theksuar se këto objektiva janë ose në përputhshmëri të plotë, ose të pjesëshme me politikat e planit.

- Objektiva 11 që lidhet me ruajtjen e trashëgimisë kulturore është objektivi që nuk lidhet me pjesën më të madhe të politikave të PDZRK.

Të gjitha objektivat e tjera mjedisore paraqesin një diversitet të madh lidhur me nivelin e përputhshmërisë së tyre me objektivat e PDZRK.

Si konkluzion mund të thuhet se, në këndvështrimin e përgjithshëm, objektivat e PDZRK-ës janë në përputhje me objektivat mjedisore.

VI.3 VLERËSIM I NDIKIMEVE MJEDISORË DHE UDHEZIMET PËR MASAT ZBUTËSE NË LIDHJE ME OM

VI.3.1 Toka

Objektiva mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qendrueshem të tokës dhe mbrojtja e saj.

Ndikimi me i madh gjatë fazes së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastruktures, sidomos asaj rrugore, ajrore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj nderkohe që nga fusha të tjera do të jene të kufizuara në një territor me të ngushte local. Nuk priten ndikime në ato sektore ose nën sektore ku perqendrimi me i madh i aktiviteteve do të këtë të beje me plotesimin e boshlleqeve ligjore dhe të strukture (aktivitete soft) ku gjithë detyrat dhe angazhimet do të jene të natyres institucionale dhe organizative. Permes okupimit të tokës, ndërtimet në infrastructure prodhojne ndikime të gjera të pakthyeshme, që reflektohen pas zhvillimit si një ndryshim në përdorimin e tokës. Toka bujqësore dhe pyjet do të pesonin shkatërrim të pakthyeshem në seksionet e marra nga ndërtimet e reja ose ato të rindertuara mbi seksionet e vjetra. Shpesh ndërtimet e reja krijojne edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurter (të riparueshme) që mund të ndoshin gjatë fazes se ndërtimit perfshijne lidhjet perms tokave bujqësore ose pyjore, demtimet dhe okupimet e tokave ose demtimin e produkteve për shkak të afersise me sheshet e ndërtimit, ndotjet e tokës etj., për shkak të zhvillimeve të reja në infrastructure, përdorimi i tokës bujqësore ekzistuese peson ndryshim nga ana e pozicionimit të lidhjeve të reja infrastrukturore. Masat që zbatohen mund të sjellin renien e perhershme të potencialit dhe prodhimtarise të tokës bujqësore që nënkupton humbjen e perhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarine bujqësore. Pozicionimi i vendosjes se strukturave infrastrukturore të reja në hapësira të hapura dhe me natyre për të konservuar biodiversitetin do të sjellin ndërhyrje direkte tek aktivitetet e vazhdueshme të zonave pyjore të cilat duhet të kryejne funksionet vegjetative bimore me ane të drureve si aktivitet primar (demtime të pakthyeshme). Udhezimet e pergjithshme dhe masat zbutese që paraqiten në këtë kapitull në vazhdim duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

Aktivitetet ndërtimore në pergjithesi (rindertime ose të reja) të infrastruktures janë burim i prodhimit të sasive të medha të mbetjeve, dhe gjithashtu krijojne presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet gjenerohen jo vetem perkohesisht gjatë fazes se ndërtimit, por edhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazes operacionale si edhe për efekt të proceseve të mirembajtjes se strukturave. Impakti nga gjenerimi i mbetjeve është i perhershem dhe në mjaft raste i pakthyeshem në lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore. Prandaj, ky impakt negativ ndaj mjedisit duhet të pakesohet me ane të masave për menaxhimin e mbetjeve. Duke konsideruar menyren sesi gjenerohen dhe llojin e strukture, sasite e mbetjeve të gjeneruara nga zhvillimet në infrastructure prej çdo sektori ekonomik duhet të konsiderohen si sasira të medha, sidomos prej veprave të nivelit kombetar ose rajonal, nderkohe që sasite e mbetjeve nga zhvillimet në nivel lokal priten të jene me të lokalizuara dhe me të pakta krahasuar me dy nivelet e para. Shqiperia ka kryer transpozimin e Direktives 2008/98/EC mbi mbetjet, me ane të VKM no. 175, date

19.1.2011 sic referohet edhe në “Strategjine Kombetare Ndersektorale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025” dhe në “Planin Kombetar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025”. në këtë aspekt, SKZHI II prezanton si objektive mjedisore “55 për qind e masës totale të mbetjeve të ripërdoret ose riciklohet deri në 2020”. ndërtimet e reja ose zgjerimet e infrastrukturave sipas sektoreve, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimet e veprimeve prioritare respektive të Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndërtimit për ripërdorimin ose procesimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara, ku efekti i sinergjise reflektohet veçanërisht në faktet e mëposhtme:

- Sasira të medha mbetjesh mund të përdoren veçanërisht në ndërtimet e rrugëve dhe infrastrukturave të ngjashme ku materialet mbushese janë mjaft të nevojshme;
- Substanca potenciale toksike të mbetjeve mund të mobilizohen në mënyrë permanente në rast se ato përdoren në menyren e duhur; dhe
- Kompozite të reja të ndërtimit shpesh kanë karakteristika me të mira funksionale në krahasim me ato konvencionale.

Në vijim të zbatimit të masave specifike që paraqiten në Plan, administrimi ekonomik i burimeve natyrore duhet të mbështetet nga masa të tjera të përgjithshme shtesë që promovojnë pakesimin e ndotjes së mjedisit duke përdorur materiale të riciklueshme në ndërtimin dhe rindertimin e infrastrukturës së parashikuar për çdo sektor. Prandaj, masa të tilla duhet të përgatiten dhe të përfshihen që në fazat e hershme të programeve të zhvillimit në çdo sektor dhe për çdo masë specifike me vete.

Objektiva mjedisore 2 (OM 2): Ruajtja e mjedisit fizik dhe teresise se elementeve natyrore të zonës nga erozioni/sedimentim.

Ndikimet e ndryshmeve klimatike në ultësira, laguna dhe zona bregdetare çojnë në dy drejtime, në erozionin bregdetar dhe rritjen e nivelit të ujit të kripur. Grykëderdhja e Vjosës në pjesën e poshtme përfshin zonën e mbrojtur Nartë-Vjosë me rreth 20,000 ha. Statusi ekologjik është i lartë dhe biodiversiteti i pasur.

Ekosistemi natyror i Nartës është i karakterizuar nga një larmi e pasur habitatesh, duke përfshirë këtu (i) lagunën, (ii) grykëderdhjen e lumit Vjosa, (iii) kënetat e kripës, (iv) dunat e rërës, (v) pyjet me pisha dhe (vi) Ishullin e Zvërnecit.

Llojet e tokave të kripura janë *Salicornia* spp., *Arthrocnemum* spp., *Salsola soda*, dhe *Limonium* spp. Me uljen e përqendrimit të kripës, shumëllojshmëria e specieve rritet me: *Arthrocnemum fruticosum*, *A. perenne*, *A. glaucum*, *salicornia europea*, *Salsola soda*, *Juncus acutus*, *Juncus maritimus*, *Inula crithmoides*, *Limonium vulgare*, *Artemisia coerulescens*, *Halimione portucaloides*. Në habitatin e rezervave të ujit të ëmbël speciet mbizotëruese janë *Phragmites australis*, *Typha angustifolia*, *Typha latifolia*, *Scirpus maritimus* dhe *Scirpus lacustris*. Në pyllin aluvial specie (pemët e pyllit) janë *Populus alba*, *Populus nigra*, *Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix amplexicaulis*, *Salix elaeagnos subsp. angustifolia*, *Alnus glutinosa*, *Alnus incana*, *Platanus orientalis*, *Ulmus minor*, *Ulmus glabra*, *Fraxinus angustifolia* ndërsa në dunat ranore janë *Ammophila arenaria subsp. arundinaceae*, *Elymus farctus*, *Echinophora spinosa*.

Kanjir and Gregoric Bon (2016³⁴) duke analizuar të dhënat optike të rilevimit në distancë në zonën e Vlorës, gjetën një erozion të fortë bregdetar 20-50 cm/vit përgjatë vijës bregdetare të jugut të Shqipërisë. Ky erosion, gjithnjë e më intensiv për shkak të stuhive të pritura nga ndryshimet klimatike, shkakton jo vetëm përkeqësimin e statusit ekologjik të ekosistemeve ujore por edhe veprim fizik dhe mekanik në ekosistemet tokësore, të cilat përbëjnë zonën strikte të mbrojtur Nartë-Vjosë (rreth 20,000 ha). Është vlerësuar se zonat e gërryera në bregdetin e Nartës janë afërsisht 2.0-3.0 ha në vit. Megjithëse, për shkak të sedimenteve shtohen sipërfaqe të reja me rërë, çdo vit humbja e biodiversitetit është e lartë sepse rehabilitimi i ekosistemeve të reja, instalimi i bimësisë dhe funksionimi i ekosistemit si i tillë kërkon një kohë të gjatë.

Për shkak të erozionit, disa habitate pritet të pësojnë dëme të mëdha nga humbja e biodiversitetit. Në varësi të vendndodhjes nga bregu, zonat me ujëra gjysëm të ëmbla do të zvogëlohen, bimësia e dunave të rërës do të humbas dhe rripi pyjor aluvial do të dëmtohet. Në vitin 2050 sipërfaqet e gërryera do të jenë afër 90 ha, ndërsa sipërfaqet e formuara nga sedimentet do të rriten në veri të grykëderdhjes së Vjosës.

Rritja e nivelit të detit, për shkak të rritjes së temperaturës, mund të ketë një larmi ndikimesh në grykëderdhjen e Vjosës dhe zonat bregdetare të Nartës; duke shkaktuar përmblytje, humbje të tokës, kripëzimin e ujërave nëntokësore dhe humbje të biodiversitetit. Ekosistemet detare dhe biodiversiteti, tashmë nën presion nga ndotja, do të ndikohen nga temperaturat më të ngrohta dhe acidifikimi, me ndryshime në riprodhimin e specieve, ushqimin dhe me ndryshime në shpërndarjen e organizmave detarë, lulëzime më të shpeshta të algave dhe zhvendosje të komuniteteve planktonike. Gjithashtu, shërbimet përkatëse të ekosistemeve detare dhe bregdetare mund të humbin me zhdukjen e ligatinave bregdetare. Zonat e grykëderdhjes janë më të cenueshme nga një rritje e nivelit të detit për shkak të topografisë së tyre të veçantë, që do të thotë se ato janë vetëm pak mbi nivelin e detit dhe janë të shpërndara me pellgje dhe laguna. Me gjasë, zgjerimi i lagunave do të rrisë kapacitetin mbajtës të shpendëve migrues dhe do të ndryshojë speciet e pranishme. Është gjithashtu e mundshme, ndryshimi në faunën dhe florën ujore në favor të specieve që pëlqejnë më shumë ngrohtësi dhe kripësi³⁵. Zonat e parashikuara për t'u prekur nga intruzioni detare (kalimi i ujit të detit në ujërat e ëmbla nëntokësore) do të jenë rreth 1,900 ha, 2,300 ha dhe 3,900 ha për avancimin e kripëzimit të ujit përkatësisht deri në 2 m, nga 2 në 4 m dhe nga 4 në 5 m lartësia e terrenit bregdetar (Figura VI-1 dhe Figura VI-2).

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat mjedisore 1 dhe 2

Duke zenë një territor të caktuar, ndërtimi i infrastrukturës së parashikuar do të shkaktojë ndikime të përhershme, të cilat do të pasqyrohen si një ndryshim në struktura të përdorimit të tokës. Prandaj, kur planifikohet integrimi i infrastrukturës së parashikuar në mjedis, duhet të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj. për të siguruar përdorimin e

³⁴Kanjir, U and Gregoric Bon, N., 2018, Coastal changes and movements in the wider Vlora (Albania) area, Research paper, September 2016 Conference: GEOBIA. DOI: [10.3990/2.382](https://doi.org/10.3990/2.382)

³⁵Travers, A., Elrick, C. and Kay, R (2010). *Background Paper: Climate Change in Coastal Zones of the Mediterranean*. Split, Priority Actions Programme, 2010

qendrueshem të burimeve natyrore, do të duhet që projektet specifike të plotesohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastruktures së re, dhe me e rëndësishmja, përdorimin e materialeve të certifikuar të ndërtimit, prodhuar nga riciklimi i post-produkteve ose mbetjeve nga sektoret e tjera. të gjithë materialet ndotes (dherat dhe mbetjet) që do të largohen, duhet të krijohet një plan për menaxhimin e tyre në bashkëpunim me NJA Novoselë dhe bashkinë Vlorë ku duhet të jene të izoluar nga ujërat nëntokesore. Toka që shtrihet nën rrugë mund të jetë në rrezik gjatë ndërtimit, pasi mund të ndotet nga derdhjet e hidrokarbureve dhe ato kimike. Pastaj toka mund të sherbeje si një burim ndotjeje kur pershkohet nga ujërat nëntokesore, ndaj duhet të evidentohet sasia e materialit ndotës të përdorur për ndërtim me qllim që të merren masat për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme të përdorura në të gjithë komponëntet infrastrukturore të Planit.

- Materiali, i cili germohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në baze të një skeme do të makimizohet duke përdorur teknika konstruktive të cilat intensifikojnë ngjeshjen e materialeve për t'u përdorur si mbushje inxhinierike.

- Megjithatë, pashmangshmerisht do të këtë një sasi të konsiderueshme materiali, i cili, për shkak të veçorive të tij fizike dhe strukturore, nuk është i pershtatshëm për t'u përdorur si mbushje inxhinierike brenda skemes. Megjithatë, ky material mund të jetë i pershtatshëm për aktivitete të tjera, sic është krijimi i peizazhit, ku nuk aplikohen kërkesa kaq të rrepta strukturore.

- Materiali i germuar i parashikuar për ripërdorim do të trajtohet dhe transportohet në minimum, dhe do të depozitohet në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet e gerryerjes. Koha midis germimit dhe ripërdorimit gjatë periudhës së lagesht duhet të jetë sa më e vogël.

- Percaktimin e vijës bregdetare që nënkupton percaktimin nga ana ligjore të asaj që quhet vija zero e detit mbi bazen e se ciles do të realizoheshin me mire vlerësimet e erozionit detar, dinamikes së levizjes së bregdetit dhe të sedimenteve.

- Mbjellja duhet perfunduar sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulese stabilizuese të tokës. Aty ku është e nevojshme do të kerkohet hapje e kanaleve për të siguruar mbjelljen e suksesshme të bimeve.

- Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gure të thyer, për të reduktuar erozionin, veçanërisht në rastet kur janë instaluar strukturat e kullimit dhe/ose nivelet e formacioneve të rruges janë ngritur dhe krijojnë shpate të zhveshura, të cilat kerkojnë stabilizim, perpara fillimit të sezonit të shirave.




Figura VI-1: Humbja e biodiversitetit nga erozioni dhe intrusioni i ujit të kripur detar




Figura VI-2: Harta e përmbytjes së zonës së projektit në varësi të nivelit të ujit në urën e Mifolit

VI.3.2 Cilësia e ajrit

Objektiva mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasite vjetore të shkarkimeve të ndotesve, për të arritur perputhshmerine me kufijte maksimale të lejueshem nga BE për shkarkimet e ndotesve atmosferike.

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit të infrastructures dhe atë të operimit në një serë aktivitetesh nga sektore të ndryshëm, por në lidhje direkt me Planin ndikimi kryesor vjen nga sektori i transportit. Gjatë fazes së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastructures, shkarkimi i ndotesve krijon impact afat-shkurter në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme. Gjatë fazes së operimit të infrastructures, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në uje e tokë, në varesi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastructures perkatese. Zbatimi i masave specifike që synojnë arritjen e qëllimeve të Planit pritet të kenë një impact pozitiv për shkak të pakesimit të shkarkimeve të ndotesve, se pari për shkak të masave të parashikuara lidhur me sistemet multimodale të transportit sic janë transporti transferues me kargo dhe pjesërisht në transportin e pasagjereve det - tokë me mjetet rrugore dhe hekurudhore. Masa të tjera nga sektoret që emetojnë shkarkime të ndotesve në ajër priten gjithashtu të kontribuojnë me efekte positive për shkak të pakesimit të ndotesve të shkarkuar, në veçanti të atyre që synojnë pakesimin e bllokimeve/ngjeshjes dhe përdorimin me të madh të sistemit public të transportit si edhe kontrollit të shkarkimeve në ajër nga industrite dhe promovimit të metejshëm të energjive të gjelbërta përmes investimeve të pritshme në hidrocentrale dhe gazit natyror.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 3

Duhet të përgatitet një program i detajuar i masave për zvogelimin e ndotjes me ndotës PM₁₀, PM_{2.5}, SO_x, NO_x, CO_x, VOC, BTEX, CFC, HCFC etj., për zonat problematike. Programi do të duhet të verëhet gjatë planifikimit të politikave dhe projekteve specifike të Planit për zonat problematike, në një shkallë me të gjere. Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale (NJA Novoselë të kenë dy stacione monitorimi sipas specifikes së zonave të zhvillimit kryesore). Koordinimi midis institucioneve qendrore dhe vendore për vlerësimin. Implementimi i sistemit të shtypjes së pluhurit: ujitja e aneve të rrugëve, përdorimi i ndarjeve të rrugëve për të kufizuar nxjerrjen e pluhurit (për shembull përdorimi i larjes së rrotave, gjë që bëhet perdite) dhe kufizimi i shpejtësisë së impianteve të levizshme në rrugë. Vendodhjen potenciale të zonave që kerkohen instalimin e kantierit, magazinim si dhe zonat e stabilizimit të tokës dhe rrugët e transportit që përdoren për shpërndarjen e materialeve. Kontrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve gjatë sezonit me nivelin me të lartë të ndotjes së ajrit me pezulli në qendrat kryesore të rëndësisë së veçante në zonën e mbrojtur dhe mirembajtje e rregullt e sipërfaqeve rrugore për të pakesuar sa më shumë që të jetë e mundur ringritjen e pezullive.

VI.3.3 Faktorët klimatikë

Objektiva mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastruktures në pergjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Nje serë aktiviteteve ndërtimore të infrastruktures dhe praktika sektoriale kane impakt temporal (te kthyshe) mbi shkarkimet e gazeve serë (GHG), që perbejne shkaku kryesor të ndryshimeve klimatike. për shkakun që karburantet fosile (nafta dhe derivatet) clirojne GHG në ajër gjatë përdorimit përfaqësojnë në keto momente burimin me të rëndësishëm të energjise në sektorin e transportit e bejne sot këtë sector të parin si burim shkarkimesh të gazeve serë në Shqiperi, pasi sektori i energjise ketu është hidro. Impakti në ndryshimet klimatike është gjithashtu pasoje në kushtet e motit dhe klimes që po rriten çdo vit. një tjetër pasoje pasoje e temperaturave të larta globale janë ndryshimet në modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet me të shpeshta të kushteve ekstreme të motit (thatesira, permbytje, erozione, stuhi me breshër, vale të nxehta, temperature të uleta me ngrica, etj.). Vendimi 406/2009/EC përcakton minimumin e kontributit të Shteteve Anetare të BE për të kapur angazhimin e reduktimit të shkarkimeve të gazeve serë të Komunitetit për periudhen nga 2013 në 2020 për të gazet serë që mbulohen nga ky vendim dhe rregullat për të bere keto contribute si dhe për vlerësimin e tyre me pas.

Ne nivelin strategjik të zhvillimit të sektoreve, masat në lidhje me fushen e adaptimit të ndryshimeve klimatike mund të trajtohen si te pergjithshme. Perpara projektimit dhe zbatimit të çdo veprimi individual do të jetë e nevojshme të krijohen udhezues specifikë, metodologji dhe procedura për grumbullimin e informacionit rreth ngjarjeve ekstreme të motit dhe për të planifikuar dhe zbatuar detyrat respective. Shkarkimet e gazeve serë nga sektore të tillë si transporti rrugor, bujqësia, energjia, etj., përfaqësojnë një rrezik të konsiderueshem për masat zbutese të ndryshimeve klimatike. Në vijim vec shkarkimeve të perkoheshme të gazeve seregjate fazes se ndërtimit të veprave infrastrukturore të parashikuara në Plan, shkarkimet e gazeve serë priten të rriten edhe pse do të merren masa për të eliminuar mjaft pengesa. Zbatimi i masave specifikë duhet të garantojne përdorim me të madh të transportit public, metodave të reja bujqësore të kultivimit dhe vadijes, energjisë të rinovueshme.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 4

Për zbatimin e masave zbutëse për ndikimet në klimë të planit zhvillimor duhet mbajtur në vëmendje, përcaktimi i protokolleve dhe monitorimi i rasteve të trajtimit të semundjeve që vijne si pasoje e ngjarjeve të motit, përcaktimi i masave të emergjencave civile për të shmangur/zbutur ndikimet nga kushtet ekstreme të motit, përcaktimi i kriterëve dhe politikave për futjen e teknologjive bashkekohore në bujqësi si dhe praktikave me të mira të bujqësisë organike, zbatimi i një politike parkimi kufizuese në zonat urbane, integrimi i ceshtjeve të ndryshimeve klimatike në kuadrin politik dhe ligjor duke specifikuar institucionet dhe për identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e masave zbutese/pershtatese ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. për të

arritur objektivin mjedisor në lidhje me pershtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si me poshte:

- ne terma afatgjate, infrastruktura duhet të jene me pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, përmbytjeve apo, ngricave);
- gjate planifikimit të çdo ndërtimi të ri, duhet të kryhet një analize ndjeshmerie e infrastruktures se parashikuar në kushtet ekstreme të motit , dhe në baze të rezultateve të saj, duhet të pergatitet një plan masash për të reduktuar në mënyrë të perhershme pasojat e ketyre fenomeneve;
- zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmerine e infrastruktures ndaj kushteve ekstreme të motit duhet të behet një detyre qendrore e menaxhimit të çdo lloj infrastrukture.
- Shtimi i siperfaqeve me pyje dhe bimesi
- Strukturimi i kerkesave për lende drusore
- Dizenjimi dhe përcaktimi i kriterëve të ndërtimit të struktura rezistente ndaj kushteve të motit dhe në veçanti ndaj temperaturave të larta dhe lageshtise
- Monitorimi i vazhdueshem i kushteve ekologjike të mjediseve natyrore
- Monitorimi i dinamikes se vijes bregdetare dhe nivelit të detit
- Monitorimi i nivelit të detit dhe cilësisë se ujerave në lagunë dhe ujërat nëntokesore
- Monitorimi i vijes bregdetare dhe sasise se sedimenteve që vijnë nga lumi Vjosë
- Monitorimi i levizjes se tokës dhe tjetersimit të saj
- Monitorimi i marrjes se zhavorreve nga shtreterit e lumenjve
- Monitorimi i gjendjes se monumenteve dhe veprave të trashegimise kulturore
- Monitorimi i levizjes se popullsise në zonat urbane dhe rurale
- Zbatimi i kodeve të reja të ndërtimit për ndertesat sociale dhe kulturore duke përdorur materiale termoizoluese dhe rezistente ndaj kushteve të motit
- Ndertimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lengeta urbane dhe industriale për të zvogeluar sasine e lendeve ndotese në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore, dhe
- Percaktimi i zonave buferike për rastet e ndikimeve nga rritja e nivelit të detit

VI.3.4 Ruajtja e trupave ujorë

Objektiva mjedisorë 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokesore dhe siperfaqesore, ujërat e njelmet, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshem.

Mbrojtja e ujërave në territor (gjithë trupat ujorë lidhet direkt me presionet e komponëntëve të cilet do të zhvillohen. Impaktet priten nga zhvillimet e elementëve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore dhe sidomos të Lagunës dhe Kripores. Në rastin konkret faktorë të tjerë kërcenues janë të shtuar nga të cilët më të rëndësishëm jane: (i) ujërat e zeza të pa menaxhuara, (ii) gropat septike individuale, (iii) derdhet në trupat ujore të pa trajtuara, (iv) mbetjete e ngurta urbane të shperndara në vende të pa përshtatëshme dhe shpesh në kanalet kulluese dhe në bregdet. Efektet e këtyre vektorve janë në fakt efekte kumulative. Nuk ka, sidoqoftë, impakte të ardhura ndërkufitare më përrjashtim të kanlit ujitës që merr ujin e Vjosës për vaditje.


Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin mjedisorë 5

Në mënyrë që të zvogelohen ndjeshëm ndikimet negative në cilësinë e ujit të detit, duhet të merren masat e mëposhtme: të blihen pajisjet e duhura për t'u marrë me derdhjet e substancave të rrezikshme në det, ujëra sipërfaqësor etj., të ndertohet infrastruktura e duhur për të pritur dhe asgjësuar mbetjet nga motovarkat dhe struktura e marinës, të sigurohet qarkullimi i rrjedhave ujore dhe kështu të parandalohet eutrofizimi përmes planifikimit të duhur dhe funksionimit të porteve.

Duhet bërë përcaktimi i zonave me specifike për qëllime të përdorimit të ujerave për rezervuare, për bujqësinë. Duhet planifikuar zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative mbi ujërat e largës, gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastruktures, si dhe në rastet e ndodhjeve të jashtëzakonshme (p.sh. derdhjet e substancave të rrezikshme). Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktika të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:

- Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të demshme të një distance më së afërmi 50 m nga Lumi Vjosë si dhe do të kufizohet prapa rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;
- Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- Kanalet anësore do të ndertohen përpara ndërtimit të rrugës, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lume, apo kanalet kulluese;
- Hedhja e betonit duhet të bëhet duke përdorur armaturen e duhur, për të shmangur ndotjen;
- Në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujërat sipërfaqësore dhe të nëntokesore.

Marrja e mostrave të ujerave nëntokesore duhet të kryhet periodikisht dhe për pH-in, turbullirën dhe përcjellshmëri elektrike matja të bëhet in situ. të gjitha veprimet e kërkuara dhe, nëse nevojiten, analizat, duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.



VI.3.4.1 Uji i pijshëm

Impaktet me të medha për arritjen e këtij objekti mjesoris pritet nga zhvillimet e sektoreve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore, (ujesjelles/kanalizimet, vaditja dhe bujqësia e blegtoaria në përgjithësi, industria ushqimore dhe përpunuese, shërbimet dhe turizmi, shëndetësia, etj)

Impaktet mbi ujërat sipërfaqesore, nëntokesore, ujrat e njelmet, ujrat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm janë karakteristike të periudhës së ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës dhe gjithashtu në vijim të operimit të strukturave edhe me tepër. Kjo në varesi respektive të sektoreve përket në lidhje me nevojën për përdorimin e ujit ose nderveprimet me burimet dhe trupat natyrore ujore. Në shumicën e rasteve këto impakte krijohen si të limituara në mjedisin lokal, megjithatë në mjaft raste ndodh efekti kumulativ i impaktit dhe krijohen ngarkesa ndotëse të medha ndotëse që ngrihen në nivel rajonal dhe disa herë edhe nderkufitar përtej kufijve. Impaktet ndërtimore të infrastrukturës ngelen në përgjithësi afat-shkurter dhe të rikthyeshme (rasti për shembull i cilësisë së ujërave). Pas fazës ndërtimore, impaktet janë kryesisht me pak të përhapura, por të përkthyeshme permanente (rasti për shembull i impaktit të morfologjisë së vijës ujore natyrore, kushteve hidrologjike të kushteve, ruajtja e zonave). Impaktet e mesipërme mund të prodhojnë ndryshime në elementet cilësore për krijimin e statusit ekologjik të ujërave sipërfaqesore, që janë elementet biologjik, hidromorfologjik, mbështetës, kimik dhe fiziko-kimik dhe në statusin kimik të ujërave. Nëse udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbatuese vëzhgohen, ndryshimet në elementet cilësore nuk do të kapërcejnë se tepërmi që të kërcenojnë arritjen e objektivave mjedisore. Veprimet e sektoreve që ndikojnë në ujrat dhe objektivat mjedisore mbi ujrat përmbledhen si më poshtë:

- Pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtpërdrejtë ose indirekt situatën hidrologjike në një zonë të caktuar duke sjellë edhe situatë eko-morfologjike mbi rrjedhën e ujit;

- Rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse (impakt në cilësinë e ujërave sipërfaqesore dhe ato nëntokesore, impakt potencial mbi ujrat balneare);

- Derdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjirjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distancë të largët deri nderkufitar mbi cilësinë e ujërave sipërfaqesore dhe nëntokesore, impakt potencial mbi ujrat balneare);

- Rrezik i lartë ekzistent nga përmbajtjet (aplikimi i zgjidhjeve ndërtimore me këtë kriter si rrezik i lartë) në zonat që përmbajten ose masa rregulluese në rrjedhën e ujërave; ndryshime në situatën hidrologjike në një zonë të caktuar, përfshirë pakesimin në zonat mbajtëse (direkt ose në distancë);

- Ndryshimet në regjimin ujor të ujërave nëntokesore për shkak të ujërave të nderhyrjeve të veprave infrastrukturore (për shembull tunelet);

- Pozicionimi i strukturave infrastrukturore në zonat aquifere me ndjeshmeri të lartë ose shumë të lartë mund të kenë impact negative mbi burimet ujore ekzistuese dhe potenciale (direkt, indirekt, nderkufitar);

- Pozicionimi në zonat e ujrave të mbrojtur të burimeve ujore (ndikim lokal, potencialisht rajonal dhe nderkufitar).

Shqipëria ka aprovuar Ligjin No. 111/2012 “Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore” dhe “Strategjine Kombetare Sektoriale për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet 2014-2040”, “NStrategjine Ndersektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025” dhe “Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025”. Midis të tjerave, këto dokumente përcaktojnë që aktivitete në ujë dhe tokat anash ujrave mund të kryhen vetëm nëse ato janë bazuar mbi planet e zhvillimit hapësiror dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të larta disproporcionale. Pozicionimi i këtyre aktiviteteve mund të ndikojnë thelbesisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore dhe të pakesojnë zonat e mbajtjes dhe impaktet cumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Udhezimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Kapitullin VII duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

VI.3.5 Trajtimi i ujërave të zeza

Me zhvillimin e parashikuar të zonës, si nga pikpamja e infrastrukturës ashtu edhe të ekturizmit, është e domosdoshme ndërtimi i rrjetit të UKZ paralelisht me sistemin e infrastrukturës rrugore.

Plani parashikon projekte lidhur me ngritjen e rrjetit të ujërave të zeza në sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë zonës urbane dhe në drejtim të rrugëve. Edhe pse sistemet do të jenë të vendosura në korridorin qendror të infrastrukturës, ky sistem do të qendrojë me vete brenda korridorit dhe nuk do të pengohet apo të ndërpritet nga një sistem tjetër si psh., kullimi dhe kanalizimet të rrjedhin së bashku, sikurse mund të jetë rasti në disa fshatra sot. Studimi planifikon vendosjen e një impianti të trajtimit të ujërave të ndotur (referohu hartës së përdorimit të propozuar të tokës).

Kjo do të sigurojë funksionim të mirë dhe efikas të sistemit dhe do të lehtësojë mirëmbajtjen dhe punimet riparuese.

Ky rregullim do të mundësohet përmes investimeve në tre drejtime kryesore:

- a) Ndërtimin e gropave septike sipas standardeve për fshatrat dhe shtëpitë e veçuara,
- b) Ndërtimin e sistemit të kanalizimeve në zonat e zhvillimit të shtetit urban, turistik, rekreativ dhe lidhjen me rrjetin e trajtimit të ujërave të ndotur impjantin e trajtimit të ujërave të ndotur i cili do të ndërtohet në Veri të Aeroportit të Akernisë.

Trajtimi i ujërave të ndotur paraqitet i rëndësishëm për zonën bregdetare për vetë faktin sepse kjo lidhet ngushtë jo vetëm me cilësinë e ujërave nëntokësore por edhe me pastërtinë e ujit të detit.

Projektet që plani parashikon në drejtim të trajtimit të ujërave të zeza janë:

- Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe ngritja e tyre në zonat e zhvillimit informal
- Zhvillimi i sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujrave të zeza për zonën e planit nga fshatrat e njesise NJA Novoselë dhe zonate e reja zhvillimore në drejtim të impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur i cili do të ndertohet në Veri të Aeroportit të Akernisë;
- Paisja me sisteme të trajtimit me kapacitete të vogla dhe individuale për zonat që shtrihen në brendësi të territorit (Sipas zonave zhvillimore);
- Hartimi i një plani menaxhimi për kanalizimet e hapura ku derdhen ujrat e zeza duke mbrojtur cilësinë e trupave ujore në zonë (deti, lumenj, lagunë) si dhe shëndetin e popullatës




Figura VI-3: Harta e të dhënave të gropave septike aktuale dhe zgjidhja e planit për trajtimin e ujrave të zeza me impjanin pranë Aeroportit të Akërnisë

VI.3.6 Mjedisi natyror

Objektivi 6. Mjedisi Natyror - Garantimi i kohezionit të popullatave dhe biodiversiteti

Ndikimet të cilat janë të lidhura me copëzimin e habitateve dhe biodiversitetin janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit ose instalimit të elementeve të infrastrukturës dhe me funksionimin e saj. Ato verehen me teper në mjedisin lokal, ndersa në rastin e projekteve me shtrirje të gjere impaktet ndihen edhe në nivelin rajonal dhe përgjate kufijve (psh: në migrimin e karnivoreve të medhenj, rruget e migrimit të shpendeve, vijat ujore të kalimit nderkufitar etj.). gjatë ndërtimit ose rindertimit të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurter dhe të kthyeshme (psh ndotje nga zhurmat e sheshit të ndërtimit, kafshet largohen prej makinerive të ndërtimit, etj.). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në perdiorimin e tokës (psh nderprerja e rrugëve të migrimit, rritja e zhurmes nga strukturat e zhvilluara në vend, pengesa në mjedis – linja elektrike, etj.).

Biodiversiteti një variabel i varur nga faktore dhe komponënte të tjere natyrore, është në shkallë të ulët të ruajtjes, ndonse në disa zona periferike një shkallë e mirë biodiversiteti mund të rehabilitohet. Sidoqoftë zona e mbrojtur është një aset shumë i vlefshem shumefunksional: biodiversitet, turizem dhe rekreativitet.

Ndertimi i strukturave të reja dhe rindertimi ose modernizimi i infrastrukturës ekzistuese mund të rezultojë në:

Humbje të zonave të habitatit dhe llojeve të habitatit dhe perfaqesuesve individuale të llojeve të bimeve dhe kafsheve (impact direkt, i perhershëm);

Ndikimi i drejtpërdrejtë dhe vijueshëm mbi funksionimin e disa habitateve për shkak të fragmentimit të habitatit;

Ne rastin e aktiviteteve me shtrirje të gjere në një habitat me të rrezikuar, një impact direkt është i mundshëm mbi biodiversitetin e zones me të ngushte ose të gjere (impakt permanent);

Kalimet e reja shpesh fragmentojnë habitatet e kafsheve të egra dhe nderpresin rruget migratore dhe rrugical e fluturimit ose pengojnë migrimin e disa grupeve të kafsheve (veçanerisht të gjitareve dhe amfibeve, nese një rrugë kryqezohet me një korridor migrimi ose fluturimi, konflikte me shpendet dhe lakuriqet e nates janë gjithashtu të mundshme), të cilat mund të pengojnë në mënyrë permanente migrimin e kafsheve individuale midis popullatave individuale dhe të shkaktojnë një rënie të biodiversitetit në disa zona (impakt direkt, kumulativ, i largët);

Shumica e problemeve të migrimit ndodhin në fazat e ndërtimit të infrastrukturave të medha ku nuk ka përkujdesje për rindërtimin e kalimeve dhe komunikimeve të shkëputura të habitateve (psh: ndërtimi i urave të gjelbërta). Kjo duhet të merret parasysh kur projektohet dhe ndërtohet (impakt direkt, në distance);

Zhurma ka impact negative veçanerisht për shpendet dhe gjitarët dhe nuk është i pranishëm vetëm në distancën me të afërt të aktivitetit, por përhapet mjaft me gjere (impakt në distance);

Rrezatimi në drejtim të qiellit prej ndricimit të strukturave të ndryshme të infrastrukturave mund të krijojë shqetësim direkt në ciklin jetësor, veçanërisht për kafshet që janë aktive natën dhe ato që janë aktive në mbremje;

Pozicionimi i aktiviteteve në uje ose në tokat në krahe të vijave ujore (që lejohet për mareveshje me rëndësi kombëtare dhe që nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të permasave të mëdha), mund të krijojë impakte negative permanente dhe direkte për habitatet ujore dhe ato përgjatë vijave, veçanërisht kur infrastruktura shtrihet përgjatë rrjedhave ujore.

Në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit paraqiten sfidat kryesore lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë: (1) nevoja për të krijuar rrjetin ekologjik Natura 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Evropian; (2) ristrukturimin dhe forcimin organizativ të strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura; dhe (3) nevoja për të garantuar zbatim me efektiv të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe planet e veprimtimit për llojet dhe habitatet.

Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve migratore të kafshëve dhe në këtë mënyrë të arrihet objektivi i SKZHI II “Përmirësimi dhe forcimi i mbrojtjes së natyrës”. Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin përkatës të masave zbutëse duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

Udhëzime të përgjithshme dhe masa zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisore 6

Sigurimi i kohezionit të sub-popullatave dhe biodiversitetit nënkupton aplikimin e masave të përhershme zbutëse ndaj ndikimeve mjedisore dhe e protokolleve të monitorimit të komponenteve faunistik dhe floristikë. Bazuar në vendin e zbatimit të projektit sigurimi i funksionimit të habitateve në zonën përreth vendosjes së projektit si kanalet kulluese dhe rrugët e komunikimit ujor, mjediset specifike si pellgje ujore (të përkohshëm ose të përhershëm), shkurret dhe pyjet në zonën përreth, etj.

Zbutja e ndikimeve në lidhje me habitatet do të menaxhohet përmes zhvillimit të planeve specifike, të cilat do të specifikojnë masat e duhura për menaxhimin e aktiviteteve të pastrimit dhe gjurmimit të zonës, trajnimin e stafit për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit, si dhe menaxhimin e tokës dhe mbetjeve. Po kështu, pastrimi i vegjetacionit duhet të kufizohet vetëm në ato zona ku kërkohet prej aspekteve teknike dhe operacionale, duke siguruar funksionimin e hapësirave të tjera. Gjatë fazës ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës duhen planifikuar zgjidhje teknike të përshtatshme duke parandaluar ndikimet negative mbi komunikimet ujore dhe aksidentet e pazakonta (psh derdhjet e lëndëve të rrezikshme ndaj faunës dhe florës). Ndikimet ndaj larmisë biologjike do të zvogëlohen duke adoptuar praktikën të mira të punës, sic janë:

- Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit dhe Rimëkëmbjes, për të identifikuar masat që do të nxisin përmirësimin biodiversitetit lokal dhe kërkesat e monitorimit. Në çdo situatë do të kërkohet dhe plan vjetor masash për sigurimin e zbatimit të kërkesave të Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit dhe Rimëkëmbjes.

- Gjatë të gjitha fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit duhet të punësohet një ekolog për të mbikëqyrur punimet e pastrimit të habitateve dhe të japë këshilla për situatat kur kërkohet.
- Shmangia e shqetësimeve ose punët brenda kanaleve të kullimit dhe ujitjes në zonën përreth projektit, sigurimi i komunikimeve ujore, dhe aty ku kërkohen punime për të mbrojtur projektin si pjesë e skemës së kullimit, duke siguruar që që punimet të ndërmerren me kujdes dhe rehabilitimi i kanaleve për të mënjeluar humbjet shtesë në habitat.
- Zonat e ndjeshme mjedisore dhe habitatet kritike në rrethinat e zbatimit të projektit do të shënohen qartë dhe do të shënohen si 'Zona të Ndaluara' (p.sh., laguna) dhe qasja nga stafi dhe kontraktorët do të jetë rreptësisht e ndaluar.
- Kufizimi i aktiviteteve të pastrimit të zonave vetëm në ato hapësira ku kërkohet kjo dhe shmangia aty ku është e mundur duke minimizuar largimin e vegjetacionit ose shqetësimin e habitateve.
- Humbja e habitatit dominues në zonën e projektit "1310 Salicornia and other annuals colonizing mud and sand" që do të preken nga ndërtimi, dhe që është i përfshirë në Shtojcën i të Direktivës së Habitatit të BE -së duhet të kompensohet në zonën përreth ndikimit pranë hapësirës së zënë nga projekti. Kjo mund të përfshijë mbjelljen e bimësisë vendase në zonat ngjitur.
- Mbjellja e bimësisë (dru, shkure, barishtore) duhet të sigurojë lidhje organike me mjediset përreth dhe duhet të realizohet përmes llojeve auktoktone duke mënjeluar rreptësisht mbjelljen e llojeve aloktone.
- Zhvillimi i një plani/procedurë të kontrollit të erozionit dhe sedimenteve brenda zonës dhe rrethinës së projektit për të përcaktuar masat që parandalojnë dhe/ose zvogëluese të ndikimeve për shkak të erozionit dhe krijimit të sedimenteve.

Objektivi 7. Mjedisi Natyror – Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme

Zbatimi i Planit merr në konsideratë dhe, përgjithësisht është në përputhje me strategjitë dhe Planet Kombëtare të veprimit (Strategjinë ndërsektoriale të Mjedisit, Strategjinë Sektorial të Turizmit, Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Plan i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit, Strategjia e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural, Ligjin për Mbrojtjen mjedisit, Ligjin e Planifikimit të territorit). Me zbatimin e Planit ndryshimet në përdorimin e tokës, vegjetacion, florë, faunë, peshq, zogj, cilësinë e ajrit, ujit dhe zhurmat, do të ndikojnë në cilësinë e mjedisit, nderkohe që masat zbutese tentojnë të ekuilibrojnë ndikimet me rimëkëmbjen. Masat përmirësuese nuk mund të parashikohen në detaje në këtë plan; ato do të jenë konkrete gjatë secilit faze zhvillimi të Planit.

Zhvillimet infrastrukturore në mjediset natyrore përfaqësojnë një humbje permanente të habitateve dhe ndikojnë në mënyrë negative permanente në perhapjen natyrore të tipeve të habitateve dhe ato të habitateve të llojeve të bimeve dhe kafsheve, në cilesinë e tyre dhe në integritimin e habitateve të popullatave. Pishat e mbjella para 40 vjetesh janë zhvilluar në perputhje me habitatin rrethues të livadheve të kripura të dominuara nga salicornia dhe fragmites në ane të kanaleve dhe pellgjeve. Sipas relacionit të Planit nuk do të preket asnjë dru pyjor të zhvilluar, nderkohe që në situatën aktuale pjesa dermuese e tyre është cenuar për shkak të zjarreve të viteve të fundit. Plani parashikon një mbrojtje aktive të burimeve natyrore dhe pejsazhit të mbrojtur në zonën e Nartës, duke synuar mbrojtjen e mjedisit dhe ekosistemit, por njëkohësisht edhe përdorimin e tyre në dobi të publikut dhe zhvillimin e turizmit natyror pa pasoja të drejtpërdrejta mbi këto sisteme.

Gjatë periudhës së ndërtimeve të reja ose rindërtimeve të sistemeve të infrastruktures, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshëm (psh: ndotje nga zhurma në kantierin e ndërtimit, turbullimi i vijave ujore). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin tokës (psh, rritje e ndotjes nga zhurmat prej transportit, pengesat në mjedis, shkatërrimi i habitateve të një lloji të kualifikuar, etj. Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin perkates duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

Po kështu Plani konsideron sinergjinë midis ekoturizmit me natyrën e mbrojtur duke kembyer benefite të ndërsjellta: shërbime funksionale të shërbimeve të ekosistemit në këmbim të mbrojtjes dhe përmirësimit të ekosistemit. Plani paraqet mënyrat për rritjen e vlerave rekreative të peizazhit natyror dhe kulturor duke promovuar ripërdorimin e vendeve arkeologjike, përmirësimi i aksesit dhe sinjalistikës dhe krijimin e rrugëve piktoreske apo shtigjet për këmbësorët në mënyrë që të promovojë aktivitetet ekoturistike.

Zbatimi i planit nuk çënon monumentet e natyrës, lagunat, rrugëkalimet ujore dhe komunikimet midis habitateve, duke ruajtur funksionimin e ekosistemeve dhe pjesën e mbrojtur natyrore.

Në ndikimet e pritshme përfshihen:

- Rritja e presionit human në vegjetacion të të gjitha tipeve si pasojë e zhvillimit;
- Rritja e rrezikut nga zjarret, në periferi të zones së ndërtimit ;
- Rritja e presionit mbi vegjetacionin e anës së kanaleve lidhes të lagunes/kripores me detin (nepermjet stacionit të pompave - hidrovorit) për shkak të shetitoreve ose rruges/shtigjeve të kembësoreve ;
- Rritja e presionit në vegjetacionin pyjor aktual (te pishave) për shkak të ndryshimit të llojshmerisë së drureve të rinj që do të mbillen në kopështe të ndërtimeve dhe/ose vilave;

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 7

Ndërkohë që masat specifike zbutëse përfshijnë :

- Hartimi i Projektit të Detajuar konform ligjit të urbanistikës nën drejtimin e Bashkisë dhe Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;
- Para dhënies së lejes investitori do të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me Bashkinë Vlorë për të siguruar aksesin publik në zonën e mbrojtur ku do të zhvillohet projekti ;
- Kompania duhet të ketë të ngritur (apo të bashkepunojë me të trete) një sistem të plote manaxhimi e monitorimi ;
- Nuk lejohet të demtohen asociacione bimore me kritere të veçanta peizazhiere (drure, kallamishte, barishtore).

VI.3.7 Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Zhvillimi i zonave të caktuara mund të çenojë integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. Pikat e vjetra e të nxehta përbejnë rrezik për shëndetin e njeriut.

Djedia e mbetjeve në fushë dhe përhapja e ndotësve nëpërmjet ajrit konsiderohet si një rrezik serioz për shëndetin, gjë që krijon rreziqe potenciale për shëndetin e banorëve lokal. Rrjedhjet e mbetjeve nga fusha ndotin ujërat sipërfaqësore të lumenjve që kalojnë pranë. Pamja e shëmtuar vizive e territorit që ndikon në imazhin e tij të përgjithshëm dhe tërheqës për aktivitetet, vizitorët dhe banorët. Shpesh, mbetjet në këto zona depozitohen në lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga ujrat dhe në këtë mënyrë zhvendosen drejt në një pjese tjetër tokë dhe në fund të rrjedhjeve ujore në det. PDZRK Vjosë-Nartë synon eliminimin e venddepozitimeve të mbetjeve përgjatë lumenjve si dhe përdorimin e tyre si hapësira të gjelbra. Kjo do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të zonës.

Ekziston një rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme dhe atyre spitalore në zona të pacaktuara. Shkarkimi i tyre në uj, ajër ose tokë shkakton rreziqe për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, sjell ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore, pastrimi i të cilave kërkon kosto të mëdha.

Aktivitetet e riciklimit kufizohen tek sektori informal dhe sektori privat zhvillon mbledhjen e pjesëve të riciklueshme të mbetjeve jo nëpërmjet sistemit. Plani parashikon riciklimin përkrah rritjes së kapacitetit të landfilleve.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutese për të arritur Objektivin Mjedisor 8

Gjenerimi i mbetjeve ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore. Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si më poshtë:

- Rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisorë dhe ripërdorimi i tokës , duke i kthyer në zonë të gjelbra me vlerë rekreative, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë.
- Të studiohen të gjitha territoret e objekteve industriale që kanë përdorur ose gjeneruar kimikate të rrezikshme për shendetin dhe të prioritizohen mbi bazën e shkallës së rrezikut, duke zbatuar të gjitha direktivat e BE-së që lidhen me ndotjen e rrezikshme të tokë.
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe përfshirja në planet rajonale e vendore të menaxhimit të mbetjeve.
- Janë të domosdoshëm buxhete të mjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve, që përfshijnë gjithashtu dhe sektorin privat.
- Të konsiderohet ngritja e një landfilli industrial për depozitimin e mbetjeve të ngurta industriale, mbas trajtimit të tyre me metodat e përcaktuara nga Konventa e Bazelit, duke shmangur depozitimin e tyre në landfillet urbane.
- Plani duhet të saktësojë orientimin drejt trajtimit të tyre sipas hierarkisë që është më praktikja dhe më e arritshmja në nivelet e ulta, të nderlidhura me masa që varen shumë nga aktorët kryesorë në qeverisjen qendrore, politikat e saj dhe përgjegjësitë e prodhuesve. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve duke vendosur standarde lokale.
- Duhet planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit dhe kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombetare (veçanërisht për fondet e BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme.
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve.
- Përcaktimi i zonave ndërkufitare detare për menaxhimin e incidenteve të ndotjes industriale.

VI.3.8 Zhurmat

Objektivi Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE-ja dhe OBSH-ja.

Në zona individuale pritet një nivel më i lartë i ndotjes mjedisorë gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej gjatë fazës së funksionimit. Ndaj, masat zbutëse duhet të realizohen gjatë fazës së ndërtimit, veçanërisht mbikqyrja e shkarkimeve prej makinerive të ndërtimit, vendosja e një kohe të kufizuar për ndërtimin dhe nëse nevojitet zbatimi i masave për të parandaluar që zhurma të përhapet në mjedis. Ndikimet gjatë fazës së funksionimit do të jenë afatgjatë. Projektet me shtrirje të gjerë ose si korridore (rrugë, linja tubacionesh, shtylla elektrike, etj.) nënkuptohet të kenë ndikim më të madh mbi mjedisin dhe në mënyrë direkte përgjatë korridoreve.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 9

Zbatimi i masave është i nevojshëm në zonat ku ndotja akustike tejkalon normat e lejuara në situatën aktuale, ndërsa nevojitet gjithashtu të merren masa zbutëse në të gjitha zonat ku

parashikohet infrastrukturë e re. Duhet të respektohen udhëzimet e mëposhtme për të arritur objektivin e reduktimit të ndotjes nga zhurma:

- duhet të sigurohen masa për të reduktuar shkarkimet e zhurmës në burim (masa nëstrukturën përkatëse infrastrukturore, automjetet në përdorim, masa logjistike, riorganizimin e levizjeve tranzitore, reduktimi i orareve të punës apo zvogëlimi i shpejtësisë në zonat e ekspozuara ndaj zhurmës, etj.) ;
- në zonat ku tejkalohen kufijtë e ndotjes, duhet të merren masa për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis (nëpërmjet barrierave të zhurmës dhe argjinaturave) dhe për të siguruar kushte të mira jetese (mbrojtja pasive);
- duhet të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta të banuar dhe në zona të cilat janë të përcaktuara në bazë të legjislacionit për mbrojtjen nga zhurma si veçanërisht të ndjeshme ndaj zhurmës;
- duhet të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e mbrojtura, në përputhje me rregullat për ruajtjen e natyrës.
- përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës për makineritë e përdorura në vende të hapura dhe në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
- mirëmbajtja e duhur e impianteve, për të minimizuar zhurmat e prodhuara nga operacionet në terren, dhe në të gjitha rastet, në përputhje me rregullat shqiptare;
- zonat e ndërtimit dhe rruget e transportit duhet të zgjidhen në mënyrë që ndotja akustike nga makineritë e transportit, funksionimi i pajisjeve dhe ndërtimet e objekteve, të mos tejkalojë vlerat kufi;

Përsa i përket ndërtimit të aeroportit të ri duhet të sigurohen standartet e adoptuara botërisht për emetimet e mjeteve fluturuese dhe masat logjistike për menaxhimin e transportit ajror. Reduktimi i emetimeve i shkaktuar nga transporti ajror rregullohet përmes Rregullores së BE-së Nr. 598/2014 mbi vendosjen e rregullave dhe procedurave në lidhje me futjen e kufizimeve funksionale në lidhje me zhurmën në aeroportet e BE-së.

VI.3.9 Trashëgimia kulturore

Objektivi Mjedisor 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonës dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Zhvillimet e infrastrukturës mund të krijojnë ndikime direkte në njësi dhe zona të trashëgimise kulturore gjatë fazës së ndërtimit dhe të funksionimit si rezultat i efekteve të mëposhtme:

- degradimi i veçorive të peizazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore (ndikim indirekt, i pakthyesëm);
- dëmtimi i strukturave të trashëgimisë kulturore (ndikim direkt, i pakthyesëm);
- shkatërrim i mbetjeve arkeologjike gjatë fazës së ndërtimit (ndikim direkt, lokal, i pakthyesëm);

- vibrime që mund të shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë kulturore (ndikim indirekt, i pakthyesëm);

- clirime gazrash ndotës që bëjnë pjesë në formimin e shirave acid dhe që shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë (ndikim indirekt, kumulativ, në distancë).

Duhet të zbatohen masa të përshtatshme për të ruajtur veçoritë e trashëgimisë kulturore të zonës. Nga aspekti i ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte shkatërruese (p.sh. gërmimet).

Gjatë fazës së funksionimit, mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv mbi trashëgiminë kulturore. Aksesimi më i lehtë tek zonat me rëndësi historike dhe kulturore do të rezultojë në rritjen e numrit të vizitorëve.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 11

Zhvillimi i infrastruktures se parashikuar mund të ndikojë të njesite dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë ndërtimit të objekteve. Për të shmangur keto ndikime, duhet të merren parasysh si më poshtë:

- Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore. Duhet të ruhet sidomos integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, zonave të ndikimit të trashëgimisë arkitektonike dhe mbetjeve arkeologjike.

- Nevojitet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re. Gjithashtu do të duhet të zbatohen masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike.

- Në rastet kur vendet arkeologjike mund të rrezikohen nga aktivitetet e ndërtimit, vendi do të jetë i mbrojtur nga rrethimi për të parandaluar dëmtimet e paqëllimshme.

- E gjithë puna e ndërtimit duhet të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve. Në rast se nevojiten më shumë hapësira ose aktivitete të lidhura me ndërtimin jashtë korridorit të punimeve, do të informohen paraprakisht autoritetet kombëtare përkatëse.

- Zbulimet e një rëndësie të madhe mund të kërkojnë ndryshimin e projektit. Në rast të zbulimit të gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, sipas nënit 146 të Ligjit 27/2018, kërkohet që në rast të zbulimit rastësor të artefakteve kulturore të ndalohen punimet dhe brenda 3 ditëve të njoftohen autoritetet përgjegjëse lokale. Këto autoritete janë: Zyra e Bashkisë, Rajoni i Policisë dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK). DRTK kryen verifikimin në terren dhe raporton pranë IMK. Institucionet më sipër janë përgjegjëse për vlerësimin arkeologjik të gjetjeve rastësore si dhe vendimin nëse punimet duhet të vijojnë apo pezullohen deri në përfundimin e vërtetimit të duhur në terren.

VI.3.10 Peizazhi

Objektivi 12. Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.

Ndikimet në cilësinë e peizazhit and aspektet vizuale nënkuptojnë ato ndryshime në mjedisin ekzistues që mund të çenojnë karakterin e një zone dhe që përjetohet nga banorët dhe turistët. Ndikimet në këtë burim drejtim të jenë ndikime dytësore ose indirekte si rezultat i aktiviteteve të projektit.

Përcaktimi i ndikimeve mbi cilësinë e peizazhit, buron kryesisht nga veçoritë vizive të hapësirës dhe nga elementet karakteristike të peizazhit që janë të pranishme në këtë hapësirë. Peizazhi cenohet me shumë nga infrastruktura që shtrihet në zona të hapura, ku impaktet janë me të dukshme për shkak të një niveli të shtrirjeje (impakte të përheshme, të pakthyeshme).

Ndikimi është veçanërisht i lartë në rastin e një nderhyrjeje infrastrukturore në zona me peizazhtë jashtëzakonshme, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elemente natyrore të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik. Impaktet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të perkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Strukturat infrastrukturore në hapësirë, behen elemente të peizazhit dhe pjeë përbërëse e tij. Kështu që, sistemimi i këtyre strukturave duhet të bëhet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të peizazhit.

Marrja në konsideratë e veçorive natyrore dhe topografise së zonës ku parashikohet të zhvillohet projekti, do të reduktojë fragmentimin e peizazhit. Udhezimet e përgjithshme dhe masat zbutese që paraqiten në pjesën vijuese të VSM-së duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

VI.3.11 Popullsia dhe Ekonomia Lokale

Objektivi Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Në vijim të impakteve mbi shëndetin human, arritjet e këtyre objektivave influencojnë gjithashtu konsiderueshëm situatën ekonomike të njerezve dhe asetet materiale që ata kanë në dispozicion. Gjithashtu, ato kanë sinergji të rëndësishme pasi synojnë të kufizojnë rritjen e mbipopullimit, kërkojnë përdorim në rritje të zgjidhjeve mbi ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës, hapësirës dhe energjisë, si edhe të efekteve të demshme mbi asetet materiale për shkak të ekspozimit të tyre në mjedise të ndotura. Impaktet do të jenë pozitive, permanente dhe rajonale.

Lidhur me problemet kryesore që lidhen me çështjet e mirëqënies, sigurisë dhe shëndetit, në mënyrë të përmbledhur ato kanë të bëjnë me aksesimin e trafikut dhe transportit në zonat urbane dhe rurale, lidhur ngushtë me lëvizshmërinë drejt tregjeve dhe ruajtjen e lidhjeve në komunitet. Ndërkohë komunitetet lokale e kanë sfidën më të madhe me ruajtjen e situatës social-ekonomike (përfshirë bujqësinë, hortikulturën, akuakulturën, pyjet, shërbimet utilitare, edukimin etj.). Zhvillimet e parashikuara në Plan detyrimisht që do të shkaktojnë me shumë trafik, me shumë emetime, me shumë zhurmë dhe me shumë trysni mbi burimet natyrore. Për të patur një zhvillim të qëndrueshëm Plan parashikon, ndër të tjera edhe zhvillimin e sistemeve të trajtimit të mbetjeve

dhe të ujrave të zeza. Në këtë këndvështrim problemet që shkaktohen nga menaxhimi i dobët i këtyre sistemeve ka gjasa të zvogëlohen.

Fokusimi në zhvillimet infrastrukturore që i përgjigjen realizimit të qëllimeve dhe objektivave përkatëse, kryesisht për t'i shërbyer rritjes së pritshme të numrit të vizitoreve në zonat përkatëse, mbart me vete rrezikun që komunitetet dhe vendbanimet ekzistuese mund të neglizhohen nga pikëpamja e shërbimeve komunitare. Ndërkohë që zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik pritet që të kontribuojë në rritjen e mirëqënies së njerëzve, ekziston rreziku që rritja ekonomike të këtë një shpërndarje të çekuilibruar. Ndër rreziqet dhe shkaqet e tyre mund të përmëndim:

- Mungesa e transportit dhe levizshmërisë e shkaktuar nga humbja e lidhjeve me tokën bujqësore, plazhet dhe shërbimet sociale, si dhe nga një transport public i pamjaftueshëm.

- Prishja e cilësisë së jetës që vjen si pasojë e zhvillimeve të reja të cilat dëmtojnë mënyrën tradicionale të jetesës dhe sjellin rritje të kostove bazë të jetesës.

Ndërgjegjësimi i njerëzve mbi problemet mjedisore nuk rezulton automatikisht me ndryshimin e sjelljeve të tyre. Duke dhënë informacione, rritur ndërgjegjësimin, dialogimin me të gjitha palet e interesuar dhe me përfshirjen e publikut në proceset vendimarrëse për politikat e propozuara do të kontribuojë se tepërmi në ndryshimin e modeleve të sjelljes përse i takon zgjidhjeve të qëndrueshme, gjë që është theksuar së tepërmi edhe në udhëzimet strategjike të Planit Kombëtar Mjedisor të Veprimt. Plani ofron zgjidhje që kanë të bëjnë me mobilitete të qëndrueshme alternative si është rasti i trafikut të biçikletave dhe makinave elektrike që klasifikohet midis menyrave me të pershtatshme të transportit në terma mjedisor dhe të shendetit. Në nivel kombëtar ky përafrim me anë të sistemit të rrugëve për biçikletat dhe makinat elektrike mund të lehtësojë transferimet në distancat e zakonshme të lëvizjeve nëpër qytete dhe zonat fushore dhe bregdetare në distance të shkurtera dhe për rekreacion në distance të gjata. Krijimi i rrugëve të biçikletave dhe rrugicave të marshimeve me anë të aksesimit të përshtatshëm në qendrat e rekreacionit do të kishte një impakt pozitiv në shendetin human.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 10

Zhvillimet e reja infrastrukturore (sidomos qëndra etransportit ajror) pritet që të shkaktojnë një rritje të niveleve të zhurmës në mjedisin përreth tyre. për të shmangur një perkeqesim të mjedisit ku jetohet në zonën përreth këtyre zhvillimeve, ky fakt duhet të mbahet në vëmendje kur të behet verifikimi i mundësive për zhvillim në fazat e mëvonshme, në kuader të sigurimit të një lidhje multimodale në rajonin përreth.

TRASHËGI MIA KULTUROR E	!!	+	>>	I R	0	?	P	S Y	Projekti i infrastrukturës rrugore parashikohet të ketë ndikime pozitive në shkallë të lartë, pasi garanton mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Këto ndikime janë të përhershme dhe të pakthyeshme. Ato janë në sinergji edhe me masa të tjera që parashikohen për të mbrojtur dhe promovuar këtë sektor. Është e rëndësishme të theksohet se realizimi apo jo i ndikimit lidhet edhe me zbatimin e marëveshjeve institucionale, kryesisht në kuadër të përcaktimit të statusit të mbrojtur të elementëve përkatës.	Infrastruktura rrugore duhet të projektohet në harmoni me standartet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementët e cilësisë së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar metodat më të mira. Duhet të respektohen distancat e zonës buferike për infrastrukturën rrugore, me gjerësi 50m. Në rast të zbulimit rastësor të artefakteve kulturore të ndalohen punimet dhe brenda 3 ditëve të njoftohen autoritetet përgjegjëse lokale (Zyra e Bashkisë, Rajoni i Policisë dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore).
PEIZAZHI									Masat në fjale pritet që të kenë impakte negative në shkallë të ulët. Keto impakte janë afatgjata, të kthyeshme dhe kumulative.	Ky projekt duhet të zhvillohet në harmoni me standartet e ruajtjes së peizazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësisë së mjedisit të

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT TË DETAJUAR TË ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE
(PDZRK) VJOSË-NARTË



	!	-	>	I R	0	?	S	C		jene paresore duke aplikuar praktikat me të mira.
--	---	---	---	--------	---	---	---	---	--	---

KAPITULLI VII: VLERËSIMI I SISTEMIT TË PLAN - MONITORIMIT

VII.1 VLERËSIM I PËRGJITHSHËM

Larmia biologjike e zonës së studimit si pjesë e rajonit të Vlorës përfshin zona të rëndësishme natyrore siç është ajo e Lagunës së Nartës, Gadishullin e Karaburunit dhe Ishullin e Sazanit, të cilat bazuar në pozicionin gjeografik, natyrën e substratit dhe klimës dallohen për llojshmërinë, karakteristikat specifike të llojeve bimore dhe shtazore që ato strehojnë dhe sasinë e tyre të konsiderueshme, duke e kthyer tërësinë natyrore të rajonit një kombinim të një rendësie të veçantë.

Monitorimi i mjedisit nuk është qëllim në vetvete (UNDP, 2018; EEA, 2012; EEA, 2014; EEA, 2015), por ai është një mjet për të marrë informacion mbi cilësinë dhe problemet me të cilat përballet vendi në secilën prej komponenteve të mjedisit (ajri, uji, toka), natyra-biodiversiteti dhe pyjet (AEAT/ENV/R/2088, 2006). Ai është një mjet për të mbështetur politikëbërjen për përmirësime në fusha të ndryshme, dhe gjithashtu për të matur shkallën e suksesit me zbatimin e politikave përkatëse. Ai është gjithashtu një mjet për të mbështetur raportimin e vendit në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe gjithnjë e më shumë në BE dhe EEA. Në mënyrë që një raportim i tillë të jetë i rëndësishëm, i besueshëm, i pranueshëm, dhe i krahasueshëm dhe që përputhet me raportimin e vendeve të tjera, monitorimi i secilit parametër duhet të ndjekë të njëjtën metodologji.

Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 1189 “Për rregullat dhe procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit” u miratua në fund të vitit 2009, bazuar në nënin 100 të Kushtetutës dhe pikën 8 të nënit 53 të Ligji Nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Ai është një version i zgjeruar dhe i rishikuar i VKM Nr. 103, datë 31. 03. 2002 “Për monitorimin e mjedisit në Shqipëri”. VKM-ja ka 6 nëne dhe një aneks që përmban katalogun e Treguesve të ndarë në 3 kategori (gjendja, ndikimi dhe stresi) dhe të grupuara sipas temës mjedisore. Artikulli i parë (i. të Përgjithshme) përmban terminologjinë e Vendimit. Treguesit e Mjedisit janë të veçuar në ata që japin informacion në lidhje me "gjendjen" dhe ata që shprehin "streset". Përkufizimi i kësaj të fundit, siç përshkruhet në VKM, ka të bëjë me stresin vetëm me efektet e ushtruara në mjedis nga burimet e ndotjes. Ky përkufizim është i pjesshëm dhe nuk përfshin forma të tjera të presioneve mjedisore që janë shkaktuar nga presione të tjera përveç ndotjes (p.sh. konsumimi i tepërt i një burimi natyror, ndryshimi i klimës, etj.).

Sipas vlerësimit të këtij raporti, përshkruar në kapitujt e mësipërm sistemi i monitorimit dhe në mënyrë të veçantë objektivat dhe treguesit e tij janë rrjedhojë logjike e punës intensive dhe të detajuar të vlerësimit dhe e nevojës për të ndjekur në vazhdimësi zbatimin e planit paralelisht me masat e detajuara të ndikimeve mjedisore.

Bazuar në raporte të ndryshme, nivelet aktuale të monitorimit deri më sot në nivelet vendore duke përfshirë dhe Vlorën kanë qënë të pakënaqshme gjë e cila lidhet me shumë faktorë (DEA, 2016). Duke qënë se sot tendenca e turizmit ecën në drejtim të rritjes së kërkesave lind nevoja për një monitorim të vazhdueshëm dhe serioz. Mungesa e kapaciteteve monitoruese si për nga teknologjia ashtu edhe ai njerëzor e vështirëson monitorimin, për këtë arsye ekspertët kanë përpunuar një system monitorues të thjeshtë i cili reflekton një nivel mesatar zhvillimi dhe kërkesash për aftësi të stafit, për një të një Bashki Evropiane të një niveli të mesatar (DEA, 2016). Sistemi përputhet me të gjitha kërkesat kombëtare dhe parashikon edhe kërkesa të reja për integrim në të ardhmen që mund të lindin si rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare që mund të lidhë qeveria shqiptare.

VII.2 SISTEMI I MONITORIMIT

Sistemi i monitorimit të ndikimeve të ndryshme në mjedis, të cilat do të shkaktohen nga zbatimi i aktiviteteve të Planit, është një mjet i përshtatshëm për t'u përdorur për një monitorim efikas. Pra, plani i monitorimit të mjedisit është korniza kryesore e menaxhimit që investotët do të zbatojnë për të siguruar zbatimin e masave zbutëse dhe sigurojnë një monitorim adekuat të performancës mjedisore dhe sociale.

Monitorimi i ndikimeve mjedisore është jashtezakonisht i rëndësishëm për zbatimin e Planit, dhe, në përputhje me Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe Direktiven 2001/42/EC, zbatimi i një program duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershem ndaj ketyre efekteve dhe të behen adaptimet e mundshme.

Sipas perceptimit të VSM-së dhe synimit të lehtësimit në përdorimin praktik për strukturat zvatuese të planit dhe grupet e tjera të interesuara, është e nevojshme që të përcaktohen disa tregues dhe një sistemi monitorimi që do ta bënin atë sa më të thjeshtë dhe praktik, duke përdorur si burimet ekzistuese ashtu dhe aktivitetet shtesë.

Sistemi i monitorimit do të sigurojë që palët e interesuara të realizojnë:

- Monitorimin e progresit drejt objektivave të Vlerësimit Strategjik Mjedisor;
- Monitorimin e ndikimeve mjedisore që vijnë nga zbatimi i Planit.
- Identifikim e ndikimeve negative të paparashikuara mbi mjedisin apo të paralajmërohen në stadi të hershme
- Mundësim për veprime korrigjuese/adaptuese të përshtatshme dhe në përputhje me objektivat dhe detajimet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Vlerësimi i ndikimeve (shih Kapitullin V Ndikimet Negative) përshkroi aktivitete ose aspekte të caktuara të projektit të cilat, nëse nuk do të zbuten, do të kishin potencialin të ndikonin

negativisht në një sërë burimesh mjedisore dhe receptorët socialë brenda zonës së ndikimit të projektit. Masat zbutëse dhe veprimet e menaxhimit për të eliminuar ndikimet e mundshme, kompensimi ose zvogëlimi i ndikimeve të mundshme të rëndësishme negative janë të identifikuar dhe përmbledhur në Kapitullin V, Masta Zbutëse. Monitorimi mjedisor është elementi kryesor i kornizës së menaxhimit mjedisor që siguron efikasitetin e masave dhe procedurave për menaxhimin dhe zbutjen e rreziqeve për receptorët fizike, biologjike dhe sociale gjatë të gjitha fazave të planit.

VII.2.1 Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit

Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis përcakton kornizën për: (i) Përcaktimi dhe përcaktimi i kufijve, pragut dhe vlerave të synuara për ndotës të caktuar në ajër; (ii) Vlerësimi i cilësisë së ajrit të ambientit në bazë të metodave dhe kriterëve evropiane; (iii) Marrja e informacionit mbi cilësinë e ajrit të mjedisit në mënyrë që të ndihmojë në uljen e ndotjes së ajrit dhe shqetësime dhe për të monitoruar tendencat dhe përmirësimet afatgjata që rezultojnë nga masat kombëtare dhe ndërkombëtare. (iv) Ruajtja e cilësisë së ajrit atje ku është e mirë dhe përmirësimi i saj në raste të tjera për zvogëlimi i emetimeve nga burimet e lëvizshme dhe ato fikse, etj. Ligji krijoi bazën ligjore për miratimin e VKM Nr. 352, datë 29.4.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe kërkesat për ndotës të caktuar të lidhur".

Në varësi të aktiviteteve Plani duhet të sigurojë edhe të marrë masat e nevojshme për uljen apo ruajtjen e vlerave brenda standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e mjedisit 2015-20 përcakton objektivat e qeverisë shqiptare për një numër ndotësish si: (i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NO_x - 40 µg/ m³, për PM₁₀ - 40 µg/ m³, për PM_{2,5-25} µg/ m³ dhe 0 µg/ m³ dhe SO₂-125 µg/ m³ për 24 orë ose 20 µg/ m³ në vit.

Tabela VII-1: Vlerat e kufi të ndotësve (burimi ISHP)

Periudha e monitorimit			Objektivat (2016)	
Ndotësit (µg/m ³)	Metoda	Vlera e periudhës mesatare	Standarti Shqiptar (µg/m ³)	Standarti BE (µg/m ³)
Pluhur total	gravim		140	80
PM ₁₀	ads		40	40
O ₃	ads		120	110
NO ₂	ads		50	40

Tabela VII-2: Niveli i kufi i ndotësve të ajrit për tu monitoruar

Ndotësit	Përqëndrimi	Periudha mesatare	Te monitorohet dhe
----------	-------------	-------------------	--------------------

			zvogëlohet nga viti
Grimcat e Imëta (PM2.5)	25 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2015
Dyoksidi i Squfurit (SO₂)	350 µg/m ³	1 orë	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
	125 µg/m ³	24 orë	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
Dyoksid Azoti (NO₂)	200 µg/m ³	1 orë	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
	40 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
PM₁₀	50 µg/m ³	24 orë	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2013
	40 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
Plumb (PB)	0.5 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2013
Monoksid Karbon (CO)	0.5 mg/m ³	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2013
Benzen	5 µg/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2010
Ozon	120 µg/m ³	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2010
Arsenik (As)	6 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2016
Kadmium (Cd)	5 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2016
Nikel (Ni)	20 ng/m ³	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2016
Hidrokarbure Aromatike	1 ng/m ³ (i shprehur si përqendrim i benzenit)	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2016
PM2.5 Përqendrim i ekspozuar i detyruar	20 µg/m ³ TME (Treguesi Mesatar i Ekspozimit)	Bazuar ne Mesataren e 3 viteve	Vlera Limit hyn në fuqi 31.12.2018

VII.3 MONITORIMI DHE VLERËSIMI I CILËSISË SË UJIT, NORMAT E UJIT TË PIJSHËM

Ligji Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" synon sigurimin e menaxhimit të integruar të ujit mbi bazen e krijimit të një kornize për mbrojtjen e burimeve ujore, e cila ndërmjet gjërave të tjera siguron monitorimin e statusit të ujit, përdorimin racional dhe uljen e ndotjes. Ligji integron kërkesa specifike të DKU (EC, 2003). Ky ligj ka sjellë

koncepte dhe përkufizime të reja në krahasim me ujin e mëparshëmlegjislationi përkatës. Ato janë në bazë të monitorimit të ujit që duhet të bëhet për të qenë në përputhje me të. Më poshtë ka disa përkufizime, të cilat janë shumë të rëndësishme për ata që merren me monitorimin e ujit.

Tabela VII-3: Treguesit fiziko-kimike të ujit të pijshëm dhe objektivat

Treguesit kimik	Vlerat e monitoruara të ujit të pijshëm në Vlorë	Standarte Kombetare ml/ujë	Maksimum	Objektiva nga 2018 (Direktiva e Këshillit 98/83/EC & të tjera)
Shija dhe era (numër hollimi)			2deg120C, 3deg250C	E pranueshme nga konsumatorët dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
Ngjyra dhe pamja e jashtme (mgL-1 shkalla Pt/Co)		1	20	E pranueshme nga konsumatorët dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
pH		6.5-8.5	9.5	≥ 6.5 dhe ≤ 9.5
Konduktiviteti elektrik (µS/cm)		40		2500
Kalcium (mgL-1)		75	200	200
Lendet pezull (mgL-1)				0
Turbullira (FTU)		0.4	4	Nuk ka udhëzime
Alkaliniteti (mg ekv/l)			n.v. ⁱ	Acc.pH
Karbonate (mgL-1)				250
Bikarbonate (HCO-3) (mgL-1)		H ₂ O jo CaCO ₃	n.v.	Acc.pH
Amonjak (mgL-1)		0	0.05	0.50
Nitrite (mgL-1)		0	0.05	0.5
Nitrate (mgL-1)		25	50	50
Fortesia Totale (°german)			20	36-71
Fosfate (mgL-1)		0,4	2,5	2.5
Lëndë Organike (mgL-1)		1	3	3
Klorure (mgL-1)		25	200	250
Sulfate (mgL-1)		25	250	250
TDS (mgL-1)		500		≤1500
Magnez (mgL-1)		20	50	0.05

ⁱe pa vlerësuar

Tabela VII-4: Treguesit mikrobiologjike të ujit të pijshëm dhe objektivat

Treguesit Mikrobiologjik	Burimi i përbashkët para Klorinimit	Vlerat në Vlore	Standarde kombëtare ml/ujë	Objektiva nga 2016 Direktiva e Këshillit 98/83/KE ml/ujë
<i>E.coli</i>			1/100	0/250
<i>Strept</i>			1/100	0/250
<i>Pseudomonas aeruginosa</i>			n.v.	0/250
Numri i kolonive 22oC			n.v.	100/ml
Numri i kolonive 37oC			n.v.	20/ml

VII.3.1 Ndotja akustike

Ligji Nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" ka transpozuar pjesërisht Direktivën 2002/49 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 qershorit 2002 në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore - Deklarata nga Komisioni në Komitetin e Pajtitimit mbi Direktivën në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore. Qëllimi i ligjit është mbrojtja e shëndetit publik dhe mjedisit nga zhurma. Ai përcakton kërkesat për monitorimin e zhurmës, vlerësimin, hartëzimin, etj. Monitorimi i zhurmës, si në burim ashtu edhe në mjedis së bashku me ndikimet negative në shëndet dhe mjedisi është i domosdoshëm. Monitorimi i zhurmës është një pjesë integrale e programit të monitorimit. Ekspertët e certifikuar kryejnë vetë-monitorim të zhurmës me shpenzimet e operatorëve.

Në përgjithësi vlera e synuar për zhurmat nuk duhet të kalojë vlerën maksimale prej Lmax-56 dB gjatë ditës dhe 45 dB gjatë natës në të gjitha zonat e zbatimit të Planit. Për të realizuar këtë duhen marrë masa të përshtatshme që të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat kombëtare dhe ato ndërkombëtare e sidomos me Direktivën e Zhurmave në Mjedis 2002/49/EC.

VII.3.2 Mbetjet dhe objektivat përkatëse

Duke u bazuar në DEA (2016) në Bashkinë e Vlorës hen rreth 125 000t mbetje në vit. Problematika e mbetjeve në këtë bashki kërkon një ndërhyrje të menjëhershme për një zgjidhje të shpejtë dhe afatgjatë. Plani dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor sugjeron ndërhyrje me projekte dhe

investime. Në plan parashikohet ndërtimi i një impianti me teknologji moderne që të diferencojë mbetjet dhe të djegë ato që nuk mund të trajtohen më tej, duke shfrytëzuar të gjitha cilësitë e këtyre mbetjeve, i vendosur në zonën industriale gjendet në rrugën për në fshatin Sherishtë.

Zhvillimi i Planit aktual kërkon integrimin e trajtimit në kuader të menaxhimit të integruar të parashikuar në DEA (2016). Sipas parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, miratuar përmes Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" çdo person që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte në mënyrë (prodhuesi i produktit) ka zgjeruar përgjegjësinë e prodhuesit. Kjo ka për qëllim të forcojë ri-përdorimin dhe parandalimin, riciklimin dhe rigjenerimin e mbeturinave. Prodhuesit duhet të pranojnë produktet e kthyer dhe mbeturinat që mbeten pasi të jenë përdorur ato produkte, si dhe menaxhimin e ardhshëm të mbeturinave dhe përgjegjësinë financiare për aktivitete të tilla.

Zbatimi i Planit dhe aktiviteteve në këtë drejtim do të mundësohen përmes respektimit të një numri të madh ligjesh dhe VKM (Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"; Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në

fund të jetës"; Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"; Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 "Për incinerimin e mbetjeve"; Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfilllet e mbetjeve"; Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 "Përmiratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"; Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"; Vendim nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"; Vendim nr. 117, datë 13.02.2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"; Vendim nr. 52 datë 5.2.2014 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"; Vendim nr. 798, datë 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjevespitalore"; Vendim nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"; Vendim nr. 371, datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"; Vendim nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; Vendim nr. 608, datë 17.09.2014 "Për përcaktimin e masave të nevojshme për nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"; Vendim nr. 641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte" dhe ligjin për importin e mbetjeve (2016) parimet strategjike kombëtare dhe ligjit mbi menaxhimin e mbetjeve si dhe duke zbatuar treparimet të BE lidhur me reduktimin e sasisë së mbetjeve: (i) Parandalimi të krijimit të mbetjeve; (ii) Duke ndihmuar në riciklim dhe ripërdorim; (iii) Duke përmirësuar grumbullimin final të mbetjeve dhe duke monitoruar. Kjo qasje e re do të çojë në një përmirësim të gjendjes së mbetjeve në të ardhmen.

Objektivat e monitorimit të mbetjeve janë:

1. **Parandalimi i krijimit të mbetjeve:** Ky është një faktor kyç në strategjinë emenaxhimit të mbetjeve. Plani duhet të synojë pakësimin e krijimit të sasisës së mbetjeve që në origjinë si dhe reduktimin e rrezikut që vjen prej tyre ngapakësimi i substancave të dëmshme, për pasojë edhe hedhja e grumbullimi i tyre do të jetë automatikisht më i thjeshtë.

2. **Ndihmë për industrinë e riciklimit:** Organizimi nga ana operatoreve të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, do të rrisë interesin e industrisë së riciklimit për grumbullimin dhe largimin e tyre nga zona.

3. **Përmirësimi hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi:** Atje ku është e mundur, për mbetjet të cilat nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren ato duhet të dërgohen në incinerator dhe në mundësi të fundit në landfill. Të dyja këtomundësi kërkojnë një monitorim të kujdesshëm pasi mund të sjellin dëmtimes serioze për mjedisin.

4. **Shmangie të hedhjes së mbetjeve det,** në shtretërit e përrrenjve dhelumenjve, buzë rrues apo në çdo vend tjetër jo të destinuar për hedhjembetjesh. Një synim i menjëhershëm duhet të jetë monitorimi i aktivitetit të ndërtimit, industrive prodhuese dhe turizmit.

VII.3.3 Ujërat e ndotura

VKM "Për trajtimin e ujërave të ndotura urbane" transpozon Direktivën 91/271 / EEC në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura urbane, të ndryshuar nga Direktiva 98/15 / EC, Rregullorja EC / 1882/2003 dhe Rregullorja EC / 1137/2008. AKM do të monitorojë shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane për të verifikuar pajtueshmërinë me kërkesat e lejes mjedisore dhe kërkesat e këtij vendimi. AKM do të monitorojë gjithashtu ujërat që janë subjekt i shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe shkarkimet direkte të mbetjeve industriale të biodegradueshme. Ministri, me anë të Urdhrit Ministror, miraton udhëzime për monitorimin e shkarkimeve dhe të ujit pritës.

VII.3.4 Larmia Biologjike dhe zonat e mbrojtura

Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit" ka për qëllim të mbështesë zbatimin e Konventës për Biodiversitetin në Shqipëri. Ajo ka vendosur kërkesa për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit. Ka kërkuar krijimin e një rrjeti monitorimi dhe inventarizimi të biodiversitetit në Shqipëri, si burimi kryesor i informacionit për vendimmarrjen përkatëse në të gjitha nivelet. Ligji Nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, date 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar ka transpozuar plotësisht nënin 2 (pika 2 dhe 3), nënin 3 (pika 1 dhe 2), nënin 4 (pika 1), nëni 6 (pika 2), nëni 11, nëni 12 (pika 4), nëni 14 (pika 1) dhe nëni 17 (pika 1) të Direktivës së Këshillit 92/43 / KEE të 21 majit 1992 për ruajtjen e habitate natyrore dhe të faunës dhe florës së egër, të ndryshuar nga Direktiva e Këshillit 97/62 / EC të 27 Tetorit 1997 duke iu përshtatur përparimit teknik dhe shkencor Direktiva 92/43 / KEE

për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër, Rregullorja (KE) Nr. 1882/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 29 shtatorit 2003,

Direktiva e Këshillit 2006/105 / KE e 20 Nëntorit 2006 Direktiva e Këshillit 2013/17 / BE e 13 maj 2013.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të vendosë sistemin e monitorimit për raste të rastit kapja dhe vrasja e specieve të caktuara, referuar në shkronjën "c" të nënit 17/4. Ajo mbart hulumtime të mëtejshme ose merr masa siç kërkohet, duke u përpjekur të shmangin ndikimet negative mbi speciet e lidhura. Ligji Nr. 10 006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" kërkon mbrojtja e specieve të kërcënuara dhe endemike të faunës së egër. Specie të tilla kanë qenë përcaktuar në "Listën e Kuqe të faunës dhe florës së egër", e cila është aprovuar kohët e fundit nga Urdhri Ministror Nr. 1280, datë 20.11.2013. Popullatat e specieve të tilla i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm të statusit të tyre dhe progresin, cilësinë dhe sasinë e specieve, habitateve dhe kushteve të shumimit.

Tabela VII-5: Objektivat, Indikatore & Synimet për VSM-në e Planit Vjosë-Nartë

Nr	OBJEKTIVAT e VSM/OBJEKTIVAT MJEDISORE	FUSHAT KRYESORE DHE PARAMETRAT MJEDISORE	SYNIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJES
1	Zhvillimi i qëndrueshëm social ekonomik për mbrojtjen e mjedisit	• Njerëzit dhe vendet e punës, kohezioni social • Mundësia e të ardhurave • Cilësia e jetesës • Asetet materiale	• Krijimi i njësive të agroturizmit në pjesët rurale dhe malore të Bashkisë • Furnizimi me ujë të pijshëm 24 h • Furnizimit me Energji 24 h • Rrjeti i ujërave të zeza • Mjetet e reja të transportit publik • Krijimi i objekteve të reja të shërbimit • Krijimi i nbizneseve të	• Të ardhurat • Numri i bizneseve • Investimet në infrastrukture • Numri i restorante, bareve dhe hotele që shërbejnë gjatë gjithë vitit • Sasia e produkteve bio në vit • Numri i vizitorëve jashtë sezonit të verës	• Përditësimi i të dhënave • Sondazhet e bashkisë • Sipërfaqja e tokës së kultivuar • Prenotimi i hoteleve

			reja bujqësore bio		
2	Promovimi i vlerave mjedisore dhe panoramike	Njerëzit, vendet e punës, peizazhi, trashëgimia kulturore, uji, ajri, florën, fauna, biodiversiteti	- Permiresimi i kushteve ekologjike - Zhvillimi i eko-turizmit dhe turizmit kulturor - Kontroll i erozionit - Ruajtja e cilësisë se ujit dhe pakesimi i ndotjeve - Rehabilitimi i habitateve, pyllezimi dhe përmirësimi i tokës	- Te ardhurat - Numri i vizitoreve në monumntet e kultures dhe zonat e vrojtimit - Investimet në restaurime, infrastrukturen ujore, marketing dhe promovim - Investime në rehabilitim, pyllezim, përmirësim peizazhi	- Përditesimi i të Dhënave - Te dhenat e fluksit të vizitoreve kulturore - Monitorimi i cilesise se ujit, ajrit, erozionit dhe habitateve - Monitorimi i flores dhe faunes se rrezikuar - Siperfaqja e pyllezuar dhe e rehabilituar
3	Impakti mjedisor në aktivitetet tradicionale ekonomike	Njerëzit, Vendet Punës, toka, asetet materiale	- Ulja e përdorimit të kimikateve dhe pesticideve në bujqësi - Respektimi i mjedisit në xjerrjen e kripës - Parandalimi i peshkimit brenda lagunave - Parandalimi i blegtorise në zonën bregdetare - Kontrolli peshkimit dhe gjuetise	- Cilesia e Ujit te Lagunave - Subvencionet per prodhimet alternative ne bujqesi - Sasia e peshkimit dhe gjahut - Prodhimi dhe perpunimi i kripes - Penalizimi i shkelesve	- Monitorimi i ujrave te lagunave - Kontrolli dhe monitorimi i peshkimit dhe gjuetise - Licensat/lejet per aktivitetet e peshkimit dhe gjuetise - Numri i penaliteteve
4	Promovimi i bashkepunimit ndërinstitucional dhe rritja e kapaciteteve menaxhuese mjedisore	Peisazhi, trashëgimia kulturore, uji, cilësia e ajrit, biodiversiteti, klima, shëndeti i	Përmirësimi i bashkëpunimit në planifikimin e infrastrukturës dhe mbrojtjen e	- Miratimi i standardeve uniforme për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin - Krijimi i	- Monitorimi i cilesisë se ujit dhe ajrit në zonat e aktivitetit të perbashket - Te dhenat e komunes dhe te

		njeriut	mjedisit • Përmirësimi i kapaciteteve ekzistuese në menaxhimin e mjedisit • Promovimi i skemave të bashkëpunimit privat publik	kompanisë me qëllim të veçantë në bazë të partneritetit privat publik për promovimin e objektivave të menaxhimit mjedisor	Bashkise Vlore për mbetjet e ngurta • Eficenca e investimeve në projektet dhe aktivitetet e përbashkëta
5	Përmirësimi i cilësisë së mjedisit për parandalimin e rrezikut të shëndetit publik (cilësia e ujit të detit, lumenjve, mbrojtja e lagunave, ruajtja e cilësisë së ajrit, vlerësimi i veprimit zonave industriale)	Shëndeti i njeriut, deti dhe laguna, cilësia e ujit, vendet natyrore, cilësia e ajrit, biodiversiteti, asetet materiale, toka, klima	• Rishikimi i politikës kombëtare për krijimin e ndikimit të lartë të objekteve industriale • Parandalimi i ndotjes së ajrit dhe ujërave • Ngritja dhe konsolidimi i sistemit të kanalizimeve • Eliminimi i derdhjes së ujërave të zeza direkt dhe indirekt në trupat ujore	• Integrimi i politikave të propozuara të PPV me PINS • Investimi në infrastrukturën e ujërave të zeza • Të dhënat mbi kontaminimet dhe numrin e popullsisë së prekur	• Monitorimi i shëndetit të popullsisë lokale • Të dhënat spitalore • Monitorimi i cilësisë së ujit, ajrit dhe nivelit të zhurmave • Monitorimi i ujërave që derdhen në laguna • Niveli i investimeve në infrastrukturën e ujërave të zeza
6	Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit përmes mbrojtjes së bregdetit dhe pjesës ujore të marinës (mbrojtja e cilësisë së detit, pejsazhit, zonave natyrore)	Cilësia e ujit të detit, peizazhi, biodiversiteti, vendet natyrore	• Ruajtja e biodiversitetit 100% • Grumbullimi i mbetjeve 100% • Mbrojtja e bregdetit • Nuk ka leje ndërtimi në zonat me vlerë panoramike të	• Cilësia e ujit të Detit • Grumbullimi i mbetjeve • Numri i lejeve të ndërtimit • Numri i anijeve dhe varkave të peshkimit • Objektet dhe infrastruktura e krijuar • Pyllëzimi	• Monitorimi GIS të PPV • Kërkime dhe Analiza të ujërave nëntokesore • Analiza e ujit të Detit • Analiza e sedimenteve nga deti • Numri i biletave të parkimit - Vendimet e

			mbrojtura dhe dalluese • Krijimi i shërbimeve të organizuara të plazhit për turizmin • Organizimi në zonat e aksesueshmërisë dhe parkimi • Rehabilitimi i zonave pyjore		Këshillit të Njesisë Administrative
7	Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit (ruajtja e pejsazhit, zonave të mbrojtura natyrore, biodiversitetit)	Shëndeti i njeriut, cilësisë së ujit të detit dhe lagunave, biodiversiteti, flora dhe fauna, asetet materiale • Rrjeti i ujërave të zeza • Para-Trajtimi • Cilësia e trupave ujore • Imazhi i Turizmit	• Mirembajtja dhe rritja e specieve endemike dhe të rrezikuara • Ndërtimi i Infrastrukturës sipas standardeve të BE • Reduktimi me 100% e shkarkimeve pa paratrajtim • Nga viti 2023, 100% e shkarkimeve të mblidhen sipas metodave të pranueshme për mjedisin • 100% trajtimi i mbeturinave industriale	• Evidenca të specieve endemike dhe atyre të rrezikuara • Numri i objekteve të para-trajtim (aktivitete industriale, aktivitetet tregtare etj) • Cilësia e trupave ujore • Gjatësia e sistemit të ujërave të zeza, sistemi i kolektorit, lidhjet • % e ujërave të zeza të përpunuara në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza • % e strehimit që ka gropa septike • % e aktivitetëve industriale që	• Projektet për rrjetin e ujërave të zeza • Matjet e cilësisë së ujit në vende të zgjedhura • Kërkime të Biodiversitetit (sidomos për speciet endemike) • Planet për monitorimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura dhe ato të reja

				kanë sistemet e përpunimit	
8	Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit (shëndeti i njerëzve, specieve të rrezikuara, cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore	• Uji, biodiversiteti, flora, fauna, toka • Konsumi i ujit për turizmin	• Ulja e nevojave për konsumin e ujit në objektet turistike • Promovimi i riciklimit të ujit dhe ripërdorimin e metodave • Ulja e nevojave për ujitje	• Nivelet e konsumit të ujit • Cilesia e trupave ujore	• Konsumi i ujit • Analizae kushteve hidrologjike • Studime te Biodiversitetit (sidomos për speciet endemike dhe ato të rrezikuara)
9	Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit (vend pune, ujërat sipërfaqësore biodiversiteti, toka)	• Biodiversitetit fauna, vendet natyrore • Aktivitetet e turizmit • Baret dhe restorantet • Transporti • Industria e ndërtimit	• Ulja e nivelit të zhurmës në zonat bregdetare turistike sipas ligjit • Kufizimi i orëve të aktiviteteve argëtuese duke punuar pranë zonave të banuara • Eliminimi i burimeve të ndotjes e zhurmës në zonat thelbësore për mbrojtjen e mjedisit • Kontrolli i zhvillimit të rrugëve të reja dhe vendndodhjen e zonave të parkimit • Kufizimi i qarkullimit të vizitorëve në zonën kryesore	• Masat e marra nga bashkia • Mendimi i Turistëve dhe banorëve • Densiteti trafikut • Volumi i punimeve ndertimore • Parku i mjeteve te përdorura ne ndertim	• Matjet e nivelit të zhurmës • Studime/Kërkime • Vendimet e Këshillit të Komunës • Monitorime te trafikut, punimeve te ndërtimit dhe te rehabilitimit

			të mjedisit në shtigje të veçanta		
10	Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit (Cilësia e tokës, habitatet, cilësia e ujit, punësimi, flora, fauna)	• Cilësisë së tokës, habitateve, cilësisë së ujit, punë • Produktet bujqësore Bio • Cilësia e ujrave nëntokësore • Kushtet e jetesës së njerëzve, dhe kushtet shëndetësore	• Rehabilitimi i tokës së kripur • Përmirësimi i pjellorisë së tokës • Përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes • Përmirësimi i Peisazhit	• Rritja e % se ishtokës bujqësore terehabilituar • Sipërfaqja e zones se rryllëzuar (Ha) • Numri i guroveve të mbyllura • Rritja % e tokës së braktisur të rikultivuar	• Analiza e cilësisë së tokës • Monitorimi GIS i PPV
11	Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit- Ndergjegjesimi i Publikut (Shëndeti i njerëzve, cilësia e ujit, ajrit, biodiversitet, trashëgimia kulturore)	• Peisazhi, trashëgimia kulturore, biodiversitetit, uji, ajri, shëndeti i njeriut	• Rritja e ndërgjegjësimit social drejt mbrojtjes së mjedisit • Promovimi i formave miqësore me mjedisin e turizmit • Rritja e përfshirjes së komunitetit lokal në veprimet e ruajtjes • Përmirësimi i infrastrukturës	• Numri i bizneseve turistike per miratimin e standardeve të eko-etiketimit • Fushatë ndërgjegjësimi • Programet edukative, reklama • Akte Pilote	• Anketim i Vizitoreve • Monitorimi i cilesise se ujit, ajrit dhe nivelit te zhurmave
12	Ruajtja dhe Përmirësimi i Cilësisë së Mjedisit (trashëgimia kulturore dhe mjedisi historik si asete, vende pune)	• Trashëgimia kulturore dhe peisazhi • Asete materiale, • Vende Pune	• Mbrojtja, rritja dhe rivendosja e monumenteve kulturore dhe trashëgimisë arkitekturore • Kontrolli i plote në ndërtimin e paligjshëm	• Punime te ndërmarra për restaurimin e monumenteve Historike • Përmirësimi i aksesit dhe Sinjalistika. • Numri i ndërtimeve	• Lejet e ndërtimit • Sondazhet e komunes • Monitorimi i sondazheve nga Ministria e Kulturës dhe Sporteve • Fotografi

			• Sigurimi i zonave mbrojtëse tampon pengojnë ndërtimin në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore. • Përmirësimi i aksesit dhe Sinjalistika.	pa leje	
13	Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardeve të shëndetit- Cilësia e Ajrit	• Klima dhe cilësia e ajrit (energja e rinovueshme , emetimet e gazit), • Kohezioni Social • Transporti	• Automjete të reja për transportin publik për të mbuluar zonën • Ruajtja e cilësisë së ajrit, standardet (BE kombëtare) • Shmangia e trafikut në zonë banimi • Përdorimi i pajisjeve miqësore energjitike • Përdorimi i energjisë diellore • 100% shmangia e djegies se mbeturinave	• Matjet standardeve të cilësisë së ajrit • Numri i automjeteve të transportit publik • Numri i pajisjeve të kursimit të energjisë, instalimi i paneleve diellore voltaike	• Matjet e cilësisë së ajrit në vende të zgjedhura • Fushata të Ndërgjegjësimi Publik • Anketa e faturimit të Energjisë • Sasia e energjisë nga burime të ndryshme
14	Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Cilesia e Ujit (cilësia e jetës,vende	• Cilësia e jetës dhe shëndetit Publik • Uji, • Flora, • Fauna	• Përmirësimi i cilësisë së ujit në standardet e pranueshme • Sigurimi i ujit të pijshëm për ndërtesat private	• Cilësia e ujit të pijshëm • Sasia e ujit per person / dite • Sasia e konsumit të ujit në zonat turistike	• Konsumimi i ujit • Cilesia e ujit • Monitorimi i cilesise se ujit te pjshe (ne bashkepunim me Insitutin e Shendetit

	pune, cilësisë së ujit, furnizimit energji)		dhe publike		Publik) periodikisht ne të gjitha pikat e kontrollit në burim dhe në pikat fundore të konsumit
15	Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Menaxhimi mbetjeve (cilësia e tokës, cilësia e ujit, cilësia e ajrit, shëndeti)	• Cilësia e jetës dhe shëndeti Publik - Ndertimi i Industrise se mbetjeve • Toka • Cilësia e ujit • Cilësia e ajrit • peizazhi • Imazhi i Turizmit	• Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së mbeturinave nga zonat e vendbanimeve dhe zonave turistike . • Eliminimi 100% i vendeve te paligjshme aktuale te hedhjes se mbeturinave në komunë • Daiferencimi i mbledhjes se mbeturinave • në vitin 2017 vendi i ri për mbetjet e ndërtimit • Promovimi i programeve te riciklimit dhe pastrimit për zonën bregdetare.	• Reduktimi i numri te deponive - Rritja e numrit të koshave të mbeturinave në Komunë • Cilësia peizazhit • Cilesia e Trupave ujore	• Analiza të trupave Ujore • Studime/Kerkime vëllimi i mbeturinave te mbledhura ne landfill • Planet e manaxhimit dhe monitorimit te mbetjeve të ngurta • Realizimi i investimeve te komunes per manaxhimin e mbetjeve të ngurta
16	Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit – Cilësia e jetës (Cilësia e jetës, mjedisi urban,	• Cilësia e jetesës, - Njerëzit asetet materiale, - peizazhi	• Përmirësimi i mjedisit urban në zonat e vendbanimeve • Rregullimi i ndërtimit	• Zbatimi i rregulloreve vendore të planifikimit • Zbatimi i projekteve strategjike të propozuara te	• Monitorimi GIS i PPV • Leje ndërtimi • Projektet publike • Vendimet e Këshillit Bashkiak • Buxheti i bashkisë

	të mirat materiale, peisazh)			planit të infrastrukturës	
17	Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit publik (siguria publike, cilësia e ujit, cilësia e tokës)	• Siguria publike, shëndeti njerëzor, njerëz, asetet materiale	• Eliminimi i rrezikut për shëndetin nga rrezatimi në zonat e banuara • Përmirësimi i sigurisë i rrugëve hekurudhore • Përmirësimi i sigurisë në plazh • Eliminimi i rrezikut ndaj zjarri.	• Zbatimi i ndertimeve mbrojtëse • Heqja e numrit të elementeve të paligjshme të infrastrukturës • Sigurimi i objekteve të parë të ndihmes se shpejte dhe vrojtuesit në plazhet e Nartës dhe Zvërnecit • Numri i zjarreve	• Monitorimi GIS i PPV • Leje ndërtimi • Vendimet e Këshillit Bashkiak
18	Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe standardet e shëndetit publik (siguria publike, cilësia e ujit, cilësia e tokës)	• Siguria publike, cilesia e ujit, toka, asetet materiale	• Mbajtja e balancit të ujit në lagune • Ulja e rrezikut nga përmytjet	• Pastrimi i pritave • Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kanaleve	Monitorim i shkembimit të ujit lagunë-det • Zbatimi i planeve të manaxhimit • Realizimi i investimeve per rehabilitimin, ndertimin dhe mirembajtjen e rrjetit te kanalizimeve

KAPITULLI VIII: PËRMBLEDHJE NË GJUHË JOTEKNIKE I RAPORTIT TË VSM-së

VIII.1.1 ÇFARË ËSHTË VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor - VSM është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i ndonjë plani, programi ose dokumenti tjetër strategjik.

VIII.1.2 KUADRI LIGJOR I VSM-ës

Kuadri ligjor i VSM-së bazohet në Ligjin Shqipëtar për VSM-në dhe kuadri ligjor europian dhe ndërkombëtar sipas Ligjit Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit të planeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji është përafëruar me Direktivën 2001/42/KE mbi vlerësimin e efekteve në mjedis prej planeve të caktuara (Direktiva e VSM-së).

VIII.1.3 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor - VSM është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i planit.

Qëllimi i VSM-së është përmirësimi i planit në mënyrë për të minimizuar ndikimin e tij të mundshëm negativ në mjedis dhe për të maksimizuar ndikimet pozitive, dhe po ashtu të sigurojë që ndikimet e mundshme negative, që nuk mund të shmangen, të menaxhohen si duhet dhe të kompensohen gjatë zbatimit të planit dhe t'i bëjnë ato më miqësore për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se VSM është një proces transparent i bazuar në pjesëmarrjen e publikut. Personat, kushtet e jetesës dhe shëndeti i të cilëve mund të ndikohen nga zbatimi i planit, do të kenë të drejtë të shprehin interesat e tyre dhe ato duhet të merren parasysh përkatësisht në procesin e vendimmarrjes.

VIII.1.4 PËRDORIMI I TOKËS SIPAS NJËSIVE STRUKTURE

Infrastruktura aeroportuale

Së bashku me rrugët lidhëse kombëtare, lokale dhe atë detare (marina) njësia më e rëndësishme e infrastrukturës do të jetë Aeroporti i Akërnisë i cili për vet rëndësinë dhe karakteristikat është strukturë që zhvillohet në nivel kombëtar. Ai do të ndërtohet në ish-aeroportin ushtarak pranë fshatit Akerni, Novoselë, Vlorë. Sipërfaqja e tij do të jetë 309 ha (1,500 m x 2,000 m) me pistë rreth 2,000 m dhe gjërësi piste (kryesore dhe ndihmese) rreth 300 m plus 600 m brez i aeroportit nga të dy anët.

VIII.1.5 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT NATYROR

Të gjitha njësitë e sistemit natyror, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë. Në përgjithësi, në njësitë strukturore me përdorim natyror nuk lejohen zhvillime të asnjë lloji, megjithatë nuk përjashtohen disa aktivitete shërbimi sidomos ato në bregun e detit si zona e plazhit.

Tabela VIII-1: Njësitë strukturore të konservimit dhe rehabilitimit mjedisor

Përshkrim	Njësi me karakter Natyror												
Sip e njësisë në <i>ha</i>	49.5	<u>334.8</u>	<u>334.8</u>	<u>69</u>	<u>86.3</u>	<u>20</u>	<u>113.5</u>	<u>44.5</u>	<u>23</u>	<u>22.8</u>	<u>73.7</u>	<u>20.8</u>	<u>102</u>
Mënyra e ndërhyrjes në territor	<u>Konservim dhe rikuperim mjedisor</u>												
Kufizime	Të respektohen distancat e mbrojtjes së vijave ujore e bregore 100 dhe 300m sipas kësaj rregulloreje dhe hartës së përdorimit të tokës. Të respektohen distancat e zonës buferike për infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe e aeroportit të ri përkatësisht me gjerësi 50m, 50m dhe 700m.												

VIII.2 ALTERNATIVA TË ZHVILLIMIT/SKENARËT

Proçesi i VSM-së ka synim që të japë informacion për alternativat e mundëshme duke kombinuar zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Tre skenarët e përzgjedhur bazohen në supozimet e mëposhtme:

a) Skenari zero, ku zhvillimi i ardhshëm ndjek trendet ekzistuese, dmth një rast ku nuk janë zbatuar propozime të veçanta të ndërhyrjes sipas planit;

b) Skenari i zhvillimit të Planit në zona bregdetare që nuk bejnë pjesë në asnjë nën zonë të peizazhit të mbrojtur, në zonën e Vjosë Nartë duke zhvilluar turizëm jo elitare por intensiv që ndryshon rrënjësisht potencialin e zhvillimit të turizmit elitare;

c) Skenari konservativ i mbrojtjes së mjedisit i cili lejon vetëm forma miqësore mjedisore të zhvillimit të turizmit, suksesi i të cilit qëndron mbi harmoninë e forcave më të gjera sociale dhe ekonomike, angazhimeve të forta të politikave dhe investimeve publike afatgjatë.

Analiza e pikëzimit është si më poshtë: skenari A rezulton me + 5 pikë, pa zhvillim, skenari B me -15 pikë ndërkohë që skenari C, i propozuar nga investitori rezulton + 1 pikë. Po të shtojmë funksionimin ose jo të shërbimeve të ekosistemit (të rëndësishme në skenarin C, me plus 5 pikë) atëherë pikëzimi më i lartë i takon skenarit C.

VIII.3 PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT

Zona e Peizazhit të Mbrojtur (ZPM) Vjosë-Nartë (Kategoria e V IUCN) është një kompleks ligatinor që shtrihet në Rajonin e Vlores. Vetë zona mbulon një sipërfaqe prej 19 738 hektarësh. ZPM shtrihet në territorin e Bashkisë Vlorë, Njësia Administrative Novoselë në veri të saj dhe Njësia Administrative Qendër në jug.

Disa prej mjediseve kryesore të Vjosë-Nartës janë ligatinat, tokat bujqësore, pyjet dhe zonat urbane. Mjediset ligatinore zënë 37% të sipërfaqes së përgjithshme. Mjedisi tjetër kryesor është toka bujqësore që zë afro 33% të sipërfaqes. Pyjet përbëjnë habitatin e tretë dhe mbulojnë 6% të territorit. Pjesa qendrore e ZPM është laguna e Nartës, një lagunë e cekët prej 2 900 hektarësh.

VIII.4 VLERËSIM I EFEKTEVE TË PRITSHME MJEDISORË TË PLANIT TË PROPOZUAR DHE MASAT PËR PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE

Toka

Objektiva mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, ajrore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj. ndërkohë që nga fusha të tjera do të jene të kufizuara në një territor me të ngushtë lokal. Toka bujqësore dhe pyjet do të pesonin shkatërrim të pakthyeshëm në seksionet e marra nga ndërtimet e reja ose ato të rindertuara mbi seksionet e vjetra. Masat që zbatohen mund të sjellin rënien e përhershme të potencialit dhe prodhimtarisë së tokës bujqësore që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqësore.

Ndërtimet e reja ose zgjerimet e infrastrukturave sipas sektorëve, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimit e veprimeve prioritare respektive të Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndërtimit për ripërdorimin ose procesimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara.

Objektiva mjedisore 2 (OM 2): Ruajtja e mjedisit fizik dhe tërësisë së elementëve natyrorë të zonës nga erozioni/sedimentim.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike në ultësira, laguna dhe zona bregdetare çojnë në dy drejtime, në erozionin bregdetar dhe rritjen e nivelit të ujit të kripur. Grykëderdhja e Vjosës në pjesën e poshtme përfshin zonën e mbrojtur Nartë-Vjosë me rreth 20,000 ha.

Për shkak të erozionit, disa habitate pritet të pësojnë dëme të mëdha nga humbja e biodiversitetit. Në varësi të vendndodhjes nga bregu, zonat me ujëra gjysëm të ëmbla do të zvogëlohen, bimësia e dunave të rërës do të humbas dhe rripi pyjor aluvial do të dëmtohet.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat mjedisore 1 dhe 2

Për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, do të duhet që projektet specifike të plotesohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së re.

- Materiali, i cili gërmohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në bazë të një skeme do të maximizohet.
- Përcaktimin e vijës bregdetare që nënkupton përcaktimin nga ana ligjore të asaj që quhet vija zero e detit mbi bazën e së cilës do të realizoheshin më mirë vlerësimet e erozionit detar, dinamikës së levizjes së bregdetit dhe të sedimenteve.
- Mbjellja duhet përfunduar sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulese stabilizuese të tokës.

- Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gurë të thyer, për të reduktuar erozionin.

Cilësia e ajrit

Objektiva mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe atë të operimit në një sërë aktiviteteve nga sektorë të ndryshëm, por në lidhje direkte me Planin ndikimi kryesor vjen nga sektori i transportit. Gjatë fazës së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastrukturës, shkarkimi i ndotësve krijon impakt afatshkurtër në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme. Gjatë fazës së operimit të infrastrukturës, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në ujë e tokë, në varësi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastrukturës përkatëse.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 3

Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale (NJA Novoselë të kenë dy stacione monitorimi sipas specifikës së zonave të zhvillimit kryesore). Implementimi i sistemit të uljes së pluhurit: ujitja e anëve të rrugëve, përdorimi i ndarjeve të rrugëve për të kufizuar nxjerrjen e pluhurit (për shembull përdorimi i larjes së rrotave) dhe kufizimi i shpejtësisë së mjeteve të levizshme në rrugë.

Faktorët klimatikë

Objektiva mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Një sërë aktiviteteve ndërtimore të infrastrukturës dhe praktika sektoriale kanë impakt permanent (të kthyshëm) mbi shkarkimet e gazeve serë, që përbëjnë shkaktues kryesor të ndryshimeve klimatike, për shkakun që karburantet fosile (nafta dhe derivatet) çlirojnë gaze me efekt serë në ajër. Një tjetër pasojë e temperaturave të larta globale janë ndryshimet në modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet më të shpeshta të kushteve ekstreme të motit (thatësira, përmbytje, erozione, stuhi me breshër, valë të nxehta, temperaturë të ulëta me ngrica, etj.).

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 4

Për të arritur objektivin mjedisor në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si më poshtë:

- në terma afatgjatë, infrastruktura duhet të jetë më pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, përmbytjeve apo, ngricave);
- gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri, duhet të kryhet një analizë ndjeshmërie e infrastrukturës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit;
- shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi

- monitorimi i nivelit të detit dhe cilësisë së ujërave në lagunë dhe ujërat nëntokësore.

Ruajtja e trupave ujqorë

Objektiva mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.

Impaktet priten nga zhvillimet e elementëve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore dhe sidomos të Lagunës dhe Kripores. Në rastin konkret faktorë të tjerë kërcenues janë të shtuar nga të cilët më të rëndësishëm janë: (i) ujërat e zeza të pa menaxhuara, (ii) gropat septike individuale, (iii) derdhet në trupat ujqorë të pa trajtuara, (iv) mbetjet e ngurta urbane të shpërndara në vende të pa përshtatëshme dhe shpesh në kanalet kulluese dhe në bregdet. Efektet e këtyre vektorve janë në fakt efekte kumulative.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 5

Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktika të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:

- nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distancë më pak se 50 m nga Lumi Vjosë si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore, siç janë kanalet kulluese;
- ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- hedhja e betonit duhet të zhvillohet duke përdorur armaturën e duhur, për të shmangur ndotjen;
- në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Uji i pijshëm

Veprimet e sektoreve që ndikojnë në ujrat dhe objektivat mjedisore mbi ujrat përmbledhen si më poshtë:

- pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtpërdrejtë ose indirekt situatën hidrologjike në një zonë të caktuar;
- rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse (impakt në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore);
- derdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distancë të largët deri ndërkufitar mbi cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore);
- rrezik i lartë ekzistent nga përmytjet (aplikimi i zgjidhjeve ndërtimore me këtë kriter si rrezik i lartë) në zonat që përmyten ose masa rregulluese në rrjedhen e ujrave;
- ndryshime në situatën hidrologjike në një zonë të caktuar, përfshirë pakesimin në zonat mbajtëse (direkt ose në distancë);
- pozicionimi në zonat e ujrave të mbrojtur të burimeve ujore.

Trajtimi i ujërave të zeza

Plani parashikon projekte lidhur me ngritjen e rrjetit të ujërave të zeza në sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë zonës urbane dhe në drejtim të rrugëve. Edhe pse sistemet do të jenë të vendosura në korridorin qendror të infrastrukurës, ky sistem do të qendrojë me vete brenda korridorit dhe nuk do të pengohet apo të ndërpritet nga një sistem tjetër si psh., kullimi dhe kanalizimet të rrjedhin së bashku, sikurse mund të jetë rasti në disa fshatra sot.

Kjo do të sigurojë funksionim të mirë dhe efikas të sistemit dhe do të lehtësojë mirëmbajtjen dhe punimet riparuese.

Ky rregullim do të mundësohet përmes investimeve në tre drejtime kryesore:

- a) Ndërtimin e gropave septike sipas standardeve për fshatrat dhe shtëpitë e veçuara,
- b) Ndërtimin e sistemit të kanalizimeve në zonat e zhvillimit të shtetit urban, turistik, rekreativ dhe lidhjen me rrjetin e trajtimit të ujrave të ndotur impjantin e trajtimit të ujrave të ndotur i cili do të ndërtohet në Veri të Aeroportit të Akernisë.

Mjedisi natyror

Objektivi 6. Mjedisi Natyror – Garantimi i kohezionit të popullatave dhe biodiversiteti

Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukurës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshme. Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës.

Ndërtimi i strukturave të reja dhe rindërtimi ose modernizimi i infrastrukurës ekzistuese mund të rezultojë në:

- Humbje të zonave të habitatit dhe llojeve të habitatit dhe përfaqësuesve individualë të llojeve të bimeve dhe kafshëve (impakt direkt, i përhershëm).
- Në rastin e aktiviteteve me shtrirje të gjerë në një habitat më të rrezikuar, një impakt direkt është i mundshëm mbi biodiversitetin e zonës më të ngushtë ose të gjerë (impakt permanent).

Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve migratore të kafshëve.

Objektivi 7. Mjedisi Natyror – Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme

Zbatimi i planit nuk çënon monumentet e natyrës, lagunat, rrugëkalimet ujore dhe komunikimet midis habitateve, duke ruajtur funksionimin e ekosistemeve dhe pjesën e mbrojtur natyrore.

Në ndikimet e pritshme përfshihen:

- Rritja e presionit njerzor në vegjetacion të të gjitha tipeve si pasojë e zhvillimit.
- Rritja e rrezikut nga zjarret, në periferi të zones së ndërtimit.
- Rritja e presionit mbi vegjetacionin e anës së kanaleve lidhes të lagunës/kripores me detin.

- Rritja e presionit në vegjetacionin pyjor të pishave për shkak të ndryshimit të llojshmërisë së drurëve të rinj që do të mbillen në kopështe të ndërtimeve.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 7

Ndërkohë që masat specifike zbutëse përfshijnë:

- Para dhënies së lejes investitori do të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me Bashkinë Vlorë për të siguruar aksesin publik në zonën e mbrojtur ku do të zhvillohet projekti.
- Kompania duhet të ketë të ngritur një sistem të plotë për manaxhimi e monitorimit.
- Nuk lejohet të dëmtohen asociacione bimore me kritere të veçanta peizazhiere (drurë, kallamishte, barishtore).

Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfillleve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Shqetësimet kryesore që lidhen me sektorin e mbetjeve janë të renditura më poshtë:

- Prania e zonave të ndotura të njohura si hot-spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që akoma nuk janë sistemuar.
- Prania e venddepozitimeve të hapura, të ligjshme dhe të paligjshme, të hedhjes së mbetjeve.
- Menaxhimi i mbetjeve është ende në nivele të ulta, sisteme grumbullimi të përziera janë të pakëta.
- Mbetjet inerte, të rrezikshme, spitalore dhe të kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore, për shkak të mungesës së landfillleve për mbetjet e rrezikshme.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 8

Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si më poshtë:

- Rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisore dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zonë të gjelbra me vlerë rekreative, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë.
- Ndërtimi i landfillit të Sherishtës do të ulë tarifat dhe rrisë riciklimin/reduktimin/ripërdorimin e tyre.
- Duhet planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit dhe kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.

Zhurmat

Objektivi Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE-ja dhe OBSH-ja.

Në përputhje me legjislacionin mbi mbrojtjen nga zhurmat, kushtet e mëposhtëme mund të aplikohen gjatë fazës së funksionimit të strukturave të reja në infrastrukturë:

- Një burim i ri zhurme nuk duhet të prodhojë ndotje përtej kufirit të lejuar të zhurmës në mjedis.

- Një burim i ri zhurme nuk duhet të rris ndotjen nga zhurma, në një zonë ku zhurma ishte tashmë përtej kufirit të lejuar, përpara se të vendosej aktiviteti i burimit të ri.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 9

Duhet të respektohen udhëzimet e mëposhtme për të arritur objektivin e reduktimit të ndotjes nga zhurma:

- duhet të sigurohen masa për të reduktuar shkarkimet e zhurmës në burim (masa në strukturën përkatëse infrastrukturore, automjetet në përdorim, masa logjistike, riorganizimin e levizjeve tranzitore, reduktimi i orareve të punës apo zvogëlimi i shpejtësisë në zonat e ekspozuara ndaj zhurmës, etj.);

- duhet të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta të banuar dhe në zonat e mbrojtura, në përputhje me rregullat për ruajtjen e natyrës;

- përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës;

- mirëmbajtja e duhur e impianteve, për të minimizuar zhurmat e prodhuara;

- çdo paisje, si gjeneratorë apo pompa, që është i nevojshëm të përdoret para dhe pas orarit zyrtar të punës, do të jetë i rrethuar nga një bariere akustike.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektivi Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe levizshmërisë së qëndrueshme.

Zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik pritet që të kontribuojë në rritjen e mirëqënies së njerëzve. Zbatimi i projekteve të kësaj natyre do të përmirësojë ndjeshëm ekonominë, punësimin, kushtet e jetesës, aksesin në zonë dhe kështu do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë ekonomik në zonat më pak të zhvilluara.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 10

Kur planifikohen politikat dhe projektet e reja, prioritet duhet t'i jepet përmirësimit të lidhjeve dhe zhvillimit në zonat më pak të zhvilluara. Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve. Kjo pritet të inkurajojë përfshirjen më aktive të komunitetit në kuadër të sistemeve infrastrukturore, në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për të gjitha shtresat dhe kategoritë sociale.

Trashëgimia kulturore

Objektivi Mjedisor 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonës dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Zhvillimet e infrastrukturës mund të krijojnë ndikime direkte në njësi dhe zona të trashëgimisë kulturore gjatë fazës së ndërtimit dhe të funksionimit si rezultat i efekteve të mëposhtme:

- degradimi i veçorive të peizazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore (ndikim indirekt, i pakthyesëm);
- dëmtimi i strukturave të trashëgimisë kulturore (ndikim direkt, i pakthyesëm);

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 11

Per të shmangur keto ndikime, duhet të merren parasysh si me poshte:

- Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore.
- Nevojitet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re.

Peizazhi

Objektivi 12. Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.

Ndikimet në këtë burim priten të jenë ndikime dytësore ose indirekte si rezultat i aktiviteteve të projektit. Ndikimi është veçanërisht i lartë në rastin e një ndërhyrjeje infrastrukturore në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elementë natyrorë të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik. Impaktet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Strukturat infrastrukturore në hapësirë, bëhen elemente të peizazhit dhe pjesë përbërëse e tij. Kështu që, sistemimi i këtyre strukturave duhet të behet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të peizazhit. Marrja në konsideratë e veçorive natyrore dhe topografisë së zonës ku parashikohet të zhvillohet projekti, do të reduktojë fragmentimin e peizazhit.

KAPITULLI IX: PËRMBLEDHJE NË GJUHË JOTEKNIKE I RAPORTIT TË VSM-SË

IX.1.1 ÇFARË ËSHTË VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor - VSM është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i ndonjë plani, programi ose dokumenti tjetër strategjik.

IX.1.2 KUADRI LIGJOR I VSM-SË

Kuadri ligjor i VSM-së bazohet në Ligjin Shqipëtar për VSM-në dhe kuadri ligjor europian dhe ndërkombëtar sipas Ligjit Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit të planeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji është përafëruar me Direktivën 2001/42/KE mbi vlerësimin e efekteve në mjedis prej planeve të caktuara (Direktiva e VSM-së).

IX.1.3 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT KRYESORE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor - VSM është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i planit.

Qëllimi i VSM-së është përmirësimi i planit në mënyrë për të minimizuar ndikimin e tij të mundshëm negativ në mjedis dhe për të maksimizuar ndikimet pozitive, dhe po ashtu të sigurojë që ndikimet e mundshme negative, që nuk mund të shmangen, të menaxhohen si duhet dhe të kompensohen gjatë zbatimit të planit dhe t'i bëjnë ato më miqësore për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është se VSM është një proces transparent i bazuar në pjesëmarrjen e publikut. Personat, kushtet e jetesës dhe shëndeti i të cilëve mund të ndikohen nga zbatimi i planit, do të kenë të drejtë të shprehin interesat e tyre dhe ato duhet të merren parasysh përkatësisht në procesin e vendimmarrjes.

IX.1.4 PËRDORIMI I TOKËS SIPAS NJËSIVE STRUKTURE

Infrastruktura aeroportuale

Së bashku me rrugët lidhëse kombëtare, lokale dhe atë detare (marina) njësia më e rëndësishme e infrastrukturës do të jetë Aeroporti i Akërnisë i cili për vet rëndësinë dhe karakteristikat është strukturë që zhvillohet në nivel kombëtar. Ai do të ndërtohet në ish-aeroportin ushtarak pranë fshatit Akerni, Novoselë, Vlorë. Sipërfaqja e tij do të jetë 309 ha (700 m x 3,200 m) me pistë rreth 2,600 m dhe gjërësi piste (kryesore dhe ndihmese) rreth 300 m plus 200 m brez i aeroportit nga të dy anët.

IX.1.5 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT BUJQËSOR

Të gjitha njësitet e sistemit bujqësor, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë.

Tabela IX-1: Njësitet strukturore të Sistemit Bujqësor

Përshkrim	Njësi me karakter Bujqësor							
Sip e njësisë	<u>433 ha</u>	<u>455 ha</u>	<u>1252 ha</u>	<u>148.4 ha</u>	<u>326 ha</u>	<u>125.3 ha</u>	<u>167.2ha</u>	<u>175.7 ha</u>
Sistemi bazë	Sistemi Bujqësor							
Tipologjia	<u>Peisazh rural, toka bujqësore me infrastrukturë vaditëse dhe kulluese, në disa raste struktura në shërbim të aktivitetit bujqësor.</u>							
Tregues të zhvillimit	Nuk parashikohen ndërtime, me përjashtim të rasteve në përputhje me legjislacionin sektorial për bujqësinë, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 'Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore', Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 "Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitet që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)" si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 "Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit"							

IX.1.6 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT NATYROR

Të gjitha njësitet e sistemit natyror brenda kufirit të zonës së PDZRK Vojsë-Nartë, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë. Në përgjithësi, në njësitet strukturore me përdorim natyrë nuk lejohen zhvillime të asnjë lloji, megjithatë nuk përjashtohen vendosja e strukturave të lehta të përkohshme për ofrimin e disa aktiviteteve dhe shërbimeve pranë zonave të plazhit.

Tabela IX-2: Njësitet strukturore të Sistemit Natyror

Përshkrim	Njësi me karakter Natyror											
Sip e njësisë	<u>355.4 ha</u>	<u>22.8 ha</u>	<u>16.4 ha</u>	<u>74 ha</u>	<u>86.3 ha</u>	<u>20 ha</u>	<u>273 ha</u>	<u>192 ha</u>	<u>129.3 ha</u>	<u>73.75 ha</u>	<u>102.37 ha</u>	<u>8.9 ha</u>
Kategoria baze e përdorimi t të tokës	Tokë natyrore - N											
Tipologjia	Park natyror & Pyll								Plazh			
Tregues të zhvillimit	Nuk Aplikohen											

Tabela IX-3: Njësitet strukturore të sistemit natyror dhe shërbime ekoturistike

Përshkrim	Njësi me karakter Natyror dhe Shërbime Ekoturistike			
Sip e njësisë	<u>224.5 ha</u>	<u>329 ha</u>	<u>335 ha</u>	<u>114.14 ha</u>
Kategoria baze e përdorimit të tokës	Natyre N dhe Shërbime S			

Tipologjia	Struktura te lehta, me materiale natyrore, gure ne dukje, dru, suva etj.
Tregues të zhvillimit	Treguesit e mëposhtëm janë orjentues por jo kufizues. Treguesit e detajuar do të përcaktohen në bazë të projektit të zhvillimit, në cdo rast të respektohet legjislacioni sektorial për Zhvillimet ekoturistike dhe agroturistike, VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, Vendimin e KKT nr.12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)” si dhe VKM nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”

IX.1.7 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT BUJQËSOR ME SHËRBIME AGROTURISTIKE

Këto njësi kanë përdorim bazë bujqësi dhe natyrë, megjithatë nuk përjashtohen disa aktivitete shërbimi. Territori i këtyre njësive shtrihet në sipërfaqe krejtësisht të pashfrytëzuara dhe shërben si një kalim gradual midis përdorimeve bujqësore dhe turistike. Përgjithësisht janë konceptuar të zhvillohen në formën e fermave të mëdha bujqësore të cilat mund të zhvillojnë aktivitetin e agroturizmit, vinotekave etj. Kështu këto ferma mund të specializohen në prodhimin dhe përpunimin e një proukti të vetëm dhe njëkohësisht të shërbejnë si vende atraksioni për kalimin e kohës të turistëve të zonës apo edhe qytetarëve nga Tirana Vlora dhe më gjerë. Zhvillimi i vinotekave, i fermave me pemtari të ndryshme apo të hipizmit etj., do të shndërrojë zonën jo vetëm në prodhuese por edhe një markë për vendin.

- 1 *Kategoria bazë* – Bujqësi dhe Natyrë
- 2 *Nënkategoria* - Agroturizëm, Ekoturizëm
- 3 *Funksioni* – Ferma, Bujtina, Bar, Restorant, njësi akomodimi

Tabela IX-4: Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike

Përshkrim	Njësi me karakter miks Bujqësor dhe Natyror me përdorime të lejuara tëshërbimeve agro dhe eko turistike.			
Sip e njësisë	385.5 ha		849.4 ha	
Kategoria baze e perdorimit të tokës	Shërbime(S) + Bujqësi(B) Agroturizëm EB3			
Tipologjia	Struktura te lehta, me materiale natyrore : gure ne dukje, dru, etj.			
Intensiteti i ndertimit	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05	i = 0.05
Koef.shfrytez.territorit	k= 5%	k= 5%	k= 5%	k= 5%
Lartesia ne kate	2-3	2-3	2-3	2-3

IX.1.8 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT URBAN DHE INFRASTRUKTUROR

Njësitë strukturore, pjesë të sistemit urban klasifikohen në:

- Njësi urbane të karakterit banim tradicional, ku përfshihen fshatrat ekzistues të: Akernisë, Poro, Zhukë-Grykëshqipe, Dëllinjë, Bishan, Fitore, novoselë, Aliban, Zërnec dhe Nartë.
- Njësitë urbane të karakterit shërbim-hoteleri, të propozuara nga studimi.

Zonat urbane të përcaktuara sipas pikës a), ruajnë kufirin ekzistues të zhvillimit dhe konsolidohen brenda territorit ekzistues. Parametrat e Zhvillimit për këto zona ruajnë parashikimet e PPV të bashkisë Vlorë. Zonat urbane të përcaktuara sipas pikës b), janë të propozuara për rrizhvim dhe shoqërohen me kërkesë për ndryshim të kategorisë së përdorimit ekzistues të tokës. Parametrat e përgjithshëm të zhvillimit për këto zona përcaktohen në tabelën e mëposhtme dhe detajohen me lejet e zhvillimit me miratim në KKT, në zbatim të këtij plani.

Të gjitha njësitet e sistemit Infrastruktural, që nuk janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV të Bashkisë Vlorë.

Tabela IX-5: Njësitet strukturore të Sistemit Infrastruktural

Përshkrim	Njësi me karakter Infrastruktural		
Sip e njësisë	63.4 ha	135.5 ha	96.4 ha
Nënkategorite e përdorimit	INT3 Infrastruktural e Transportit Ujor	INT4 Infrastruktural e Transportit Ajror	S2 Shërbime Tregtare dhe Biznesi S2-7(Dyqane), AR3-6 (Fushe Golfi)
Tipologjia	Marine Turistike	Aeroport	Golf Resort

IX.1.9 NJËSITË STRUKTURE TË SISTEMIT UJOR

Të gjitha njësitet e sistemit ujor ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë. Në çdo rast zhvillimi pranë trupave ujorë aplikohen distancat sipas zonave buferike të treguara në hartën e përdorimit të propozuar të tokës:

- Distanca 100m nga bregu i detit dhe bregu i lumit, mbrojtje strikte, ndalohen ndërtimet dhe çdo lloj aktiviteti dhe përdorimi privat që tjetëron territorin, aksesit është i lirë dhe sipas rastit duhet të plotësojë kushtet e sigurisë për jetën e individëve.
- Distanca 300 m nga bregu i detit dhe rrjedha aktuale e lumit të Vjosës, mbrojtje e moderuar, ndalohen ndërtimet e përhershme, mund të aplikohet për leje për struktura të përkohshme, sezonale, me materiale të lehta të cmontueshme, në shërbim të aktivitetit turistik, mbajtjes pastër të territorit përreth dhe sigurisë për jetën e individëve/pushuesëve.

- | | |
|---|---|
| ○ Njësia NO.U.100, me sipërfaqe 31.63 ha | ○ Njësia NO.U.87, me sipërfaqe 116.32 ha |
| ○ Njësia NO.U.101, me sipërfaqe 62.70 ha | ○ Njësia NO.U.88, me sipërfaqe 28.32 ha |
| ○ Njësia NO.U.103, me sipërfaqe 274.31 ha | ○ Njësia NO.U.90, me sipërfaqe 28.47 ha |
| ○ Njësia NO.U.142, me sipërfaqe 765.40 ha | ○ Njësia NO.U.91, me sipërfaqe 1994.38 ha |
| ○ Njësia NO.U.1514, me sipërfaqe 10.82 ha | ○ Njësia NO.U.94, me sipërfaqe 1563.06 ha |
| ○ Njësia NO.U.1515, me sipërfaqe 12.08 ha | ○ Njësia QE.N.503, me sipërfaqe 120.48 ha |
| ○ Njësia NO.U.1522, me sipërfaqe 11.03 ha | ○ Njësia QE.U.104, me sipërfaqe 43.07 ha |
| ○ Njësia NO.U.1523, me sipërfaqe 13.34 ha | ○ Njësia QE.U.105, me sipërfaqe 96.12 ha |
| ○ Njësia NO.U.1524, me sipërfaqe 16.08 ha | ○ Njësia QE.U.106, me sipërfaqe 33.70 ha |
| ○ Njësia NO.U.1528, me sipërfaqe 6.11 ha | ○ Njësia QE.U.118, me sipërfaqe 11.34 ha |
| ○ Njësia NO.U.172, me sipërfaqe 46.14 ha | ○ Njësia QE.U.1562, me sipërfaqe 0.01 ha |
| ○ Njësia NO.U.177, me sipërfaqe 16.96 ha | ○ Njësia QE.U.1563, me sipërfaqe 0.96 ha |

- Njësia QE.U.1564, me sipërfaqe 7.63 ha
- Njësia QE.U.1566, me sipërfaqe 44.22 ha
- Njësia QE.U.1567, me sipërfaqe 39.95 ha
- Njësia QE.U.208, me sipërfaqe 1.30 ha
- Njësia QE.U.92, me sipërfaqe 37.52 ha
- Njësia QE.U.93, me sipërfaqe 84.42 ha
- Njësia QE.U.95, me sipërfaqe 12.18 ha

IX.2 ALTERNATIVA TË ZHVILLIMIT/SKENARËT

Proçesi i VSM-së ka synim që të japë informacion për alternativat e mundëshme duke kombinuar zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Tre skenarët e përzgjedhur bazohen në supozimet e mëposhtme:

a) Skenari zero, ku zhvillimi i ardhshëm ndjek trendet ekzistuese, dmth një rast ku nuk janë zbatuar propozime të veçanta të ndërhyrjes sipas planit;

b) Skenari i zhvillimit të Planit në zona bregdetare që nuk bejnë pjesë në asnjë nën zonë të peizazhit të mbrojtur, në zonën e Vjosë Nartë duke zhvilluar turizëm jo elitare por intensiv që ndryshon rrënjësisht potencialin e zhvillimit të turizmit elitare;

c) Skenari konservativ i mbrojtjes së mjedisit i cili lejon vetëm forma miqësore mjedisore të zhvillimit të turizmit, suksesi i të cilit qëndron mbi harmoninë e forcave më të gjera sociale dhe ekonomike, angazhimeve të forta të politikave dhe investimeve publike afatgjatë.

Analiza e pikëzimit është si më poshtë: skenari A rezulton me + 5 pikë, pa zhvillim, skenari B me -15 pikë ndërkohë që skenari C, i propozuar nga investitori rezulton + 3 pikë. Po të shtojmë funksionimin ose jo të shërbimeve të ekosistemit (të rëndësishme në skenarin C, me plus 5 pikë) atëherë pikëzimi më i lartë i takon skenarit C.

IX.3 PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE DHE VEÇORIVE TË MJEDISIT

Zona e Peizazhit të Mbrojtur (ZPM) Vjosë-Nartë (Kategoria e V IUCN) është një kompleks ligatinor që shtrihet në Rajonin e Vlores. Vetë zona mbulon një sipërfaqe prej 19 738 hektarësh. ZPM shtrihet në territorin e Bashkisë Vlorë, Njësia Administrative Novoselë në veri të saj dhe Njësia Administrative Qendër në jug.

Disa prej mjediseve kryesore të Vjosë-Nartës janë ligatinat, tokat bujqësore, pyjet dhe zonat urbane. Mjediset ligatinore zënë 37% të sipërfaqes së përgjithshme. Mjedisi tjetër kryesor është toka bujqësore që zë afro 33% të sipërfaqes. Pyjet përbëjnë habitatin e tretë dhe mbulojnë 6% të territorit. Pjesa qëndrore e ZPM është laguna e Nartës, një lagunë e cekët prej 2 900 hektarësh.

IX.4 VLERËSIM I EFEKTEVE TË PRITSHME MJEDISORË TË PLANIT TË PROPOZUAR DHE MASAT PËR PARANDALIMIN / ZBUTJEN E TYRE

Toka

Objektiva mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, ajrore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj. ndërkohë që nga fusha të tjera do të jenë të kufizuara në një territor me të ngushtë lokal. Toka bujqësore dhe pyjet do të pesonin shkatërrim të pakthyeshëm në seksionet e marra nga ndërtimet e reja ose ato të rindertuara mbi seksionet e vjetra. Masat që zbatohen mund të sjellin rënien e përhershme të potencialit dhe

prodhimtarisë së tokës bujqësore që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqësore.

Ndërtimet e reja ose zgjerimet e infrastrukturave sipas sektorëve, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimit e veprimeve prioritare respektive të Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndërtimit për ripërdorimin ose procesimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara.

Objektiva mjedisore 2 (OM 2): Ruajtja e mjedisit fizik dhe tërësisë së elementëve natyrorë të zonës nga erozioni/sedimentim.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike në ultësira, laguna dhe zona bregdetare çojnë në dy drejtime, në erozionin bregdetar dhe rritjen e nivelit të ujit të kripur. Grykëderdhja e Vjosës në pjesën e poshtme përfshin zonën e mbrojtur Nartë-Vjosë me rreth 20,000 ha.

Për shkak të erozionit, disa habitate pritet të pësojnë dëme të mëdha nga humbja e biodiversitetit. Në varësi të vendndodhjes nga bregu, zonat me ujra gjysëm të ëmbla do të zvogëlohen, bimësia e dunave të rërës do të humbas dhe rripi pyjor aluvial do të dëmtohet.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat mjedisore 1 dhe 2

Për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, do të duhet që projektet specifike të plotesohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së re.

- Materiali, i cili gërmohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në bazë të një skeme do të maximizohet.
- Përcaktimin e vijës bregdetare që nënkupton përcaktimin nga ana ligjore të asaj që quhet vija zero e detit mbi bazën e së cilës do të realizoheshin më mirë vlerësimet e erozionit detar, dinamikës së levizjes së bregdetit dhe të sedimenteve.
- Mbjellja duhet përfunduar sa më shpejt të jetë e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulese stabilizuese të tokës.
- Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gurë të thyer, për të reduktuar erozionin.

Cilësia e ajrit

Objektiva mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe atë të operimit në një sërë aktiviteteve nga sektorë të ndryshëm, por në lidhje direkte me Planin ndikimi kryesor vjen nga sektori i transportit. Gjatë fazës së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastrukturës, shkarkimi i ndotësve krijon impakt afatshkurtër në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme. Gjatë fazës së operimit të infrastrukturës, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në ujë e tokë, në varësi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastrukturës përkatëse.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 3

Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale (NJA Novoselë të kenë dy stacione monitorimi sipas specifikës së zonave të zhvillimit kryesore). Implementimi i sistemit të uljes së pluhurit: ujitja e anëve të rrugëve, përdorimi i ndarjeve të rrugëve për të kufizuar nxjerrjen e pluhurit (për shembull përdorimi i larjes së rrotave) dhe kufizimi i shpejtësisë së mjeteve të levizshme në rrugë.

Faktorët klimatikë

Objektiva mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Një sërë aktiviteteve ndertimore të infrastrukturës dhe praktika sektoriale kanë impakt permanent (të kthyshëm) mbi shkarkimet e gazeve serë, që përbëjnë shkaktues kryesor të ndryshimeve klimatike, për shkakun që karburantet fosile (nafta dhe derivatet) çlirojnë gaze me efekt serë në ajër. Një tjetër pasojë e temperaturave të larta globale janë ndryshimet në modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet më të shpeshta të kushteve ekstreme të motit (thatësira, përmbytje, erozione, stuhi me breshër, valë të nxehta, temperaturë të ulëta me ngrica, etj.).

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 4

Për të arritur objektivin mjedisor në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si më poshtë:

- në terma afatgjatë, infrastruktura duhet të jetë më pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, përmbytjeve apo, ngricave);
- gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri, duhet të kryhet një analizë ndjeshmërie e infrastrukturës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit;
- shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi
- monitorimi i nivelit të detit dhe cilësisë së ujërave në lagunë dhe ujërat nëntokësore.

Ruajtja e trupave ujorë

Objektiva mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.

Impaktet priten nga zhvillimet e elementëve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore dhe sidomos të Lagunës dhe Kripores. Në rastin konkret faktorë të tjerë kërcënues janë të shtuar nga të cilët më të rëndësishëm janë: (i) ujërat e zeza të pa menaxhuara, (ii) gropat septike individuale, (iii) derdhet në trupat ujorë të pa trajtuara, (iv) mbetjet e ngurta urbane të shpërndara në vende të pa përshtatshme dhe shpesh në kanalet kulluese dhe në bregdet. Efektet e këtyre vektorve janë në fakt efekte kumulative.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektin mjedisore 5

Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktika të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:

- nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distancë më pak se 50 m nga Lumi Vjosë si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore, siç janë kanalet kulluese;
- ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- hedhja e betonit duhet të zhvillohet duke përdorur armaturën e duhur, për të shmangur ndotjen;
- në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Uji i pijshëm

Veprimet e sektoreve që ndikojnë në ujrat dhe objektivat mjedisorë mbi ujrat përmbledhen si më poshtë:

- pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtpërdrejtë ose indirekt situatën hidrologjike në një zonë të caktuar;
- rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse (impakt në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore);
- derdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distancë të largët deri ndërkufitar mbi cilësinë e ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësor);
- rrezik i lartë ekzistent nga përmytjet (aplikimi i zgjidhjeve ndërtimore me këtë kriter si rrezik i lartë) në zonat që përmyten ose masa rregulluese në rrjedhen e ujrave;
- ndryshime në situatën hidrologjike në një zonë të caktuar, përfshirë pakesimin në zonat mbajtëse (direkt ose në distancë);
- pozicionimi në zonat e ujrave të mbrojtur të burimeve ujore.

Trajtimi i ujërave të zeza

Plani parashikon projekte lidhur me ngritjen e rrjetit të ujërave të zeza nën sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë zonës urbane dhe në drejtim të rrugëve. Edhe pse sistemet do të jenë të vendosura në korridorin qendror të infrastrukturës, ky sistem do të qendrojë me vete brenda korridorit dhe nuk do të pengohet apo të ndërpritet nga një sistem tjetër si psh., kullimi dhe kanalizimet të rrjedhin së bashku, sikurse mund të jetë rasti në disa fshatra sot.

Kjo do të sigurojë funksionim të mirë dhe efikas të sistemit dhe do të lehtësojë mirëmbajtjen dhe punimet riparuese.

Ky rregullim do të mundësohet përmes investimeve në tre drejtime kryesore:

- a) Ndërtimin e gropave septike sipas standardeve për fshatrat dhe shtëpitë e veçuara,
- b) Ndërtimin e sistemit të kanalizimeve në zonat e zhvillimit të shtetit urban, turistik, rekreativ dhe lidhjen me rrjetin e trajtimit të ujrave të ndotur impjantin e trajtimit të ujrave të ndotur i cili do të ndërtohet në Veri të Aeroportit të Akernisë.

Mjedisi natyror

Objektivi 6. Mjedisi Natyror – Garantimi i kohezionit të popullatave dhe biodiversiteti

Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshme. Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës.

Ndërtimi i strukturave të reja dhe rindërtimi ose modernizimi i infrastrukturës ekzistuese mund të rezultojë në:

- Humbje të zonave të habitatit dhe llojeve të habitatit dhe përfaqësuesve individualë të llojeve të bimeve dhe kafshëve (impakt direkt, i përhershëm).
- Në rastin e aktiviteteve me shtrirje të gjerë në një habitat më të rrezikuar, një impakt direkt është i mundshëm mbi biodiversitetin e zonës më të ngushtë ose të gjerë (impakt permanent).

Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve migratore të kafshëve.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 7

Pastrimi i vegjetacionit duhet të kufizohet vetëm në ato zona ku kërkohet prej aspekteve teknike dhe operacionalë, duke siguruar funksionimin e hapësirave të tjera. Gjatë fazës ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës duhen planifikuar zgjidhje teknike të përshtatshme duke parandaluar ndikimet negative mbi komunikimet ujore dhe aksidente të pazakonta (p.sh. derdhjet e lëndëve të rrezikshme ndaj faunës dhe florës). Ndikimet ndaj larmisë biologjike do të zvogëlohen duke adoptuar praktikën të mira të punës, sic janë:

- Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit dhe Rimëkëmbjes, për të identifikuar masat që do të nxisin përmirësimin e biodiversitetit lokal dhe kërkesat e monitorimit.
- Gjatë të gjitha fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit duhet të punësohet një ekolog për të mbikëqyrur punimet e pastrimit të habitateve dhe të japë këshilla për situatat kur kërkohet.
- Shmangia e shqetësimeve ose punët brenda kanaleve të kullimit dhe ujitjes në zonën përreth projektit, siguri i komunikimeve ujore.
- Zonat e ndjeshme mjedisore dhe habitatet kritike në rrethinat e zbatimit të projektit do të shënohen qartë dhe do të shënohen si 'Zona të Ndaluara' (p.sh., laguna) dhe qasja nga stafi dhe kontraktorët do të jetë rreptësisht e ndaluar.
- Kufizimi i aktiviteteve të pastrimit të zonave vetëm në ato hapësira ku kjo kërkohet dhe shmangia aty ku është e mundur duke minimizuar largimin e vegjetacionit ose shqetësimin e habitateve.
- Mbjellja e bimësisë (dru, shkure, barishtore) duhet të sigurojë lidhje organike me mjediset përreth dhe duhet të realizohet përmes llojeve auktoktone.
- Zhvillimi i një plani/procedurë të kontrollit të erozionit dhe sedimenteve brenda zonës dhe rrethinës së projektit.

Objektivi 7. Mjedisi Natyror – Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme

Zbatimi i planit nuk cënon monumentet e natyrës, lagunat, rrugëkalimet ujore dhe komunikimet midis habitateve, duke ruajtur funksionimin e ekosistemeve dhe pjesën e mbrojtur natyrore.

Në ndikimet e pritshme përfshihen:

- Rritja e presionit njerzor në vegjetacion të të gjitha tipeve si pasojë e zhvillimit.
- Rritja e rrezikut nga zjarret, në periferi të zones së ndërtimit.
- Rritja e presionit mbi vegjetacionin e anës së kanaleve lidhes të lagunës/kripores me detin.
- Rritja e presionit në vegjetacionin pyjor të pishave për shkak të ndryshimit të llojshmërisë së drurëve të rinj që do të mbillen në kopështe të ndërtimeve.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 7

Ndërkohë që masat specifike zbutëse përfshijnë:

- Para dhënies së lejes investitori do të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me Bashkinë Vlorë për të siguruar aksesin publik në zonën e mbrojtur ku do të zhvillohet projekti.
- Kompania duhet të ketë të ngritur një sistem të plotë për manaxhimi e monitorimit.
- Nuk lejohet të dëmtohen asociacione bimore me kritere të veçanta peizazhiere (drurë, kallamishte, barishtore).

Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Shqetësimet kryesore që lidhen me sektorin e mbetjeve janë të renditura më poshtë:

- Prania e zonave të ndotura të njohura si hot-spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që akoma nuk janë sistemuar.
- Prania e venddepozitimeve të hapura, të ligjshme dhe të paligjshme, të hedhjes së mbetjeve.
- Menaxhimi i mbetjeve është ende në nivele të ulta, sisteme grumbullimi të përziera janë të pakëta.
- Mbetjet inerte, të rrezikshme, spitalore dhe të kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore, për shkak të mungesës së landfilleve për mbetjet e rrezikshme.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 8

Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si më poshtë:

- Rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisorë dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zonë të gjelbra me vlerë rekreative, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë.
- Ndërtimi i landfillit të Sherishtës do të ulë tarifat dhe rrisë riciklimin/reduktimin/ripërdorimin e tyre.
- Duhet planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit dhe kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.

Zhurmat

Objektivi Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE-ja dhe OBSH-ja.

Në përputhje me legjislacionin mbi mbrojtjen nga zhurmat, kushtet e mëposhtëme mund të aplikohen gjatë fazës së funksionimit të strukturave të reja në infrastrukturë:

- Një burim i ri zhurme nuk duhet të prodhojë ndotje përtej kufirit të lejuar të zhurmës në mjedis.
- Një burim i ri zhurme nuk duhet të rris ndotjen nga zhurma, në një zonë ku zhurma ishte tashmë përtej kufirit të lejuar, përpara se të vendosej aktiviteti i burimit të ri.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 9

Duhet të respektohen udhëzimet e mëposhtëme për të arritur objektivin e reduktimit të ndotjes nga zhurma:

- duhet të sigurohen masa për të reduktuar shkarkimet e zhurmës në burim (masa në strukturën përkatëse infrastrukturore, automjetet në përdorim, masa logjistike, riorganizimin e levizjeve tranzitore, reduktimi i orareve të punës apo zvogëlimi i shpejtësisë në zonat e ekspozuara ndaj zhurmës, etj.);
- duhet të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta të banuar dhe në zonat e mbrojtura, në përputhje me rregullat për ruajtjen e natyrës;
- përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës;
- mirëmbajtja e duhur e impianteve, për të minimizuar zhurmat e prodhuara;
- çdo paisje, si gjeneratorë apo pompa, që është i nevojshëm të përdoret para dhe pas orarit zyrtar të punës, do të jetë i rrethuar nga një bariere akustike.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektivi Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe levizshmërisë së qëndrueshme.

Zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik pritet që të kontribuojë në rritjen e mirëqënies së njerëzve. Zbatimi i projekteve të kësaj natyre do të përmirësojë ndjeshëm ekonominë, punësimin, kushtet e jetesës, aksesin në zonë dhe kështu do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë ekonomik në zonat më pak të zhvilluara.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 10

Kur planifikohen politikat dhe projektet e reja, prioritet duhet t'i jepet përmirësimit të lidhjeve dhe zhvillimit në zonat më pak të zhvilluara. Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve. Kjo pritet të inkurajojë përfshirjen më aktive të komunitetit në kuadër të sistemeve infrastrukturore, në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për të gjitha shtresat dhe kategoritë sociale.

Trashëgimia kulturore

Objektivi Mjedisor 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonës dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Zhvillimet e infrastrukturës mund të krijojnë ndikime direkte në njësi dhe zona të trashëgimisë kulturore gjatë fazës së ndërtimit dhe të funksionimit si rezultat i efekteve të meposhtme:

- degradimi i veçorive të peizazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore (ndikim indirekt, i pakthyeshëm);
- dëmtimi i strukturave të trashëgimisë kulturore (ndikim direkt, i pakthyeshëm);

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 11

Per të shmangur keto ndikime, duhet të merren parasysh si me poshte:

- Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore.
- Nevojitet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re.

Peizazhi

Objektivi 12. Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.

Ndikimet në këtë burim priten të jenë ndikime dytësore ose indirekte si rezultat i aktiviteteve të projektit. Ndikimi është veçanërisht i lartë në rastin e një ndërhyrjeje infrastrukturore në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elementë natyrorë të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik. Impaktet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Strukturat infrastrukturore në hapësirë, bëhen elemente të peizazhit dhe pjesë përbërëse e tij. Kështu që, sistemimi i këtyre strukturave duhet të behet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të peizazhit. Marrja në konsideratë e veçorive natyrore dhe topografisë së zonës ku parashikohet të zhvillohet projekti, do të reduktojë fragmentimin e peizazhit.

KAPITULLI X: PROCESI I KONSULTIMEVE

KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË RAPORTIN E VSM-SË			
Data	25 Shkurt 2021		
Vendi	Novoselë, qendër		
Takim Konsultativ me Banorë, QJF, Përfaqësues të qeverisjes Vendore NJA Novoselë, Bashkia Vlorë, ARZM Vlorë, AZHT, AKPT, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mjedisit			
Data	25 Shkurt 2021		
Vendi	Novoselë, qendër		
Pjesëmarrësit	Emër Mbiemër	Institucioni	Firma
Firma			
	• Lanan Ghekoj	M. Novoselë	
	• Vangel Sotiri	K/ Pshk	
	• Arben Doraj	Banor	
	• Pro Moshaj	K/ Fshk	
	• Petraq Myrteli	Banor	
	• Qemal Çame	Banor	
	• Elidon Braka	BANOR	
	• ROLAND HAMIT	BANOR	
	• Zardhyl Difti	Banor	
	• Simo Ribaj	Vizioni i Gjelbër	
	• Lulezim Troka	Përkujdesi	
	• Vasil Kusin	Ujësjetësi	
	• Gerald Gjergj	Instalimesh	
	• Alim Arshaj	Novoselë	
	• Arta Mja	N.A. Nall	
	• Denise Allushaj	Njës. Novoselë	
	• Zamirë B. Haxhi	Nj. A.	

• Pinar Murr	Kryetari Eksperti Inovatare	
• Antoneta Naci	DRH-Fi-VL	
• Suela Joupaj	DRH-Fi-VL-gjyikndet	
• Enkeleida Haruni	DRH-Fi-VL-gjyikndet	
• Arkel Murr	Mjancat	
• Mihal Tuni	Punapj	
• Sokol Lica	Qytetar	
• Mro Alushi	Bidoje/kytar	
• Arion Seferi	ADRI Vlorë	
• Argjilo Todri	Mjancat	
• Terri Zykaj	Mjancat	
• Endro Denukaj	Ekspert	
• Albana Kupa	Ekspert	
• Adri Erebara	Ekspert	

Çështjet që
u diskutuan

Takimi u zhvillua në Sallën e Kinoteatrit të Njësisë Administrative Novoselë. Përpara se të fillonte takimi salla u dezinfektua dhe u morën të gjithë masat e dezinfektimit anti Covid-19 për të pranishmit duke respektuar distancimin social.

Takimi filloi në 09:11 AM dhe përfundoi në 11:10 AM me prezantimin e Metodologjisë së hartimit të raportit të **VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR të PDZRK Vjosë - Nartë** si dhe komponentët kryesor zhvillimor të planit, nga Sulejman Sulçe.

Ai theksoi:

- Rëndësinë e hartimit të një VSM për këtë plan;
- Objektivat dhe qëllimin e raportit të VSM-ës në lidhje me planin;
- Çështjet kryesore që do të trajtoheshin në këtë raport VSM-je;
- Hapat konkret që do të ndiqen në hartimin e raportit të VSM-ës për këtë plan;

U prezantuan në mënyrë të detajuar komponentët e Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombetare:

- **Sistem Urban**
- **Sistem Ujor**
- **Sistemi Natyror**

- **Sistemi bujqësor**
- **Sistemi Infrastrukturor**

Në vazhdim u përmendën presionet Kyçe Mbi Mjedisin të cilat cojnë në zhvillimin e objektivave në hartimin e raportit të VSM-ës për **PDZRK Vjosë - Nartë**.

Në fund u prezantuan plane të ngjashme të adaptuara në vendet e BE-së për të parë raste të ngjashme.

Pas prezantimit u hap seanca e pyetjeve dhe diskutimeve.

- **Simo Ribaj**: Ai theksoi se kryefjala e kësaj zone është pejzazhi, dhe në shikojmë me anë të këtij plani një pejzazh të transformuar, kështu që goditet kryefjala e zonës së mbrojtur.

Intensiteti i zhvillimit socio-ekonomik është shumë i madh për atë që dëgjuam. Mendoj që kjo duhet të shikohet me precedentë. Për çështjen e Aeroportit që është vepra ndoshta më e madhja në këtë territor për zhvillimin socio-ekonomik në këtë zonë, shoqëria civile është dorëzuar përpara interesit të madh të komunitetit për zhvillimin e zonës në lidhje me aeroportin. Këtë në nuk e kemi kundërshtuar jo se ai nuk ka impakt, por përballë komunitetit edhe në tërësi, por jo 100%. Duhet të shikohet që projekti i aeroportit të jetë sa më miqësor me mjedisin në të gjitha aspektet e tij, në formë dhe në funksion. Në na vjen keq që pemët janë djegur, pylli është djegur dhe në jemi për ta rivitalizuar zonën dhe për të mbjellur pemët dhe i gjithë vlerësimi duhet të shikohet në dritën e ndryshimeve klimatike, duhet të merret kjo çështje në konsideratë me qëllim të bëjmë më të mirën e pritshmërive negative që presim nga klima në vazhdimësi.

Në flasim për zhvillime miqësore me mjedisin dhe çdo komponent i planit të shikohet në këtë kontekst.

- **Vangjel Sotiri**: Kryeplak i fshatit Delisuf theksoi se nuk ka dijeni se sa është marrë parasysh ruajtja e pejzazhit kur në lagunën e Këllëngës e në vijim është dëmtuar i gjithë bregdeti me argjinaturë kanali i cili shfrytëzohet nga biznes privat. Kështu atje janë dëmtuar rëndë të gjitha dunat shekullore që të gjithë banorët i mbajnë mend. Zhvillimi duhet të jetë për të gjithë. Zhvillimi i akuakulturës në Këllëngë me hapjen e kanaleve të komunukimit dhe ngritjen e argjinaturave e ka prishur në mënyrë brutale natyrën. Nuk është menduar për komunitetin e zonës, pasi aty ska më plazh dhe futen në konflikt me banorët e vendit. Unë theksoj që duhet pyetur dhe më parë për shfrytëzimin e zonës. Plani është menduar shumë mirë, pasi ruan natyrën. Komuniteti në Delisuf e mbështet zhvillimin dhe duhen ngritur problemet e shfrytëzimit të tanishëm të lagunës së Këllëngës.

- **Kanan Shakaj**: Kryetar i Njësisë Administrative Novoselë thekson se me Planin jemi plotësisht dakort dhe nuk kemi asnjë kundërshtim për zhvillimin e tij. Në mënyrën se si Këllënga shfrytëzohet sot duhet të ndërhyjmë në mënyrë urgjente pasi atje kanë qënë duna mijra vjecare të cilat janë dëmtuar rëndë.

Problemi tjetër që theksojmë është legalizimi i shtëpive pasi Novosela dhe fshatrat përreth konsiderohen brenda Zonës së Mbrojtur, ndaj dhe duhet ta merrni në konsideratë këtë shqetësim nga banorët e zonës.

- **Anton Seferi:** Shqetësimi i shpendëve është marr parasysh?
- **Sulejman Sulçe:** janë lënë nën zonat kryesore të zonës së mbrojtur të pa prekuar në planin e hartuar dhe të krijohet mundësia e folenizimit sezonal të tyre. Por pa diskutim që ka një shqetësim të tyre të shtuar. Biologët do ta trajtojnë me shumë kujdes çdo komponent që zbut ndikimet nëpërmjet masave zbutëse dhe përmirësuese.
- **Serrik Zyka:** Banor i njësisë dhe Kryetar i Fshatit Cerkovinë, shpreh dakortësinë complete për zhvillimin e Planit.
- **Vangjel Sotiri:** Kryeplak i fshatit Delisuf theksoi se edhe para viteve '90 Pista e Avjonave në Akërn ka funksionuar dhe në asnjë rast nuk ka dëmtuar asnjë shpend, madje ka patur aq shpend sa sot nuk mund ti marrësh me mend. Shpendët dëmtohen nga gjuetia e paligjshme jo nga Aeroporti që do të ndërtohet, ndaj në jemi për zhvillim.

Fotografi





KONSULTIM ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN NË
RAPORTIN E VSM-SË

Data	27 Korrik 2021, Ora 12:00																																																																																										
Vendi	Njësia Administrative Novoselë, Hidrovori i Akërnisë, Vlorë																																																																																										
Pjesmar- rësit	Takim konsultativ me grupet e interesit për procesin e VSM-së të PDZRK Vjosë-Nartë <table> <tr> <td>Data</td><td colspan="3">27 Korrik 2021 Ora 12:00</td></tr> <tr> <td>Vendi</td><td colspan="3">NJA. Novoselë, Hidrovori i Akërnisë, Vlorë</td></tr> <tr> <td>Pjesmarr- ësit</td><td>Emër Mbiemër</td><td>Institucioni</td><td>Firma</td></tr> <tr> <td></td><td>• DENADA Muharremi</td><td>CREDINS BANK</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Edjona Shkullaj</td><td>Adem Vllari</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Manuela Prifti</td><td>NJA. Novoselë</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• KLAUDIO KERERI</td><td>SOLEL & S&S</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Paufel Sokhi</td><td>Te. P. Sokhi</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• ALEKSANDËR MITRAJ</td><td>KRYETARI ESHATIT POZO</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Redjan Securiq</td><td>D.T.F</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Thoma Leka</td><td>CERCI</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Simo Ribaj</td><td>Green Vision</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Jindita Cdo</td><td>OCCRP</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Lefton Moxro</td><td>Samonjop</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Tullumbeshi Myteli</td><td>Punë administrative</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Arben Myi.</td><td>NJA. Novoselë</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Elman Ghega</td><td>NJA. Novoselë</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Zydion Vargsi</td><td>PPNEA</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Aleksander Trejce</td><td>PPNEA</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Kemal Xherri</td><td>PPNEA</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Thorlindim Xhalo</td><td>PPNEA</td><td></td></tr> <tr> <td></td><td>• Ledion Balkaci</td><td>MTM</td><td></td></tr> </table>			Data	27 Korrik 2021 Ora 12:00			Vendi	NJA. Novoselë, Hidrovori i Akërnisë, Vlorë			Pjesmarr- ësit	Emër Mbiemër	Institucioni	Firma		• DENADA Muharremi	CREDINS BANK			• Edjona Shkullaj	Adem Vllari			• Manuela Prifti	NJA. Novoselë			• KLAUDIO KERERI	SOLEL & S&S			• Paufel Sokhi	Te. P. Sokhi			• ALEKSANDËR MITRAJ	KRYETARI ESHATIT POZO			• Redjan Securiq	D.T.F			• Thoma Leka	CERCI			• Simo Ribaj	Green Vision			• Jindita Cdo	OCCRP			• Lefton Moxro	Samonjop			• Tullumbeshi Myteli	Punë administrative			• Arben Myi.	NJA. Novoselë			• Elman Ghega	NJA. Novoselë			• Zydion Vargsi	PPNEA			• Aleksander Trejce	PPNEA			• Kemal Xherri	PPNEA			• Thorlindim Xhalo	PPNEA			• Ledion Balkaci	MTM	
Data	27 Korrik 2021 Ora 12:00																																																																																										
Vendi	NJA. Novoselë, Hidrovori i Akërnisë, Vlorë																																																																																										
Pjesmarr- ësit	Emër Mbiemër	Institucioni	Firma																																																																																								
	• DENADA Muharremi	CREDINS BANK																																																																																									
	• Edjona Shkullaj	Adem Vllari																																																																																									
	• Manuela Prifti	NJA. Novoselë																																																																																									
	• KLAUDIO KERERI	SOLEL & S&S																																																																																									
	• Paufel Sokhi	Te. P. Sokhi																																																																																									
	• ALEKSANDËR MITRAJ	KRYETARI ESHATIT POZO																																																																																									
	• Redjan Securiq	D.T.F																																																																																									
	• Thoma Leka	CERCI																																																																																									
	• Simo Ribaj	Green Vision																																																																																									
	• Jindita Cdo	OCCRP																																																																																									
	• Lefton Moxro	Samonjop																																																																																									
	• Tullumbeshi Myteli	Punë administrative																																																																																									
	• Arben Myi.	NJA. Novoselë																																																																																									
	• Elman Ghega	NJA. Novoselë																																																																																									
	• Zydion Vargsi	PPNEA																																																																																									
	• Aleksander Trejce	PPNEA																																																																																									
	• Kemal Xherri	PPNEA																																																																																									
	• Thorlindim Xhalo	PPNEA																																																																																									
	• Ledion Balkaci	MTM																																																																																									

• Ena Hica	MTK	BS
• ENELA MOUE	ACPD-Q. Beqirimeze	
• Kastriot Shehu	Shogati 2000	Sele nica
• Klodur Hoxha	Shogati 2000	
• Eduard Shokri	BCRD	
• Albana Gjuri	AKPT	
• Anisa Qorri		

Çështjet që u diskutuan

Takimi u zhvillua në zonën ku do të bëhet investimi, kjo bazuar edhe në ligjin mbi VSM. Për realizimin e takimit ishin marrë masat për krijimin e një salle në mjedis të hapur, me tënd, karrige, projektor dhe tabelë projektuese.

Takimi filloi në 12:15 PM dhe përfundoi në 14:00 PM. Në këtë takim kishte përfaqësues nga shoqëria civile e Njesisë Administrative Novoselë, organizatat jofitimprurëse, akademikë të qyteti të Vlorës, përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe përfaqësues të bizneseve të interesuara.

Në këtë takim u mbajtën dy prezantime, fillimisht nga Znj. Anisa Qorri, Drejtore e AKPT-së, më pas Z. Sulejman Sulçe.

Znj. Qorri prezantoi rëndësinë e studimit për zonën, me përparësi zhvillimin e zonës Vjosë-Nartë, Vlorë.

Në këtë prezantim u trajtuan këto çështje:

- Hartimi i PDZRK, qëllimi dhe objektivat
- Zhvillimi në kontekstin e planit të përgjithshëm kombëtar
- Plani i propozuar
- Rekomandime

Gjatë prezantimit, u theksua bashkrendimi ndërsektorial, koordinimi institucional si dhe zbatimi i detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dokumentat e planifikimit në fuqi, për territorin që është subjekt zhvillimi. Plani zhvillimor kërkon që zhvillimi turistik i propozuar të ndjekë një rrugë të qëndrueshme që kontribuon në një menaxhim cilësor të zonës së mbrojtur, territorit publik dhe privat, duke kontribuar në mirëqenien e zonës.

Si përfundim, propozimet e PDZRK Vjosë-Nartë për investime strategjike në infrastrukturë dhe përmirësim të peizazhit natyror, synojnë realizimin e një modeli suksesi, ku natyra, ekonomia dhe shoqëria mund të zhvillohen bashkërisht. Si rekomandime kërkohet që të respektohen masat për një zhvillim të qëndrueshëm.

Z. Sulejman Sulçe prezantoi metodologjinë e hartimit të raportit të Vlerësimi Strategjik Mjedisor të PDZRK Vjosë-Nartë.

Ai theksoi:

- Rëndësinë e hartimit të një VSM-je për këtë plan
- Objektivat dhe qëllimin e raportit të VSM-së në lidhje me planin

- Çështjet kryesore që do të trajtoheshin në këtë raport VSM-je
 - Hapat konkret që do të ndiqen në hartimin e raportit të VSM-së për këtë plan

Prezantimi vijoi me detaje të Njësive Strukturore të Planit të Detajuar të Zonës me Rëndësi Kombëtare Vjosë-Nartë:

- Sistem Urban
- Sistem Ujor
- Sistemi Natyror
- Sistemi Bujqësor
- Sistemi Infrastrukturor

Në vazhdim u përmendën presionet kyçe mbi Mjedisin të cilat çojnë në zhvillimin e objektivave në hartimin e raportit të VSM-së për PDZRK Vjosë-Nartë.

Në fund u prezantuan plane të ngjashme të adaptuara në vendet e BE-së për të parë raste të ngjashme.

Gjatë prezantimeve pati ndërhyrje nga pjesëmarrësit në lidhje me pamundësinë për tu njohur me dokumentet e PDZRK Vjosë-Nartë, duke qenë se sipas tyre njoftimi për konsultimin publik është marrë vetëm një ditë përpara, dhe prezantimi vizual nuk ishte shumë i qartë.

Në përgjigje të shqetësimeve të pjesëmarrësve, Znj. Eva Kica, përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sqaroi se publikimi mbi datën e takimit, ashtu si është parashikuar në ligj, është bërë më datë 21 korrik në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Kjo sipas pikës 3 të kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 219 datë 11.3.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”, i cili citon “Autoriteti propozues organizon takimin me grupet e interesit, ku prezantohet në mënyrë të përmbledhur plani apo programi i propozuar, **brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dërgimit të njoftimit**. Gjithashtu, sipas pikës 4 të kreut II të VKM Nr. 219 datë 11.3.2015, grupet e interesit i përgjigjen autoritetit propozues brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e takimit për kërkesa apo sugjerime për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM-së. Ndaj, çështja e pamundësisë për tu njohur në kohë me dokumentet e PDZRK Vjosë-Nartë është e adresuar.

Znj. Eva Kica kërkoi që të bëhej një debat konstruktiv për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së dhe të jepen mendime dhe rekomandime për të ruajtur balancën midis zhvillimit social dhe mjedisor, si qëllimi kryesor i konsultimi me grupet e interesit.

Disa nga pyetjet kryesore:

- Zybjon Vorpsi prezantues i PPNEA: A do të preket pylli nga ndërtimet që do të behën?
- Thoma Leka: Zona në fjalë ka shumë probleme- të tilla si probleme me pronësinë, a e keni hartën përkatëse, ne kemi eksperiencë negative në lidhje me zhvillimin turistik. Në këtë zonë vërehen ndërtime të shumta pa plotësuar kushtet e zhvillimit të qëndrueshëm. Pra, ne nuk po e zhvillojmë sipas rregullave turizmin. Në sondazhe që shoqata jonë ka kryer ka rezultuar se rreth 85% e të

pyeturve e duan ndërtimin e aeroportin. Pylli i sodës me 6 mln pemë të mbjella gjatë viteve të regjimit komunist duhet të mbrohet dhe të shtohet dhe të mos pritet gjatë zhvillimeve të planifikuara. Plani i zhvillimit të kësaj zonë ka probleme, duhet të mos bëhet vetëm për individë apo subjekte të veçanta, por duhet të mbajë parasysh interesat kombëtare. Shembuj të zhvillimeve nga vende të tjera ka plot që mund të zbatohen, por gjithmonë në të mirë të kombit. Çdo investim që bëhet të mbajë parasysh edhe efektet negative në faunën apo florën e zonës. Ne jemi gati të mbjellim edhe 1 mln pemë të tjera për të minimizuar efektet e këtyre investimeve. Por do të duhej një informim më i gjerë nëpërmjet mediave që mund të sigurojnë informimin dhe pjesëmarrje edhe të banorëve të zonës së Vlorës.

- Simo Ribaj: Ai theksoi se kryefjala e kësaj zone është peizazhi, dhe ne shikojmë me anë të këtij plani një peizazhi të transformuar, kështu që goditet kryefjala e zonës së mbrojtur.

- Intensiteti i zhvillimi socio-ekonomike është shumë i madh për aq sa dëgjuam. Mendoj që kjo duhet të shikohet me precedencë. Për çështjen e Aeroportit, që është vepra ndoshta më e madhja në këtë territor për zhvillimin socio-ekonomik në këtë zonë, shoqëria civile është dorëzuar përpara interesit të madh të komunitetit për zhvillim e zonës në lidhje me aeroportin. Këtë ne nuk e kemi kundërshtuar jo se ai nuk ka ndikim, por përballë komunitetit edhe ne tërhiqemi, por jo 100%. Duhet të shikohet që projekti i aeroportit të jetë sa më miqësor me mjedisin në të gjitha aspektet e tij, në formë dhe në funksion. Ne na vjen keq që pemët janë djegur, pylli është djegur dhe ne jemi për ta rivitalizuar zonën dhe për të mbjellë pemë dhe i gjithë vlerësimi duhet të shikohet në dritën e ndryshimeve klimatike, duhet të merret kjo çështje në konsideratë me qëllim që të bëjmë më të mirë e pritshmërive negative që presim nga klima në vazhdimësi.

- Në flasim për zhvillime miqësore me mjedisin dhe çdo komponent i planit të shikohet në këtë kontekst.

- Kanan Shakaj: Kryetar i Njesisë Administrative Novoselë, thekson se me Planin jemi plotësisht dakord dhe nuk kemi asnjë kundërshtim për zhvillimin e tij. Në mënyrën se si Këllënga shfrytëzohet sot duhet të ndërhyjmë në mënyrë urgjente pasi atje kanë qenë duna mijëra vjeçare, të cilat janë dëmtuar rëndë.

- Problemi tjetër që theksojmë është legalizimi i shtëpive pasi Novosela dhe fshatrat përreth konsiderohen brenda Zonës së Mbrojtur, ndaj dhe duhet ta merrni në konsideratë këtë shqetësim nga banorët e zonës.

- Xhemal Xherri PPNEA: A do merren parasysh konventat ndërkombëtare dhe planet shqiptare për tu futur në BE, sepse aeroportet nuk duhet të ndërtohen në zonat e mbrojtura? Presioni ndërkombëtar por edhe eksperiencia e vendeve të tjera nuk lejon ndërtime të aeroportit në këto zona.

- Sulejman Sulçe: Sigurisht që do të mbahen parasysh konventat ndërkombëtare. Kemi katër shembuj të eksperiencave ndërkombëtare ku janë ndërtuar aeroporte. Aeroporti i Ohrit ndodhet 100 m larg liqenit të Ohrit, i cili ka të pranishme 360 specie; Aeroporti i Podgoricës, Aeroporti në Slloveni dhe Aeroporti i Kroacisë janë të gjithë pranë parqeve kombëtare. Aeroporti do të ndërtohet në të njëjtën zonë ku ka qenë më përpara aeroport, një argument i pashmangshëm.

- Aleksandër Trocaj: A mund të rekomandohet një vendndodhje tjetër për ndërtimin e aeroportit që do të jetë më i përshtatshëm nga ana mjedisore dhe ligjore, a është kompetencë e kësaj VSM-je?
- Sulejman Sulçe: VSM e ka të drejtën që të propozojë çdo modifikim dhe masa shtrënguese në lidhje me planin e propozuar. Struktura e Raportit të VSM-së parashikon një kapitull pikërisht për “Përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit të planit të propozuar, përfshi edhe alternativën e mos planifikimit (alternativa zero)”, si dhe arsyetimet përkatëse për secilën prej tyre, duke argumentuar vlerësimin dhe avantazhet/disavantazhet e tyre. Për aeroportin është duke u zhvilluar edhe një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis i veçantë.

Fotografi





REFERENCA

1. AEAT/ENV/R/2088, 2006. A Guide for Local Authorities Purchasing Air Quality Monitoring Equipment” Issue 2.
2. Albania coastal Management Plan. Final Report-Phase Two. Albania. PAP/MAP-UNEP. Dobbin Milus International. Vienna, Virginia, USA. Committee for Enviromental Protection (Government of Albania). The World Bank/METAP. 80pp.
3. Alfred Mullaj et alt. (1999): *Flora and vegetation of the the Kune – Vain Lagoon Complex*. Biological Studies. Tirana. 1-1999, pp. 84-98.
4. Alfred Mullaj et alt. (1999): *Flora and vegetation of the Vlora Bay*. Biological Studies. Tirana. 1-1999, pp.72-83.
5. Alfred Mullaj, Anisa Cano, Alma Imeri, Albana Zotaj, 2012 – *Flora and mapping habitats in the estuary of Shkumbini River*. International Conference on Marine and Coastal Ecosystems: increasing knowledge for a sustainable conservation and integrated management. MarCoastEcos2012, Tirana, Albania 25 – 28 April, 2012.
6. Babani, F., Kongjika, E., Mullaj, A., and Ylli. A (2008). Trophic state of Albanian water ecosystems based on phytoplankton photosynthetic pigments. BRI. FNS based on biological indicators. International Journal of Research in Applied, Natural and Social Sciences. Vol. 2, Issue 5, 143-152
7. Bego F, Saçdanaku E, Pacifici M, Rondinini C (2018): Small terrestrial mammals of Albania: distribution and diversity (Mammalia, Eulipotyphla, Rodentia). *ZooKeys* 742: 127–163. <https://doi.org/10.3897/zookeys.742.22364>
8. Bego F., Hysa E., 2014. Influence of the artificial water reservoirs in the feeding strategy and distribution of the Otter (*Lutra lutra*) along the Drinos river valley, Albania.
9. Benda P., Ševčík M., Bego F., Sachanowicz K., Spitzenberger F., Tájek P., Tájková P., Uhrin M. (2019): Bats (Mammalia: Chiroptera) of the Eastern Mediterranean and Middle East. Part 15. The fauna of bats and bat ectoparasites of Albania with a catalogue of bats from the western Balkans in the collection of the National Museum, Prague. *Acta Soc. Zool. Bohem.* 83: 1-238
10. Beqiraj, S. (2001). Mollusca – Butakët. - Në “Biodiversiteti në ekosistemin bregdetar Delta e Vjosës – Laguna e Nartës”. UNDP, GEF/SGP, SHBSH. Tiranë: 46 – 52.
11. Beqiraj, S., Pinna, M., Basset, A., Fetahu, B., Doka, E., Ismailaj, M., Barbone, E., Sangiorgio, F., Fedele, M, (2007). Preliminary data on the macrozoobenthos of the Albanian coastal lagoons (lagoons of Patok, Karavasta, Narta). *Transitional Waters Bulletin TWB, Transit. Waters Bull.* 3(2007), 37-43. DOI 10.1285/i1825229Xv1n3p37
12. Bino, T., Shumka, S and Lleshi, R. (2016). Draft-National Action Plan for the Dalmatian Pelican (*PelecanusCrispus*) in Albania. Wetland management and Dalmatian Pelican conservation in the Mediterranean basin program. Tirana pp 34

13. Çako, V., Zhuri, E., Babani, F., Karaja, Th. (2014). Evaluation of trophic status in Narta lagoon
14. Carpenter, S.R., Cottingham, K.L., Shindler, D.E. (1992). Biotic feedbacks in lake phosphorous cycles. *Tree* 7, 332 –336
15. Climate Change Programme, UNDP.
16. DEA, 2016. Vlerësimi Strategjik Mjedisor/Shërbim konsulence, për hartimin e planeve të përgjithshme vendore, për katër bashki, Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol. Vlore, Raport, p, 2019.
17. Directive 92/43/EEC (1992): Council Directive 92/43/EEC of 21 May 1992 on the conservation of natural habitats and of wild fauna and flora. European Treaty Series, Nr. 104: pp. 14-80.
18. Draft report of the Albania's Third Communication to UNFCCC. C
19. EC, 2003. Common implementation strategy for the Water Framework Directive (2000/60/EC) Guidance Document No 7 Monitoring under the Water Framework Directive Produced by Working Group 2.7 – Monitoring
20. EEA, 2012. Streamlining European biodiversity indicators 2020: Building a future on lessons learnt from the SEBI 2010 process No 11/2012
21. EEA, 2014. Digest of EEA indicators 2014, Technical report No 8/2014
22. EEA, 2015. National monitoring, reporting and evaluation of climate change adaptation in Europe No 20/2015
23. Fryhof, J. 2012. Threatened freshwater fish and molluscs of the Balkan. Potential impacts of the hydropower projects - report. ECA Watch Austria & EuroNatur, 81 pp
24. Fryhof, J. and Brooks, E. 2011. European Red List of Freshwater Fishes. Luxembourg: Publication office of the European Union
25. Gjeografia e Shqipërisë, Botim i Akademisë së Shkencave
26. Gjiknuri, L. & Hodo, P. (1996). *The ecological evaluation of the most important lagoons of Albania*. In Tekke, R. M. H. (Editor). Management of coastal lagoons in Albania. EUCC. Leiden. p. 7-20.
27. Holmlund, S., Hammer, M. (1999). Ecosystem services generated by fish populations. *Ecological Economics* 29 (1999) 253 – 268
28. Jablonski D., (2011). *Reptiles and amphibians of Albania with new records and notes on occurrence and distribution*. Acta Soc. Zool. Bohem. 75: 223–238, 2011 ISSN 1211-376X.
29. Jiri Dusik, Albania - General Methodology on SEA - 1st Draft, June 2012
30. Kretzschmar, H., Eccarius, W. & Dietrich, H. 2007. The Orchid Genera Anacamptis, Orchis and Neotinea. Phylogeny, taxonomy, morphology, biology, distribution, ecology and hybridisation, ed. 2: 1-544. EchinoMedia verlag, Bürgel
31. Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor (KIBP)
32. Maniglio C., 2011. *Annalisa, Architettura del Paesaggio*, Franco Angeli.

33. Mathers, S., Brew, D.S., Artherton, R.S., (1999). Rapid Holocene evolution and neotectonics of the Albanian Adriatic Coastline
34. MedWetCoast, (2010). Plani i menaxhimit të zones se pejsazhit të mbrojtur Vjosë-Narte. Dhjetor 2010, p. 113
35. Mizsei E., Jablonski D., Végvári Z., Lengyel S., Szabolcs M., 2017. *Distribution and diversity of reptiles in Albania: a novel database from a Mediterranean hotspot*. Amphibia-Reptilia 38 (2017): 157-173.
36. MoE. 2004: Plani i Menaxhimit të Zones se Pejsazhit të Mbrojtur Vjosë-Narte. GEF/UNDP-MM-Ruajtja e ligatinave dhe ekosistemeve bregdetare në rajonin e Mesdheut. Tiranë. pp. 113
37. MoE., (2013). Urdher Lista e Kuqe e flores dhe faunes – Red list of threatened plant animal species of Albania. Tirana
38. Mullaj, 1989: *Bio-ecological Considerations on Coastal Vegetation of our country*. Works of the Biological Research Center, Tirana. Nr.7, pp.131-142.
39. Munari, C., Tessari, U., Rossi, R., Mistri, M. (2012): The ecological status of Karavasta Lagoon (Albania): closing the stable door before the horse has bolted? Marine Environmental Research 69, 1. 123-135
40. Peja, N., Vaso, A., Miho, A., Rakaj, N. & Crivelli, A. (1996). *Characteristics of Albanian lagoons and their fisheries*. Fisheries Research 27: 215-225.
41. Plani i Integruar Ndersektorial i Bregdetit – Dokumenti i Nismes
42. Plani i Integruar Ndersektorial i Zones Ekonomike Tirane-Durres – Dokumenti i Nismes
43. Plani i Përgjithshem Kombetar i Territorit – Dokumenti i Nismes
44. Plani Kombetar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025
45. Pollock B., 2008. *Raport Përfundimtar i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i Planit të Përgjithshem Rregullues të Tiranës*.
46. Prigioni C., 1996. *Distribution of mammals in Albania*. Hystrix, (n.s.) X (1-2) (1996): 67-73.
47. Rakaj, N. (1995). *Iktiofauna e Shqipërisë*. Shtëpia botuese “Libri Universitar”, pp.700
48. Raporti i gjendjes se Mjedisit, 2019
49. Rogozi E., Bego F., Papa A., Mersini K., Bino S., (2012): *Distribution and ecology of small mammals in Albania*. International Journal of Environmental Health Research, 1-11. DOI:10.1080/09603123.2012.717917.
50. Ross, S.W., (2003). The relative value of different estuarine nursery areas in North Carolina for transient juvenile marine fishes. Fishery Bulletin 101, 384-404.
51. Saçdanaku E., Haxhiu I., 2015. *Population Structure of European Pond Turtles, Emys orbicularis (Linnaeus, 1758) in Narta Lagoon (Vlora Bay, Albania)*. International Science Index Vol:9, No:3, waset.org/Publication/10000600.

52. Samiti i Ballkanit Perendimor – rrjeti i korridoreve kyç rajonale të transportit
53. Selfo L., Sulce S., Guri S., Hanxhari R. dhe Malltezi J., 2013. *Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Rregullues të Tiranës*, 244 faqe
54. Selfo L., Sulce S., Malltezi J., dhe Bodinaku E., 2014. *Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Trans Adriatic Pipeline*, 182 faqe.
55. Shqipëria – Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
56. Shqipëria – Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
57. Shumka S, (2014). Fish Survey in Vjosa River basin. Report for VERBUND. Vienna. pp 45.
58. Smith, K., Darwall, W., (2006). The Status and Distribution of Freshwater Fish Endemic to the Mediterranean Basin.
59. Strategjia e Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko - Jonian (SBERAJ),
60. Strategjia e Evropës Juglindore 2020 (SEJ 2020)
61. Strategjia Kombëtare Ndersektorale për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020
62. Strategjia Kombëtare Ndersektorale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025
63. Strategjia Kombëtare Ndersektorale për Mjedisin 2015-2020
64. Strategjia Kombëtare Ndersektorale për Turizmin 2015-2020 (përfshirë trashëgiminë kulturore, artin dhe kulturën)
65. Strategjia Sektoriale Kombëtare për Energjinë 2015-2030
66. Strategjia Sektoriale Kombëtare për Transportin 2015-2020
67. Strategjia Sektoriale Kombëtare për Ujesjellesit dhe Kanalizimet 2014-2020
68. Technital. November 1995. *Study on the hydro-biological importance of the lagoon channels*. European Commission PHARE programme: Karavasta lagoon wetland management project, Technital S.p.A., Venezia, 69p.
69. The Albanian Adriatic coastline. Journal of Coastal Research 15, 345-354.
70. UNDP, (2010). Protected Areas Gap assessment and Marine protected areas development project. (Consolidated Report, prepared by L. Kashta). Report, p. 195
71. UNDP, 2018. Assessment of Albania's National Capacities on Environmental Monitoring. GEF/UNDP project. Tirana, Report, p, 146.
72. Urdhër Nr. 1280, datë 18.12.2013 “Për miratimin e Listës së kuqe të Florës dhe Faunës së egër të Shqipërisë”, miratuar nga Ministri i Mjedit.

ANEKS

1. PERSHKRIMI I KRITEREVE DHE METODOLOGJISE SE VLERËSIMIT PËR OBJEKTIVAT MJEDISORE

• Toka

Në tabelën me poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qendrueshem të tokës dhe mbrojtja e saj.

Indikatori/Kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
- ndryshimi i strukture aktuale te përdorimit të tokës dhe pyjeve (zbatimi i aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në toka bujqësore dhe zona pyjore do të coje në humbjen dhe/ose ndryshimin e perhershëm të kategorise se përdorimit të tyre (nga tokë bujqësore apo zone pyjore në truall ndërtimi apo ndonje kategori tjeter) - ndryshimi i strukture se përdorimit te tokes bujqësore me potencial të mire prodhues (zbatimi i aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në toka bujqësore me potencial të mire prodhues do të coje në humbjen e perhershme të tokës bujqësore me cilesi të lartë) - probabiliteti i zbatimit të aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me status të veçante (zbatimi i aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me status të veçante mbrojtjeje / konservimi mund të preke në mënyrë të konsiderueshme ato cilesi për të cilat zona është vene nën kete status) - probabiliteti i zbatimit të aktiviteteteve qe lidhen me nderhyrjet infrastrukturore	A - s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk prekin zonat pyjore apo tokën bujqësore, sipas ndarjes aktuale te përdorimit të tokës. B - ndikim i parendesishem: Nese zbatohen dispozitat ligjore, ndikimi mbi përdorimin e qendrueshem të tokës bujqësore dhe pyjeve do të jetë i parendesishem, pavaresisht faktit se aktivitetet do të zbatohen në toka bujqësore me potencial të mire prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirepercaktuar të prodhimit te lendes drusore. C - ndikimi bëhet i parëndesishem për shkak të zbatimit të masave zbutese: Probabiliteti i ndryshimit të strukture aktuale te përdorimit të tokës bujqësore dhe pyjeve është i lartë. Infrastruktura do të shtrihet në toka bujqësore me potencial të mire prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirepercaktuar te prodhimit të lendes drusore. Duhet parashikuar masa zbutese per te reduktuar ndikimin. D - ndikim i rëndësishem: Probabiliteti i ndryshimit të strukture

	aktuale të përdorimit të tokës bujqësore dhe pyjeve është shumë i lartë. Ndikimi mbi përdorimin e qendrueshëm të tokës bujqësore dhe të pyjeve do të jetë i konsiderueshëm. Infrastruktura do të shtrihet në toka bujqësore me potencial të mirë prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirepercaktuar të prodhimit të lëndës drusore. Nuk mund të merren masa zbutese për të reduktuar ndikimin
--	---

• Ajri

Në tabelën me poshtë janë pershkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotesve, për të arritur perputhshmerinë me kufijtë maksimale të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotesve atmosferike.

Indikatori/Kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
- sasia vjetore e emetimeve të ndotesve në ajër, dmth e oksideve të squfurit, oksideve të azotit, lëndes organike volatile pa permbajtje metani, amoniakut dhe grimca të ngurtave PM_{2.5}; PM₁₀ (permiresime të matshme të cilësisë së ajrit duke arritur nivelet e synuara të ndotesve e ajrit në lidhje me shenjetin e njerezve, sipas vlerave respektive: për NO_x - 40 µ/m³, për PM₁₀ - 40 µ/m³, për PM_{2.5} - 25 g/m³ dhe 20 g/m³ dhe SO₂ - 125 µ/m³. - numri vjetor i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes së ajrit me grimca të ngurta, i matur në pikat e monitorimit, të cilat janë të ekspozuara ndaj emetimeve të ndotesve (duhet të reduktohet me 40% numri i diteve kur tejkalohet niveli i ndotjes së ajrit me grimca të ngurta; sa më pak dite me ndotje të lartë të ajrit, aq më i ulët është ndikimi tek shëndeti i njerezve dhe kostoja për shoqërinë, për shkak të numrit relativisht të lartë të	A - s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe grimcat e ngurta), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar. Zbatimi i aktiviteteve do të reduktojë emimet e ndotesve. B - ndikim i parëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe grimca të ngurtat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar, por jo deri në atë masë sa të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në (Strategjia Kombëtare e Zhvillimit) SKZHI-II. C - ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutese: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe grimca të ngurtat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. për të reduktuar emimet duhet të parashikohen dhe zbatohen

njerezve të ekspozuar, shendeti i të cileve preket nga ky faktor)	masa zbutese në mënyrë që niveli maksimal i emetimeve të zbrese në kufijte e parashikuar në SKZHI-II. D – ndikim i rëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktoje emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe grimca të ngurtat), për të cilat janë përcaktuar kufijte maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijte e përcaktuar në SKZHI-II. Nuk mund të merren masa zbutese për të reduktuar nivelin e emetimeve nën kufijte e përcaktuar dhe për të mbajtur ndikimin në nivelin e përcaktuar të ndotjes së ajrit me grimca të ngurta. E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktoje emetime të ndotesve në ajër (përfshirë edhe grimca të ngurtat), për të cilat janë përcaktuar kufijte maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa kufijte e përcaktuar në SKZHI-II do të tejkalohen në mënyrë të konsiderueshme dhe ndotja e ajrit me grimca të ngurta do të jetë në nivel të tillë që do të ketë një efekt të konsiderueshëm dhe të demshëm mbi shëndetin e njerezve. X – vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave
--	--

- **Faktoret klimatike**

Ne tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 4: Adaptimi i infrastruktures në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Indikatori/Kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
-adaptimi i infrastruktures perkatese ndaj ndryshimeve klimatike (aktivitetet që lidhen me ndërtimin / rehabilitimin e infrastruktures perkatese duhet të përfshijnë aktivitete që zvogelojnë apo	A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gjë e tillë s’ka nevojë të garantohet; aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë rritje të emetimeve të gazeve ‘serë’. Zbatimi i aktiviteteve do të reduktojë emetimet e gazeve ‘serë’.

parandalojne pasojat e ndryshimeve klimatike, veçanërisht të permbytjeve, debores dhe ngricave) -sasia vjetore e emetimeve të gazeve 'serë' (sasia maksimale e emetimeve të gazeve 'serë' nuk duhet të tejkalojë sasinë e synuar vjetore prej 18,000 Gg CO₂ ekuivalent në 2020. Ndikimet kumulative të të gjithë aktiviteteve të Planit nuk duhet të shkaktojnë një sasi vjetore nga të gjitha burimet e emetimeve të gazeve 'serë' që të tejkalojë vlerat e synuara që jepen në SKZHI-II lidhur me Reduktimin e Emetimeve të Gazeve 'serë' në 2020.)	B - ndikim i përdësishëm: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gje e tillë s'ka nevojë të garantohet. Emetimeve e gazeve 'serë' do të rriten, por jo deri në atë masë sa të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. C - ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutese: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gje e tillë s'ka nevojë të garantohet. Emetimeve e gazeve 'serë' do të rriten deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. për të reduktuar emetimet duhet të parashikohen dhe zbatohen masa zbutese, të cilat do të garantojnë që niveli i emetimeve nuk do të kalojë kufijtë e parashikuar në SKZHI-II. D - ndikim i rëndësishëm: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gje e tillë s'ka nevojë të garantohet. Emetimeve e gazeve 'serë' do të rriten deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. Nuk mund të merren masa zbutese për të reduktuar nivelin e emetimeve nën kufijtë e përcaktuar. E - ndikim shkatërrues: Aktivitetet e parashikuara nuk garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo zbatimi i aktiviteteve do të rritë emetimet e gazeve 'serë' deri në atë masë sa kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II do të tejkalohen në mënyrë të konsiderueshme. X - vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
---	---

• Uji

Ne tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqesore, ujërat e njelmet, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.

Indikatori/Kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
---------------------------------	----------------------

- mundesi nderhyrjeje në zonat me burime ujore të mbrojtura (zbatimi i aktiviteteve jashte zonave me burime ujore do të thote me pak mundesi për ndotjen e ujit nëntokesor që përdoret si burim furnizimi me uje) - mundesi nderhyrjeje në zonat me burime ujore për larje (zbatimi i aktiviteteve në zonat me burime ujore për larje do të thote me shumë mundesi për ndotjen e ujerave që përdoren për larje) - mundesi nderhyrjeje në zonat me rrezik permbytjeje (zbatimi i aktiviteteve në zonat me rrezik permbytjeje redukton zonat mbrojtese dhe rrit mundesine për deme nga permbytjet) - mundesi nderhyrjeje në zonat ujembajtese me një nivel të lartë të prekshmerise (zbatimi i aktiviteteve në zonat ujembajtese me një nivel të lartë të prekshmerise do të thote me shumë mundesi për ndotjen e ujerave nëntokesore)	A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet nuk do të ushtrojne trysni shtese mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqesore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm, apo ndikimi do të jetë pozitiv. B – ndikim i parendesishem: Nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqesore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm do të jetë i parendesishem, pavaresisht faktit se aktivitetet mund të zbatohen në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujembajtese me një nivel të lartë të prekshmerise, në zona me burime ujore për larje apo në zona me rrezik permbytjeje. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutese: Megjithë zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqesore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm mund të jetë e madhe, sidomos për shkak se probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujembajtese me një nivel të lartë të prekshmerise, në zona me burime ujore për larje apo në zona me rrezik permbytjeje, është i lartë. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutese për të reduktuar ndikimin. D – ndikim i rëndësishem: Megjithë zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqesore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm do të jetë e madhe, sidomos për shkak se probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujembajtëse me një nivel të lartë të prekshmerise, në zona me burime ujore për larje apo në zona me rrezik permbytjeje, është shumë i lartë. Nuk mund të merren masa zbutese për të reduktuar ndikimin. E – ndikim shkaterrues: Megjithë zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujërat nëntokesore dhe sipërfaqesore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm do të jetë jashtezakonisht e madhe, sidomos për shkak se probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujembajtese me një nivel të lartë të prekshmerise, në zona me
--	--

	burime ujore për larje apo në zona me rrezik permbytjeje, është shumë i lartë. Mitigation Nuk mund të merren masa zbutese për të reduktuar ndikimin. X - vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës se të dhënave.
--	--

• **Mjedisi natyror**

Ne tabelen me poshte janë pershkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes se biodiversitetit.

Indikatori/Kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
- mundësia e nderhyrjes në zonat qendrore të habitateve të mishngrenesve të medhenj (zbatimi i aktiviteteteve që lidhen me nderhyrjet infrastrukturore në zonat e rëndësishme ekologjike të habitateve të mishngrenesve të medhenj do të sjelle një tryzni me të madhe mbi keta lloje dhe do të nderprese linjat e migrimit; ka mundësi potenciale për ndikim tek biodiversiteti në nivel rajonal dhe nderkufitar) - mundësia e nderhyrjes në zonat me pyje të dendura (planifikimi i infrastruktures se re në zona me pyje të dendura do të sjelle ndikime negative mbi kafshet e egra dhe do të nderprese linjat e migrimit; ka mundësi potenciale për ndikim tek biodiversiteti në nivel lokal dhe rajonal)	A - s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Nuk do të këtë ndikim në kohezionin e popullatave dhe në mbrojtjen e biodiversitetit, apo ndikimi do të jetë pozitiv. B - ndikim i parendësishem: Nese zbatohen dispozitat perkatese ligjore, ndikimi në kohezionin e popullatave dhe në mbrojtjen e biodiversitetit do të jetë i parëndësishëm. C - ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutese: Megjithë zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund të garantohet kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimet e rëndësishme. D - ndikim i rëndësishem: Megjithë zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund të garantohet kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Nuk është e mundur të merren masa zbutese për të reduktuar ndikimin. E - ndikim shkaterrues: Megjithë zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi mbi kohezionin e popullatave dhe mbrojtjen e biodiversitetit është shkaterrues. Nuk është e mundur të merren masa zbutese për të reduktuar ndikimin. X - vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës se të dhënave.

Ne tabelen me poshte janë pershkruar kriteret e vlerësimit dhe metodologjia për OM 7: Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Indikatori/Kriteri i vlerësimit	Shkalla e vlerësimit
